

The background of the entire cover is a dark, deep blue or purple, speckled with small white stars, suggesting a cosmic or night sky theme. In the center, there is a glowing, ethereal figure. The figure has a human-like face and torso, but instead of two arms, it has multiple arms extending outwards in various directions. The figure is surrounded by a bright, golden-yellow light that radiates outwards, creating a halo effect. The figure's body appears to be made of or composed of this light. The overall effect is one of divine or supernatural power.

Salih Basha

HIPNOZË

**PËRVOJA TË NDRYSHME
&
SHEMBUJ PRAKTIKË**

Salih Basha

**HIPNOZË
PËRVOJA TË NDRYSHME & SHEMBUJ PRAKTIKË**

www.dijahyjnore.ch

www.sa-kra.ch

www.syri3.com

Redakturën, lekturën dhe korrekturën
Hasan HAMËZBALAJ

Recensent
Daut DEMAKU
Sabir KRASNIQI

Salih Basha

HIPNOZË

PËRVOJA TË NDRYSHME & SHEMBUJ PRAKTIKË

St. Gallen 2002

PARATHËNIE

*“Lutja është lidhje direkte në mes Zotit dhe të të
përkushtuarit.”*

*“Dije se çdo gjë po ndodh për të mirën tënde.”
“Çdo vuajtje, çdo dhimbje, çdo fatkeqësi ju formon
dalngadalë në fytyrë të Zotit.”*

(Satyananda Paramhansa)

LEXUES TË DASHUR!

Në këtë libër që e kam shkruar për ju, të cilët keni hyrë në rrugën e zhvillimit shpirtëror, mund të lexoni dhe të përvetësoni shumë përvoja të mia nga lëmi i hipnozës (shërimin me të), nga lëmi i zbulimit të magjisë së zezë (shërimin e tyre) - thjesht: përvoja okulte dhe mistike të larta. Ka shumë gjëra të cilat, si çdo mistik, nuk kam guxuar t'i jap për publikim, se ato mbesin fshehtësi shpirtërore dhe nuk i jepen çdokujt. Ju që jeni në këtë rrugë, ju e kuptoni saktë, kurse ju që do ta arrini këtë zhvillim të lartë, do ta kuptoni më vonë. Ky libër, edhe pse është vetëm një pikë dije ndaj asaj që në realitet ekziston në ne dhe jashtë nesh, besoj se do të jetë një pikë nxitëse për zhvillimin tuaj më të lartë. Ky libër është i kuptueshëm për ata njerëz që janë të etshëm për dije jo të zakonshme, që kanë sëpaku pak njohuri për parapsikologji, magji, okultizëm dhe mistikë. Por për ata njerëz që janë plotësisht materialista dhe fare nuk besojnë në okulten, në të padukshmen, për ta mund të jetë e pakuptimtë dhe e papranueshme, edhe pse të gjitha ato që thuhet janë krejtësisht të vëtrëta dhe drejtpërdrejt nga përvojat e mia dhe të rrethit apo të miqve me të cilët kam jetuar, si dhe të ndonjë autori të shquar botëror. Këta njerëz le ta dinë se truri i njeriut nuk është shfrytëzuar as 10%, kurse dija e shpirtit tonë është

e pakufishme dhe me realizimin e së Vërtetës, me zgjimin e Zotit në ne, jo vetëm që do t'i dinim të gjitha gjërat në tokë, por ne do të gjenim dhe njihnim dijen e tërë universit, të çdo dimensionit që ekziston.

Në këtë libër kam paraqitur fotografi origjinale të punës sime, si dhe fotografi të tjera fantastike, qoftë të miat, që i kam pikturuar vetë, qoftë të autorëve të tjerë. Kam dhënë fjalë të urta, të miat origjinale, dhe të mistikëve botëror, si dhe të Resulullah (Avatar) Meher Babës. Në fund e kam dhënë edhe fjalorin e fjalëve të huaja dhe të panjohura, ashtu edhe të emrave me rëndësi, ku besoj se edhe kjo do t'ju ndihmoj për ta kuptuar më mirë këtë libër.

Ja çka thotë Resulullah (Avatar) Meher Baba në librin e tij **“Zoti flet”** për ata njerëz të cilët merren me artin e hipnozës dhe me përdorimin e saj për të mirën e njeriut:

“Në qoftë se dikush i shfrytëzon fuqitë e ulëta okulte për qëllime të mira, ai i arrin fuqitë e larta okulte në jetën e ardhshme, pa përdorimin e ushtrimeve intensive tantrike. Ngjashëm me këtë, ai i cili e përdor talentin e vet në hipnozë për qëllime të mira e arrin llojin e lartë të fuqive okulte në jetën tjetër të ardhshme.”

Autori
St.Gallë -Zvicër, dhjetor 2001

FJALA RECENSENTIT

Në cilësinë e recensentit të librit të Salih Bashës „*Hipnozë: Përvoja të ndryshme, shembuj praktikë*“ kam një drojë se nuk mund të jem sa duhet dhe sa e kërkon kjo punë – vlerësues objektiv.

Sepse gjallim imi i përhershëm ka qenë dhe mbetet i zbatimit praktik të dijes teorike. Ky gjallim imi përputhet plotësisht me atë thënien e Gëtes, kur nënvizon: „Mendja e fuqishme që bën zbatimin praktik të dijes teorike është mendja më e mirë në botë.“

Prandaj, kur flas për këtë libër të Salih Bashës, që është i mbushur me aq shumë shembuj praktikë dhe me aq përvoja të ndryshme të ambientit shqiptar, me personazhe dhe me emra e mbiemra, patjetër më duhet ta përgëzoj autorin që ia dhuron lexuesit shqiptar një libër kaq të çmueshëm me vlera të larta.

Autori ka punuar me përkushtim dhe dashuri të rrallë. Por është udhëhequr edhe nga një dije solide e këtij lëmi.

Prandaj, urimet e mia dhe faleminderës për këtë libër-dhuratë!

Daut Demaku

NË VEND TË PARATHËNIES

Parapsikologjija, edhe pse një ndër lëmenjt më të vjetër në historinë e njerzimit, mjerisht, në hierrarkinë e shkencës empirike, ende nuk radhitet në vendin që meriton. Megjithatë, paraqitja e fenomeneve të ndryshme enigmatike, lë hapsirë që pushteti i sajë të ndjehet gjithkund, bile edhe më tekë skeptiket ! Hipnoza është njëra ndër degët e shumta në lëmitë e parapsikologjisë, e cila është edhe si urë lidhëse mes shkencës empirike (hipnoza njihet edhe si degë shkencore) edhe asajë alternative, si edhe një ndër fenomenet më bindëse për ekzistimin e veprimeve dhe ndikimit të sferës mistike. Dhe, pikrisht, ky libër që keni në duar, i autorit S.Basha, shpalosë në mënyrë transparente vetitë e përgjithshme të pushtetit të hipnozës, të pushtetit të forcës së dijes, pra, të pushtetit të parapsikologjisë, në vetë qenjen-njeri, si dhe rrethin në përgjithësi.

Libri në fjalë, është edhe një thesar shumë i çmuar në pasurinë e vogël që posedon literatura shqipe në këtë lëmë, por njëkohsisht edhe libër, që do të jetë frymzues për shumë autor të rinj ; libër që do t'i ngjallë shpresat e shumë të pashpresëve ; libër që do t'ua ngritë besimin atyre që e kanë humbur...Autori S.Basha është munduar që në mënyrë kronologjike ta paraqes përvojën e vet shumëvjeqare, që ke arritur përmes formave të ndryshme, si teke ne në Kosovë, ashtu edhe në përfundim (ku qe disa vite edhe gjendet me qëndrim). Për mes rasteve konkrete, autori sqaron në hollësi hapat e parë të tij në këtë lëmë deri tek sukseset e shumta që ka arritur në sherimin e shumë sëmundjeve për të cilat mjeksija aktuale është treguar e pa suksesshme, gjë që vërtetojnë vetë pacientet e sheruar. Është shumë e rëndësishme të cekët, se të gjitha rastet janë rastet autoktone e jo të marrura si shembuj nga autorët e huaj, që i hasim te shumë libra tjerë. Pra janë raste konkrete, si ato

eksperimentale, ashtu edhe ato me efekt mjekues, edhe me informacione të mjaftueshme, si për vendin edhe kohën e procesit, gjithashtu edhe për vetë indentitetin e pjesëmarrësve, gjë që ia ngritë madhështinë e këtij libri. Gjithashtu, autori S.Basha, është përpjekur që gjatë shkrimit të këtij libri ta përdorë një gjuhë sa më burimore, që të jetë sa më e kapshme për secilin, duke mos harruar që në fund të librit të jep edhe një fjalorth të fjalëve të huaja për ta zbërthyer sa më mirë kuptimin e secilit term që përdorët në brendi të këtij libri.

Edhe pse titulli i librit lë të kuptohet se kemi të bëjmë me lëminë e hipnozës nga përvoja e vet autorit edhe nga shembujt praktik që i ka aplikuar ai, në lexim e sipër, lexuesit i afrohet mundësija që të pasurohet edhe me njohuri të shumta të misticizmit në përgjithësi, të cilat autori i sqaron me një sens të posaqëm në rastet e duhura, për të cilat lexuesi do të bindet vet.

Pasi që autori, S.Basha, posedon njohuri të thella në lëminë e parapsikologjisë (që e vërtetojnë edhe mirënjohjet, certifikatat e diplomat e shumta që i ka nga shumë institucione europiane), njohuri të cilat i ka brumosur me eksperiencë të gjatë praktike, shpresojmë se në të ardhmen do t'i përkushtohet edhe më shumë penës dhe do ti pasuroi bibliotekat tona me njohuri të reja të parapsikologjisë që konsiderohen shumë të rëndësishme, si për individin në veçanti, ashtu edhe për shoqërinë në përgjithësi, si dhe do t'u kontribuojë institucioneve të ardhshme përkatëse të këtij lëmi, që shpresojmë se së shpejti do t'i kemi edhe ne shqiptarët.

Kreuzlingen 2002
Sabir Krasniqi

DY FJALË PËR LIBRIN

Bashkudhëtarë të nderuar në rrugën e njohjes, ju që keni etje ta njihni realitetin në sa më shumë përmasa, pa paragjykim, me shpirt të hapur e me dashuri të çiltër njerëzore - në dorë keni, padyshim, librin më interesant të këtij lloji nga të gjithë ata që deri më tani u botuan në gjuhën shqipe, qoftë si libra autoriale burimorë, qoftë si përkthime nga autorë të huaj.

Libri i *Salih Bashës* „**Hipnozë. Përvoja të ndryshme. Shembuj praktikë**“ është një udhërrëfyes i mrekullueshëm për botën e madhe të dukurive mistike e parapsikologjike, i cili me një qartësi e thjeshtësi të veçantë ofron shpjegime (bazuar kryesisht në përvojat e drejtpërdrejta të autorit) për fenomenet e nduarndurta që qëndrojnë në kufijtë e së panjohurës e që lidhen me „zonën e muzgët“ të së ndërdijshmes sonë, aty ku çasja e vetëdijshme rëndom është në prag të së (pa)mundurës. Autori me një guxim të veçantë prezanton përvoja mistike nga më interesantet, që vijnë si rezultat i një periudhe të gjatë (më se 20 vjeçare) hulumtimesh me vetveten dhe me të tjerët.

Një libër i mrekullueshëm që meriton vëmendje të veçantë.

Prizren, maj 2003
Hasan HAMËZBALAJ

ZBULIMI I UJËRAVE NËNTOKËSORË, I VENDEVE POZITIVE DHE NEGATIVE ME ANTENAT “L”, ME LAVJERRËS DHE AUTOHIPNOZË

“Kur të shohësh një njeri të mirë, mundohu të tejkalosh shembullin e tij, kur të shohësh ndonjë njeri të keq, kthehu e hulumtoje veten mos i ke edhe ti të njëjtat të meta.”
(Konfuçi)



Ekzaminimi i energjive negative mbi hart në largësi.

(fotografoi: Salih Basha)

Gjatë punës fillestare në zhvillimin shpirtëror, interesim kryesor imi thuaja se ka qenë zbulimi i ujërave nëntokësorë dhe i kanaleve të padukshme për syrin e njeriut, zbulimi i energjive pozitive e negative si dhe i vendeve pozitive tokësore, i bjeshkëve që kanë fuqi të mëdha dhe i

energjiive pozitive të atyre bjeshkëve. Interesim të madh, në fillim, tek unë zgjonte një lëmë i parapsikologjisë, ashtuquajtur *radiestezia*. Radiestezia merret me zbulimin e rrezatimeve të padukshme statike, sidomos ato që vijnë nga ujërat lëvizës nëntokësorë, nga mineralet, energjitë statike teknike, kosmike etj. Gjithashtu merret me zbulimin e vendeve negative dhe pozitive, si në banesë ashtu dhe jashtë saj, pa marrë parasysh ku ato gjenden. Këtu nuk e kam për qëllim të shpjegoj çdo send për radiestezinë, po vetëm për përvojat e mia, sepse radiestezia është lëmë e gjerë më vete.

Vëllai, Njaziu, pasi që kreu shkollën e mesme për teknik laboratorik të biologjisë, vendosi që të shkojë në Fakultet të Pylltarisë në Sarajevë. Ky lëmë e tërhiqte mjaft, se e donte natyrën dhe punën në natyrë. Njaziu, në një rast, kishte rënë në kontakt me një libër të një radiestezisti kroat, Stanko Jordan. Dhe, kur Njaziu erdhi në pushim, ma solli atë libër. Kur e lexova, u fascinova me këtë lloj dije, për mua, ende të panjohur. Ky autor kishte bërë shumë hulumtime në lëmin e radiestezisë, si në zbulimin e ujërave nëntokësorë, të vendeve të papërshtatshme për banim, kishte hulumtuar shtëpitë e nemura kanceroze, rrezet statike elektronike si dhe kishte bërë hulumtimin e ndikimit negativ të tyre në shëndetin e njeriut.

Unë fillova ta studioj këtë dhe të bëj në praktikë, vetë, zbulimin e këtyre rrezatimeve të ujërave nëntokësorë, fillova punën me lavjerrës, me antenat “L”, me letra dhe numra e rrathë të ndryshëm, mirëpo në fillim edhe pse nuk kisha mjaft mjete gjindesha me gjëra të thjeshta që i bëja vetë për të hulumtuar dhe për të mos u ndalur në studimet e këtij lloji.

Një herë isha në Prishtinë dhe rastësisht u njoha me një person nga Gjakova, me zotëri D., i cili e kishte sjellur gruan e vet për shërim në spitalin e Prishtinës. Atë javë isha i fascinuar me librin e radiestezisë së atij kroati dhe disi

spontanisht e fillova bisedën, si duke i bërë pyetje z. D., edhe pse nuk e dija në e kuptonte ai këtë lëmë. Fillova të flas për antenat “L” dhe për ujërat nëntokësorë. Zotriu D. filloi dhe ky të flasë për këto rrezatime dhe për ujërat, të cilët rrjedhin thellë nën tokë, që nuk shihen me syrin e njeriut. Unë edhe me këtë person u befasova dhe e pyetja veten: Si zotriu D. aq mirë i njihte këto rrezatime të padukshme nëntokësore? Ku i kishte mësuar ky këto? Si unë ende nuk kisha dëgjuar për to? Zotriu D. filloi të flasë për punën që e bënte në Gjakovë, sesi ai i kishte bërë vetë antenat “L” prej bakrit dhe me to i zbulonte ujërat nëntokësorë nëpër fshatra, si fshatarët shpesh e thirrnin në ndihmë që t’ua përcaktonte vendin për bunarë dhe ujë të pijes etj. Njëherit, tregoi sesi në një organizatë ku punonte duhej shpesh nëpër rrugë të çilnin me buldozher kanale, ku shpesh ndodhte të hasnin në tela të rrymës, në tela telefoni apo në gypa të ujit dhe, me ato antena, pa problem, zotriu D. po i zbulonte ato, duke mos shkaktuar kështu dëme materiale, të cilat organizata, më vonë, duhej t’i kompensonte. Unë u gëzova mjaft kur e takova një njeri i cili po i njihte këto gjëra.

Në fshatin Vraniq, ku banonte babai, Azemi, e kishim shtëpinë në fshat dhe nja shtatë hektarë tokë mbi fshat, në bjeshkë. Kisha dëshirë që në fshat dhe në bjeshkë të gjeja ujëra nëntokësorë që më vonë të mund t’i shfrytëzonim për ujitjen e tokës. E luta z. D. që, kur një ditë të kishte kohë, të vinte tek ne për zbulimin e ujërave nëntokësorë. Zotëria D. pranoi që të vinte një të shtunë, ku unë do ta prisja në Suharekë, në stacion të autobusëve, kah ora 8 e mëngjesit. Këtë ditë u takuam me zotërinë D., i cili më tregoi shumë gjëra për këtë lëmë, si e kishte bërë zbulimin e ujërave, si punohet saktë me tela apo antenat “L”. Pas një pauze në fshat, zotëria D. nxori telat e bakrit të lakuar si germa “L” dhe filloi menjëher punën. Lëvizte ngadalë e me kujdes nëpër oborr, duke mbajtur në duar dy telat, lehtë, pa i

shtrënguar shumë. Shihej se telat nuk po i lëvizte dora e tij, po një rrymë krejtësisht tjetër, jashtë trupit fizik. Kur shkoi në një vend, në mes të oborrit, filluan telat të bashkoheshin në mes veti. Tërheqja zgjati në ecjen prej nja një metër e gjysmë dhe prapë telat u kthyen në vendin e vet. Shkoi edhe më poshtë, dhe aty, në një vend, në drejtim të njëjtë, si më lart, filluan që t'i bashkoheshin telat. Në këtë moment zotëria D. tha se në këtë vend ka ujë nëntokësor, i cili po vinte prej bjeshkës dhe lirisht, tha, këtu mund të çilni bunar. Nuk qenka shumë thellë dhe paska mjaft ujë në këtë damar. Edhe në dy vende gjeti ujë nëntokësor, por në ato vende kishte më pak.

Zotërinë D. e luta që të më mësonte sesi t'i mbaja telat në duart e mia dhe pas pak fillova sikur zotëria D. që të lëvizja nëpër oborr, ku edhe ai vetë kishte kaluar më parë, për të parë se a do të punonin edhe me mua telat apo jo. Po nuk i besoi vetes dhe kësaj pune, njeriu mund të bllokojë energjinë në vete dhe telat fare tek ai nuk punojnë. Mosbesimi e bllokoi energjinë e padukshme që të mos qarkullojë deri te telat që ti mban në duar. Duke ecur nëpër oborr, në të njëjtin vend, një forcë e padukshme filloi që të m'i ofronte telat e bakrit në mes veti. Dukej se një magnet po i tërhiqte telat. Në atë rast e bëra një provë, ku fillova t'i shtrëngoja pak telat me duar e mos t'i lëja të lëviznin. Zotëria D. më tha të mos i shtrëngoj duart, se nuk lejohet qarkullimi i energjisë. Unë i thash se jam duke bërë provë, në është vërtet energjia ajo që po m'i bashkon telat apo është besimi i im. Unë e pashë se me të vërtetë ishte një forcë jashtë meje që i tërhiqte telat në duart e mia dhe i bashkonte në mes veti. Ajo forcë tërheqëse e padukshme vazhdoi derisa isha në atë fushë ku uji rridhte thellë nën tokë dhe i cili vinte prej lart e shkonte teposhtë kah fusha e fshatit. Posa e kaloja atë fushë, telat ktheheshin në vend të vet dhe qëndronin paralel. Dallimi në mes të tërheqjes

magnetike të rrymës nëntokësore dhe vendit neutral, ku nuk kishte rrymë të padukshme lëvizëse, ishte i dukshëm dhe real.

Sot vendosëm që të ngjiteshim lart në bjeshkë. Na panë disa fshatarë dhe na lutën që të shkonim në oborrin e tyre e të lypnim vendin ku ka ujë nëntokësor, se donin të çilnin bunar. Në dy vende kishin gërmuar e uji nuk u kishte dalur. Zotëria D. me tela u gjeti një burim të madh nëntokësor dhe fshatari ynë u gëzua, meqë çelja e bunarit kot i kushtonte para. U nisëm nëpër fshat, unë duke i mbajtur telat dhe kohë pas kohe hulumtoja ujëra. Ishte interesant një rast në rrugën e cila çonte në fshatin Mushtisht. Ishte uji i lumit të madh të Vraniqit i cili vinte nëpër vijën për vaditjen e fushës dhe duhej të kalonte nëpër një gyp të gjerë për ta këputur asfaltin nën tokë, për të dalur në anë tjetër të rrugës. Aty shihej qartë se kishte ujë nën tokë, i cili po dilte në anën tjetër të rrugës. Unë e provova si do të reagonin telat mbi atë ujë që ishte në gypa, i mbuluar sipri, dhe po hynte në një anë e po dilte në anën tjetër. Telat reagonin njëjtë, veç me një fuqi më të madhe, ku bënë rreth, dhe fuqia tërheqëse ishte dhënë e madhe. Këtu mbeta i befasuar, meqë saktësisht shihej forca lëvizëse e ujit nëntokësor. Telat në atë fushë të fuqishme nuk ndaleshin duke u rrotulluar derisa e kaloja fushën e padukshme të rrymës së ujit. Deri në bjeshkë zbulova shumë ujëra nëntokësorë. Fshati Vraniq ishte i pasur me ujëra nëntokësorë të intensiteteve të ndryshme.

Pas një kohe erdha në kontakt me literaturë të radiestezisë dhe të bioenergjisë të një autori nga Bosna i ashtuqujtur Osman Hasanpashiq, i cili merrej në mënyrë profesionale me bioenergji, duke i shëruar njerëzit, dhe me radiestezi, ku bënte hulumtimin e vendeve “të sëmura” (të dëmshme) në banesë, si dhe vende të tjera. Tregonte rëndësinë e radiestezisë për hulumtimin e energjive negative në banesë. Gjithashtu tregonte një hulumtim si të them privat dhe shkencor, që e kishte bërë në një spital të Sarajevës, ku i

kishte hulumtuar 265 pacientë, të cilët kishin qenë me sëmundje të ndryshme. Çdo pacienti ia kishte hulumtuar sëmundjen me lavjerrës dhe kishte shkuar në shtëpinë apo në banesën e tyre dhe kishte hulumtuar vendet ku kishin fjetur e banuar. Gjatë punës hulumtuese me vete gjithnjë e kishte pasur një mjek të praktikës së përgjithshme, një motër medicinale dhe një teknik medicinal. Prej 265 pacientëve, ka rezultuar se vetëm 5 pacientë kanë qenë të sëmurë prej shkaqesh të ndryshme të panjohura, kurse 260 pacientë, me sëmundje të ndryshme, kishin qenë të sëmurë prej rrezatimeve të dëmshme statike në vendbanimet e tyre, ku kishin kaluar pjesën më të gjatë të jetës e ku kishin pasur fatin të jetojnë mbi ato energji të padukshme e të rrezikshme për jetë. Këto rrezatime të dëmshme kishin buruar prej ujërave nëntoksorë, prej mineraleve nëntokësore, prej mjeteve teknike dhe elektronike, prej rrezeve të dëmshme kosmike etj. Me ndërrimin e vendit të fjetjes, krevatit, apo dhomës, dhe me bllokimin e atyre rrezatimeve, përmirësimi i pacientëve është bërë i dukshëm dhe i shpejtë. Mirëpo, çka ka qenë kryesorja, edhe në spital është bërë izolimi i atyre energjive dhe ndërrimi i vendqëndrimit, sepse shumë pacientë prej vendeve të sëmura në banesë, kur shkojnë në spital, iu qëllon fati që edhe atje të ndodhen në vendet me rrezatime negative, ku përmirësimi i tyre është i pamundur.

Puna me lavjerrës ishte interesante, sepse fillimisht zbulova shumë gjëra. Për të punuar lavjerrësi si duhet, ti duhet të besosh në të fuqishëm dhe, së pari, duhet të dish saktë e pa dyshim ta pyesësh se në cilën anë, kur të sillet lavjerrësi, ta tregon Po-në e në cilën anë ta tregon Jo-në. Kur të bësh pyetje, rri i qetë, neutral, pa menduar as dyshuar, se, pas pak, lavjerrësi do të fillojë të rrotullohet në njërën anë, e cila për ty është po ose jo, dhe me këtë anë që lavjerrësi tregon, ti e di përgjigjen që ta jep ndërdija (nëpërmjet lëvizjes së lavjerrësit).

Në fillim kam punuar vetë, por më vonë kam filluar të punoj me një shok, profesor i shkollës së mesme, (B.K.), i cili kishte në trupin e tij një sasi të madhe të bioenergjisë, kurse lavjerrësi te ai punonte me një saktësi të plotëfuqishme. Shpeshherë provokoheshim në mes veti. Ndonjëherë më thirrte në telefon e më thoshte se kisha mysafirë, sa vetë kisha në dhomë etj. Unë merrja një fletë, i shkruaja 10 numra me rend, që simbolizonin mysafirët te profesori, dhe, një gisht e mbaja mbi numrin 10 dhe e pyesja lavjerrësin: A i ka profesori 10 vetë? Lavjerrësi thoshte: jo. Pastaj, kaloja në numrin 9, e kështu deri sa e gjeja saktë sa veta i kishte profesori në banesë. Pra, lavjerrësi më tha po kur erdha te numri 1. Këtë ditë e thirra në telefon profesorin dhe i thashë se vetem një mysafir e kishte sot. Profesori qeshi dhe tha: saktë, ia ke qëlluar. Ashtu, gjithnjë saktë, profesori e dinte se sa mysafirë ose sa persona ishin te unë në banesë.

Njëherë i pati ndodhur kështu profesorit: Kishte shkuar te një shok i veti, aty ku banonte (në Prizren) për ta vizituar. Kur shkon, sheh se në atë familje ishte një heshtje me pikëllim. Profesori e pyet shokun se çka kishte ndodhur tek ta. Shoku i thotë se u kishte vdekur një djalë i vogël, dymuajsh, pa pasur asgjë. Profesorit i kujtohet dhe pyet se ku kishte fjetur fëmija dhe ku kishte ndejur kohën më të gjatë para se të vdiste. Shoku ia tregon profesorit një vend në dhomë të pritjes, ku fëmija gjithnjë kishte qëndruar dhe në atë vend gjithnjë kishte qarë, duke mos e ditur ata se çka kishte fëmija që po qante. Profesori kërkon nga shoku i vet që t'ia gjente një lavjerrës, se donte diçka të hulumtonte në dhomë. Natyrisht se befasohet shoku i tij dhe thotë: E kam veç një lavjerrës të metaltë të muratorëve, të cilët e kanë harruar këtu te unë kur ma kanë ndërtuar shtëpinë. Profesori ia kërkon atë lavjerrës të madh, të cilin e merr në dorën e djathtë, kurse dorën e majtë e shtrin përpara, duke ecur ngadalë, dhe fillon të hulumtojë nëpër atë dhomë. Duke iu ofruar atij vendi, ku

kishte qëndruar fëmija para vdekjes, lavjerrësi zë t'i silllet me një shpejtësi të madhe në rreth. Kur profesori i afrohet qendrës, një rrymë e fuqishme kalon nëpër lavjerrës, nëpërmjet dorës e në majë të kokës, fuqi, e cila gati ia merr vetëdijen dhe për pak profesorit e t'i binte të fikët nga ajo fuqi e padukshme, e cila i ishte dukur sikur do t'ia pëlçiste majën e kokës. Kur largohet profesori nga ai vend, e prek kokën me dorë dhe ajo pak i ishte çarë, ku i kishte dalur një pikë gjak në majë të kokës, kurse shoku i vet i befusuar pa masë, e pyet se a ishte çdo gjë në rregull dhe si ishte e mundur një gjë e tillë. Profesori e pyet shokun se çka ka përfundimi kësaj dhome. Shoku i thotë se nuk ka asgjë “veç kanali i ujërave nëntokësore të qytetit kalon nën ne”. Profesori i tregon shokut të vet për rrezikun e atij kanali që po i sillte kësaj shtëpie dhe u thotë se “për këtë arsye është e mundur që t'ju ketë vdekur fëmija, nga rrezatimet e atij kanali të ujit nën shtëpinë tuaj.”

Unë atë ditë shkova te profesori, i cili ma tregoi rastin si i kishte ndodhur dhe kokën ku i kishte plasur pak gjaku; tash vetem një dregëz i kishte mbetur nga gjaku i tharë. Më vonë kam lexuar se disa radiestezistë e kanë humbur jetën, janë sëmurë, ose më kurrë nuk kanë punuar me radiestezi nga frika e atyre sulmeve të fuqishme nga rrezatimet statike nëntokësore.

Mënyra më efikase dhe më e sigurt, njëherit e parrezikshme, për të punuar me radiestezi është puna me harta të terrenit. Punohet me lavjerrës, mbi hartën e atij terreni të cilit duhet bërë ekzaminimi, në largësi nga vendi konkret. Pra, në një vend të sigurt, neutral, në dhomën tënde.

Më vonë, kam mësuar se *ndërdija* i di dhe i sheh të gjitha rrezatimet e padukshme, si të ujërave nëntokësore, ashtu rrezatimet teknike, duke filluar prej frigoriferëve, TV-së, radios, orëve elektrike të tavolinës, rrymave kosmike dhe energjive shumë të holla të magjisë së zezë. *Ndërdija* i sheh

edhe vendet neutrale dhe pozitive. Mënyra më efikase e zbulimit të këtyre rrezeve është *qartëpamësia* ose *autotransi*, ku me autohipnozë (nëse personi është i ushtruar në këtë drejtim të punojë me autohipnozë) i sheh ato rreze të çfarëdo lloji, i vlerëson dhe di çka të bëjë, si të mbrohet prej tyre etj. Rrezatimet e frigoriferit janë aq të dëmshme, sa njeriu vështirë mund ta paramendojë dhe ta kuptojë atë. Në fillim, kur kam rënë vetë në autotrans, nuk kam ditur fare se çka janë ato rreze dhe as si të mbrohem prej tyre. Njëherë rashë në autotrans në banesën time, ku ushtroja në një kuzhinë të vogël që kisha. Papritmas, në fillim zëri i brendshëm më tha se tash ka për të punuar frigoriferi, ku pas disa sekondash vërtet u lëshua në funksion. Në atë moment filloi një ndjenjë tepër e keqe të zhvillohej në mua, ku më dukej se një makinë dhjetëtonëshe po ma shtypte trupin dhe shpirtin tim. Ato rrezatime, tash të dukshme, më shponin dhe më depërtonin nëpër aurë, më bënë dëm të papërshtatshëm. E pashë se ishte një gjë tepër e keqe për trupin tonë nëse ne rrimë intenzivisht në një energji negative të atillë.

Një natë desha të vërtetoja se a kishte në banesën time rrezatime negative, respektivisht në vendin tim, ku flija. Vendosa t'i zbuloj dhe t'i shoh shumë gjëra sesi duken në anën tjetër të realitetit, jo vetëm në dhomën time, po edhe në shumë rrethana dhe vende të tjera.

U zgjova në autotrans, ku e pashë, në anën tjetër, dhomën ku flija. Ishte interesant: Shihja trupin tim duke fjetur i cili thua se ishte shtangur. Shikova kah toka, ku kisha mundësi shumë thellë të shikoja, por duhej përcaktuar se çka të shikoja nën tokë. Në tokë, thellë, kalonte një damar i ujit, i cili lëvizte si poshtë - lart dhe si lart- poshtë, por e kishte një drejtim ku shkonte, dhe e kishte dritën disi si të arit, e cila ngjitej përpjetë, pa kufij, me një fuqi të padukshme. Dukej sikur do ta prente trupin, po të hyje në atë energji, e cila prente krevatin përgjysmë dhe vazhdonte më tutje. Kjo

energji e gjallë, e kishte gjerësinë e kufizuar, afërsisht 60 cm. diametrin. Televizori, kur ishte fikur, lëshonte rreze në distancën përafërsisht 2 metra, kurse kur punonte ishte mjaft i rrezikshëm për shëndetin e njeriut dhe rrezatonte mbi 6 metra largësi prej televizorit. Nëse njeriu qëndronte brenda kësaj energjije të dëmshme, ai ishte i bombarduar nga këto rreze të padukshme, ku njeriu për disa orë mbushej plot me këso rreze dhe fillonte një nervozë e siklet i papërshkrueshëm te njeriu. Prej ekranit dilnin rreze të fuqishme, si elektrike – statike, ashtu dhe valë mentale me fotografi dhe sugjestionë të padëshirueshme e shpeshherë edhe urdhëra të padukshëm për syrin dhe veshin e njeriut, ku dikush me qëllim e bënte këtë, qoftë për shitjen e mallit të caktuar, për qëllime politike etj. Njeriun, rrezet e padukshme e shponin tejepërtej dhe asgjë nuk i ndalte ato. Kjo energji kalonte nëpër trupin fizik, por edhe nëpër objekte të tjera. Trupat energjitikë e merrnin këtë energji me lloj - lloj mendimesh negative (e pozitive fare rrallë herë). Kjo energji negative dukej si një frymë shpuese, të cilën thuaja nuk e ndalte asgjë.

Ishte shumë interesant me trupin tim. Unë kisha në gisht një unazë, të cilën e kisha bërë vetë për mbrojtje kundër energjive negative, si psikike, magjike e të tjera. Kjo unazë quhej “Atlanta”. Rreth meje ishte formuar një mbrojtje, rreth trupit tim fizik dhe astral. Unë dukeshin sikur kam hyrë në një sferë prej qelqi. Ishte shumë interesant kur vinin rrezet e këqija: ato refuzoheshin, shkitnin në mbrojtjen time; po edhe më ineresant ishin disa mendime të këqija, kur vinin e i binin asaj sferë mbrojtëse dhe ktheheshin dikah. Ishte edhe më interesant, kur i shikoja fëmijët duke fjetur, kur e kishin astralin në trup dhe donin të rrotulloheshin, së pari rrotullohej trupi eterik e pastaj në të njëjtën formë kthehej edhe trupi fizik. Shihej kur dilte trupi astral dhe kur kthente prapë në trupin fizik, e ndonjëherë me shpejtësi, se astrali kishte hasur në rrezik ose e kishte sulmuar dikush në atë botë.

Nëse njeriu qëndronte gjatë mbi ato energji të këqija nëntokësore apo teknike, ato rreze së pari intensivisht ia dridhnin aurën derisa ia dobësonin atë vend, pas një kohe fillonin ta shponin aurën, ia deformonin çakrat, ia kthenin mbrapsht ose ia ndalnin krejt ato. Personi shpejt mbushej me ato rreze të këqija, ku astrali nuk mund të dilte jashtë dhe njeriu shqetësohej e nuk mund të flinte si duhet; në mëngjes zgjohej i lodhur. Nëse njeriu qëndronte gjatë mbi ato rreze, aura çahet dhe energjia të cilën e merrte nëpër çakra nga kosmosi i dilte nëpër atë të çarë ose nuk merrte më energji, çakra i deformathej dhe ai organ, i cili gjendej në afërsi të asaj të çare fillonte të sëmurë. Kjo varej prej fuqisë së rrezatimit dhe llojit të tij. Ishte interesant të vëshesh një njeri i cili kishte hajmali mbrojtëse apo talisman. Rreth trupit të personit, njëjtë, siç e sqarova më lart, me unazën time, ishte formuar një mbrojtje si prej qelqit, ku asgjë nga magjia e zezë nuk depëronte në aurë.

Shpeshherë personat në mënyrë intuitive iknin nga rrezatimet e tilla, kishte disa persona që u ishin adaptuar atyre rrezeve të dëmshme dhe mbi to flenin e asgjë nuk i gjente, disi ishin imunë ndaj atyre rrezeve të dëmshme. Këso eksperimentesh kam bërë shpesh, ku interesant më ka ardhur si dukej magjia e zezë dhe e bardhë. Nëse një objekt ishte i programuar ndaj një personi për keq, ai objekt e kishte aurën e vet të keqe dhe kudo që ishte personi, aura e tij apo ndërvoja i pranonte ato rreze të dëmshme si të vetat dhe personi e ndinte veten keq, varësisht prej programit që kishin “instaluar” në largësi në atë objekt qëllimisht. Magjia e badhë ishte një energji shumë e mirë. Personi që e pranonte atë energji, e ndiente veten shumë mirë. Nganjëherë, në atë gjendje, i shihja mendimet e këqija, të cilat vinin si topa zjarri dhe e sulmonin njeriun në aurë. Rryma, e cila gjendej brenda murit, nëpër tela, shihej si një dritë e verdhë, që dilte jashtë murit për disa cm., shihej qartë kah po shkonin telat e rrymës

nëpër dhomë, dhe ishte ky një shikim rentgen në astral. Kur shtegu i rrymës ndodhej te koka e njeriut, i cili ishte shtrirë në krevat, rryma në të kapte diametrin e gjerë, ku personit i shkonte nëpër kokë e deri në mes të trupit. Personi e ndjente veten keq, fillonin dhembjet e kokës për çdo ditë e më shumë derisa intuitisht largohej nga ai vend, sepse pyste shpesh pse po i dhemb koka. Prej këtyre rrezeve personi shihte ëndrra të këqija, meqë ndërdija i tregonte se me të diçka nuk është në rregull, po personi nuk e kuptonte rastin deri vonë.

Kishte bjeshkë pozitive, të cilat e rrezatonin një energji shumë të mirë me një ngjyrë vjollce të çelët. Gjithashtu, kishte edhe bjeshkë negative e të rrezikshme, ku qëndronin qenie të këqija në to. Kishte vende të shenjta, si tyrbet, ku njerëzit i kishin mbushur me besim e energji pozitive. Diametri i asaj energjie të mirë ishte mjaft i gjerë rreth tyrbes, po kishte tyrbe ku disa krijesa të drites u ndihmonin njerëzve kur i luteshin Zotit për ndonjë qëllim të vetin.

Shtazët, këto vende, qoftë pozitive, neutrale apo negative, i njohin shumë mirë. Disa shtazë i ndjekin vendet negative e disa largohen prej tyre. Muri i betonit rrezatonte mbi 20 cm largësi, nëse njeriu mbështetej ose flente afër tij i dhimbte koka.

Populli tregon se përpara, kur dikush ka dashur të ndriqte një shtëpi, së pari, një natë, në atë vend i kanë lënë dhentë për të fjetur. Në atë vend ku kanë fjetur, atë natë, dhentë, e kanë ndërtuar shtëpinë, të sigurt se ai vend është i mirë për banim. Dhentë flejnë ose në vendet neutrale ose në ato pozitive.

Macet i ndjekin vendet negative, bubërrecat gjithashtu, kurse qentë e ndjekin ose vendin neutral ose pozitiv. Po qëlloi ahuri i gjave me rreze të këqija, ato janë të sëmura, lopët nuk japin tambël etj.

ARTI I HARRESËS

*“ Më mirë është të largosh prej teje një të keqe apo një të
metë tënden, se të bësh njëmijë të mira”*

(Salih Basha, mistik)



Thellimi i transit hipnotik dhe seansa e fundit e shërimit të epilepsisë

(fotografoi: S. B.-mistik)

Ndoshta ju vjen çudi nga ky titull që po lexoni, sepse ne zakonisht jemi mësuar që ta forcojmë të mbajturit mend e jo ta zvoglojmë atë.

Këtu do të ju shkruaj sesi ky lloj Arti i Harresës te ne, në popullin shqiptar, përdoret për shërimin e njerëzve të sëmurë nga magjia e zezë. Do të ju shkruaj si unë vetë këtë lloj Arti të Harresës e kam përdorur dhe e përdori për pastrimin shpirtëror dhe shërimin e të tjerëve. Ashtu do të ju shkruaj sesi shumë shkencëtarë botërorë këtë teknikë e kanë përdorur për t'i pastruar e harruar shumë gjëra që ju kanë penguar në jetë për shkak të memorjes së lartë.

Kur kam filluar të merrem me zhvillim shpirtëror, kam qenë i interesuar për shumë gjëra, sidomos për shërimin e magjive të zeza, të cilat janë shumë dominante në popullin tonë, ku „shtrigat e zeza“ këtë magji të keqe e bëjnë me ëndje për t'i mprapur njerëzit e pafajshëm, duke mos e njohur ligjin hyjnor, të cilin Zoti e ka caktuar - Ligjin e Karmës: „ç'të mbjellësh, korrë“ apo “çka i bën dikujt, ashtu ty të kthehet“.

Shpesh kam dëgjuar se te ne disa hoxhallarë po i shërojnë pacientët nga magjia e zezë duke ua nxjerrë me dhunë emrat, që po i kujtohen të sëmurit dhe po e pengojnë, ndërkohë hoxha po i shkruan në fletë e pastaj po i kallë në flakë këta emra të shkruar dhe, në këtë mënyrë , ai po vazhdon derisa po e gjen emrin kryesor të atij apo të asaj që i ka bërë me të vërtetë magji të zezë dhe, si po e kallë emrin e këtij personi, pacienti i mbushur me programe të mendimeve të këqija, që hyjnë në lëmin e magjisë së zezë, po zbrazet dhe po shërohet automatikisht, aty për aty.

Gjatë hulumtimit tim, qysh herët, u njoha me dervish Destan Berishën, që ishte për mua mik dhe shok i nderuar nga Hoça e Vogël, një sufi me qartëpamësi të lartë, i cili shihte e dëgjonte në botën eteriko-astrale.

Kisha raste të shërimeve, por unë në atë kohë nuk mund t'i shëroja vetë disa njerëz nga magjia e zezë, kështu që kërkoja ndihmë nga dervish Destani, i cili vinte pa pritesë për t'u ndihmuar të sëmurëve. Kemi pasur shumë raste bashkëpunimi në atë kohë me të. Unë kam qenë atëbotë vetëm asistent i dervish Destanit, kryeja punët që ai m'i jepte për t'i kryer.

Po ua tregoj një rast konkret pune që kemi pasur në një fshat malor myslimanësh të rrethit të Prizrenit. Më kanë kërkuar ndihmë për një femër shumë të sëmurë prej një fshati mbi Reçan të Prizrenit, për të cilën prindërit e saj na thanë se e kishin dërguar për shërim te shumë mjekë dhe nuk kanë pasur fare sukses. Pastaj e kishin dërguar te shumë hoxhallarë

dhe njerëz që i shërojnë njerëzit nga magjitë dhe kishin përdorur lloj - lloj barnash, po kurrfarë suksesi nuk kishin pasur deri më atëherë. Çfarë simptomesh kishte sëmundja e kësaj gruaje të sapomartuar që ishte e re, 17-18 vjeçare? Alivanosej - e humbte vetëdijen, grindej pa vetëdije me persona të panjohur dhe të imagjinuar e të padukshëm për sytë e të tjerëve. E rroknin katarza apo llahtari psikike me dhimbje të mëdha e britma të padurueshme për të tjerët, bërtima të cilat ta futnin frikën. Kësaj femre shpesh i zihej fryma, ku dukej si e vdekur. Në këtë gjendje rrinte me orë dhe kur zgjohej, zgjohej pa forcë duke mos ditur se çka ka bërë gjatë asaj kohe dhe çka ka folur. Pas kësaj vinte në vete, rrinte normalisht disa kohë dhe prapë e fillonte dramën e llahtarisë psikike.

Ç' bëri dervish Destani me këtë femër të sëmurë? Më urdhëroi që ta merrja një fletë të pastër dhe një laps kimik. I mori tespihet e veta, të gjata, prej 1001 kokërrash. Kur ne ishim aty, pacientja ishte me vetëdije të plotë dhe e qetë. Dervish Destani e urdhëroi këtë femër që të ngritej në këmbë dhe e përbiroi nëpër rrathë të tespiheve tri herë, duke kënduar në vete disa lutje. Si e ka përfunduar këtë ritual, pacientja u sëmur si herave tjera. Me të vërtetë ishte gjë e hatashme dhe e dhimbshme ta shohësh një vajzë të bukur e cila kishte hyrë në martesë e nuk mund ta shijonte natën e parë të martesës dhe muajin e mjaltit me burrin e vet. Ashtu, as familja nuk mund të kënaqej me gëzimin e martesës së djalit të tyre, dhimbje e cila ishte shndërruar në pikëllim të errët. Ajo shtëpi aq bukur e ndërtuar, e pastër, për një kohë të shkurtër ishte shndërruar në ferr të vërtetë nga një dorë e zezë e pamëshirshme dhe e mallkuar. Dervishi, në tespihet e veta, i kishte të ndara 7 kokrra nga tërë rrethi i tyre. U lut dhe e thirri në ndihmë një emër, për mua të pa njohur. Ai emër ishte një qenie hyjnore. Gjatë kësaj kohe dervishi e urdhëroi këtë femër që të tregonte se cilin po e shihte që i ka bërë

magji të zezë, kush e ka sjellur në këtë gjendje. Pacientja nuk foli nja gjysmë ore fare, veç shkarravitej, bërtiste dhe i zihej fryma. Dervishi e prekte trupin e saj me tespihe, e urdhëronte që të flasë, dhe lutej. Më në fund filloi të flasë dhe e tregoi një emër. Dervishi më urdhëroi që ta shkruaja atë emër në fletë. Pas kësaj ajo filloi të thotë shumë emra të tjerë. U bënë 10 emra të ndryshëm, si femra ashtu meshkuj. Këta emra ishin emra familjarësh, fqinjësh, shokësh e shoqesh të saj. E pyeta dervishin se si është e mundur që kaq shumë njerëz t'i bënin magji një njeriu? Dervish Destani tha se personi që i ka bërë magji të zezë fshihet dhe maskohet në lloj - lloj figurash të njerëzeve, deri edhe në figurë të prindërve të personit.

Pasi që i shkrova këta emra, dervishi e mori atë fletë (me emra), foli diçka dhe i fryni fletës, pastaj e kallli... Por një qoshe e fletës mbeti pa u kallur e në të ishte një emër femre. E pyeta dervishin: Pse ajo qoshe me atë emër nuk po kallet? Tha: kallet... dhe, dikur, me disa lutje, u kall ajo qoshe letre me emrin e një femre të panjohur. “Ky emër është i një femre që merret me magji të zezë dhe paska një mbrojtje të madhe, për këtë arsye nuk kallej...” - tha dervish Destani. Pacientja ende rrotullohej dhe bërtiste, kishte dhimbje të mëdha. Dervishi vazhdoi që të nxjerrë emra të tjerë, të cilët u bënë 24. Vetëm një emër nuk e tregonte kurrsesi. Pacientja, në vaj, tha: “Kur po tentoja ta tregoj atë emër, ajo grua po më furë e po më thotë se do të të mbys po tregove se kush jamë unë”. Dervishi e përdori një taktikë psikologjike, ku i bërtiti me zë të lartë dhe iu vërsul pacientes me tespihe për ta goditur, duke i thënë: A po e tregon atë emër kush është a të bëra copë-copë! Pacientja e tha emrin me vështirësi, unë e shkrova shpejt e shpejt dhe ia dhashë dervishit. Ai e mori letrën me atë emër, që e tha pacientja, u lut diçka në vete, i fryni letrës dhe e kallli letrën me atë emër. Unë e pritja me padurim se ç'do të ndodhte pas kësaj. Si u kall tërësisht,

pacientja e sëmurë u zgjua nga ajo llahtari e madhe dhe tha: U çlirova... Po kush jeni ju? Çka keni lypur këtu me mua në dhomë?! Në rregull është, i tha dervishi, ne kemi ardhur të të shërojmë, mos ki frikë fare, tash je e shëruar. Grua e thirri të vjehrrën e vet me “nënë”, ku hynë vjehrrë e vjehrra, të gëzuar që u ishte zgjuar e reja e tyre. Dervishi i bëri një kontroll astral shtëpisë, ku konstatoi se para derës së shtëpisë dhe para derës së dhomës së nuses kishin qitur ujë nga uji me të cilin lahet kufoma, të programuar që ajo të luante mendsh e pastai këta ta lëshonin përgjithmonë. Pastai dervishi gjeti tesha të nusës, të prera, ku një fqinje e tyre i kishte prerë. Dervishi urdhëroi që teshat e prera t’i zhduktnin. Pastai e mori një gotë me ujë dhe e mbushi me energji pozitive, me lutje speciale, me ujë të ashtuqujtur “ujë të bekuar” dhe i rekomandoi që këtë ujë, tri ditë me radhë, nusja ta pinte, se do t’ ia largonte të këqijat.

Pas një kohe kam dëgjuar se kjo nuse më nuk ishte sëmurë dhe se kishte filluar jetën normale.

Këtë teknikë kam filluar ta përdor te shumë pacientë të sëmurë psikikisht, ku edhe sot e kësaj dite e përdori. Kjo teknikë nuk është diçka sekrete, siç e kam konstatuar më vonë, por është diçka shumë e thjeshtë për ta përdorur. P.sh. e kam pasur një rast në Prizren me një djalë të ri e të bukur, po psikikisht jo në rregull. Kishte qenë i regjistruar në Akademinë Ushtarake të Beogradit dhe atje ishte sëmurë psikikisht apo, mund të them lirisht, e kishin sëmurë psikikisht. Simbas disa shenjave që i pashë te ky njeri, dikush atje në Akademinë Ushtarake kishte manipuluar, në mënyrë negative, me hipnozë dhe ia kishin çrregulluar ndërdijen, duke i deponuar posthipnozë me afat të gjatë dhe duke ia programuar çmendurinë dhe humbjen e kontrollit në jetën e përditshme.

Si mjet të parë për shërim, te ky pacient, e kam përdorur Artin e Harresës. Pacientin e kam detyruar të

shkruajë në një fletore të zbrazët çdo send që i kujtohej dhe që po i pengonte gjatë jetës së përditshme, qofshin ato në formë traumash që i ka përjetuar më parë, ëndrra etj. Pacienti herë kishte vetëdije, herë nuk kishte vetëdije normale, sepse ndonjëherë kur dilte prej vetëdijës normale, fliste gjëra që, për njerëzit normalë, ishin pakuptim. Pacienti fillonte normalisht të shkruante, ku i shkrunte disa fjali, e pastaj bënte veç vija të ndryshme. E detyrova që të mendonte në fotografi dhe veç vija le të shkruante në fletore. Kështu e mbushi gjysmë fletore - herë me fjali, herë me shkarravina të shkruara pa kuptim. E mora atë fletore dhe para syve të tij e ndeza, duke i thënë atij se tash të gjitha ato të këqija po i kalleshin, zjarri po ia merrte dhe ai po lirohej prej tyre përgjithmonë. Pas këtij rituali personi automatikisht u qetësua dhe tashi lirisht mund të komunikojë me të, ku e hipnotizova, pasi që, më parë, një gjë e tillë ishte e pamundshme. Pastrova shumë bllokada dhe programe negative në ndërdijen e tij, pastai e ktheva në vetëdijen normale e të shëndoshë. Pas një muaji, ky person “i luajtur menç” ishte normalizuar plotësisht dhe kishte shkuar tek baba i vet në Gjermani për të punuar.

Kjo teknikë e pastrimit psikik, te disa persona ndikon menjëherë, kurse te disa të tjerë më vonë. Të njëjtën teknikë e kemi përdorur kur kam qenë në ritual të ecjes nëpër zjarr, ku, para se të shkonim te zjarri, i kemi shkruar të gjitha të metat prej të cilave do të dëshironim të liroheshim, si p.sh.: vuajtjet, sëmundjet, mendimet e këqija, urrejtjet etj. Në këtë mënyrë kemi vepruar kur është ndezur zjarri: mbi turrë të druve është vendosur një kuti letrë për vendosjen e flisë (kurbanit) për t’ia dhuruar zjarrit që ai t’i pastronte ato te ne. Secili që i afrohej turrës së druve të ndezura qëndronte përballë kutisë, në këmbë, e i drejtohej zjarrit me këto fjalë: “Këto të meta po t’i jap ty, zjarr, që të lirohem prej tyre”. Pas këtij rituali të shkurtër, largoheshim prej zjarrit të ndezur, ku

pastaj vinte tjetër individ me “flinë” e vet. Me të vërtetë, kur i ndizte zjarri ato të këqija, e ndjeje veten më lehtë, disi si të liruar prej një peshe.

Të njëjtat metoda i përdorin shumë vende të botës, duke i ndezur zjarret e duke ecur nëpër to. Në Meherzad të Indisë, qyteti ku ka qëndruar Resulullah (Avatar) Meher Baba, mbahet rituali i kalljes së zjarrit, ashtuqujtur DUNI. Ky ritual i zjarrit është themeluar qysh se ka qenë gjallë Resulullah (Avatar) Meher Baba, ku dhe sot e kësaj dite, për çdo të 12-tin e çdo muaji, mbahet ky ritual nga nxënësit dhe adhuresit e tij. Dhe, njësoj, siç u theksua, në letër i shkruajnë të metat dhe të këqijat, pastaj ia japin zjarrit kurban. Zjarri ndikon në nivelin e pestë të vetëdijes. Për këtë Resulullah (Avatar)-Meher Baba thotë: *“Zjarrit i jepem fli vetitë tona negative prej të cilave ne dëshirojmë të lirohemi”*.

Këto gjëra i kam provuar vetë me autohipnozë. Dhe, ky ritual i kalljes së të këqijave është i dukshëm në botën astarle: Kur ti qet në letër një veti të keqe, një mundim psikik apo, thjesht, ndjenjën e ndonjë personi i cili të pengon shumë, atomet e letrës në mënyrë fotografike e pranojnë shkrimin tënd dhe i ruajnë ato ndjenja apo mendime që ti i ke shkruar mbi atë letër. Pra, këto të meta shkulen pre aurës tënde mentale, emocionale dhe astrale dhe kalojnë në letër. Kur ti, para vetes, e ndez këtë letër me ato të meta që i ke shkruar në të dhe imagjinon se këto të meta do t’i merrë zjarri si fli, duke u ndezur letra me ato të meta, prej letrës dhe prej aurës tënde, mentale, emocionale dhe astrale dalin si pika të zeza ose si shigjeta të vogla prej anës së përparme të trupit tënd dhe drejtohen kah flaka, duke u zhdukur në ajër dhe ti prej atyre të metave lirohesh. Këtë ritual të ndezjes së të këqijave duhet ta përsëritësh shpeshherë dhe ta bësh shprehi, sepse ka shumë shtresa mentale ku janë të deponuara të këqijat, pastaj ne, për çdo ditë, mbushemi nga të tjerët dhe nga vetja jonë me lloj - lloj mendimesh negative. Kurrsesi

nuk do të thotë që ti të jeshë në autohipnozë dhe t'i largosh këto të meta. Edhe kur je në vetëdijen normale ky pastrim ndikon njëjtë, si të jemi në gjendje të ndryshueshme të vetëdijes.

Pra besoj se e kuptuat saktë ritualin e kalljes së të këqijave, i cili ka domethënie shumë të madhe për zhvillim spiritual dhe pastrimin e të metave apo të këqijave në vetvete. Nëse doni ta përdorni këtë ritual, merreni një fletore apo fletë të pastër, shkruani të metat tuaja, prej të cilave dëshironi të liroheni, si: sëmundjet e ndryshme, depresionet, frikësimet e ndryshme ose, nëse e ndjeni veten pa vlerë, pa forcë, nëse ju pengon dikush në jetë dhe dëshironi që të liroheni prej tij, pakënaqësitë e ndryshme etj. Të gjitha këto shkruani në letër, merreni atë letër dhe, para se ta ndizni, thuani më zë ose në vete këto fjalë: “Të gjitha këto të këqija po ia jap zjarrit kurban”. Hirin hidheni në mbeturina dhe puna përfundoi.

Këto metoda i kanë përdorur edhe shumë shkencëtarë botërorë. Pasi që isha shumë i interesuar për këtë lëmë, këtu në Gjermani (Mynih), në bisedë e sipër me një kolegë nga Irani, i cili ishte student i Gjermanistikës dhe kishte dëgjuar për këtë metodë, më tha se e kishte një skriptë, të cilën ia kishte dhënë një shoqe, studente gjermane, e të cilën e mbanin si send me vlerë një grup i vogël e i ngushtë studentësh, thuaja sekret. Një kopje, pra, e kishte dhe iraniani Ali.

Skripta quhej: „Gipt es eine Kunst des Vergessens“ nga autori Harald Weinrich (d.m.th: *Ka një art të harresës*) dhe ndahej në shtatë kapituj. Këta kapituj ishin:

1. Von Themistokles bis Umberto Eco : Kunst des Gedechnisses-Kunst des Vergessens. (*Prej Themistokleut deri te Umberto Eko - arti i të mbajturit mend-arti i harresës*)
2. Dr.Lurias-Lethotechnik (*Dr.Lurias-teknika e lethes*)
3. Ein Fall für Borgos: Hypermnésie und Amnesie (*Një rast për Borgosin : Hipermnëzia dhe amnezia*)

4. Eine Teufelskunst: Faustes Vergesens (*Një art i djallit - harresa e Faustit*)
5. Nitzsches Kunst und Kraft des Vergesens (*Arti i Nigës dhe fuqia e harresës*)
6. Unbefriedetes und Befriedetes Vergesens: Freud (*Harresa e pakënaqshme dhe e kënaqshme: Frojdi*)
7. Valenzen und Ambivalenzen des Vergesens (*Valencat dhe ambivalencat e harresës*)

Arti i harresës në gjuhën latine quhet: Ars Oblivionalis ose Ars Oblivionis. Fjala Lethe rrjedh prej fjalës greke që do të thotë: Lumë i harresës.

Po i marr vetëm disa shembuj të këtyre shkencëtarëve, të cilët kanë shkruar ose vetë e kanë përdorur këtë teknikë.

Do të marr një tregim të vërtetë medicinal prej një mjeku rus, dr.neuropsikiatër Aleksander Romanoviç-Luria (1902-1977), i cili e ka përcjellë 30 vjet një pacient të vetin. Në vitin 1968 e ka publikuar një libërth me titull: "*Një libërth i vogël për mbamendje të lartë-mendja e një mnemonisti*", libërth i cili është përkthyer në shumë gjuhë botërore. Pacienti nuk është ankuar për harresë, por për të mbajturit mend të tepërt (hipermnezi). Ky pacient çdo send që ka bërë, çkado që ka folur, çkado që ka lexuar, për çdo send, kurdoherë, në çdo kohë, ka qenë në gjendje të kujtohet; madje, çkado të jetë pyetur - për cilëndo revistë apo libër që ka lexuar, madje para shumë vitesh, të dijë dhe faqen të ta tregojë, edhe sa rreshta ka pasur, e leje më përmbajtjen e saj. Pacienti i dr.neuropsikiatër, Aleksandër Romanoviç-Luria, quhej Seresevski dhe e quanin njeri që nuk di të harrojë. Dr.Luria shkruan për mnemoteknikën (*teknikë e lartë e të mbajturit mend*) dhe neologismu-në (*teknikë e harresës*), pasi ka hulumtuar dhe e ka gjetur në mitologjinë greke me titull: „Lethoteknika”- teknika e Lethës: teknikë e Lumit të

Harresës. Ashtu në këtë vend e ka gjetur edhe vetë Danten, i cili kishte shkruar për Artin e Harresës.

Në librin e Dr.Luries shkruan se si pacienti i tij, Seresevski, kur ka dashur diçka të harrojë, ka marrë atë që ka dashur të harrojë dhe e ka shkruar në letër, atë letër pastaj e ka shqyer copë-copë dhe e ka hedhur; ose atë që ka dashur ta harrojë, e ka shkruar në letër dhe atë letër e ka kallur. Ashtu ai është liruar prej gjërave të tepërta nga memorja e vet e lartë dhe e rënduar.

Pokështu, edhe Fridrih Niçe, i cili në vitin 1868, si djalosh 24 vjeçar, bëhet profesor për Filologji Klasike në Universitetin e Bazellit dhe i cili shkroi shumë vepra shkencore, ka një vepër që quhet:” Zu allem Handel gehört Vergessens” (*Në proceset e përgjithshme hyn edhe harresa*). Niçe ka qenë shumë i interesuar për Artin e Harresës dhe ka shkruar shumë për këtë Art. Frojdi shumë mirë e shpjegon në Psikanalizë, se diçka në ne që ka qenë e vetëdijshme ka kaluar në mosdije dhe aty ruhet. Kjo ndikon te individit tërë jetën, si frikë ndaj ndonjë gjëje apo sendi, njeriu apo shtaze, ose ndaj ndonjë ngjarjeje tragjike etj. Ne shpesh frikësohemi për një gjë e nuk dimë pse frikësohemi, pra atë frikë duhet ta gjejmë në mosdije (ndërdije) e ta sjellim në vetëdije, dhe si ta kuptojmë, ne spontanisht e harrojmë atë, ajo më nuk ndikon në ne dhe në këtë moment i humb fuqia, meqë i zbulohet arsyeja e asaj traume apo frike dhe me këtë pacienti vetvetishëm shërohet.

Pra ky ishte Arti i Harresës i cili ka rëndësi shumë të madhe si për shërim, ashtu dhe për zhvillim shpirtëror

KUKULLA E HUMBUR U GJET

“Gjuha po të ishte e fortë, do ta kishin copëtuar dhëmbët.”

(Salih Basha, mistik)

Pasi që jetoja në qytetin e Prizrenit, kurse babai im, me anëtarët e tjerë të familjes, jetonte në fashtin Vraniq, unë shpesh, në fund të javës, shkoja në fshat për ta vizituar familjen. Fshati e kishte një bukuri të veçantë për mua, sepse aty isha i lindur, përjetimet dhe kënaqësitë më të mëdha të fëmijërisë i kisha pasur pikërisht në këtë fshat të mrekullueshëm e legjendar.

Sa herë që shkoja në fshat, bëja eksperimente me hipnozë, me mediumë të ndryshëm, po ashtu edhe iu ndihmoja me anë të hipnozës për ndonjë problem shëndetësor, fizik apo psikik.

Në një rast, ishte një problem i një natyre krejtësisht tjetër - kishte humbur një kukull. Pasi që vëllai, Nijaziu, punonte si punëtor sezonal në Zvicër, ia kishte blerë vajzës së vet, Mirjetës, një kukull të bukur, por të madhe, thuaja sa një fëmijë i vogël. Pasi që fëmijët kishin luajtur me kukull, atë e kishin përlyer me baltë dhe nëna e tyre ua kishte pastruar te kroi. Aty e kishte lënë për t’u terur. Kukulla ishte me të vërtetë e bukur dhe e rrallë për atë rreth, madje edhe kushtonte dhe aso lloj kukullash nuk besoj të kishte në atë rreth në atë kohë. Gjatë asaj kohe, dyert e oborrit ishin të hapura krah më krah, ku çdo gjë dukej nga ana e kundërt e rrugës dhe nga jashtë brenda në oborr. Në ato çaste, papritmas, kukulla ishte zhdukur.

Atë ditë të premtë, të vitit 1999, ishte mot i bukur pranveror i muajit maj. Kisha ardhur prej qytetit në fshat, me dy fëmijët e mi, Arbenën, të cilën për shkak të dashurisë e quaja Benushë dhe djalin, Arbenin, dhe atë e quaja shkurt

Beni ose ndonjëherë edhe Benush. Me ne ishte dhe bashkëshortja ime, Kasema. U gëzua shumë familja për ardhjen tonë. Megjithatë, në atë moment vërejta se diçka nuk ishte në rregull, kishte ndodhur diçka, dukej si një atmosferë pikëllimi. Pasi i përfunduan të gjitha ceremonitë e pritjes, nuk m'u ndejt pa pyetur se çka në të vëtetë nuk ishte në rregull. E pyeta Havën, gruan e vëllait, Njaziut, se çka ishte ky pikëllim që po e vëreja, mos kishte ndodhur diçka e keqe ? – He, more baci Salih, u përgjigj Hava, na e kanë vjedhur kukullën e madhe e të bukur të Mirjetës në mes të oborrit dhe në pikë të ditës. Fëmijët e kishin përlyer kukullën, e mora dhe e lava te kroi, e lash mbi një dërrasë, që të terej dhe gjithnjë e kontrolloja ; pak pa ardhur ju, kukulla veç ishte zhdukur pa asnjë gjurmë, thua e kishte lëshuar toka. Dyert e oborrit i kemi pas të hapura krah më krah dhe dikush na e mori kukullën, që aq shumë na ka prekur. I thashë të mos mërzitej, “vetëm shëndosh të jemi, se kukulla mund të blihet përsëri.” - Po, po ashtu është, baci Salih, veç qenë duke u kënaqur fëmija me atë kukull të bukur, - tha Hava, gruaja e Njaziut.

Pasi që e dija një metodë të zbulimit të gjërave me anë të hipnozës, sidomos me udhëtim astral-eterik, mendova të provoj me motrën, Luljetën, dhe vajzën, Arbenën, ku të dyja ishin medime shumë të mira, me të cilat kisha bërë shumë eksperimente dhe ushtrime të shumta.

Dalja nga trupi fizik me trup astral ose eterik ishte dhe është shumë fascinuese për mua. Në fillim kam lexuar shumë për udhëtimin astral, për trupin astral etj. Në gjuhën shqipe as që kishte diçka të shkruar e as që njihej kjo lëmë. Të vetmen dije që kam mundur të gjej në gjuhën shqipe ka qenë kontakti direkt me sufitet shqiptarë, si me shehlerë të ndryshëm dhe dervishë, të cilët, të vetmit e dinin këtë mundësi, po të cilët e mbanin sekret dhe e quanin Sirr-fshehtësi.

Pasi që isha dhe jam shpirt i parehatshëm, sa i përket hulumtimit të të së andejshmes, hulumtimeve okulte, si të ndërdijes dhe të mbidijes, sidomos të botës astrale-eterike, me kohë pata filluar drejtpërdrejt ushtrimet me veten dhe me të tjerët.

Ndërkohë e pata zbuluar praktikisht dhe e pata bindur veten se me të vërtetë përveç botës fizike, që ne e njohim si realitet objektiv, ekzistojnë edhe botëra të tjera reale, por me vibracione të ndryshme energjitike dhe - edhe me banorë (krijesa), që toka nuk i ka, por populli i njeh nëpërmjet përrallave, tregimeve dhe legjendave, si engjuj, zana të malit e deri te djalli.

Bota fizike e kishte kopjen e vet energjitiko-eterike. Kjo botë eterike ishte plotësisht reale dhe origjinale, si bota fizike që ne e njohim, dhe asgjë nuk po ndodhte në materie pa ndodhur njëherë në eterik. Bota astrale ndryshon pak prej asaj eterike, meqë vibrimet i ka pak më të vrazhta se bota eterike, por thuaja të dy botërat janë gadi të ngjashme, veçqë bota astrale ka pak më shumë ngjyra dhe atje çdo mendim shihet me fotografi. Bota eterike është orgjinali i materies, kurse bota materiale është kopje e eterikut e jo bota eterike kopje e botës fizike. Mirëpo, përveç ligjeve që ka bota e materies, si ndjenjat, fortësinë, shijen, ajo i ka edhe ligjet e veta dhe rregullat e veta të dalluara nga bota materiale-fizike. P.sh. njeriu në tokë, pa ndihmën e ndonjë fuqie energjitike – fizike, si motorët e ndryshëm, nuk mund të fluturojë. Kurse në botën eteriko-astrale, njeriu mundet pa kurrfarë problemi të fluturojë dhe të depërtojë nëpër mure me trupin astral-eterik, mund të udhëtojë në çdo dimension tjetër dhe të merrë forma të çdo objekti apo krijese, duke e kuptuar çdo gjuhë të botës dhe çdo gjuhë të çfarëdo krijese të çfarëdo dimensionit. Për këto botëra mund të shkruhen libra të tërë.

Me motren, Luljetën, kisha punuar shumë dhe kisha zbuluar shumë gjëra në botën astrale-eterike. Edhe pse isha

fillestar në këtë lëmë, Luljeta më ka ndihmuar shumë për të zbuluar shumë gjëra, por edhe unë asaj i kam ndihmuar për zhvillim spiritual. Atë e kam ushtruar që të bëjë zbulimin e magjive të zeza, si te ne në familje, ashtu edhe te të tjerët.

Kurse, e dashura, vajza ime, që me dashuri e quaja Benushë dhe e mendoja si një engjëllushe, ajo ishte një medium shumë i mirë dhe i jashtëzakonshëm për moshën e vet, por ishte shumë e re dhe nuk guxoj që të bëja eksperimente me të sa duhet. Këtë frikë e mora kur shkova në vizitë te shoku Hasan B., i cili poashtu ishte i interesuar për parapsikologji, sidomos për hipnozë. Shpesh bisedonim për këto gjëra me shokun Hasan, por ai dëshiroonte më shumë të bindej në praktikë dhe t'i shihte drejtpërdrejt me sytë e vet këto fenomene. E hipnotizova Benushën dhe fillova seancën me të. Me të vërtetë ishte fascinuese sesi një vajzë 11 vjeçare, si Arbena, të dinte aso gjërash dhe të jepte përgjigje aq inteligjente, ku, natyrisht, në gjendje të vetëdijshme, normale, nuk do të mund t'i dinte ato. Mirëpo, në atë çast, kisha punë dhe e lash Benushën ashtu në autotrans, pasi i dhashë vetëdijen që të mund të kontrollonte vetveten. Edhe shoku Hasan i kishte dy fëmijë si dy drita, të bukur e të shëndoshë, dhe, si amator që isha në lëmin e hipnozës, nuk ma preu mendja se mund t'i ndodhte diçka. Kur u ktheva në dhomë, e pashë Benushën të nervozuar, sepse fëmijët e shokut Hasan luanin me të dhe e ngacmonin, duke e pyetur se si po e ndjente veten në autohipnozë dhe gjëra të tjera që Bena nuk i duronte. Kur hyra brenda, e ndjeva Benën duke iu thënë fëmijëve “largohuni, se mund t’ju shkatërroj”. M’u drejtua mua Bena: “Babi, të lutem largomi këta fëmijë, se mund të shkatërroj ndokend, se sytë po më qesin zjarr”. Unë mendova se Benusha po bën shaka me shokët e vet, por kur e shikova vëmendshëm në fytyrë, e pashë se prej dy syve të Benushës dilnin si dy rreze të kuqe laserike, përafërsisht 20 cm. Herë dilnin prej syve, herë tërhiqeshin mbrapa. Shpejt e shpejt e

mora komandën mbi Benën dhe shpejt e qetësova në tërësi. Bena më tha: “Babi, më ngacmonin fëmijët e bacit Hasan e unë shkoja gjithnjë duke u nervozuar; këta nuk e dinë se unë mund t’i dëmtoj me fuqinë e syve të mi, se sytë po më qesin zjarr prej nervozës së ngacmimit të tyre.” Pas pak e lidha me engjëllin e vet dhe e pyeta se çka duhej të bëja me Arbenën tash e në të ardhmen? Engjëlli i Benushës më dha përgjigje, dhe, nëpërmjet gojës së Benës, më kshilloi: “Me Arbenën duhet të bësh pauzë e të mos punosh derisa t’i mbushë 14 vite. Atëherë piçet fizikisht dhe mentalisht e pastaj mund të punosh e ta zhvillosh pa problem, sepse tash është ende e re. Pas këtyre viteve mund të arrish gjëra të larta shpirtërore, nëse punon me rregull dhe me kujdes. Kjo ishte frika që e kisha për Benën dhe nuk guxoja tash për tash të punoja me të.

Vendosa, megjithatë, që të punoja edhe me Benën, edhe me Luljetën. I hipnotizova të dyjat, ku i lidha dorë për dorë, në mënyrë që edhe në astral të ishin së bashku. Në hipnozë iu dhashë vetëdije, i nxora prej trupit fizik dhe i qita aty në eterik të dhomës, ku ishim duke bërë eksperimentin. Fillimisht veprova kështu: Tash keni për të dalur prej trupit tuaj fizik, të dyjat, sikur që keni vepruar edhe herave të tjera. Por sot, këtu dhe tash, do të dilni në eterik të fshatit tonë (Vraniqit). Dikush prej fëmijëve të fshatit, siç e dini edhe vetë, na e ka vjedhur kukullën e Mirjetës. Ju do t’i pyetni fëmijët e fshatit ose do ta gjeni vetë se kush e ka Kukullën tonë të bukur e të madhe. I urdhërova të dyjat dhe u thashë: “Dilni me eterik, këtu në dhomë ku jemi ne, këtu dhe tash. A dualt prej trupit?” - i pyeta të dyjat. “Po”, u përgjigjën njëzërit në trans hipnotik. I pyeta se ku jeni tash? Ato u përgjigjën njëzërit: “Ja, aty, para derës së dhomës.” Iu thash: “do të përgjigjeni herë njëra e herë tjetra, sipas nevojës. Ju tash keni aftësi që me këta trupa, në të cilët ndodhëni, thuaja çdo send të bëni; mund të depërtoni edhe nëpër mure, mund të merrni forma të ndryshme, mund të fluturoni etj. A

kuptuat?” “- Po”, thanë njëzëri. Më pas shtova: “tash fluturoni mbi shtëpitë tona dhe shikoni, prej së largu, në perspektivë të shpeztëve, prej së larti poshtë dhe kënaquni me atë shikim dhe me atë pamje. A jeni mbi shtëpitë tona?” - i pyeta qetë. “Po”, u përgjigjën të dyjat. “Si po ju duket lart?” - i pyeta prapë? “Qenka shumë mirë” - u përgjigj Benusha. Ju thashë se tash fluturonin mbi fshat dhe ku të shihnin poshtë fëmijë duke luajtur, të zbritnin ngadalë mbi tokë. Mirë, u përgjigjën të dyjat. Deri tash folnin përnjëherë të dyjat, edhe Lulja edhe Bena. Këtu vërtetohej se me të vërtetë ishin në trup eterik ku, përnjëherë, të dyjat, shihnin se çka po ndodhte, në të njëjtën kohë, në fshatin tonë. Luljeta tha se po i shohim disa fëmijë, duke luajtur poshtë në fshat. Mirë, u thashë, zbritni poshtë dhe shikoni me çka po luajnë dhe në cilin vend apo në cilën anë të fshatit janë ata. Benusha tha: Tash jemi te fëmijët. Pyetni, iu thashë, se çka po bëjnë? Fëmijët po thonë, u përgjigj Benusha, se po luajnë si zakonisht. Shikoni se mos e kanë ndonjë kukull e po luajnë me të? Jo nuk kanë, u përgjigj Luljeta. Pyetni fëmijët, u thashë, se mos e kanë parë ndonjë fëmijë tjetër në fshat duke luajtur me ndonjë kukull të madhe. Ata fëmijë u përgjigjën se nuk e kishin parë asnjë fëmijë duke luajtur me aso kukulle. Mirë, shikoni në tjetër vend dhe hulumtoni. Ja, këtu qenkan duke luajtur disa fëmijë, tha Luljeta. Shkoni e pyetni se mos, rastësisht, ka parë fëmijë të tjerë duke luajtur me ndonjë kukull të madhe.

Kur i pyetën, njëri prej tyre u kishte thënë se, atje larg, ishin disa fëmijë duke luajtur me një kukull. Mirë, u thashë, falënderojeni këtë fëmijë që ju dha ndihmë dhe shkoni atje, ku janë duke luajtur fëmijët me kukull. U nisën në atë drejtim, ku Benusha, me një zë gëzimi, u përgjigj: Qe, babi, atje po i shohim disa fëmijë duke luajtur me kukullën tonë. Këta fëmijë e paskan marrë. Unë, pak i befasuar, i thashë Benushës: Kape e mos e lësho atë fëmijë. Këtë urdhër nuk

duhej t'a jepja, se ata nuk kishin se ku të shkonin. Bena tha: e kapja, babi. Mirë, mirë - i thashë Benës, lëshoje, se nuk ka ku të shkojë. Benusha tha: Babi, ti kur më urdhërova ta kapja, ne ishim larg, por dora ime u zgjat aq sa arriti deri te fëmija, ku dhe fëmijët tjerë u frikësuan pak me atë gjest jo të zakonshëm. Si është e mundur, babi, që dora të zgjatet aq shumë? - më pyeti Benusha, edhe pse ishte në trans hipnotik. I thashë Benushës se qysh në fillim ju kam thënë se në botën eteriko-astrale thuaja çdo gjë është e mundshme, sepse këtu ligjet janë të ndryshme në krahasim me botën fizike, ku jetojmë ne me trupin fizik. E kuptova, tha Benusha, të falemnderit, babi. Bena fliste si të ishte zgjuar, sepse u kisha dhënë edhe vetëdije në këtë trans, vetëdije jo aq të plotë sa të mos i zbatonin urdhërat e mij. Pastaj, i thashë Benushës: Thuaju fëmijëve që të mos frikohen dhe le të rrinë të qetë. Së pari, pyeti se të kujt janë. Mirë, babi, u përgjigj Benusha me zërin e saj magjepës, si të një engjëllushe. E lejova vetëm Benushën të përgjigjej. Këta fëmijë janë të Ali dhe Salih Shabanit, të dy vëllezërve, tha Benusha. Pyeti, së pari, se si e kanë marrë kukullën, si ka qenë ngjarja. Benusha u përgjigj: Babi, këta fëmijët po thonë: Si për çdo ditë, ne po i lëshonim gjënë për të kullotur kah Reka e Buzhalës. Atë ditë, duke u kthyer prej andej, kishin qëlluar dyert e oborrit tuaj të hapura krah më krah. Në oborr, te kroi, e pamë një kukull të madhe. U befasuam, se kurrë kësó kukulle nuk kishim parë në jetën tonë. Në oborr nuk ishte askush. Lakmuam pa masë dhe e morëm me veti.

Në dhomë, ku punoja me trans hipnotik, ishin edhe të tjerët e familjes, po ishte edhe vëllai i vogël, Samiu, që poashtu ishte një medium shumë i mirë për moshën e tij dhe tash punonte vetë me autotrans. Ai kishte filluar të merrte përvojë të madhe për këto botëra të panjohura për shumë njerëz. Samiu, shpeshherë, dëshironte të ndërhynte në pyetje, por nuk e lejoi. Benushë, thashë, të lutem pyti këta fëmijë: A

mos ju ka parë dikush prej familjes suaj - nëna, babai apo dikush tjetër që jeni duke luajtur me kukullën që ju e keni vjedhur? Fëmijët po thonë se askush nuk i ka parë gjer më tash. Po mirë, ku po luajnë me kukull që nuk po i sheh askush, i thashë Benës. Në tavan të shtëpisë së re, ku askush nuk rri aty. Thuaju, Benushë, fëmijëve: A e dini se kukullën e huaj e keni vjedhur dhe tash Mirjeta jonë po qan për kukullën e vet që ju ia keni marrë! Po, e dimë, u përgjigjën fëmijët, por po kemi dëshirë që edhe pak, ne, të luajmë e pastaj ua kthejmë prapë. Mirë, thuaju, Benushë: Mbasi po thoni se do të luani edhe pak dhe do të na e ktheni kukullën, atëherë tregoni se kur do ta ktheni kukullën tonë, edhe sa kohë? Fëmijët u përgjigjën: Edhe dy javë dhe ne ua kthejmë kukullën. Mirë, thuaju, Benushë, se ne po pajtohemi, por jepnani fjalën se pas dy javësh do të na e ktheni. Po, po; ua japim fjalën - thanë fëmijët. I urdhërova Luljetën dhe Benushën t'i lëshojnë fëmijët që të luajnë rehat dhe më tutje, por, pas dy javësh, të na e kthenin kukullën, siç na e dhanë fjalën. I urdhërova që të ktheheshinn te dyjat në trup fizik. Pas pak kohe i pyeta: A u kthyet në trupin fizik? Po, u përgjigjën te dyja. Tash, çdo gjë që keni parë e ndier në botën astrale, keni për ta mbajtur mend dhe, kur të dilni nga transi hipnotik, do të m'i tregoni në detaje. Tashi shumë mirë po e ndjeni veten, çdo gjë është në rregull me ju, jeni plot energji, të qeta, të lumtura, gjithnjë e më të afta po bëheni, më të dashura, më të ditura.

Çdo herë, kur punoj me ndonjë medium apo pacient, i jap sugjestionë pozitive të shëndetit dhe të sukseseve të ndryshme në jetë. U thashë të dyjave që “kur të numëroj deri në tre, ju keni për të dalur nga hipnoza. Çdo gjë ka pë të qenë në rregull dhe çdo gjë është në rregull. A është çdo gjë në rregull?” Bena u përgjigj se çdo gjë është në rregull dhe është e gatshme të delë prej hipnoze, kurse Lulja tha se kishte kokëdhimbje. Mirë, Lule, kur të numëroj deri në tre, koka

jote do të jetë e kthjellët dhe e lehtë, e kthjellët dhe e lehtë, tash koka jote është e lehtë dhe e kthjellët, e lehtë dhe e kthjellët... 1,2,3. Si po e ndjen tash veten? e pyeta Lulen. Mirë, tha, tash është çdo gjë në rregull. 1. Tash po zgjohesh prej gjumit hipnotik. 2. Gjithjë e më shumë po zgjohesh prej hipnozës, shumë mirë po e ndjen veten. 3. Ju u zgjuat, tash jeni të zgjuara, çelni sytë, shumë mirë po e ndjeni veten, ngrihuni. Dhe u zgjuan të dyjat të çlodhura, pushueshëm dhe të disponuara. Filluan normalisht të lëvizin, duke qeshur, gojën vesh më vesh, me gëzim e hare. I pyeta, si po e ndjeni veten? Shumë mirë, u përgjigjën. Benusha kurreshtare më pyeti edhe një herë sesi është e mundur që dora të zgjatej aq gjatë dhe mos të këputej nga trupi. Ia përsërita se bota astralo-eterike ka ligje të tjera dhe mundësi të pakufishme. Trupi astral ka mundësi të merrë çfarëdo forme dhe madhësie, të shndërrohet në gur apo shtazë, të zvogëlohet në atom apo të rritet pa kufi. Njëherit, ka mundësi të udhëtojë nëpër lloj - lloj dimensionesh, t'i vizitojë njerëzit e njofshëm në largësi, apo të shkojë në planete të tjera, ose të shkojë për të vizituar parajsën a ferrin, por këtë, nëse i lejohet prej qenieve të atyre dimensioneve, por gjithmonë me udhëheqësin shpirtëror me vete, për shkak të sigurisë dhe udhërrëfimit. Pastaj, ka mundësi të kthehet në të kaluarën, të shikojë në të tashmen dhe ta parashikojë të ardhmen për aq sa i lejohet të shikojë prej dy engjujve tanë që i kemi me vete. Kjo varet edhe nga ajo sesa ne vetë jemi shpirtërisht të zhvilluar dhe sa besojmë në këto gjëra, njëherit dhe sa e kemi pastruar veten nga mendimet e këqija që i kemi grumbulluar në vete (ashtuquajtur “pastrimi i Karmës”). Shpirti pastrohet duke pastruar mendjen.

Ndërkohë, posa dolën Lulja dhe Benusha nga transi hipnotik, Samiu intervenoi me fjalë të rrepta dhe tha se ai vetë do të shkonte te Salih Shabai dhe do t'ia kërkonte kukullën. Samiu besonte në këso gjërash, se vetë ishte

medium i mirë, por unë nuk e lejova, duke i thënë se: Ti nuk guxon askund të shkosh, sepse së pari nuk e dimë qind për qind se a është e vërtetë çka thanë Lulja dhe Bena dhe, fundi i fundit, po presim pas dy javësh se çka do të ndodhë, a do ta kthejnë kukullën apo ka qenë vetëm një fantazi e udhëtimit astral. E dyta, thashë, se , si dëgjuam, fëmijët thanë se asnjëri prej prindërve nuk e di se e kanë kukullën dhe se janë duke luajtur në tavan të shtëpisë, ashtu që kur të shkosh te prindërit e tyre, ata mund të të nxjerrin problem.

Pas kësaj, unë u ktheva në qytet dhe në javën tjetër shkova prapë në fshat, te baba Azem. Luljeta menjëherë më tha se Samiu ka shkuar te të Salih Shabanit dhe e ka kërkuar kukullën, por nëna e atyre fëmijëve e ka bërë horë, duke e fyer me fjalë të rënda dhe duke i thënë se “fëmijët e mi nuk janë hajna dhe, po ta kishin vjedhur ndonjë kukull, ne do ta kishim parë deri tash”. Mirëpo, Samiu nuk kishte ndejur rehat dhe kishte shkuar për të dytën herë ta kërkojë, duke ua përmendur se kukullën e kanë fëmijët në shtëpinë ku nuk banojnë dhe po luajnë në tavanin e shtëpisë. Ju nuk e dini që e kanë vjedhur. Unë i fola Samiut për këtë gjest, meqë ne nuk ishim të sigurt se kukullën e kishin vjedhur ata fëmijë, meqë ne ishim amatorë në hulumtimin e së vërtetës në botën astrale.

Kur u ktheva përsëri në fshat, ,javën e dytë, Hava, gruaja e Njaziut, më tha me gëzim se kukullën e kishin gjetur. Ajo tha: Baci Salih, rrafsh dy javë kur janë bërë, prej se ju keni punuar në hipnozë me Lulen dhe Arbenën, na e ka kthyer kukullën babai i atyre fëmijëve, Aliu. Kur erdhi, e kishte pasur një thes në krah, e aty e kishte futur kukullën; na e dha, duke kërkuar falje që fëmijët e kishin marrë pa dijen e tyre, fshehtas, dhe kishin luajtur deri tash në tavanin e shtëpisë së re, ku ende nuk banonin... dhe tha: pash Zotin na falni... dhe urdhronu kukullën e fëmijëve tuaj!

Pra, kështu dual e vërteta e plotë për kukullën e humbur, e cila prapë u gjet, duke iu kthyer gëzimi i madh Mirjetës së vogël e të bukur si një engjëllushe, e cila shumë më donte dhe ashtu e doja shumë si qenie njerëzore

ZBULIMI I MAGJISË SË ZEZË DHE SHËRIMI NGA AJO

“Shkova tek e keqja, e keqja më mësoi për të mirë”

(Salih Basha, mistik)

Edhe pse isha në atë kohë fillestar në lëmin e okultizmit, sidomos në lëmin e hipnozës, megjithatë kisha mësuar shumë gjëra, të cilat, më parë, as vetë nuk i kisha besuar fare. Mirëpo, njeriu ndryshon në jetën e vet, sepse vetë jeta është një mësim me lloj - lloj përvojash të ndryshme. Kisha lexuar shumë libra në gjuhën serbo-kroate, si për magjinë e bardhë, ashtu edhe për magjinë e zezë; po ashtu kisha pasur kontakte të shumta me sufite shqiptarë, si me shehlerë dhe dervishë, të cilët shumë mirë e njihnin fshehtësinë e këtyre zanateve shumë të lashta të njerëzimit. Prej sufive kam mësuar shumë gjëra dhe tek ta kam gjetur një thesar shumë të madh, i cili qëndronte i fshehur dhe i mbyllur për masat e gjera njerzore e ku fshihej dija sesi mund të gjenden dhe të shkatërrohen magjitë e zeza. Sufitë punonin duke u bazuar vetëm në Kur'an dhe shumë dije i mbanin fshehur, duke mos ia zbuluar gjithkujt, se dikush atë dije mund ta keqpërdorte kundër njerëzimit.

Në këtë lëmë, dijen më të madhe ma ka dhënë i ndjeri dhe i nderuari pa masë nga ana ime, dervish Destan Berisha, nga Hoça e Vogël, i cili ishte sufi shqiptar qartëpamës i një niveli të lartë. I nderuari, Dervish Destani, ishte specialist për gjetjen dhe shkatërrimin e magjive të zeza; nga ai e kam fituar besimin dhe e kam marrë një dije të madhe në këtë lëmë.

Pas studimeve të shumta dhe eksperimenteve me hipnozë, kam kuptuar se çdo magji që bëhet, bëhet si urdhër

në ndërdije, se ndërdija i lexon dhe i pranon valët më të imta psikike që dërgohen drejt saj dhe i merr ashtu siç janë të dërguara, në çfarëdo forme dhe mënyrë, pa marrë parasysh largësinë apo vendin. Magjinë e zezë apo të bardhë unë e quaj viruesa mental. Ky virues i programuara, prej një personi të caktuar, dhe që bëhet për një person të caktuar, nuk i jepet njeriut në trup fizik, por në trupin energjistik, ku ndërdija e atij personi reagon sipas programit të saj; ndërsa, si objekt-bazë për programim përdoret një pjesë fizike e marrur nga personi, mbi të cilin fiksohet qëllimi i mbarë apo i mbrapshtë. Pra viruesi mental është shkak, kurse pasoja shihet aty për aty ose më vonë në trupin fizik apo psikik. Magjia mund të bëhet edhe në largësi, pa qenë afër personit. Kur magjia hidhet, urdhërohet exhini apo demoni i ferrit që ta sëmujë atë person. Lutjet të cilat gjenden në Kur'an janë shpatë e pamëshirshme për shkatërrimin e këtyre magjive dhe exhinve-demonëve të ferrit; këto Zoti i ka dërguar për mbrojtjen e njerëzimit.

Magjia bëhet me të gjitha llojet e elementeve kosmike, duke filluar prej elementit të zjarrit, ajrit, ujit apo tokës; çdo element e ka fuqinë e vet magjike, e cila është si një shpatë me dy teha, kah t'i jep luftëtari shpatës, ajo pret ose mbron. Shpesh më kanë pyetur njerëzit sesi është e mundur që një njeri prej një gote uji, që i ka hedhur personit para derës së shtëpisë, ta luajë mendsh; apo me marrjen e një qimeje, të sëmuret njeriu; apo me prerjen e një teshe po ashtu të çregullohet njeriu për tërë jetën e vet. U kam thënë se plotësisht është e mundur, dhe se, edhe tek ne, në Kosovë, dhe në trojet shqipëtare përgjithësisht, përdoret zakonisht magjia primitive dhe joprofesionale. Magjia profesionale është shumëherë më e rrezikshme se magjia primitive.

Sot shkenca, sidomos Fizika Atomike, e ka vërtetuar se çdo gjë që ekziston në natyrë është e gjallë, dhe se një objekt që për syrin e njeriut është i ngurtë dhe i vdekur, për

shkencën e sotit është i gjallë. Si është e mundur që një objekt i vdekur të jetë i gjallë? Shkenca e fizikës thotë se çdo objekt, pa marrë parasysh se a është i zjarrtë, i gazet, i lëngët apo i ngurtë, në vete mban atome dhe këtë me numër tepër të madh, të cilët lëvizin në mënyra të ndryshme, varësisht prej asaj se ai objekt çfarë materie kimike përmban në vete, çfarë strukture atomike ka, cilit element kimik apo cilit element kosmik i përket. Atomët, si grimcat më të imta që ekzistojnë, e kanë bërthamën me elementet tjera që sillen rreth bërthamës, të cilat lëvizin pa ndërprerë, si në objektin e gjallë, ashtu edhe në atë “të vdekur”. Në qoftë se edhe objekti “i vdekur” ka atome, të cilat lëvizin pa ndërprerë edhe që për syrin e njeriut janë të padukshëm, atëherë edhe një copë stof i marrur nga njeriu, mund të jetë i gjallë dhe ka energjinë e atij personi, të cilit i është marrë stofi. Atomi ka energji të jashtëzakonshme. Dihet se çfarë armësh, sot, kanë ndërtuar shkencëtarët. Atomi ka fuqi të marrë energjinë psikike dhe atë, me lehtësi shumë të madhe, ta mbajë atë energji dhe ta emitojë. Këtë fshehtësi e dinë magjistarët apo magjistaret tona, por jo siç e shpjegova nëpërmjet atomeve, por këta e dinë se ky ritual duhet të bëhet duke fryrë e duke bërë lutje; thjesht, me bërjen e ritualeve apo “të adeteve”, siç i quan populli te ne, dhe kështu e mbushin atë objekt të marrur nga personi i caktuar dhe bëhet programimi mental. Ky objekt i programuar mund të quhet një “*bombë atomike mentale*”, e cila është e mbushur me energji të madhe psikike, i afrohet në afërsi personit të caktuar (të cilit i dedikohet) dhe ndërdija e atij personi e pranon atë programin si të vetin. Pra, aura e atij personi të sulmuar, e lexon dhe e pranon atë magji apo urdhër mental dhe ndërdija vepron në moment ose më vonë, varësisht si është bërë programimi. Aura e atij objekti është shumë e madhe dhe mund të ketë ngjyrë të errët dhe erë të trishtueshme, nese është bërë për të keq. Këto valë janë shumë të holla dhe ende, në botën fizike, nuk kanë mundësi

që të regjistrohen dhe të maten apo të kontrollohen me mjete teknike. Ndërdija i takon anës irracionale, kurse vetëdija asaj rracionale. Ashtu edhe ndërdija e ka vetëdijen e vet. Këtë gjë vetë e kam vërtetuar, kur e kam bërë projeksionin e astralit me vetëdije, ashtu edhe kur kam qenë në ëndërr i vetëdijshëm. Në lidhje me këto valë shumë të imta psikike kam mësuar pasi që kam studiuar e punuar në praktikë me radiestezi dhe këtë, në degën e radionikës, ku kam qenë i fascinuar në këtë drejtim.

“Ligji i të ngjashmes” funksionon plotësisht në lëmin e radionikës. Në këtë ligj thuhet: *“Çka vlen për një pjesë, vlen edhe për tërësinë”*. Një qime e prerë nga floku juaj, është lidhje direkte me trupin tuaj subtil energjistik. Kjo është lidhje jomateriale, por reale, nëpërmes së cilës mund të ndikohet në ju. Ju jeni ndikimi rezonant që dërgoni valë në simbol. Magjistari, i cili punon në dagidi (figurë prej dyllit të bletës, e bërë në figurën e një personi të caktuar, dhe, në të cilën figurë, është bërë figurimi i një organi) . Në qoftë se magjistari e shpon atë figurë të dyllit me qëllim të keq, personi i përcaktuar mund të sëmuret aty për aty (nëse nuk ka mbrojtje). Po në qoftë se e shpon atë figurë të dyllit në ndonjë qakër, ku e aktivizon ndonjë organ të personit të caktuar, atëherë ai person mund të shërohet nga ai organ.

Kjo përvojë që e thamë më lart ndoshta ju duket e pamundshme, por këtë me të vërtetë e ka realizuar e vërtetuar Luj Montegi (libri i tij në gjuhën frengje: *Panorama de l'art sorcier*: Një paciente në spital të Parisit ka ndier dhembje prej Kongresit Amerikan, e shpuar nga personi i lartpërmendur, i cili para të gjithëve ka bërë eksperiment dhe kjo gjë, aty për aty, është vërtetuar nga personat që e kanë përcjellë këtë gjë në Spitalin e Parisit)¹.

Isha mbrapa banesës duke shkurtuar dru me disa miq, drutë i përgatitja për dimër. Në atë kohë erdhi shoku S.,i cili kërkoi ndihmë për t'i ndihmuar një femre, të cilën ai e njihte.

Ishte grua e martuar dhe shumë e sëmure. Shoku S. shpjegoi se ishte e sëmuer që 6 muaj, të gjitha analizat e mjekut ia kishin bërë, por asnjë sëmundje fizike nuk i kishin gjetur. Përkundrazi, fizikisht ishte plotësisht e shëndoshë. Mirëpo, në anën tjetër, shpirtërisht shkonte duke u sëmure shumë e më shumë. Shoku S. tha se e kemi pasur nëpër hoxhallarë, po asnjëri mirë nuk i ka bërë. Nuk kemi lënë vend pa e dërguar, aty ku kemi dëgjuar se dikush mund të ndihmojë, po askush nuk ka mundur t'i ndihmojë. Ajo nuk po han asgjë, është dobësuar shumë. Vetëm një çokollatë dhe një gotë qumësht në ditë e merr. Kur po vjen mbrëmja, po i bie të fikët, po e humb vetëdijen e kur po zgjohet nga agonia, po zgjohet me dhembje të mëdha si dhe bërtima të llahtarshme. Në atë kohë, tha, shkarravitet nëpër dysHEME, dhe nuk mundet askush ta ndalë e ta qetësojë. Kjo gjendje zgjat 2-3 orë e, pastaj, vjen në vete dhe pyet se “ku jam”, “çka është bërë me mua”. Gjatë kësaj kohe asgjë nuk mban mend, se çka ka ndodhur me të. Shoku S. tha se edhe ditën, kohëve të fundit, po e rrok kjo llahtari... tërë familjen e ka sjellë në gjendje të keqe... Të lutem, Salih, a po vjen njëherë të shohësh se a mund t'i ndihmosh apo jo. Unë i thashë se jam duke shkurtuar dru, po nuk ka problem, vij patjetër. E këshillova shokun S. që, kur të shkojë në shtëpi, të marrë një litar ose një shokë dhe rreth shtratit, ku ajo bjen, ta bëjë një rreth të përsosur dhe t'i vizatojë disa ylla 6 dhe 5 rremësh, ku ylli pesërrremësh të jetë me majë jashtë rrethit. Shoku S. shkoi e, pas një dy orësh, shkova edhe unë atje ku më priste shoku S.

Hyra në dhomën e pritjes, në odë. Aty ishte një grua, rreth 50 vjeç, me dy gra të reja, shoku S. dhe një mashkull tjetër. Shoku S. më sqaroi për rastin gjatë asaj kohe çka kishte ndodhur, ende pa ardhur unë këtu. Ky kishte bërë një rreth me konop reth e rrotull shtratit, aty në atë dhomë, ku ende shihej, që kishte rrethuar shtratin, si dhe i kishte bërë disa yje të parregullt dhe joprecizë. Shoku S. tha: Si e rrokte llahtaria,

ne e futnim në rreth dhe kjo menjëherë qetësohej e nuk i kishte më ato dhembje dhe ato bërtima të llahtarshme.

Rrethi magjik njihet si një mbrojtës i vërtetë i atij personi, i cili e bën për mbrojtje dhe hyn në të gjatë ritualeve magjike. Rrethi e simbolizon tërë universin. Faktikisht, ti si mikrokosmos je i mbrojtur prej çdo sulmi magjik gjatë asaj kohe derisa je në rreth.

Para meje ishte një femër e re, e dobësuar, e zbehtë dhe shumë e bukur. Fizikisht nuk dukej se ishte e sëmurë. Ishte gruaja e S. Duke biseduar ne, e rroki sëmundja. E vendosëm në dyshek ku ishte bërë rrethi, por këtë herë rrethi nuk bënte punë aspak, ajo vazhdonte të qëndronte pa vetëdije, ku pastaj shumë shpejt zgjohej dhe fillonte bërtimat e njohura, të çdoditshme të saj. Fillova të punoj me ato çka dija, që kisha mësuar për këto gjëra deri në atë moment kundër sulmeve psikike e magjike. Së pari e hipnotizova. Pastaj fillova ta qetësoj, por shumë shpejt më dilte prej kontrolli dhe prej hipnoze, e kapte llahtaria dhe bërtiste me tërë fuqinë që kishte. Në këtë mënyrë e provova shumë herë, por kot, prapë e vazhdonte të veten. I bëja mbrojtje psikike asaj dhe vetes. Ashtu e zgjeroja aurën mbrojtëse me ngjyrë të kaltër rreth meje dhe saj dhe, në botën astrale, rreth rrahtëve, i bëja yjet pesërremësh të pandërprerë në të katër anët e botës, që simbolizonin katër engjëjt kryesor. Kjo mbrojtje ndikonte përkohësisht, por si e humbja koncentrimin, prapë e rrokte e njëjta gjë. Unë nuk e kisha vërejtur se ishte mbushur dhoma me njerëz. Kishte ardhur Shpëtimi, i cili ishte medium shumë i mirë. E thirra atë dhe 6 veta të tjerë, u bëmë rreth dhe u kapëm dorë për dore. U mundova që tërë energjinë tonë ta përdornim për mbrojtje. U thoja që të koncentroheshin intensivisht në largimin e të keqes dhe në mbrojtjen e saj. Ajo, në atë kohë, qetësohej dhe binte në gjumë, por posa ne e lëshonim rrethin, menjëherë e rrokte llahtaria e mëparshme. Nuk dija se ç'të bëja më me të. S. dhe vjehrra e saj propozuan

që ta çonim në qytet, ta kalonte lumin dhe ajo e keqe do t'i kalonte menjëherë. Ky ishte një ritual që e kishin provuar më parë dhe që kishte pasur sukses. Mirë iu thashë, po e provojmë edhe këtë herë. Këta e kishin një kamion të vogël, ku hypëm në të: Pacientja, e cila ishte si në komë e që herë pas here zgjohej me bërtima të mëdha dhe me dhembje, vjehrra e saj, unë, shoku S. dhe burri i saj. U nisëm për në qytet. Me të vërtetë, posa e kaluam lumin Bistricë, ajo u qetësua plotësisht. Kjo grua, afër spitalit kryesor, te Gjumnazi, kishte gjininë: nënën e babanë e vet. Si hymë në shtëpinë e tyre, në çast u sëmure si më parë. Si duket, edhe këtu kishte burim magjik kundër saj. Edhe këtu u krijua një atmosferë e keqe nga llahtarija e saj. Iu kujtua dikujt, që ishte aty në afërsi një sufi-dervish dhe shkuan e e thirrën për ndihmë. Erdhi dervishi, i cili filloi menjëherë lutjet. Me vete i kishte tespihet e gjata. Tek ne sufi - dervishët i bajnë tespihet me 1001 kokërra. Këto tespihe sufite i përdorin për dhikër të ditës dhe të natës, ashtu edhe për shërimin e njerëzve. Disa sufi – dervishë, në fillim të atij rrethi të tespiheve, nga ana e djathtë, i kanë nga 7 kokrra të tespiheve, gjë që për ne ishte sekret dhe nuk e tregonin domethënien e tyre (Këta shtat kokrra jan edhe si simbol i shtat emrave kryesor të Zotit). Dervishi filloi ta përbironte këtë grua nëpër tespihe, pasi tespihet i bënte rreth, e fuste trupin e saj nëpër të. Këtë e bëri vetëm tri herë, dhe atë duke u lutur. Pasi që e përbiroi nëpër tespihe, e sëmura u qetësua dhe erdhi në vete, duke u habitur kur pa veten te prindërit e vet. Tha: çka kam lypur unë këtu?! Pas disa ceremonive familjare: çaj, kafe, muhabet, u gëzuam që u qetësua e sëmura, e cila filloi të bisedonte me të tjerët dhe tash isha i lirë të shkoja në shtëpi. Na përcuellën tërë familja. Hypëm në kamion dhe u nisëm për në shtëpi. Por, posa mbërrimë në vendin, ashtuquajtur Bazhdarhane, të qytetit tonë, me kamion, përsëri e rroki ajo llahtari. Burri i saj më luti të shkoja tek ta, se “nuk po dimë çka t'i bëjmë, e ti

ndoshta i ndihmon diçka. Prapë e shtrimë mbi dyshek, kur erdhëm në shtëpinë e tyre. Ajo vazhdoi bërtimën e mëparshme. Mirëpo, tash thoshte se donte të vdiste, se më nuk po mund t'i duronte dhimbjet e mëdha. Unë i bërtisja fuqishëm dhe i thoja se ti nuk guxon të vdesësh, ti duhet të shërohesh dhe të jetosh. Ti tash nuk e ke kohën të vdesësh, e, sëmundja ka për të t'u hequr, patjetër, se ne jemi më të fuqishëm dhe më të dijsëm. Në atë moment ajo u qetsëua. Vjehrra tha se “kah kemi qqyrur, na kanë thënë se ka magji të zezë dhe askush nuk ka mundur ta shërojë.” Nusja intesivisht valëvitej, duke bërtitur. U thashë disave që ta mbanin e ta ndalnin të mos shkarravitej më. Tre personave u thashë që ta mbanin, secili, për një gjymtyrë. Unë e kapa për një dore dhe e shtrëngoja sa mundja, me tërë fuqinë, ashtu edhe ata tre e shtrëngonin njëri për njëren këmbë, tjetri për tjetren, dhe njëri për njëren dorë. Arritëm vetëm për disa sekonda ta mbanim që të mos lëvizte, kur papritur, katër vetëve, na gjuajti në largësi disa metra. Njërën e përplasi për mur. Tri herë provuam, por, kot, na përplaste për mur, sikur të ishim lodra e jo njerëz. Kjo ishte një fuqi e hatashme, por e pakontrolluar, dhe e pavetëdijshme. Kjo ishte diçka e pabesueshme, një femër katër meshkuj t'i hedhte, si të ishin thasë me pupla e jo djem të fuqishëm e të rinj! Mbeta pa fjalë dhe çuditësha me fuqinë që e kishte kjo femër në këtë gjendje. Unë e dija se ishte në një gjendje transi, imponuar me dhunë nga ndonjë forcë e errët exhina-demon, pra nga magjia e zezë, por ende nuk e dija se ku ishte e fshehur në shtëpi magjia e zezë. Ajo edhe më tej klithte, se donte të vdesë, se nuk mund të jetonte më nga dhimbjet që kishte në trup e në shpirt. Unë i bërtisja me zë, se ajo nuk guxon të vdesë, se ajo duhet të jetojë dhe të shërohet. E dija se magjia ishte në atë shtëpi, po në atë kohë nuk kisha aftësi qartëpamësie për t'i gjetur ato. Përndryshe, më nevojitej një medium i mirë për t'i gjetur magjitë. Shokun Shpëtim, i cili ishte aty, në fillim e hipnotizova dhe e pyeta

për atë femër të sëmurë, por, për fat të keq, e bëri një gabim, dhe e humba besimin në të për të punuar më tutje, edhe pse, më parë, me Shpëtimin, kishim gjetur dhe shëruar magjitetë e zeza në tjera vende dhe atë me shumë sukses të madh.

Kur, papritmas, nëna e S. erdhi, duke bërë titur, e frikësuar, të lypte ndihmë për nusen tjetër: Salih, nusen tjetër e ka rrokur një dhembje e madhe dhe e padurueshme në kokë. E pyeta se ku ishte ajo nuse. Më udhëhoqi në një dhomë tjetër, ku nusja e re ishte tkurrur me tërë trupin e vet dhe e kishte kapur kokën me duar. Shihej se ishte shumë e plogështuar dhe vuante shumë. Nusja e re quhej B...e. Iu afrova dhe e pyeta se çka kishte. Më tha se po i dhimbte koka pa masë. Ia vura dorën pas koke dhe u koncentrova thellë në dhimbjen e saj, duke ia marrë në vete dhimbjen. Duke ia marrë dhimbjen, e ndija vetë atë dhimbje, por unë, për fat, e dija metodën e pastrimit nga ndotësitë që i merrja prej pacientëve, duke i shëruar, dhe menjëherë lirohesha prej saj. Kështu vazhdoja disa minuta dhe, pas pak, e pyeta sesi po e ndinte veten. Pak më mirë jam, tha. Rreth meje ishte mbushur dhoma me njerëz kurreshtarë. Nuk kisha kohë t'i largoja e të punoja në qetësi. Kështu B... e drejtova dhe i thashë: shikomë drejt në sy dhe bën çdo gjë unë çka të them. Mundohu vetëm zërin tim ta dëgjosh e asnjë tjetër. Kështu fillova ta hipnotizoja, edhe pse ishin kushtet e pamundshme për hipnotizim, meqë ishte tërë familja aty dhe bënin zhurmë. B... ra shumë shpejt në transin hipnotik, pavarësisht se tërë familja e saj kurreshtare, kinse donin t'i ndihmonin, rrinin mbi kokat tona. E pashë se ishte mediume shumë e mirë dhe aty për aty ia dhashë aftësitë për një kohë të shkurtër që të shihte me syrin e tretë, pra në botën astrale dhe eterike, dhe të dilte në ato botëra pa kurrfarë problemi, kuptohet nën udhëheqjen time. I bëra disa prova me të. E qita me trup eterik në botën eterike dhe e ktheja prapë në trupin fizik. I dhashë dhe aftësi të parashikimit dhe të dijes për çdo njeri,

kur unë ta pyesja. E pyeta për atë femër të sëmurë, se pse ishte e sëmurë. B... tha se ka shumë sehire të këqija. Së bashku me B... shkova tek e sëmura, e cila ishte në gjendje të keqe, duke klithur se donte të vdesë e nuk po mund t'i qëndronte mundimit të madh. E lidha B... me astralin e femrës së sëmurë, ku B... filloi të qajë për të. I thashë B... t'i thotë asaj se ajo kurrsesi nuk guxonte të lëshonte trupin e vet, se ajo duhej të shërohej dhe të jetonte. Në atë moment, fillova ta pastroja me ndihmën e B..., ku ajo, përkohësisht, u qetësua dhe ra në gjumë. E vura B... me trup astral aty në dhomë që të kontrollonte se mos kishte rastësisht magji të zezë. Së pari e mësova atë që ta njihte, nëpërmjet ngjyrës, sesi dukej magjia e zezë. I thashë se posa ta shihte, do ta njihte se prej kujt është bërë ajo, por vetëm mua do të më tregonte, të tjerëve jo. E kontrolloja gjithnjë B..., se mos po i ndodhte diçka dhe i thoja se “unë të kam nën kontroll dhe nën mbrojtje, asgjë nuk mund të të ndodhë, une ty të mbroj në çdo dimension”. Në këtë dhomë nuk pa asgjë. E nxora në një dhomë tjetër, ku dhe aty nuk pa gjë. E nxora në korridor dhe i thashë “shiko në çdo qoshe të këtij korridori dhe te dera kryesore e shtëpisë”. Pas pak, B... tha: “po këtu paska sehire!” Ku janë? - e pyeta me kurreshtje. Te dera e shtëpisë, në një qoshe, prapa një letfe të derës. I thashë: “kthehu në trupin fizik me astral”. Tha se u kthye. Isha me të vërtetë kurreshtar se çka do të gjente mbrapa derës. Iu afruam derës së shtëpisë dhe tha: “ja këtu”! B... e kishte zgjatur dorën eterike deri te dera e thoshte “ja këtu, unë po i prek me dorë!” Ne e shihnim B..., se veç në largësi po tregonte ku janë sehiret. I thashë të afrohet afër derës. Ajo u afrua dhe tregoi një vrimë, në një qoshe të derës, një një metër mbi tokë. Aty thellë dukej sikur të kishte diçka. E kërkova një tel ose, thashë, nëse e keni një krrabëz me të cilën thurren çorapët. Pas pak erdhi nëna e Sab... me një krrabëz në dorë. Ia mora dhe ia dhashë vetë B... që t'i nxirrte prej asaj qosheje, se ajo më mirë do t'i shihte, si në

materie, ashtu dhe në astral. Pas pak, e nxori një truq flokësh nga ajo vrimë shumë e vogël. Çuditesha sesi ishte e mundur që ajo vrimë të zinte aq shumë flokë! Ajo tubë e flokëve ishte në disa vende e lidhur nyje, me qëllim të caktuar, se flokët ashtu vetë nuk mund të lidheshin. Të gjithë u habitën me atë sukses, si timin, ashtu edhe të B.... E pyeta se të kujt janë këto flokë. Tha: „Të nusës së sëmurë janë flokët!“ Çka duhet tash të bëjmë me këto flokë? “Duhet jashtë shtëpisë t’i kallim ato“. Kështu, dualëm jashtë derës së oborit, në rrugë, dhe i kallëm. Kur filluan të digjen, e lëshuan një kundërmim të rëndë, sa mezi pritëm të digjeshin e të largoheshim prej atij vendi. Pasi u dogjën, shkuam në oborrin e shtëpisë dhe vazhduam hulumtimin e mëtutjeshëm të magjive të zeza. Tash e kishim katin e epërm pa hulumtuar. E urdhrova B... që të dilte me astral dhe të shkonte t’i hulumtonte dhomat e katit të dytë. E shikoi një dhomë, ku tha se nuk po shihte kurrfarë magjie. Shkoi në tjetrën dhomë, edhe aty nuk pa gjë. Tash i thashë të shkonte me astral në dhomën ku po flinte nusja e sëmurë. Kur, papritur, B... tha se në atë dhomë kurrsesi nuk po mund të hynte. Është plotësisht një errësirë e madhe dhe shumë ftohtë; aty janë magjitë kryesore ku ruajnë exhinët-demonët, unë nuk po mund të hyj. E urdhërova të kthehej në trupin fizik. Pastaj, i thashë që të shkonim lart së bashku dhe mos të vinin të tjerët. B... ishte në autotrans dhe duhej ta mbaja për dore, se nuk kishte fuqi të duhur dhe ishte si e përgjumshme. Ishte fillestare dhe nuk dinte sesi të veprojë në këtë gjendje. Por, edhe pse ishte fillestare në këtë lëmë, ishte medium i jashtëzakonshëm, shihte shumë mirë në astral dhe nuk gabonte. U ngjitëm lart në dhonën e nuses së sëmurë. Tash, ashtu në trans siç ishte, e pyeta se ku i kishte parë magjitë, në cilin vend të kësaj dhome. Ajo bëri me gisht kah muri përballë derës së dhomës. Mirëpo, aty kishte një regall të madh dhe të bukur. B...tha: “mbrapa atij regalli janë magjitë, të futura nën një letfë, në një vrimë të vogël.” I

thashë: a je e sigurt se aty janë magjitë. Po, tha. “Po më vjen keq t’ju them, thashë, po dikush prej jush duhet ta çmontojë këtë regall, se mbrapa gjenden të bamet (sehiret). Sab... tha se nuk ka kurrfarë problemi, nëse ka nevojë e bëjmë copë-copë, se na ka ardhur shpirti në fyt tërë familjes, na është bërë shtëpia xhehenem e nuk po dimë se kah t’ia mbajmë. Filluan ta çmontojnë. Unë dhe B... rrinim në këmbë dhe mendoja se çka do të bëhej - do të ishin me të vërtetë aty magjitë apo jo, se herën e parë kishim sukses të madh në gjetjen e tyre. Kur, papritur, B... filloi të më shikonte mua dhe të shikonte në një qoshe të dhomës, ku ishte një vitrinë me xhama, në të cilën ishte e fshehur një fotografi. E kuptova dhe kërkova të ma sillnin atë fotografi. Posa ma sollën foton, pa shikuar mbrapa, duke qenë i bindur se askush nuk ishte prapa nesh, i thashë: Kush është këtu që ka bërë magji në këtë shtëpi? Në foto ishin disa vetë dhe një plakë. E çoi gishtin te plaka. Kush është kjo? - e pyeta. Është halla e Sabit... Kur, papritmas, e dëgjova një bërtimë mbrapa nesh: Uh, Zoti e vraftë atë shtrigë, po shumë i kemi besuar dhe gjithnjë e kemi lënë vetë në shtëpi, e ajo... Me vrap shkoi poshtë në katin e parë të shtëpisë, ku ishte familja në tërësi. Unë e kisha nën kontroll B...dhe duhej të rrinim derisa t’i gjenim magjitë, se ishte me të vërtetë shumë me rëndësi. U ndi poshtë një bërtimë e madhe, ndihej një tollovi dhe parahati e veçantë. Babai i Sabit... e kishte marrë pushkën (çiften) e gjuetisë dhe donte të shkonte në Landovicë që ta vriste të motrën. E nxora prej autotransi B... dhe vrapova poshtë të shihja se çka u bë atje. Gruaja e kishte kapur burrin e vet për krahësh dhe nuk e linte të dilte prej shtëpije. Ai betohej se do ta vriste atë që u kishte bërë magji. I dola përpara dhe i thashë: “çka don të bësh ti me këtë gjest të keq? Ti nuk je gjykatës që ta ndëshkosh, po Allahu i plotfuqishëm është ai që gjykon e, tek e fundit, ti nuk e di a është e vërtetë apo jo kjo që thotë B...” Pastaj vazhdova: “Në qoftë se ti e bën këtë gjë, unë po shkoj në

shtëpi dhe tërë atë që punova deri më tash po e kthej si ka qenë. Unë kam ardhur të bëj mirë te ju, e jo keq. Të lutem, qetësohu, se ju lë si keni qenë më parë. Në çast u qetësua plaku dhe kërkoi falje për gjestin që bëri para familjes. Për këtë arsye nuk tregohet kurrë se kush i ka bërë magjitë, nëse nuk është e nevojshme, se dikush mund të futet në bela. Qëllimi i shëruesit duhet të jetë që atë familje ta pastrojë dhe ta mbrojë nga magjitë, nëse është e nevojshme tregohet personi dhe lexohet lutja që i shkatërron apo i kallë magjitë dhe exhinët (demonët) e ferrit që janë caktuar për ta sëmurë personin; më në fund, vetvetiu magjistaren e zezë do ta rrokë paraliza, të cilën vetëm mëshira e Allahut mund ta shërojë.

Shkova lart dhe prapë e hipnotizova B... duke e kthyer në autotrans. Regallin e larguan nga dhoma Sab... me vëllanë tjetër. Pasi që u lirua ajo pjesë e dhomës, B... tha se “prapa asaj letfe gjenden magjitë e zeza”. Iu afrova atij vendi, ku në një zgavër shumë të vogël dukej një tufë flokësh. I nxora me një brisk shumë të hollë. Ishin një tufë flokësh të prera me qëllim dhe të lidhura në tri nyje. U thashë se këto flokë janë të prera prej nuses me qëllim dhe të lidhura me qëllim të caktuar. B... tha se duhej t’i kallnim jashtë shtëpisë. Të gjithë u befasuan me suksesin tonë, po unë u gëzova më shumë, se pata shumë sukses. Dualëm jashtë oborrit dhe i kallëm. Po në atë moment, gruaja e sëmurë u zgjua nga ajo llahtari dhe u qetësua tërësisht, duke mbetur e habitur me vetveten, kur i tregonin se ç’ kishte ndodhur me të dhe si i kishim gjetur magjitë e zeza, si te dera e shtëpisë, ashtu dhe në dhomën e saj. Një gabim shumë të madh e kemi bërë që flokët e lidhura i kemi kallur pa i zgjidhur nyjet. Për këtë do të trego më poshtë se çka ka ndodhur pas këtij gjesti. Nuk mund ta merrni me mend se çfarë gëzimi e kishte kapluar atë familje. Ata u çuan dhe përgatitën shumë gjëra për të pirë dhe për të ngrënë, u bë festë e vërtetë që reja e tyre u shërua dhe bëri mirë. Këtë natë me B... shëruam shumë vetë aty. E

mësova B... që vetë të binte në autotrans. E mësova që të udhëtonte me astral. E njoftova me disa shehlerë që e kishin lëshuar trupin më herët në teqen e sheh Nexhatit të cilët ishin vetem dritë (nur), të cilët me dëshirë i ndihmonin, kur kjo kërkonte ndihmë. E njoftova me një të mbërrimë, i cili, pas një jave, e ka pranuar si nxënëse B... ku pastaj intensivisht e ka mësuar për shumë gjëra. Kështu këtë natë e kaluam për bukuri.

Të nesërmen mendova se çdo gjë është në rregull me atë familje kur, papritur, pas dite, Sab... më thirri në telefon dhe tha se nusja prapë është sëmure, po vetëm kur ka shkuar te nëna e vet. Të lutem, eja e na ndihmo. Shkova prapë dhe me kamion të vogël shkuam tek prindërit e nuses, e cila, me të vërtetë, prapë ishte sëmure, edhe pse e kisha shëruar ditën e kaluar. Me B... gjetëm prapë mbrapa një krevati flokë të lidhura nyje, sikur herën e kaluar. Flokët ishin të nusës vetë. Në atë dhomë nusja kishte fjetur kur kishte qenë vajzë. Si i kallëm, nusja u çue dhe më kurrë nuk është sëmure. Kësaj nuseje ia kam porositur një talisman, të mbushur me ritual të magjisë së bardhe dhe atë prej arit që ta mbrojë kundër çdo magjie të zezë.

Iu dhashë këshilla për nusen që ta dërgonin në spital dhe t'i jepnin diçka që t'i përmirësohej trupi fizik, sepse ishte dobësuar shumë prej magjive të zeza. Pastaj, u thashë që asgjë të mos merrte prej askujt, kur të vinin për ta parë. Nusen menjëherë e kanë dërguar në spital, ku intensivisht e ka ruajtur burri i vet.

Pas një jave, burri i saj më tregoi se derisa e kishte gruan në spital, kishte shkuar halla (motra e babait të tij) që ta vizitonte të sëmurën, dhe, s'i kishte sjellë gjë tjetër, pos një veze. Falmëni, se s'më ka qëlluar gjë tjetër, thotë, dhe kur tenton t'ia jepë në dorë, i shoqi ia rrëmben nga dora dhe e përze plakën... Mirë, tash shko!... - i thotë, Dhe e merr vezën, del jashtë, në rrugë, dhe i mëshon për asfalti, por – për çudi –

veza nuk thehet. “Prapë i mëshova, sa pata fuqi për asfalti, por, çuditërisht veja kërcente si një top gome dhe, kurrsesi, nuk thehej...” Dikur, tha, se ka marrë një gur të madh dhe, me sa ka pasur fuqi, ia ka lëshuar vesë përmbi dhe vetëm atëherë veja është bërë copë-copë... Pas një kohe, tregojnë se i kishin ndodhur shumë gjëra kësaj familjeje brenda një kohe të shkurtër. Tregojnë se B... tri ditë e tri netë kishte ndejur në trans, duke u lutur, se një fuqi e errët magjike kishte vendosur që dikend, prej asaj shtëpie, ta merrte. Kishte vendosur që ta merrte një vajzë të vogël, e cila e kishte ndjerë vdekjen dhe intensivisht qante e thoshte se nuk do të vdesë. Thonin se shpeshherë kërciste kulmi i shtëpisë, sikur donte dikush ta prishte. Kështu B... i kishin ardhur në ndihmë disa njerëz, shehlerë të vdekur, dhe atë krijesë e kishin larguar që askend të mos e mbyste. Megjithatë, ajo fuqi ia kishte mbytur një lopë dhe vetëm atëherë ajo shtëpi ishte liruar nga fatkeqësia.

Pastaj B... i kishte ardhur nga zëri i brendshëm që të shkruante në fletore, e kishte marrë lapsin dhe kishte filluar të shkruajë me një shkrim në persishten e lashtë. Kjo grua kurrë në këtë jetë nuk ka ditur të shkruajë asnjë gjuhë të huaj. I ka shkruar tri fletore dhe tash, kur i shkon ndokush për të kërkuar ndimë për ndonjë sëmundje, ajo i shëron me ato shkrime.

KEQPËRDORIMI I AUTOTRANSIT: ARSIMTARJA NË VEND TË NJËSHIT, NË DITAR, PA VETËDIJE, IA SHËNON DYSH

*“Njerëzit më shumë e ndiejnë erën e keqe të trupit të huaj,
sesa erën e keqe të trupit të vet”*

(Salih Basha, mistik)

Shpeshherë kur punoja me persona që ishin mediumë të mirë, kisha dëshirë që t’u ndihmoja, duke ua dhënë shifrën për autohipnozë, që, më vonë, ta përdornin për të mësuar më mirë në shkollë apo, përgjithësisht, për të mirën e vetvetes: për mësim të shpejtë dhe të gjatë, për shëndet, për programim të jetës për të mirën e vet në të ardhmen ose për suksese të gjithanshme. Mirëpo, 99% të personave e kanë keqpërdorur këtë fuqi të mrekullueshme, ku më vonë kanë qenë të pafat që ta përdorin këtë aftësi dhe e kanë humbur këtë aftësi. Keqpërdorimi i autotransit dhe humbja e tij për një njeri e ka peshën sikur një të verbri t’i jepen sytë për të parë, pa kufi, por, një ditë, ai, t’i humbasë sytë për shkak të keqpërdorimit të tyre dhe tani e tutje do të jetojë, si më parë, siç ka qenë i verbër. Pse po e them këtë? Çka qenka autotransi i vërtetë dhe a mundet çdokush ta ketë këtë aftësi? Unë e di se mundet çdokush ta ketë këtë aftësi, por, me një kusht, që ta ketë mësuesin e vërtetë me dije të madhe në të gjitha botërat, ose mediumi të punojë vetë me kujdes të madh, duke mos udhëtuar në botëra të tjera, pa qenë i përgatitur me dije të asaj bote, pa ditur mbrojtje psikike të lartë dhe pa ushtruar që ta pastrojë shpirtin e vet, se përndryshe është gjithnjë në rrezik nga sulmet e qenieve të errëta të astralit, të cilat janë shumë të

afta dhe e dinë në ç'shikallë të dijës gjendesh, kur ti, duke punuar, atyre ua çelë kanalin, ku mund të vijnë në atë rreth dhe të të bëjnë dëme të papërshkrueshme. Këtu në Evropë dhe në shumë vende të botës ka shumë hipnotizues, që vetë i incizojnë kasetat për autohipnozë dhe i shesin, por që rrallëkujt i ndihmojnë, sepse personi, edhe po hyri në autohipnozë, nuk di sesi të veprojë e çka të bëjë, ose provon ndonjë gjë që nuk di se çka është duke bërë dhe bën gabime me vetveten, sidomos nëse ka frikë dhe është i panjohuri për botën astrale. Ai person që ka frikë kur të bie në autohipnozë, frika në atë gjendje i shumëfishohet dhe mund të përfundojë në neuropsikiatri. Këtu nuk dua që t'ua fus frikën për autohipnozë, po, përkundrazi, dua t'ua çel sytë që mos ta keqpërdorni dhe mos të humbni, se qëllimi është që të fitoni me këtë e të arrini lart në zhvillimin shpirtëror. Hipnozën dhe autohipnozën unë e bëj në mënyrë mistike dhe personin që dua ti ndihmoi në sherim e zhvilloj dhe e mësoj përkohsisht për botëra tjera, për ligjet e atyre botërave dhe për qeniet e tyre, se për këto më ka mësuar përvoja shumëvjeçare, si teorike, ashtu dhe praktike.

Ja si ishte puna me shokun Sh..., i cili ishte medium shumë i mirë. Në këtë kohë, unë dhe shoku, Sabir Krasniqi, bënim eksperimente me hipnozë dhe e përdornim Sh...si medium të mirë për shumë eksperimente dhe për shumë punë në botën astrale, sidomos kur ishte puna për hulumtimin e magjive të zeza, për zbulimin e sëmundjeve të ndryshme; thjesht, në çdo lëmë që na binte ndërmend për të hulumtuar. Shoku Sh..., në atë kohë, shpesh qëndronte me ne, kur bisedonim për studimet e shumë fushave të okultizmit, të magjive etj., për të cilat, deri më tash, ky nuk kishte njohuri fare e as që kishte dëgjuar për to. Pasi që ishte nxënës i dobët në shkollë të mesme, vendosa që t'ia jap aftësinë që vetë të bie në autohipnozë dhe vetveten ta udhëhiqte, kështu që të kishte mundësi të mësonte më mirë dhe të bëhej nxënës i

mirë. Meqë isha futur në drejtimin e mistikës dhe kisha zbuluar sesi punohet me hipnozë, në këtë drejtim, ku rrallë ndonjë hipnotizues mund t'i bëjë këto gjëra, atëherë e pata mësuar edhe Sh... për këto gjëra dhe ky filloi të merrej me këto lojëra pa u këshilluar me mua dhe pa u shkolluar deri në fund për shumë gjëra që i përkisnin botës astrale, sidomos për qeniet e kësaj bote, rreziqet dhe mbrojtjen kundër çdo të keqeje. Ky e kishte një shok (Sad...), i cili shpesh e nxiste Shp... që të binte në autotrans dhe t'i hulumtonte gjërat personale, si të vetat, ashtu dhe të shokut, dhe shpesh preknin gjëra private, ku nuk kishin të drejtë të lëndonin sferën private të personave të tjerë, duke mos ditur dëmet që mund t'i shkaktoheshin vetë hulumtuesit, i cili veç sa kishte filluar t'i mësonte gjërat okulte. Shp.... nuk tregonte se çka ka punuar kur ka qenë vetë; ndonjë send tregonte shoku i tij, S..., se çka kanë punuar, kur kanë qenë vetë në shtëpi, dhe, kur punoja me Shp... me hipnozë, e detyroja të ma tregonte të vërtetën se çka kishte punuar dhe çka kishte hulumtuar në trans me qëllim që ta dija se mos po i bënte dëm ndokujt apo vetvetes.

Një ditë, tërë klasa e Shp..., kishte provim me shkrim nga matematika. Tjetrën ditë arsimtarja e lëndës i kishte sjellë provimet me shkrim dhe ua lexonte notat. Pasi ua lexoi notat, secilit me rend, ua vënte notat në ditar. Shp.. në këtë lëndë ishte i dobët dhe e kishte marrë njësh (notë të dobët). Por Shp... kishte vendosur ta bënte një eksperiment me arsimtaren e matematikës dhe ishte plotësisht i sigurt se ajo ngjarje, ashtu si donte vetë, do të ndodhte. Në bangë ishte ulur së bashku me shokun e vet, S..., të cilit i thotë:: shih se çka kam për t'i bërë arsimtares së matematikës. Arsimtarja tash i thirrte me rend, ua tregonte notën që kishin marrë në provim me shkrim dhe ua vënte notën në ditar. Shp.. bie në autotrans dhe e merr nën kontroll ndërdijen e arsimtares. Shokut të vet i thotë: “arsimtarja do të thotë me zë Shp....

njësh, kurse në ditar ka për ta shënuar dysh, pa vetëdije, dhe patjetër këtë ka për ta bërë”. Shoku S... i thotë : “ik, more, se kjo është e pamundur”. Shp... i thotë “ke për të parë se plotësisht është e mundur”.

Ditari ishte i hapur, ku shiheshin emrat dhe notat që i shkruante arsimtarja. Për çudi, ndodhi diçka që askush nuk e kishte pritur. Arsimtarja kur erdhi te emri i Shp...tha : Shp...: njësh, kurse në ditar, në rubrikën e duhur, ia vuri dysh (notë kaluese) dhe e shkroi me laps kimik, që vështirë fshihej. Në atë moment, e tërë klasa filloi të qeshte, meqë e dinin se Shp... ishte nxënës i dobët në këtë lëndë dhe e kishte marrë njësh. Arsimtarja i urdhëroi nxënësit që të ndaleshin e të mos qeshnin, se nuk ishte për të qeshur. Një nxënës u ngrit dhe i tha arsimtares: “Shp... ia vure dysh në ditar, edhe pse e ka marrë njësh.” Arsimtarja, me bindje, tha se ia kishte vënë njësh. Prapë, klasa filloi për të qeshur me arsimtaren, e cila ishte shumë e bindur se ia kishte vënë njësh dhe nuk e shihte kurrsesi gabimin, sepse i ishte ndërruar bindja në ndërdije, ku ajo aspak nuk mund ta merrte me mend një gjë të tillë. Shp... e bëri një urdhër kolektiv për tërë klasën që të mos qeshte më dhe klasa, në çast, u qetësua dhe harruan në moment se çka ndodhi. Ky ishte një keqpërdorim që nuk bën të përsëritet.

KEQËPËRDORIMI I AUTOTRANSIT

ARSIMTARI I GJUHËS TËRË ORËN BËRI SHAKA PA VETËDIJE

“Tepër i mirë, jo i mirë, tepër i keq, shumë i keq”

(Salih Basha, mistik)

Si çdo kund, ka profesor ose arsimtar që punën e vet e bëjnë në mënyrë korrekte, me disiplinë dhe seriozitet të vërtetë. Rast i tillë ishte dhe një arsimtar i gjuhës pranë kësaj shkolle të mesme të Prizrenit, ku mësimet i vijonte dhe mediumi ynë, Shp.... Ky arsimtar i gjuhës ishte serioz dhe i përpiktë në punën e tij. Nga serioziteti i tepërt, nxënësit kishin frikë nga ai, se shpeshherë i dënonte nxënësët, të cilët nuk u përmbaheshin rregullave që ky ua kishte dhënë nxënësve dhe rrallëkush këtë arsimtar e kishte parë, në klasë, duke qeshur ose duke bërë shaka. Përçdoherë, kur vinte në klasë, shkonte në vend dhe ulej, e çilte ditarin, pyeste se kush mungon, tregonte se çka kanë atë ditë për të mësuar, dhe, shkurt, ishte i përpiktë dhe serioz. Këtë ditë, ky arsimtar duhej të pyeste me nota.

Shp... i thotë shokut të vet, S...: “Sot arsimtari ka për të pyetur me nota, shiko se çka kam për t’i bërë, se duhet të përgjigjem dhe unë me notë e nuk jam i përgatitur. Sot arsimtari i gjuhës, tër orën, vetëm ka për të qeshur e për të bërë shaka, ka për të treguar vica dhe do të harrojë tërësisht se ka dashur të pyesë me notë, aspak duke mos qenë i vetëdijshëm që ka bërë tërë orën shaka.” Shoku i tij i thotë Shp... se kjo gjë është absolutisht e pamundur, arsimtari i gjuhs të bëjë një gjë të tillë, kurrsesi nuk është e mundur. Atë kurrë nuk e kemi parë duke qeshur, pa le më të tregojë vica. Shp... i thotë “ke për ta parë vetë .“ Shp..., pra, kishte filluar

të bëhej mjeshtër i vërtetë i manipulimit me ndërdijen e të tjerve, duke mos ditur pasojat e ardhshme që do t'i vijnë nga kjo gjë.

Si hyri arsimtari në klasë, si zakonisht, u ulë në karrige, e lëshoi ditarin mbi tavolinë dhe tha seriozisht se sot ka për të pyetur me nota. Por, për çudi, pas një momenti iu ndryshua fytyra serioze që e kishte deri më tash dhe filloi të qeshë dhe të bëjë shaka, të tregojë barcoleta, njëjtë sikur të ishte me shokë të vet e jo me nxënës. Tregonte vica që nuk u tregohen nxënësve. Klasa ishte, tërë orën, në gëzim e hare, duke qeshur e duke u argëtuar si është më së miri. Sot kaloi kjo ditë për mrekulli dhe të gjithë nxënësit ishin të befasuar sesi ishte e mundur një gjë e tillë me arsimtarin, shumë serioz, të gjuhës. Qe, dora ,se je fantastik! - i tha S...shokut të vet, Shp...

Të nesërmen e kishin edhe një orë me të njëjtin arsimtar. Kur hyri arsimtari në klasë, si zakonisht, e hodhi ditarin mbi tavolinë dhe iu tha nxënësve: “Dje ju kam pyetur me nota, kurse sot e kemi një mësim të ri.” Shumica e nxënësve u përgjigjën: “Jo, arsimtar, dje ke bërë tërë orën shaka me ne dhe ke treguar vica”. – Çka?! Kjo nuk është e vërtetë, unë dje ju kam pyetur me nota “- tha arsimtari i gjuhës me habi të madhe. Kur e hapi ditarin dhe e pa të zbrazët, që me të vërtetë nuk kishte asnjë notë, u zbeh i tëri në fytyrë. E pyti edhe një nxënës tjetër për ditën e kaluar, njëjtë e mori përgjigjen dhe u bind se diçka nuk ishte në rregull me të. Ashtu i zbehur, arsimtari mbeti në një shok psikik mbi gjysmën e orës, duke menduar se mos kishte kapituluar psikikisht, i preokupuar thellësisht sesi ishte e mundur që ky të tregonte vica, të cilët nuk fliten, para nxënësve.

Edhe ky ishte një keqpërdorim i autotransit, që hyn në fahun e magjisë së zezë.


Këtu po u tregoj shumë gjëra të palejueshme që i ka bërë ky medium. Këto i kam vetëm si shembull që të tjerët, të cilët do të punojnë me këto gjëra, mos ta keqpërdorin autotransin, se më vonë i kanë pasojat negative për vetë keqpërdoruesin, sa nuk mund ta merrë me mend asnjëri. Mos të harrojmë se me shokun Shp... kemi kryer shumë punë të mira në autotrans, u kemi ndihmuar shumë njerëzve për t'u shëruar, si fizikisht, ashtu edhe psikikisht, sidomos kemi bërë shërimin e njerëzve prej magjisë së zezë mu në qytetin e Prizrenit.

Po ua tregoj edhe dy raste që i kanë ndodhur të njëjtit medium.

HARRIMI I TRUPIT ETERIKO- ASTRAL NË TRUP TË FEMRËS

*“Dembeli gjithmonë thuaja dy herë e kryen të njejtën punë”
(Salih Basha, mistik)*

Shp..., një ditë, i kishte dhuruar një unazë një femre të re dhe të bukur. Me këtë femër nuk kishte qëllime serioze, por vetëm qëllim të aventurës, edhe pse i ishte betuar për seriozitet. Një ditë, me shokun e tij, S..., si zakonisht, donin të bënin një eksperiment me trupin astralo-eterik dhe të dinin më shumë për qëllimet e asaj vajze. Shp...



„Ngushëllimi“ (foto)

del prej trupit të vet fizik me trup eterik dhe shkon e i futet asaj vajze në trupin fizik, për t’ia lexuar qëllimin. Edhe pse kishte mënyra të tjera për ta njohur të vërtetën për atë femër, ai e zgjodhi këtë mënyrë, që fare nuk është e preferuar për amatorin, sepse me këtë metodë, njeriu mund të marrë ndonjë sëmundje prej tjetrit, nëse nuk ka mbrojtje psikike ose nuk di për këto gjëra. Pasi që hulumtoi atë që dëshoi, Shp... doli prej

autotransit. Pak pasi doli prej autotransi, i thotë shokut të vet se ishte shumë i lodhur. Dhe ra për të fjetur më herët. Të nesërmen duhej të shkonin, së bashku me shokun e vet S..., në shkollë. Kur u nisën për në shkollë, Shp... diçka nuk ishte në rregull: ishte i trullosur, dukej i hutuar, nuk kishte kontroll as në të folur, as në të ecur. Shoku i tij, S..., tregonte sesi këtë ditë puna ishte shumë keq me Shp... Shpeshherë nuk kishte kontroll, kur donte ta kalojë rrugën, nuk shikonte anash. Disa herë gati e shkelën automjetet. Në shkollë nuk fliste, rrinte i përgjumshëm. Kur e pyeste dikush, nuk përgjigjej. Vetëm thoshte se nuk ishte mirë, diçka nuk ishte në rregull. S... thotë se “mezi e kam dërguar në shtëpi, duke u kujdesur shumë për të, se mos po e shkelte ndonjë auto.” Kur kthehen në shtëpi, shokut të tij i kujtohet dhe, ai, i thotë: “Bjer në autohipnozë dhe shiko se çka është puna me ty”. Kur Shp... bie në gjendje tjetër psikike, sheh se astralin e kishte harruar, tërë natën, në trupin e asaj vajze, së cilës ia kishte dhuruar unazën. Posa e ktheu trupin astral në trupin e vet fizik dhe doli prej autotransi, Shp... menjëherë u kthjellua, sikur të mos kishte ndodhur asgjë. Filloi të fliste si është më së miri me të tjerët. Atë ditë, pas dite, e takuam atë femrën që ia kishte dhuruar unazën. Ajo erdhi te Shp... dhe e nxori unazën prej gishtit me protestë, duke e fyer atë dhe duke i thënë: “Tërë natën të kam parë ëndërr dhe e di se ti nuk kishe kurrëfarë qëllimi serioz veçse të më shfrytëzosh. Merre këtë unazë, se nuk më nevojitet unaza jote.”

Tani do t’ju tregoj sesi Shp..., si medium shumë i mirë, në vend që t’i zhvillonte këto aftësi dhe të përparonte kah dija më e lartë kosmike, ai e humbi edhe atë që kishte. Kjo gjë i përngjan, siç theksuam edhe më lart, sikurse qorrit t’i jepen sytë dhe, pas pak kohësh, t’i humbasë ata prej mosdijes, duke provuar gjëra që nuk duhet të provohen. Magjistari më i madh i shekullit 19-të, Elifas Levi, për fillestarët dhe ata që në fillim bëjnë këso gjëra, thotë: „Një

njeri fillestar kur të hyjë në botën okulte dhe i provon forcat e tilla pa u shkolluar si duhet, i përngjan një fëmije të paditur, i cili hyn në grumbull të barotit dhe luan me shkrepsë, duke mos ditur se mund ta djegë veten dhe të tjerët“. Të njëjtat gjëra, thuaja i ka bërë vëllai im, Samiu, prandaj më vonë, jam detyruar që t’ia humbas autotransin, për të mos i bërë dëm vetes apo të tjerëve, sepse deri në atë kohë ai ishte ende i papjekur dhe nuk kam mundur ta kontrollojë se çka po bën me ato fuqi të padukshme.

Një ditë, Shp... dhe shoku i tij, S..., në dhomën e vet, vendosin që të hulumtojnë diçka në astral. Shp... del me trupin astral dhe pa e bërë mbrojtjen psikike, të cilën as që dinte ta bënte, shkon në një dimension tjetër. Mirëpo, në atë rast, aty pari kishte qëlluar një krijesë ferri. Ia sheh trupin e tij fizik të zbrazët e pa mbrojtje dhe vendos të futet brenda tij, ngase këto krijesa mezi presin të gjejnë një trup të tillë pa zot. Këto krijesa janë të lloj-llojshme, siç janë exhinatë apo të ashtuqujturit demonë të kategorive të ndryshme: Njerëz që kanë vdekur dhe nuk pajtohen me vdekjen dhe, me çdo kusht, mundohen të jetojnë në materie apo krijesat të tjera negative që vijnë gjatë ditës nga Ferri ose janë të shtuquajtur elementar që janë të krijuar prej ndokujt dhe tash janë bërë të gjalla që kërkojnë që të manipulojnë me të tjerët. Posa ajo krijesë ferri i futet në trupin fizik, Shp... menjëherë kthehet trupit të vet. Por, krijesa nuk e lejonte Shp... të futej në trupin e vet fizik. Ajo protestonte dhe ia hedhte trupin fizik prej një qosheje të dhomës në tjetrën, herë e përplaste për mur, herë për dysheme, herë e ngriste pezull. Kjo ngjarje i përngjante një filmi horror të vërtetë. I kujtohet Shp... që ta thërrasë magjistarin apo mësusin e vet. Me këtë magjistar, unë e kisha njoftuar më parë në astral, magjistar të shekullit 15, i cili kishte pranuar t’i ndihmonte Shp... në mësimet okulte. Posa e thërret, ai menjëher vjen, ia largon prej trupit atë krijesë (apo

demon) dhe e ndjek që mos t'i kthehet më. Në atë moment, Shp... lirohet dhe kthehet normalisht në trupin e vet fizik.

I nderuari, Mehmet Selaj nga Prizreni, i qet në dritë disa fshehtësi në lidhje me atë se pse kanë të drejtë krijesat e ferrit të dalin ditën në materie. Mehmet Selaj thotë se të keqes i është e lejuar që prej ferrit t'i lëshojë të dalin ditën një numër të caktuar krijesash ferri. Për çdo ditë ato kanë të drejtë, ditën, të dalin vetëm nga 3 orë. Sakaq, ditën e premte, kanë të drejtë të dalin në materie 7 orë. Kjo ditë për ne është më e rrezikshmja, sepse intensivisht 7 orë jemi të sulmuar padukshëm nga këto krijesa të padukshme të ferrit, edhe pse ne në popull këtë ditë e marrim si ditë të shenjtë që është plotësisht gabim. Profetët nuk kanë treguar për këto gjëra në mënyrë që mos ta frikësojnë popullin, por ata kanë thënë, sidomos profeti Muhamed, se të premten duhet të mos punohet shumë, të falemi dhe të lutemi më tepër, se lutja Zotit ndihmon që të mbrohemi nga e keqja, nga krijesat e ferrit, të cilat janë shumë të rrezikshme për ata që mendojnë keq apo bëjnë keq, se me mendime të këqija u çilet rruga dhe u përgatitet terreni në trupin tonë fizik e astral atyre krijesave suptile, të cilat janë të padukshme për sytë tanë fizik.

Prej këtij momenti Shp... më nuk guxoi të luajë me autotrans dhe dalngadalë e humbi këtë aftësi të madhe okulte dhe iu kthye jetës normale, si ka qenë më parë: i paditur në lëmenjtë okult.

BISEDË ME BIMËT

SHP... FLET ME TRËNDAFILIN

“ Me të mirë arrin të bëhesh i shenjtë, kurse me të keq diktator”

(Salih Basha, Mistik)



„Shpirti i drurit“ (foto)

Pas studimeve të ndryshme e punimeve shkencore të shumë shkencëtarëve eminentë botërorë, sidomos të biologut Bakster, një amerikan, i cili kishte bërë shumë eksperimente me bimët në kohën e vet, për herë të parë kishte zbuluar, rastësisht, se bima reagon në strese njëjtë, sikurse njeriu, në qoftë se lidhet me detektor të ashtuquajtur “detektor i rrenëve”, ku polizija zakonisht e përdor për zbulimin e

rasteve të pa zgjidhëshme. Bekeri e vërtetoi më vonë se bima, sikurse njeriu, ka jetë dhe e di se çka po ndodh në rrethinën ku jeton dhe më gjerë. Ky biolog bëhet shumë i njohur në botë për zbulimet fascinuese me bimë, sidomos në hulumtimin e bimëve me anë të hipnozës, me ç'metodë bëri shumë zbulime interesante. Kështu edhe unë vendosa të bëj eksperimente me bimë me anë të hipnozës. Një natë, isha te shoku Sabir Krasniqi, me të cilin bënim eksperimente me hipnozë. Me ne ishte mediumi (Shp...). Vendosa që këtë natë ta bëj një eksperiment me bimët. Kisha dëshirë që, në trans, ta shndërroja trupin eterik të Shp... në bimë apo në ndonjë dru dhe të shihja se çka do të ndodhte me të - a do të dilte ashtu siç të tjerët kishin bërë eksperimente të tilla e të ngjashme. Pasi e dija se trupi eteriko-astral ka mundësi të marrë forma të ndryshme dhe atë çfardo forme qoftë - të bimës, të njeriut, të shtazës apo çfardo qenie a objekti që ekziston në univers, vendosa që ta hipnotizoja Shp... dhe fillova në këtë mënyrë: E futa në trans të thellë hipnotik dhe i thashë: Shp... ti e njeh mirë oborrin e shtëpisë, ku banonon tash Sabiri! Po, tha Shp... Para derës hyrëse të shtëpisë, në anën e djathtë, ekziston një trung trëndafili, me trëndafila të kuq. Shp... tha: po, e di. Pra, shikoje mirë edhe një herë dhe prej këtij momenti kam për ta dhënë një aftësi që ti të shndërrohesh në çfarëdo forme. Tash ke aftësi të shndërrohesh në atë trëndafil, i cili gjendet para derës së shtëpisë së Sabirit. Trupi yt astral i tëri ka për të marrë të gjitha vetitë e atij trëndafili të bukur, që gjendet para derës së shtëpisë, me gjithë çka ka ai trëndafil, si me dije, ndjenja, shije, bukur; pra çdo send çka ndien ai trëndafil, ke për të ndier edhe ti; çdo send çka di ai trëndafil, ke për të ditur edhe tij. A kuptove mirë? – I thashë. Po, tha qartë Shp.... E urdhërova dhe i thashë: Këmbët e tua po shndërrohen në rrënjë të trëndafilit; duart e tua po shndërrohen në degë dhe fleta të trëndafilit. Trupi yt po shndërrohet në trup të

trëndafilat, kurse koka po të shndërrohet në lule të trëndafilat. Ti tash je komplet ai trëndafili para shtëpisë së Sabirit dhe nuk je përkohësisht Shp.... Pas pak, e pyeta: kush je ti tash? Ai u përgjigj seriozisht: unë jam ai trëndafili i cili jeton para derës së shtëpisë së Sabirit. Prapë e pyteta: tash nuk je Shp? Jo, tha, tash jam trëndafil. Bukur, i thashë, të lutem më trego si po e ndjen veten si trëndafil? Ai u përgjigj: mirë, po jo aq mirë! I thash: po pse, a mos ke ndonjë problem që po të mundon? Të lutem, më trego saktë cilat janë ato probleme që po të mundojnë? Shp... u përgjigj serioz: Një nga problemet me rëndësi është ai me Bujën (vllau i vogël i shokut Sabir)! Pse me Bujën, çfarë problemi ke? - e pyeta. Ai vazhdoi: Kur po çohet Buja, natën, po më pshurrë, ashtu i përgjumshëm, nuk po shkon në WC, por po vjen drejt e po më pshurrë mua, se po i vjen më lehtë për t'u liru, duke mos ditur se mund të më thajë me urinë! Të gjithë ne që ishim në dhomë qeshëm me zemër me atë thënie të Shp... në trans. Më vonë e vërtetuam dhe e pyetëm nënën e Sabirit, e cila i donte shumë trëndafilat. Ajo na tha se me të vërtetë ndonjëherë Buja po urinonte i përgjumshëm te trëndafili, ku edhe vetë po brengosej për atë gjë, se i donte pa masë trëndafilat e saj të bukur, e cila intensivisht kujdesej për ta.

Po tjetër problem a ke që të mundon? -e pyeta Shp... Po, tha, djali i vogël i Sabirit po vjen nganjëherë e po m'i rrahë dhe po m'i prishë fletët me një thupër, ku atij po i duket lojë, duke mos e ditur se po më lëndon; nuk po mundem si duhet të marrë energji prej diellit, se pa fletë nuk mund të ushqehem. Nëna e Sabirit po na ruan mjaft ne drëndafilave, po ky, prapë, po vjen e po na i lëndon fletët. Edhe kjo është e vërtetë, tha shoku Sabir. Po tjetër problem, me trëndafilat tjerë, a ke? e pyeta prapë Shp.... Po, më tha, e kemi një problem të madh të gjithë trëndafilat dhe një frikë të madhe prej atyre krimbave, që iu kanë vërsulur asaj dardhe të shkretë dhe gati e kanë tharë tërësisht, duke ia ngrënë fletët.

Edhe ne, ashtu, po frikohemi, se mos po vijnë te ne e njëjtë mund të na thajnë. Prej kurrështjes u ngritëm dhe pamë në oborr, se me të vërtetë e kishin sulmuar krimbat atë dardhë, së cilës ia kishin dëmtuar fletët thuaja tërësisht. Pas kësaj unë u interesova për shumë gjëra, ndoshta për gjëra që askush në botë nuk di për to dhe fillova ta pyes më tutje. Fillova ta pyes dhe të flas me të, duke i thënë: Ju e dini se njerëzit e kanë trurin në kokë dhe nëpërmes trurit njerëzit mendojnë dhe lidhen me botën fizike, ju trëndafilat ku e keni trurin me të cilin po mendoni dhe po flitni sikurse tash që ti po flet me mua? Ai u përgjigj me një ton interesant: Jo, këtë nuk guxoj ta tregoj, se nuk bën; është rrezik për ne trëndafilat! Pse është rrezik për ju? - e pyeta. Është rrezik për ne trëndafilat, se po e ditët këtë fshehtësi, ju njerëzit, mund të na shkatërroni. Unë mbeta pa fjalë, duke menduar se ç'do të thotë kjo, fytyra e tij ishte serioze dhe fliste me ton serioz. Mirëpo, unë isha kurrështar dhe këmbëngulës, ndaj fillova në lloj - lloj mënyrash t'i bëja pyetje, që ta nxirrja të vërtetën nga ai për trurin e fshehtë, se ku e kanë trëndafilat. Fillova ta pyes me rend se a e kanë trurin në lule, tha jo; në rrënjë, prap tha jo; në trung, po ashtu tha jo, nuk e kemi aty; filloi të heshtë dhe nuk fliste kurrësi. Tash fillova në mënyrë të qetë të bisedoja me të: Ju, të gjithë trëndafilat, shumë mirë e dini që unë ju adhuroj, ju dua, ju kultivoj, ndihmoj rritjen tuaj dhe ju jap dashuri. Ai u përgjigj: Po, ne e dimë këtë për ty. Atëherë, pse nuk po më tregon se ku e keni trurin, me të cilin po mendoni? Mirë, po të tregoj veç ty e askuj tjetër dhe, me zë të ulët tha: "trurin, ne, trëndafilat, e kemi pikërisht ku mbarojnë rrënjët dhe fillon trungu, në tokë, ku duket si gungë në mes të trugut dhe rrënjëve, aty ne e kemi trurin me të cilin mendojmë; por, të lutem, mos i trego askujt, se mos po na dëmton ndokush. I thashë: jo, mos ki dert për këtë. Dhe ai, në moment, u qetësua, si në trup, ashtu edhe në fytyrë. Pastaj, Shp... të shndërruar në trëndafil, fillova ta pyes përsëri:

Shpeshherë, mua , po edhe të tjerëve, kur është koha e çeljes së trëndafilave, na shkon mendja të marrim, të këpusim një trëndafil të bukur për t'i marrë erë, ndonjëherë edhe e këpusim nga një. A dëmtoheni ju trëndafilat nga ne njerëzit me këtë gjest? Shp...- drandafil, tha: jo, kurrsesi nuk na dëmtoni, sepse ne vetë ju detyrojmë, pa vetëdijen tuaj normale, të këputni ndonjë trëndafil, sepse ju, kur t'i merrni erë gonxhes sonë, ju kënaqeni dhe na dërgoni dashuri e ne ushqehemi me dashurinë tuaj, dhe sa ma shumë dashuri që ju na jepni, ne edhe më të bukur bëhemi. Me të vërtetë kjo ishte një përgjigje interesante, se dashuria e mban gjallë jo vetëm një trëndafil, por edhe tërë Universin. Në atë rast, m'u kujtuan shumë tregime për bimët që kisha lexuar, si nga biologu Bakster dhe të tjerët. Në librin e vet Baksteri tregon një tregim interesant të një magjistareje plakë, të magjisë së bardhë, e cila këshillon që të bëhet eksperiment me dy fletë të njoma të ndonjë bime: Merrni dy fletë të freskëta të ndonjë bime. Njëren fletë lejeni mbi orman dhe harroni që ajo ekziston më; kurse tjetrën fletë, mbajeni te shtrati, ku fleni, dhe atë fletë, për çdo natë, merreni në dorë dhe nga dhjetë minuta shikojeni me dashuri të pandërprerë, kështu 30 ditë rresht. Kur të bëhen 30 ditë, merrni dy fletët, atë mbi orman, e cila me siguri për dy ditë është plotësisht e tharë dhe këtë, që i keni dhënë dashuri, e cila fare nuk është tharë nga dashurija që intensivisht i keni dhënë. Baksteri tregon se ky eksperiment ka pasur sukses të qindpërqindtë, se koncentrimi në fletë, duke i dhënë dashuri, ka qenë i nivelit të lartë. M'u kujtua edhe fleta e një peme, të cilën, sipas disa shkrimeve, e kanë gjetur në Turqi, e, mbi të cilën, me shkronja arabe, kanë shkruar, fjalën Allah, ku tërë fleta është tharë, vetëm fjala Allah ka mbetur e freskët në fletën e tharë, meqë fjala Allah e tëra është dashuri e pakufishme.

Pastaj, e pyeta Shp... - trëndafil: Kush po të do më së shumti në këtë shtëpi? Tha me gëzim: Nëna e Sabirit; nën

dashurinë dhe kujdesin e saj ne po rritemi si është më së miri. Të gjitha këto ishin të vërteta dhe ne, gjithë të pranishmit, u befasuam me përgjigjet e Shp... - trëndafil. Pas këtij eksperimenti të suksesshëm, kuptohet se e ktheva në gjendje normale, si njeri, sikur ka qenë më parë, duke i thënë: Ti, tash, je trëndafil apo jo? Po, tha Shp..., trëndafil. Prej këtij momenti ti tash po kthehesh në gjendje normale tënden, si ke qenë, si Shp...; kur të numroj deri në tre, ti do të jesh Shp...: 1.2.3... tash je Shp... normal... Kush je tash? e pyeta. Shp..., tha, tash jam unë, Shp... Bukur, i thashë, dhe e nxora prej transit hipnotik si zakonisht.

Eksperimente të ngjashme kam bërë edhe me motren, Luljetën, e cila po ashtu ishte medium i mirë. Luljetën, njëjtë, e kam shndërruar në një trëndafil të shtëpisë, si dhe në shumë gjëra të tjera në fshatin Vraniq, ku banonte babai dhe vëllezërit e mij. Kur e kam shndërruar Lulen në një trëndafil të shtëpisë, jam befasuam me përgjigjet që i dha Luljeta si trëndafil. E pyeta se si po e ndjente veten si trëndafil, që po jeton nën strehë, para shtëpisë sonë? Ajo u përgjigj shpejt e me ton të lartë: Shumë keq po e ndjej veten dhe shumë po frikohem, se mos do të thahem! Pse keq, çka ke? Lulja - trëndafil u përgjigj: Babai, Azemi, më ka prerë deri në rrënjë dhe ka dashur të më shkulë krejt prej atij vendi e të më gjuaj, i jam bërë tullusum... Unë menjëherë dola të shoh se a ishte e vërtetë ajo çka tha Lulja si trëndafil, se unë i kisha mbjellë ata trëndafila dhe i doja. Kur, ç'të shohësh: me të vërtetë deri në rrënjë e kishte prerë babai dhe kishte filluar të gropojë vendin për ta nxjerrë tërësisht atë trëndafil, por për ndonjë arsye të panjohur për mua e kishte ndërprerë punën e nuk e kishte nxjerrë prej dheut. Shum mirë më kujtohet një rast, kur kam punuar me një shok nga Sophia, me shokun, Ali Jashari, i cili ishte medium shumë i mirë e i cili kishte një problem dhe dyshonte se mos i ka bërë ndokush në të kaluarën magji të zezë. Kur e futa në trans, ia dhashë aftësinë e përkohshme që

t'i zbulojë nëse i ka bërë ndokush magji. Në trans e gjetëm se një plakë, e cila kishte vdekur, i kishte bërë atij dhe tërë shtëpisë magji të zezë që askush mos të shkonte mbarë në atë shtëpi. Ajo plakë kishte qenë e pamëshirshme dhe tërë atë rreth e kishte bërë „lamë thiu“ me magji të zezë. Aliun e ktheva në të kaluarën, gjegjësisht pesë minuta pa u bërë magjia e zezë, ku filloi të flasë: Tash jam në odë, diçka po më çon në toalet, edhe pse nuk kam aq nevojë që të derdhë ujë. Posa hyra në WC, aty është një dritare e vogël, nga e cila shikohet në bahçen tonë, ku ka pemë të ndryshme. Në këtë rast, po e ndiej një zhurmë të lehtë dhe po shikoj për dritare e drejt në bahçe. Nëpër gardh po hyn në bahçe ajo plaka e fqinjve afër, po nuk po e njoh, se është terr. Po hyn tinëz, duke shikuar, se mos po e sheh ndokush. Iu afrua mollës dhe i nxori disa penj, të disa ngjyrave, dhe filloi t'i lidhë në një degë, duke folur diçka. E pyeta Aliun se kush ishte ajo plakë dhe për çka po i lidhte ata penj në atë mollë? Aliu nuk dinte të vërtetën dhe tha: është terr dhe nuk po e njoh kush është. E dija se ka një mundësi për ta ditur saktë se kush ishte dhe për çfarë qëllimi kishte ardhur tinëz në bahçe, natën, për t'i bërë ato rituale dhe atë pa e parë askush. I thashë Aliut: tash dëgjo mirë: ti po e sheh atë mollë afër shtëpisë në bahçe? Po tha Aliu. Afroju asaj molle qetas, i thashë. Iu afrova, tha Aliu. Mirë, prej këtij momenti ti, Ali, ke mundësi dhe ke për t'u shndërruar tërësisht në atë mollë. Këmbët po të shndërrohen në rrënjë të asaj molle, trupi po të shndërrohet në trung dhe duart e koka në degë. Ti tash je ajo mollë dhe nuk je përkohësisht Aliu, prandaj çka ndjen dhe çka di tërësisht ajo mollë, edhe ti po di. Ti po di për tërë atë rreth se kush është dhe çka është. A dëgjove, e pyeta Aliun. Po tha: dëgjova. Kush je tash, më trego? Tha: tash jam molla në bahçe. Të lutem, trego saktë se kush ishte ajo plaka? Ç'bëri aty dhe çka foli? Aliu i shndërruar në mollë filloi seriozisht të fliste. Ajo është fqinja jonë, kushërira me emrin F... Kjo ka ardhur në

bahçe të shtëpisë sonë, ku në mua ka lidhur disa penj të zi dhe ka bërë magji të zezë, më ka lidhur mua, po edhe tërë familjen e Aliut e ka lidhur për të keq. Kjo plakë nuk ua do asnjërit të mirën në këtë shtëpi dhe dëshiron të dalin fare e të lidhen sikur ky pe, duke mos përparuar kurrë! Ç’ tha kjo plakë, duke të lidhur ty në rrema? e pyeta Aliun-mollë. Kjo plakë tha: „Sikur që po i lidh këta penj të zezë, në këtë mollë, ashtu iu lidhtë puna tërë kësaj familjeje dhe mos iu priftë e mbara kurrë. Çka po ndodh me ty, me atë plakën dhe me shtëpinë e Aliut, kur ajo plakë po i lidhë ata penj te zi? Së pari unë, si mollë, po bie nën komandën e kësaj plake, ku duhet intensivisht t’u dërgoj të njëjtat mendime tërë banorëve të kësaj shtëpie; pastaj, në çast, kjo energji e keqe, edhe kësaj plake po i kthehet, e cila tërë kohën po e ndjen këtë të keqe, por disi kjo po rritet me të, edhe pse shpirti po shkon duke iu nxirë, prandaj nuk po e ndjen veten mirë; ashtu tërë banorët e shtëpisë po e ndiejnë këtë sulm, si prej meje, mollës, edhe prej kësaj plake, por nuk po e kuptojnë vetëdijshëm; kujtojnë se nuk është gjë e keqe. Mirë, tash është mjaft dhe menjëherë, tërësisht, po shndërrohes në Ali, siç ke qenë më parë, me të gjitha që ke pasur; vetëm dijen e mollës po e merr me vete. Kush je tash? e pyeta Aliun. Jam Aliu, tha. Tash je para asaj molle dhe, të lutem, merre atë pe dhe zgjidhe, duke thënë me zë: sikur që po i zgjidh këta penj, ashtu po zgjidhen të këqijat e shtëpisë sonë dhe përgjithmonë po largohemi prej këtyre të këqijave. Aliu i tha këto fjalë me zë dhe pohoi se “i zgjidha penjtë dhe të këqijat e shtëpisë u zgjidhën e u larguan dhe shkuan tek ajo femra në astral, si një errësirë e keqe.”

Këtë ditë bëra me Lulen edhe një eksperiment, duke e shndërruar në një arrë, të cilën e kishim mbjellë në një vend nën shtëpi. Pasi e shndërrova në arrë, e pyeta: Të lutem, më trego si po e ndjen veten, si arrë që je, në atë vend. Ajo tha: shumë keq po e ndjej veten! Po pse po ndjehesh aq keq? e pyeta. Lulja e shndërruar në arrë, u përgjigj: së pari në vendin

ku më keni mbjellë, ujë të mjaftueshëm nuk kam për ekzistencë dhe ju nuk po më ujitni që të ushqehem; dhe vazhdoi: ju njerëzit, kur nuk kujdeseni për ne, pse po na e ndërroni vendin, po na shkulni prej vendit, ku ne vetë e kemi zgjedhur, dhe po na mbillni në ndonjë vend të thatë, duke na harruar dhe as ujë, as ushqim për rrënjë duke mos na dhënë! Më mirë lenani vetë ku mbijmë, se ju, nganjëherë, ku po na mbillni në ndonjë vend, po mbesim pa ushqim e po thahemi pa nevojë.

Me këtë arrë me të vërtetë ishte ashtu. Këso eksperimentesh kisha bërë shumë.

Është interesant rasti, kur nipin, Shpendin, e pata shndërruar në bletë dhe e çova në koshere të bletëve të shihte se çfarë problemi kishin, meqë diçka me to nuk ishte në rregull, edhe pse unë, mbi tri vjet, isha kujdesur për to e kisha studiuar punën dhe organizimin e tyre të admirueshëm që ato kanë. Pasi që kishim një fermë me mbi 50 koshere bletësh, vendosa të dija se çka po na thonin bletët.

Me Shpendin kisha bërë shumë eksperimente dhe ky ishte mediumi dhe nxënësi im i parë shumë i mirë. Pasi që e shndërrova në një bletë të vogël, e dërgova drejt e në një koshere. Shpendi, i shndërruar në bletë, u përgjigj: Jam në rrezik, po më sulmojnë bletët e kësaj koshereje, meqë po e dinë se nuk i takoj kësaj koshereje dhe po më detyrojnë të dal jashtë kosheres. I thashë që t'i lusë bletët ta lënë brenda, se “ke shkuar për t'u ndihmuar dhe po duam të dimë sesi janë duke jetuar, a kanë ndonjë problem”... Dhe i thashë: Tregoju se je njeri e nuk je bletë, po je shndërruar përkohësisht në bletë që të mos frikësohen dhe që më mirë t'i kuptosh. Kur Shpendi ua barti këto mesazhe, bletët u qetësuan dhe nuk e sulmuan më. Shpendi tha: ato tash veç po më flladitin. Pyeti, të lutem, se çfarë problemi kanë tash për tash. Bletët iu përgjigjën se i kishin disa probleme. Si problem i parë, thanë, jemi drejtpërdrejt nën diell, pa kurrfarë mbuloje, ku po

bëhet shumë nxeht; neve po na nevojitet shumë mund për t'i freskuar dhomat, sepse po frikohemi mos po na shkrihet mjalti në koshere. Grejzat po na dëmtojnë shumë, duke na e zvogëluar fuqinë punëtore dhe, më e rëndësishmja: ujë të pijes nuk kemi afër koshereve dhe neve po na duhet të shkojmë shumë larg për ujë, ku, në këtë kohë, shumica e bletëve punëtore, të mbushura me ushqim, po na mbesin rrugëve. I falënderova për bashkëpunim dhe me të vërtetë ishte ashtu siç thanë bletët, ishin nën diell, pa mbulojë, i dëmtonin shumë grejzat dhe nuk kishte afër ujë të pijes. Pas kësaj, të gjitha çka kërkuam bletët ua sigurova.

ZBULIMI I MAGJISË SË ZEZË

SI SAMIU DHE MUHARREMI GJETËN TE NJË MIK MAGJI TË ZEZË?

“Duaji ata , dhe ata të donë ty; mos i duaj, edhe ata ty nuk të donë”

(Salih Basha, mistik)



“Ana tjetër-2”

(pikturoi:Salih Basha, mistik)

Në fillim e kam mësuar edhe vëllanë, Muharremin, që të hipnotizojë dhe ia mësova mënyrën mistike të shërimit të njerëzve me hipnozë, ku si medium të mirë e përdorte vëllanë e vogël, Samiun. Samiut filloi t’i delë zëri se po shëronte. Kështu, edhe Muharremi ndonjëherë e hipnotizonte ndonjë person dhe i ndihmonte për shërim, aq sa kishte mësuar deri

në atë kohë. Një ditë, në bisedë e sipër, një i njofshëm i fshatit tonë, iu kishte ankuar Muharremit se kishte probleme të shumta familjare, sidomos me gruan e tij, e cila gjithnjë po mbetej shtatzanë, po gjithnjë po i dështonte fëmijët pas disa muajsh. “Po dyshojmë se mos kemi magji të zezë, se tërë familja disi jemi ngatërruar në mes veti e nuk kemi rehati thua fare kohëve të fundit.” Iu kishte lutur Muharremit që të shkonte tek ai e t’ia kontrollonte shtëpinë, se diçka nuk ishte në rregull me ta.

Muharremi, si medium e kishte marrë vëllanë e vogël, Samiun, e kishte futur në trans hipnotik, duke e udhëhequr ai, si dhe Samiu vetveten. Kishin hyrë në shtëpinë e mikut dhe kishin filluar të kontrollonin - së pari dhomën e tij, ku ai flinte me gruan e vet. Me Muharremin dhe Samiun ishte miku ynë me nënen e tyre plakë. Samiu menjëherë e gjen se në atë shtëpi kishte magji të zezë dhe pikërisht ajo plakë i kishte bërë ato. Pra, vjehrra i kishte bërë të resë, të cilën e urrente pa masë dhe nuk dinte se çka t’i bëjë, ndaj i kishte bërë magji, që ajo të mos lindte fëmijë. Pra, ky do të ishte një shkak që djali i vet ta lëshonte gruan dhe ai më vonë ta merrte një grua tjetër. Pra, kjo plakë e kishte bërë atë plan të fshehtë, duke e prishur zemren dhe shpirtin e vet. Duke menduar se nuk do ta dijë askush, shkonte i paguante sa nuk bën ato magji nëpërmjet magjistarëve të zinj. Këto magjitë e fundit, i kishte paguar shtrenjt te një hoxhë i fshatit Sopi, i cili shkrunte magji të zeza. Plaka e pamëshirshme e kishte bërë rrëmujë tërë një lagje me magji të zeza. Plaka ishte me ta, kur i hulumtonin magjitë, e cila, kohë pas kohe, shtirej kinse është e pafajshme dhe e paditur për këso gjërash, duke thënë: kuku, qyqe, qysh sehire të ketë? Kush ka qenë ai njeri i pashpirt, he Zoti e vraftë! Samiu i thotë Muharremit: mu këtu në këtë dhomë ka sehire dhe shkon e kap jastëkun në atë anë të kauçit ku flinte gruaja. I thotë mikut: të lutem, shkepe këtë jastëk, se këtu brenda ka sehire. Kur e hap tërësisht dhe e qet mbi

dysHEME pambukun, në të gjen një letër katrore. Samiu thotë se ajo ishte magjia e bërë. Letra ishte e çuditshme: në të ishte i vizatuar krevati, një burrë e një grua në aktin seksual, ku gruas, në organin seksual, në anin e femrës, ia kishin vizatuar një gjilpërë, e cila e shponte anin tej e përtej, në mënyrë që ta bllokonte atë dhe kjo femër mos të lindte më fëmijë – të ishte e mbyllur për lindje të fëmijëve. Plaka ishte zbehur në fytyrë, duke menduar se tash Samiu do t'i tregonte djalit të saj... Samiu urdhëron që, pa tjetër, atë plakë ta qitnin jashtë. Nuk i tregoi të birit se e ëma u kishte bërë magji të zezë, që mos t'i prishej familja. Plaka shpejt del jashtë, po në atë moment, Samiun e sulmon, në astral, një demon ferri, i trishtueshëm, i cili tentonte ta ruajë atë magji dhe atë plakë. Thjesht, donte ta shkatërronte Samiun, sepse atë detyrë e kishte demoni. Pasi që, më herët, në trupin eteriko-astral, Samiut, ia kisha montuar, në ballë, një armë, me një diamant të kuq, Samiu, kur i dilte ndonjë krijesë ferri, automatikisht e shkatërronte atë. Këtë herë Samiu kishte problem me këtë lloj demoni, se, kur e copëtoi në shumë pjesë, çdo pjesë e tij, u shndërrua në demon të vogël, dhe ata e sulmuan Samiun nga të gjitha anët. Por Samiu e dinte mbrojtjen psikike - astrale dhe i largoi ata.

Pas këtij pastrimi nga magja e zezë, kjo femër ka mbetur shtatzanë, dhe ka fëmijë.

Për Samiun mund të shkruaj një libër të tërë me përvojat e tij, por, për fat të keq, kam qenë i detyruar që t'ia largoj përkohësisht këtë aftësi, se Samiu, në atë kohë, ishte i ri shumë dhe i pashkolluar sa duhet, ku dhe filloi ta keqpërdorte ndonjëherë këtë aftësi. Kjo aftësi, nëse nuk përdoret si duhet, është rrezik për atë që nuk di ta përdorë, sidomos për shëndetin e tij, por po ashtu edhe për rrethin në të cilin jeton.

Po ua tregoj një ngjarje të vërtetë, që i ka ndodhur Samiut. Unë isha duke jetuar në Prizren me fëmijët. Para një dite e pashë Samiun, i cili ishte tërësisht i shëndoshë në

fytyrë. Të nesërmen erdhi tek unë, në banesë, dhe u befasova me të kur pashë se ishte dobësuar shumë, për një natë, në fytyrë. Me habi e pyeta: Sami, me bacin, çka të ka gjetur që je dobësuar kështu për një natë në fytyrë? Samiu duke qeshur tha: Ndasht, baci Salih, se çfarë suksesi kam arritur sot, nuk ta merr mendja: kam luftuar kundër demonëve dhe e kam shëruar një femër nga fshati Grejkoc, që kish qenë e pamundur të shërohej. Kjo femër as nuk kishte folur e as ecur, posa ia kam larguar prej trupit demonët, tash ajo po flet e po ecën pa problem; po unë me atë femër vëtrat kemi qenë në rrezik prej demonëve, të cilët e kishin zaptuar tërë trupin e saj. Familja e saj janë habitur dhe janë gëzuar pa masë, ashtu edhe unë jam gëzuar shumë që është shëruar.

Samiu ka qenë amator dhe pa përvojë për këto gjëra të mëdha okulte. Ato krijesa, të cilat i ka përzënë, pikërisht kanë filluar për ta ndjekur kudo që ka shkuar Samiu. Te ne, në fshatin Vraniq, pati filluar të dëgjohej se dikush po ecte nëpër tavan të shtëpive. Gruaja e Njaziut shpesh i ka parë në ëndërr, atë kohë, disa krijesa jo të mira që mundoheshin të bënin dëm te ne në shtëpi. Shpesh ka trokitur dera apo dritarja, pa qenë askush jashtë shtëpisë. Kur e kontrollova më vonë shtëpinë, pashë se ato krijesa që bënin zhurmë në shtëpinë tonë, ishin exhinë-demonë, të cilët Samiu i kishte përzënë prej asaj femre. Unë, në atë kohë, nuk kam ditur se çka t'ju bëja, veçse e kam detyruar Samiun t'i mbyllte ata demonë në një gur, sa një top i vogël, që më mos të mund të dilnin për të bërë dëm te tjetër kush.

Samiu ka filluar të keqpërdorte këtë fuqi edhe një herë në Prizren, në një çajto, ku ka qenë me disa shokë. Në atë çajto kanë qenë edhe tri femra të reja e të panjofshme. Samiu u thotë shokëve: Çka po paguni nëse i sjell ato tri femra këtu, në tavolinën tonë, e ato nuk kanë për ta ditur se për çka kanë ardhur tek ne. Do të vijmë dhe do të pijmë me ne në tavolinë! Kuptohet se, për shokët e tij, kjo gjë ka qenë e

pamundur. Samiu, në autotrans, i thërret me dhunë, pasi i urdhëron ndërdijet e tyre, ku ato çohen, si robotë, pa vetëdije, dhe shkojnë te Samiu, duke u kërkuar falje që të ulen me ta, edhe pse fare nuk njiheshin me asnjërin në atë tavolinë. Shokët e tij, kuptohet, të befasuara me suksesin e Samiut, e qerasin ai çka dëshironte. Me siguri se ka bërë edhe shumë keqpërdorime të tjera, dhe, meqë e kam parë rrezikun, jam detyruar që t'ia largoj autotransin, që ta shpëtonte veten dhe të tjerët.

E AJURA E FYTIT SI EKSPERIMENT

*“I pasuri me pasuri fizike nuk është gjithmonë i pasur.
I pasuri me pasuri shpirtërore është gjithmonë i pasur”*
(**Salih Basha, mistik**)

Shpesh tuboheshim me shokë, ku bisedonim për hipnozë, parapsikologji, okultizëm, kosmos dhe për shumë dimensione të tjera. Me shokun Brahë kisha punuar shumë herë me hipnozë, ky ishte një medium i veçantë, dhe shpesh eksperimentoja me të. Këtë natë e mësova Brahën sesi punohet me autohipnozë, ashtu edhe për rreziqet e saj, nëse ai nuk di të punojë si duhet me të. E këshillova mirë, ku i thashë: Të lutem, mos luaj me sugjestione, kur je në autotrans, sepse kur je në atë gjendje, ndërdija nuk e kupton shakanë dhe, çfarë urdhri që merr prej vetëdijes, automatikisht e zbaton dhe pikërisht të ndodh në trupin fizik ajo çka e ke urdhruar. Të lutem, mos bëjë shaka me veten e as me të tjerët, se mund të dëmtosh ndokend. E këshillova: Çkado që të punosh, pyete *zërin tënd të brendshëm*, ose *udhëheqësin tënd shpirtëror*, ai të udhëheqë si duhet. E nëse ti punon pa dije dhe me hamendje, mund të gabosh dhe atë shumë keq, se këtë nga përvoja po ta them. Braha më tha: Thuaje ndonjë shembull pozitiv dhe diçka që mund të gaboj e mund t’i shkaktoj vetit dëm. Ja, disa shembuj pozitivë i thashë: nëse je në autotrans e të dhemb koka dhe ti vetes i thua “tash numëroj deri në tre dhe koka ime do të jetë e lehtë dhe e freskët” dhe numëron, atëhere automatikisht do të të kalojë dhembja e kokës dhe do të jesh shumë mirë. Ose, je duke nirthur, dhe je në autotrans, e i thua vetes: “pas dy minutash trupi im do të fillojë të ngrohet”, me të vërtetë ashtu ka për të ndodhur dhe trupi ka për t’u ngrohur. Këto gjëra shumë mirë i dinë joginët në Indi, të cilët e kanë të ushtruar

fuqinë e lartë të vullnetit. Në Himalaje është ftoht i madh dhe ka borë disa metra mbi tokë. Shpeshherë, kur shkojnë vizitues për të vizituar Tibetin, kanë parë joginët në gjendje të thellë transi, duke medituar, ku, rreth tyre, me diametër afër 10 metra, shihet gropa e thellë, në të cilën bora është e shkrirë dhe ai duket si në një bunar prej bore duke medituar. Ajo është fuqia e ndërdisjes, që ka shkaktuar nxehtësi rreth trupit të joginit, ku bora është shkrirë dhe ngadalë ka rënë në tokë pa u lënduar. Pra, kjo është fuqia e autotransit. Këso shembujsh ka shumë në botë. Braha tha: “Të lutem, trego ndonjë shembull negativ, ku mund ta lëndojmë veten”. Ja, një shembull negativ: Je në autotrans dhe dëshiron të bësh një eksperiment, pa e ditur pasojën, dhe i thua vetes: „po më ajet fyti“ apo „bajamet“; fyti menjëherë ka për t’u ajur. „Po më dhemb barku“, barku do të të dhemb. I thashë Brahës: të lutem, mos luaj me këso sugjestionesh, kur je vetë, se nuk di të dalësh prej vështirësisë, në të cilën ke hyrë vetë, dhe zor do ta kesh të dalësh prej gjendjes së keqe. Braha nuk foli fare dhe as që bëri më pyetje, thua ishte skeptik në këto përgjigje që mori.

Kështu kaluan disa ditë dhe Braha, një ditë, u lajmërua dhe më pyeti se kur mund të takohemi për të biseduar. Kur erdhi tek unë, filluam të bisedojmë dhe menjëherë më tha: Salih, tash, vërtet po të besoj se çka do të thotë sugjestionimi negativ që i jepet vetes; ishte ashtu si na këshillove atë natë kur ishim së bashku këtu. E dita menjëherë se ka bërë eksperimente me veten dhe i thashë: “e paske provuar me veten si është puna me sugjestionet! Braha filloi të më tregonte. Tha: para disa ditësh, rashë në autotrans, njëjtë si ti më ke këshilluar dhe dola me eterik të kontrolloja shtëpinë tonë, se mos na kishte bërë ndokush magji të zezë. Menjëherë gjeta disa hajmali dhe gjëra të tjera në oborr dhe brenda në shtëpi dhe pashë se kush i kishte bërë ato të këqija. U ktheva në trup, e mora vëllanë dhe shkuam e i gjeta ato

hajmali të fshehura. Pas këtyre zbulimeve, u ktheva në odë dhe vendosa të bëja një provë me veten dhe rashë në autotrans, duke i thënë vetes: kur të numëroj deri në tre, do të më ajet fyti, gjithnjë duke mos besuar në fjalët tua, se një gjë e tillë mund të ndodhte vërtet në materie. Kisha dalur nga autotransi dhe prisja se çka do të bëhej me mua. Por, për çudi, pas disa minutash, në mënyrë automatike, m'u ka ajur fyti dhe filloi një dhembje mjaft e madhe. Prej dhembjes së madhe nuk mund të koncentroheshja e të hyja përsëri në autotrans që të largoja atë dhembje të padurueshme. Kjo dhembje, kjo vuajte dhe pagjumësi zgjati tri ditë e tri netë intensivisht, derisa u lodha shumë dhe, më në fund, arrita të bija përsëri në autotrans dhe të jepja urdhër që “kur të numëroj deri në tre, dhembja dhe e ajura e fytit do të më largohen”, por gjithnjë me frikë se do të mbeteshja në atë gjendje dhe intensivisht duke menduar të të thërrisja ty në ndihmë, por, për çudi, fill pas kësaj, m'u ndal dhembja dhe m'u shçaj fyti, sikur mos të kisha pasur gjë. M'u duk se linda për së dyti dhe i thashë vetes se “më nuk do të luaj me këso gjërash, as me veten e as me dikë tjerët”. E di se Braha shumë gjëra nuk m'i ka treguar (se çka ka bërë me veten dhe me të tjerët), por, për fat, besoj se ka qenë shkak ky eksperiment dhe se pak i është mbushur mendja që më mos të luajë me këso gjërash tejet serioze dhe të një domethënie të lartë.

PO MË VJEN FTOHTË NATËN, KUR PO BI NË ODË TË FLEJ

“ Kur ta jep Zoti, kurrë nuk të humb; kur ta jep njeriu, mund të të humb “

(Salih Basha, mistik)

Unë, Braha dhe shoku, Arben Shala, shkuam te një familje, e cila na kishte thirrë për t'i ndihmuar diçka, se tërë familja nuk ishte në rregull. Pasi Braha ishte medium i mirë, dëshirua të zbulonim se çka mund të kishte kjo familje dhe t'u ndihmonim diçka, aq sa ishte e mundur. Zonja e shtëpisë, në bisedë me ne, na tha se para derës së shtëpisë, para një muaji, na e ka hedhur dikush një mace të ngordhur, dhe, prej atëherit, diçka e padukshme po lëviz nëpër shtëpinë tonë dhe ne po frikohemi dhe nuk jemi mirë tërë anëtarët e familjes sonë. Sipas hulumtimeve të mia, atë mace e kishte mbytur një femër aty afër, që merrej me magji të zezë, dhe e kishte urdhëruar shpirtin e asaj maceje që tërë familjen të mos i linte të qetë përgjithmonë. Po ashtu, para derës së asaj shtëpie, kishin qitur ujë të kufomës, me qëllim që kjo shtëpi të ftohej; si ajo kufomë që ishte pa jetë, ashtu të bëhej ajo shtëpi pa jetë. Të njëjtat rituale i kishte bërë e njëjta femër. Pra, shumë keq kishte menduar për këtë shtëpi. E mora edhe Brahën, të shikoja se çka po na thoshte edhe ky dhe të shihja se a po na përputheshin faktet. Mirëpo, Braha u përgjigj se nuk kishte mundësi të shihte, se udhëheqësi i tij e kishte lidhur në eterik me zinxhirë. E pyeta se pse e kishte lidhur; por tha se nuk dinte. Këtu gënjeu, nuk e tha të vërtetën. I thashë Brahës që t'i thoshte udhëheqësit ta zgjidhte. Braha tha: “nuk po më zgjidh, veç po më shtrëngon edhe më shumë”. Dhe u nervozua shumë, ndaj shau. U preka - së pari që e shau

mbrojtësin e vet, dhe, së dyti, Braha kishte bërë diçka keq, që nuk po e dinte as ai vetë ose nuk po donte të tregojë. E dija se diçka nuk ishte në rregull, dhe se Braha kishte punuar pa më pyetur mua e pa e pyetur udhëheqësin e vet shpirtëror; kishte punuar keq për vete ose për të tjerët. Udhëheqësi shpirtëror po e ruante Brahën që mos të bënte edhe më keq, po ia ruante shpirtin që të mos mëkatohej më tutje. Me siguri se ishte për të mirën e Brahës. E pyata Brahën se çka kishte bërë keq diçka që udhëheqësi nuk po e lejonte të lirohej. Braha nuk u përgjigj, veçse më pyeti se pse, që një javë ditë, po mërdhieheshin ai dhe të tjerët që po flinin në odë, “edhe pse po kallim zjarr në vazhdim, po na vjen sikur jemi duke fjetur në oborr, jashtë, nën qiell të hapur”. Më trego të vërtetën, i thashë, ç’eksperiment ke bërë me atë odë, mos e ke prishur murin e odës tërësisht në astral dhe ka mbetur oda pa mbrojtje. Po, për besë, tha Braha, ashtu është! Ishte i befasuar si e dita të vërtetën. Braha filloi të fliste për veten: “Një natë, në autotrans, duke luajtur, i hiqja bllokat e murit të odës, një nga një, dhe, ashtu, tërë odën, e kam çelur, si të ishte shtëpia duke u ndrequr prej fillimit, dhe pa blloka mbeti oda pikërisht aty ku isha unë. Pra, të gjithë bllokat i kam hequr, veç shtyllat i kam lënë. E ndjeja se po hynte ajri i ftohtë në odë, po duke menduar se, ndoshta, nuk do të ndodhte ashtu, e kam lënë krejt odën të çelur!” I thashë Brahës, se “kur nuk je i mbrojtur në eterik, ashtu edhe në fizik nuk je i mbrojtur. Posa të mbrohet ana eterike, mbrohet edhe ana fizike; pra, çka i ndodh trupit eterik, i ndodh edhe trupit fizik.” E hipnotizova Brahën dhe me eterik e çova në odën e vet, ku i ktheu bllokat e murit, siç kishin qenë më parë, dhe, prapë, e ktheva në trup në gjendje normale.

Të nesërmen, më lajmëroi se në odë, tashmë, çdo gjë ishte normale, sikurse ka qenë më parë; asnjëri nuk po nirthte më.

HUMBJA E PËRJETIMIT TË KOHËS: 4 MINUTA SI 24 ORË

“Gozhda mbi gozhdë nuk ngulet”

(Salih Basha, mistik)

Ishim takuar këtë natë te shoku Arben Shala, si shumë herë të tjera. Këtë natë bëra shumë eksperimente me hipnozë dhe të gjithë u befasuan. Si medium e përdora Brahën, se ishte medium shumë i mirë. Pasi i bëra disa hulumtime te unë dhe te disa shokë tjerë, në trupat tanë eterikë, e mësova Brahën që të shikonte pikërisht me syrin e tretë në trupin eterik. E mësova që njeriun ta shihte sikur të ishte prej qelqit, se për afërsisht ashtu duket trupi eterik. Të gjitha organet duken si të ishin prej qelqi, pra janë të tejdukshme. Pastaj, me Brahën kam shkuar në të kaluarën dhe në të ardhmen. Njëherë e kam kthyer Brahën në të kaluarën, ku Braha e kishte pasur syrin çorr dhe dorën sakat. Kur pashë se Braha ishte sakat, i çova dy duart kah qielli dhe iu luta Zotit që Brahës, në atë kohë e në atë dimension, t’ia shëronte sytë dhe duart. Në atë kohë dhe dimension, Braha kishte qenë plak me flokë të thinjura e me mjekërr të gjatë e të thinjur dhe, prej lutjes që bëra unë, siç isha i veshur me rroba të bardha, atypëraty u shërua Braha me ndihmën e Zotit. Meqë kisha shkuar edhe unë në atë dimension dhe në atë kohë, në eterik, kur u kthyem, u kthyem të dy përnjëherë në trupat tanë fizik. Mua më kishte parë sesi me trupin eterik po dilja dhe po hyja nëpër majë të kokës. Kështu, duke punuar me Brahën, ai tha se është shumë i lodhur nga ato udhëtime kosmike dhe kohëra të ndryshme. E pyeta se a kishte dëshirë që të pushonte ose që të flinte pak. Ai u përgjigj: “po, dëshiroj që të flej pak.” Po sa orë dëshiron të flesh? e pyeta Brahën. Tha

se dëshironte të finte 6 orë dhe ato do të ishin mjaft për të. Braha ishte në autotrans, me sy të hapur, por gjithnjë e udhëhiqja unë, se ai vetë nuk dinte si të punonte. E urdhërova që t'i mbyllte sytë. Kur i mbylli, i thashë se tash momentalisht ishte te shtëpia e vet. A je te shtëpia ? e pyeta. Po tha, në shtëpi jam. I thashë se shtratin ia kishin shtruar dhe le të bëhej gati të binte për të fjetur. Para se të flesh, ti po ke dëshirë ta shikosh televizorin. Po shikon filma dhe po kënaqesh me ta. Pas pak, e pyeta se a i kishte parë filmat që i donte, ai tha “po, i pashë të gjithë”. Mirë, pra, të gjithë mbaj mend, urdhërova. Tash je lodhur dhe dëshiron të flesh. A ke rënë për të fjetur? “Po, rashë”. Mirë, pra, i thashë: Tash, edhe pse po flen, prapë je në kontakt me mua dhe nuk ke për t’u zgjuar pa të thënë që të zgjohesh. Edhe kur të zgjohesh te shtëpia jote, ti je prapë në kontakt me mua, a dëgjove? Po, dëgjova, - u përgjigj. Tash i ke sytë e mbyllur dhe po kënaqesh duke fjetur; kësò gjumi të këndshëm ende deri më tash nuk ke përjetuar; tash po sheh ëndrra të bukura. Shihej për nga trupi se Braha ishte plotësisht i relaksuar dhe dukej i lumtur në fytyrë. I sugjerova: “Tash kaloj një orë që ti po flen në gjumë të thellë e të këndshëm, shumë mirë po e ndjen veten. Tash kaluan dy orë... tri orë... katër orë... ti edhe më tutje thellësisht po fle, ku tërë trupi po të pushon dhe po të mbushet me energji. Tash kaluan pesë orë, shumë mirë po e ndjen veten, dhe gati je ngirë gjumë. Tash i bëre gjashtë orë, plotësisht je ngirë gjumë dhe ke pushuar thellësisht, çdo gjë që ke përjetuar, ti po i mban mend dhe, tash, atje te shtëpia, po zgjohesh... je atje në dhomë, çili sytë! Vishu dhe eja këtu, te ne, ku jemi duke ndejur, te Arbeni, kthehu në trup fizik. U veshja dhe u ktheva në trup - tha. Mirë, tash kur të numëroj deri në tre, ti ke për t’u zgjuar i kthjellët, i pushueshëm dhe plot energji. 1, 2, 3... zgjohu! Çdo gjë është në rregull te ti. Ti je zgjuar tash... Braha u zgjua. Të tjerët filluan ta pyetnin sesi po e ndjente veten. Së pari Braha e ndezi cigaren, u largua në

një anë dhe nuk fliste, vetëm heshte. Arbeni e pyeti se a kishte fjetur mjaft. Braha u përgjigj me bindje: uha, sa mirë kam fjetur, rrafsh 6 orë të plota kam fjetur. Por, pastaj, i hutuar, më pyeti: Salih, diçka nuk po kuptoj, si është e mundur që unë së bashku me ju isha këtu mbrëmë, sakaq shkova te shtëpia, e shikova TV-në, pashë filma, rashë për të fjetur, kam parë ëndrra të bukura, kam fjetur plot 6 orë dhe jam ngritur, jam veshur dhe, prapë, në të njëjtin vend, të nesërmen, qenkemi mbledhur së bashku ne shokët e natës së parë, që erdhëm te ju! Të gjithë qeshën me Brahën. Arbeni i tha se nuk ka fjetur as 4 minuta të plotë; “derisa Salihu ka punuar me ty, ti ke fjetur 3 - 4 minuta e t’u ka dukur se 24 orë kanë kaluar dhe po të bëhet gjëja se prapë, natën e dytë, ke ardhur te ne me të njëjtët shokë dhe në të njëjtin vend. Braha me bindje të plotë tha se “nuk është e vërtetë kjo çka po thoni për mua, unë me të vërtetë kam qenë te shtëpia dhe tërë natën kam fjetur, ku, prapë, natën tjetër, kam ardhur te ju.” Jo Brahë, ti ke fjetur vetëm 4 minuta e t’u kanë dukur 24 orë. Mos harro, se ndërdijsa nuk ka kohë dhe vetëm 4 minuta ke fjetur. Unë e kam shpejtuar kohën në ty, i thashë Brahës seriozisht. Braha prapë me bindje thoshte se ne po bënim shaka me të, e se ajo çka kishte përjetuar ishte e vërtetë. U ngrit në mënyrë demonstrative dhe iku prej nesh me bindje se ne po bënim shaka me të dhe nuk lejonte që t’ia sqaronim çështjen në tërësi. Përjetimi i Brahës ishte shumë real, se e kishte përjetuar me trup eterik, të plotë, e për këtë arsye, nuk mund ta dallonte realitetin fizik prej përjetimit astral-eterik. Të gjithë qeshëm, të gëzuar, me atë fenomen që ndodhi me Brahën, i cili e kishte humbur ndjenjën e kohës dhe të hapësirës.

Atë javë, Braha, tërë javën, kudo na shihte mua dhe Arbenin, ikte prej nesh, nuk donte që të kontaktonte me ne derisa, një ditë, në Ortakoll të Prizrenit, lagje ku Braha banonte dhe shpesh e vizitonte një çajtofe afër shtëpisë së vet,

e takova Brahën në çajtores dhe nuk donte të më fliste. I thashë: I kam vetëm dy fjalë me ty, e ti, nëse nuk më beson, ajo le të mbetet çështje jotja: nëse don fol, nëse nuk don kurrë mos fol me mua. I thashë: Brahë, unë asgjë me qëllim të keq dhe keq nuk kam punuar me ty, ashtu asgjë kundër vullnetit tënd nuk kam punuar. Ti atë natë, në autotrans, ku të kam udhëhequr, na ke ndihmuar të gjithëve që të shërohemi e po ashtu edhe vetes. Atë natë nuk më lejove që t'i sqaroja disa gjëra në lidhje me kohën dhe ligjet e ndërdijes, se ti, atë natë, me të vërtetë ke fjetur vetëm 4 minuta e jo 6 orë, si të është dukur ty në trans, e as që je kthyer te ne pas 24 orësh. Ata urdhëra të përjetimit të gjatë t'i kam dhënë që ti të pushosh e, kur të zgjohesh, të jeshë i pushueshëm. Asgjë mashtrim nuk ka qenë, ashtu është ligji i ndërdijës që 4 minuta të të duken 24 orë, ose shumë e më shumë, nëse të sugjerohet që ashtu ta përjetosh. Kjo që ti ke përjetuar, është kënaqësi e jo dobësi. Pastaj, e pyeta: “atë natë, kur je zgjuar, a ke qenë plotësisht i pushueshëm?” Ai tha: “po, plotësisht kam qenë i pushueshëm.” Pra, a po sheh se koha është iluzion e njeriut mund ta shfrytëzojë kohën ndryshe. Braha u përgjigj: po ajo çka kam përjetuar m'u duk e vërtetë e jo mashtrim. Po, iu përgjigja, për ndërdijen dhe për atë dimension është e vërtetë, se në atë dimension ti mund të kthehesh kurdo në të kaluarën, të jesh në të tashmen ose të shkosh në të ardhmen e të shikosh çka po ndodh. Braha u qetësua dhe tha: Po ta dija se ju kam ndihmuar pak, prapë do të ju ndihmoja. I thashë: jo pak, po ti na ke ndihmuar shumë, mos harro se edhe unë në një dimension shumë të kam ndihmuar. Po, tha, e di: me të vërtetë më ke ndihmuar shumë. I thashë Brahës se si amator që është, rrallë kush aq pastër e aq qartë mund t'i përjetojë gjërat, siç ai i ka përjetuar. Prej atij momenti, Braha nuk kishte frikë, as prej nesh, as prej të andejshmes së panjohur, ku me gjithë dëshirë punonte me mua.

HARRIMI I TRUPIT ETREIK NË TRUP TË HUAJ

“E folmja tepër është si e ngrënmja tepër”

(Salih Basha, mistik)

SI MOTRA LULE MBETI ME TRUP ETERIK NË TRUPIN TIM FIZIK

Këtë natë i kisha dy mediume të mira, motrën, Lulen, dhe nipin, Shpendin, që të eksperimentoja më ta. Shpeshherë i hipnotizoja nga dy mediume dhe bëja eksperimente që të shikoja rezultatet, sesi do të shihnin në astral, të dy mediumet, në të njëjtën kohë. Pra, si po i sheh njëri dhe tjetri medium, ose i dërgoja të dytë që të shihnin të njëjtën gjë në astral. Së pari punova me Lulen, e cila ra në trans hipnotik të thellë, ku ishim në një dhomë të vogël të shtëpisë sonë, në fshatin Vraniq. Sonte desha të dija për loken Xhemile, të cilën e doja shumë dhe e cila më kishte rritur me dashuri. Ishte e sëmurë dhe ishte lodhur shumë, thuaja për vdekje, mezi që ecte me një shtagë kaçarrule, por e cila ende nuk i kishte humbur shpresat për jetë, edhe pse i kishte mbushur gadi 90 vjet. E lidha Lulen me shpirtin e lokes Xhemile, që të shihte se çka kishte dhe a do të mund t'i ndihmoja diçka që t'ia përmirësoja shëndetin, apo jo. Lulja filloi të flasë: jam lidhur me eterikun e lokës Xhemile, ku lokja po thotë: pasha nënën jam lodhur shumë, nuk kam energji më për jetë dhe jam plakur mjaft. Nuk keni asgjë ç'të më ndihmoni, ju falemnderit shumë; dua të vdes; mjaft më kam jetuar, kam parë mjaft, çka kam dashur të shoh, tashi më jam lodhur sytë, me nënën. I thashë Lules që ta pyesë loken se kur do ta lëshojë këtë botë. Lulja tha: lokja po thotë se ajo do që ta

lëshojë trupin fizik përgjithëmonë në vjeshtë, edhe tre muaj. Kur bënim eksperimentin ishte koha e verës. Lulja vazhdoi: lokja Xhemile po thotë se “po ka qejf të jetojë edhe tre muaj, se pas tre muajsh piçen dardhat ujëse e po kam qejf edhe një herë të ngihem me to, tjetërsend nuk më mbetet merak.”

Nuk ka vonuar disa minuta dhe lokja Xhemile me të vërtetë erdhi te ne, në dhomë të vogël, ku isha duke bërë eksperiment dhe mbeti e hutuar kur pa Lulen të shtrirë në katalepsinë hipnotike, e cila ishte bërë akull në trupin fizik. Lokja Xhemile e preku Lulen, dhe e habitur tha: kuku, qyqe, çka i keni bërë çikës kështu, qenka bërë si xhenaze, e paskeni trulluar të tërën. I thashë: ik, loke, se jemi duke punuar diçka. Lokja tha me ton serioz: hə, po e vetni se kur kam për të vdekur, a?! Unë nuk fola asgjë, por u habita sesi lokja Xhemile ia qëllloi.

Dhe, me të vërtetë, rrafsh pas tre muajsh, kur u poçën dardhat ujëse, lokja Xhemile e lëshoi këtë botë.

Këtë natë, në një dhomë më të madhe të vëllait, Nijaziut, e hipnotizova përnjëherë edhe Lulen, edhe Shpendin, dhe i pyesja për të njëjtën gjë të dytë, për ta vërtetuar faktin. Këtë natë, të dytë, i pyeta për gabimet që unë, si amator në hipnozë, po i bëja gjatë hipnotizimit. Njëherë Lulja m’i tregoi disa gabime, herën tjetër Shpendi. Duke punuar me Lulen, pas një kohe të shkurtër, iu ktheva Shpendit, i cili nuk më dha përgjigje dhe nuk fliste. E thirra me ton pak më të lartë dhe i thashë: Shpend, a po më dëgjon, duke menduar se ishte në trans hipnotik; kur Shpendi i hapi sytë, i habitur, dhe tha: hə, daja Salih, çka u bë?! Në këtë rast Shpendi kishte hyrë prej hipnozës në gjumë normal dhe u zgjua normalisht prej gjumit, e jo prej hipnozës, se në hipnozë nuk do t’i kishte çelur sytë dhe nuk do të më përgjigjej me habi. Shpendin e hipnotizova edhe një herë me qëllim që t’i jepja sugjestionet pozitive dhe prapë e ktheva në

gjendjen normale të vetëdijes dhe e dërgova për të fjetur, se ishte pas orës 24. Me Lulen punova më tutje.

Me rastin e Shpendit plotësisht e vërtetova se njeriu kurrfarë rreziku nuk ka prej hipnozës, se njeriu, edhe po qe se “harrohet” në hipnozë (i humb kontakti me hipnotizuesin), në mënyrë të natyrshme kalon prej hipnozës në gjumë natyror. Pra, kurrfarë rreziku nuk ka, ndaj nuk ka arsye të frikësoheni pa nevojë: vlen për ju që dëshironi të hipnotizoni apo të hipnotizoheni.

Unë i kisha disa probleme me veshkë dhe doja të dija se në çfarë gjendjeje gjendeshin ato. Këtë herë e përdora teknikën e shndërrimit të astralit në forma dhe gjini të ndryshme. Lulen tash e shndërrova në Salih, në mua, komplet: me gjini, me organe, me dije dhe ndjenja. Kur e pyetja pas kësaj Lulen se kush ishte tash, ajo thoshte: tash jam Salihu. Si po e ndjen veten si Salih? Mirë, thoshte, veç qenka interesant të përjetosh komplet gjininë tjetër që nuk e ke. A ke probleme? e pyta. Jo, tha, nuk kam aq probleme. E pyeta prapë: Si i ke veshkët? Lulja-Salih u përgjigj: diçka veshka e djathtë nuk është në rregull. A ke mundësi që ti ta përmirësosh atë? Po, tha, pa problem. Mirë, i thashë, përmirësoje! E përmirësova, tha, pas një minute. E pastrova veshkën e djathtë, në fund të saj ishte një bllokadë. Pas një kohe Lulen - Salih e riktheva prapë në gjendjen si ishte, në Luljetë.

Pas pak, e përdora edhe një teknikë tjetër, ku Lulen e futa në trupin tim, që të vërente dallimin dhe të vërtetoja se a do të fliste njëjtë për trupin dhe organet e mia, siç kishte folur Lulja - Salih. Pasi që ishte shumë vonë: ora 1 pas mesnate, e nxorra Lulen prej hipnozës dhe e çova të binte për të fjetur. U zgjua e përgjumshme, edhe pse i kisha dhënë sugjestionë që të kthjellohej plotësisht. Këtë herë kisha harruar diçka pa përfunduar si duhet me Lulen. Rashë për të fjetur edhe unë, por, për çudi, nuk më merrte gjumi, kisha një

ndjenjë se edhe dikush ishte me mua; e ndjeja veten si të isha duplikat; edhe një njeri ishte në mua. Diçka lëvizte në mua, herë tek këmbët, herë te koka, herë trupit. Kur u koncentrova mirë dhe e pyeta veten se çka është kjo gjë në mua, në çast e ndjeva zërin e Lules, e cila m'u përgjigj se ajo gjendej në mua, meqë kisha harruar ta ktheja në trupin e saj fizik. Dhe ajo, tash, ishte e shqetësuar në trupin fizik, edhe pse e dinte se tek unë nuk kishte rrezik. E urdhërova që të dilte prej trupit tim fizik dhe të kthehej në trupin e vet. Njëherë nuk besova se do të mund ta hiqja trupin e saj astral prej trupit tim, por, kur e urdhërova që të dilte prej meje, për çudi, menjëherë m'u lirua trupi dhe fjeta pa probleme. Kur e kam hipnotizuar herën tjetër Lulen, e pyeta për këtë rast dhe ajo më tregoi sesi kisha vepruar drejt me të kur e kisha urdhëruar të dilte prej trupit tim e të kthehej në trupin e vet, sesi nuk kishte mundur të flinte, se nuk e kishte pasur trupin e saj eterik në trupin e vet fizik etj. Këto që i përjetova këtë natë ishin me të vërtetë zbulime interesante, si për mua, ashtu besoj edhe për ju, që doni të punoni, qoftë me veten, qoftë edhe me të tjerët, me hipnozë.

SHPENDI NË RREZIK DHE FUQIA E INTUITËS

“Mos premto, pa u menduar mirë, se më vonë mund të pendohesh”

“Hipnoza nuk është e rrezikshme, por hipnotizuesi mund të jetë i rrezikshëm”

(Salih Basha, mistik)

MOS U KOLL!

Këto ngjarje që do t'ua tregoj janë të vërteta, sikurse ato të mëparshmet dhe ato që do të vijnë më tutje. Kjo është një e vërtetë që më ka ndodhur me Shpendin, me djalin e motrës Minire, ku, nëpërmes gabimeve si amator në hipnozë, e kam sjellë Shpendin në rrezik, ndoshta edhe me jetë. Për këtë arsye ju duhet ta njihni natyrën e ndërdijes së njeriut, ligjet e saj, mbi këtë të keni së paku njohuri teorike para se të punoni me hipnozë me të tjerët, po ashtu ta njihni metodën e dhënies së sugjestionëve personave, të cilët i vini në hipnozë. Askund nuk gjeni në literaturë për hipnozën, se hipnoza është e rrezikshme, se këto rreziqe nuk njihen në praktikë. Thuhet në një vend se “hipnoza është e rrezikshme, se nuk ka rrezik”. Sipas përvojës sime, kam ardhur në përfundim se me të vërtetë hipnoza nuk është e rrezikshme. Me këtë përvojë mund të them: *“Hipnoza nuk është e rrezikshme, por hipnotizuesi mund të jetë i rrezikshëm”*. Hipnoza, si metodë, është neutrale: në cilin drejtim e drejton hipnotizuesi, ashtu ajo funksionon. Hipnoza është shpatë me dy teha, sa mund të bësh mirë, aq mund të bësh keq me të. Ndërdija vepron nën

urdhër të hipnotizuesit, apo, nëse personi punon vetë, me autohipnozë, urdhërat i jep vetëdija e tij; pra, çka të urdhërojë vetëdija, ashtu ndërvoja vepron.

Shpesh, verës, më mbetej banesa vetëm, se fëmijët shkonin për të ndejur te dajallarët. Shpendi ishte i ri, po ishte shumë i interesuar për art, ndaj gjithnjë vinte tek unë, se unë, si hobi, e kisha artin: punoja në bez me ngjyra të vajit, ku ndonjëherë edhe shitja ndonjë pikturë, për të fituar diçka për jetesë. Pasi e kisha Shpendin me vete, vendosa të bëja, me të, ndonjë provë me hipnozë. E dija se, çdo herë, diçka të re zbuloja dhe po ashtu përjetoja përjetime interesante. Kështu, m'u kishte bërë shprehi që, gjithnjë, mediumit, kur ishte në hipnozë, t'i thoja: merr frymë, merr frymë... ku mediumi punonte sipas sugjerimeve të mia. Sot, me Shpendin, e pashë se intuita apo fuqia e Dritës më kishte përgatituar herët vetem për ta ndihmuar dhe për ta shpëtuar nga rreziku Shpendin. E futa në hipnozë dhe i thashë se çdo gjë ishte në rregull me të. Kur, papritur, Shpendi, në hipnozë të thellë, filloi që të kollej. Unë, fare pavetëdijshtë, i thashë: mos u koll! Dhe, isha ndalur e po mendoja se çka të punoja sot me Shpendin; ndërkohë, si zakonisht, i thashë: merr frymë... Shpendi mori frymë, po unë asgjë tek ai nuk vëreja, dhe as që pritja të vërej. Të dytën herë, e zgjata pauzën dhe i thashë: merr frymë... por kësaj here, Shpendi mori frymë me shpejtësi dhe thellë. E vëreja se diçka nuk ishte në rregull dhe kur e shikova në fytyrë, ai nuk merrte frymë fare dhe veç shkonte duke u skuqur nga presioni i mungesës së frymës. Kur i thashë: merr frymë, atëherë filloi që të merrte frymë. D.m.th. Shpendi merrte frymë vetëm atëherë kur unë i thoja: merr frymë... Pra, plotësisht, pa vetëdije, ia kisha marrë komandën ndërdijes së tij dhe ai plotësisht e kishte humbur instiktin e frymëmarrjes; merrte frymë vetëm nën urdhërin tim. Të them të drejtën, u frikësova, por e kam pasur një të mirë të madhe në këto raste, se gjithmonë rrija i qetë dhe kisha kontroll mbi

veten time dhe rrethin. Këso rastesh, më ndihmonte intuita pa masë dhe, me me sukses, dilja prej rreziqeve, atëherë kur ndodhesha në to. Kështu fillova t'i rekomandoja Shpendit që të merrte frymë, meqë vetë nuk merrte më dhe, ndërkohë, i urdhërova që çdo gjë të mbante mend se çka i kishte ndodhur gjatë kësaj kohe, derisa ishte në hipnozë. I thashë: mbaje mend edhe arsyen që ti pa urdhërin tim nuk ke mundur të marrësh frymë sipas instiktit. I thashë: kur të numëroj deri në tre, ti do të dalësh nga hipnoza, dhe çdo gjë do të jetë në rregull me ty. Pasi numërova, Shpendi u zgjua dhe filloi që të merrte frymë normalisht, të fliste normalisht dhe çdo gjë ishte në rregull me të. Pas pak tha: Uh, u lirova!... Po, ç' pate, or Shpend, tregomë, të lutem, e pyeta. Kur më urdhërova të mos kollesha, para meje dolën disa dyer gjigante, si të ndonjë kështjelle mesjetare, dhe zunë të mbyllën. Kur ato u mbyllën përfundimisht, unë më nuk mund të merrja frymë, se nuk hynte ajri nëpër ato dyer gjigante para meje. Kur më urdhëroje: merr frymë! vinte një grusht i madh, i mëshonte asaj porte të madhe dhe atëherë nga fuqia e grushtit ato hapeshin dhe hynte ajri në mua nga jashtë. Kështu, vetem ti kur urdhëroje të merrja frymë, grushti i mëshonte portës dhe vinte ajri në mua. E pyeta edhe një herë Shpendin se si po e ndjente tash veten. Tha se tash po ndjehej shumë mirë. Këtu unë u lirova, po kisha frikë që ta hipnotizoja përsëri. Por e dija se patjetër duhej hipnotizuar, që t'ia fshija sugjestionin negativ, të cilin ia kisha dhënë më parë: "mos u koll" dhe t'ia jepja ato pozitive. E hipnotizova edhe një herë, duke punuar me kujdes, gjithnjë duke e kontrolluar dhe duke e sugjestionuar se, tash, është çdo gjë në rregull, si dhe duke i thënë se çdo nevojë biologjike të organizmit tënd ti mund ta kryesh: mund të kollësh, kur të vjen për t'u kollur; mund të qeshësh, kur të vjen për t'u qeshur... Tash je normal, tërësisht si më parë...

Ndërdija i ka ligjet e veta, nëse i thua mediumit «nuk po të dhemb koka », atij, megjithatë, do t'i dhembë koka. Por, nëse i thua se “tash e ke kokën të lehtë dhe të freskët, spontanisht ka për t’iu hequr dhembja kokës. Të dashur lexues, mësoni së pari ligjin e ndërdijes dhe dhënien e saktë të sugjestionëve, e pastaj punoni me ndërdije, qoftë te vetja, qoftë tek të tjerët. Kjo që më kishte ndodhur nuk ishte rastësi. Prej kësaj ngjarjeje kam mësuar shumë, dhe pastaj kam qenë shumë më i kujdesshëm, kur punoja, qoftë për prova të ndryshme, qoftë për shërimin e pacientëve.

DHËMBI DO TË MË EKSPLODOJË

Ishim tubuar të gjithë te baba Azem, në fshatin Vraniq. Unë me fëmijët dhe motra Minire me fëmijët e vet. Të hënën, para dite, kisha vendosur që të kthehesha me Shpendin në qytet (Prizren). Këtë javë kisha punuar shumë gjëra me Shpendin në hipnozë. Në autobus ishte tollovi e madhe dhe mezi se gjeta një vend për t’u ulur. Shpendi ishte afër meje, kur, papritmas, atij filloi t’i dhimbte dhëmbi shumë, sa filloi të qante prej dhembjes së tij. E pyeta se çka kishte, që i shkonin lotët. Ai tha: “po më dhem dhëmbi dhe atë pa masë” dhe e mbante faqen me dorë. M’u kujtua se ndoshta mund t’i ndihmoja diçka me hipnozë, edhe pse isha amator në planin e dhënies së sugjestionëve. Megjithatë, vedosa ta provoja njëherë. I thashë të afrohej te koka ime, ia thashë shifrën e hipnozës, dhe automatikisht ra në hipnozë të thellë. Punova me të shpejt e shpejt, në mënyrë që mos të më diktonin njerëzit rreth meje, se çka isha duke bërë me të. I dhashë sugjestion, se “kur të numëroj deri në tre, dhembja e dhëmbit ka për t’u ndalur deri në Prizren”. E nxora nga hipnoza, dhe, për çudi, i kishte kaluar dhembja e dhëmbit; ai u gëzua pa masë që nuk kishte më dhembje, por njësoj edhe

unë isha i gëzuar që arrita t'i ndihmoja Shpendit. Kështu, pa problem, mbërrimë në Prizren. Posa e ka qitur këmbën e parë mbi tokë ka filluar dhimbja e dhëmbit përsëri. Banesën e kisha vetë dhe i thashë që të shkonim te unë të punoja me hipnozë, për t'ia kaluar dhembjen e dhëmbit. Kur mbërrimë në banesë, e qita prapë në hipnozë dhe ia hoqa dhembjen e dhëmbit.

Këtë ditë kisha vendosur për ta vizituar shokun, Hasan Hamëzbalaj, të cilit i kisha premtuar se do ta merrja Shpendin dhe do të bëja, me të, disa prova me hipnozë, ku ai vetë do të bindej për fuqinë e hipnozës. Këtë ditë, te Hasani, dëshironim që ta hulumtonim banesën e tij, se mos kishte rrezatime të këqija statike, ujëra nëntokësorë etj. E futa Shpendin në autotrans dhe e udhëhiqja vetë. Në dhomën kryesore kishte pasur mjaft rrezatime statike, ku prej fuqisë së tyre Shpendit ia filloi dhembja e dhëmbit dhe e lëshuan këmbët. I dhashë forcë me sugjestionë që t'i kalonin dhimbjet e dhëmbit, mirëpo, për çudi, prapë i dhimbte dhëmbi. Unë nuk dija më se çka t'i bëja për t'ia ndaluar dhimbjen e dhëmbit; nuk më kujtohej se çfarë sugjestionesh i kisha dhënë më parë. Në bahçe të Hasanit gjetëm edhe vende neutrale, në të cilat ta kishte ënda të rrije aty. Ishte bërë gadi ora 23 e natës. Vendosa të ngrihesha e të shkoja në banesë me Shpendin. Ai ishte gjithnjë me dhembje të dhëmbit, e cila shkonte duke iu bërë e padurueshme. Na përcolli shoku Hasan deri diku. Kur mbërrimë afër banesës dhe Shkollës së Re, aty ku mbaronte asfalti, Shpendi filloi të qajë me zë nga dhembja e dhëmbit. Unë, me të vërtetë, nuk dija se çfarë të bëja në atë moment; Shpendi filloi të bërtiste e të shkarravitej nëpër tokë nga dhimbja e madhe që kishte. Në vend se të më rrokte paniku, jam qetësuar thellësisht dhe kam menduar se çfarë duhej tash të bëja, që ta shpëtoja Shpendin. E kapa dhe e ngrita nga toka, ia dhashë shifrën e hipnozës, ku ai, ashtu duke qarë e duke i rrjedhur lotët, ra në hipnozë, por edhe në

hipnozë qante e i rridhnin lotët, veçse pa zë. E qetësova ngadalë, këtu më ndihmoi intuita dhe më erdhi një ide shumë e mirë, që ta pyesja ndërdijën e tij, se çfarë do të duhej të bëja me të, që t'ia ndalja dhembjen e padurueshëm të dhëmbit.

E pyeta: çfarë ke, Shpend? Po më dhemb dhëmbi, tha ai, duke iu dridhur buzët ende ngapak. E pse po të dhemb dhëmbi kaq shumë? e pyeta. Sepse më ke dhënë shumë sugjestionet të ndryshme, nga të cilat dhëmbi po don të më çahet në dy pjesë. U befasova me përgjigjen e Shpendit, se ishte shumë e vërtetë ajo çka tha: me të vërtetë kisha harruar se çfarë sugjestionesh i kisha dhënë atij tërë ditën, deri më tash, kundër dhembjes së dhëmbit. E pyeta ndërdijën e Shpendit: të lutem, më trego se çfarë të bëj që të ndalet dhembja e dhëmbit dhe të shërohet dhëmbi. Shpendi u përgjigj: të gjitha sugjestionet, që m'i ke dhënë, tash duhet t'i fshishë. Mirë, thashë, merri e fshij të gjitha ato sugjestionet. Pas pak, tha: i fshiva të gjitha. Ia përsërita: a i fshive të gjitha sugjestionet? Po, tha Shpendi, të gjitha. Mirë, e tash çka duhet bërë që të ndalet dhimbja përgjithnjë dhe të të shëndoshet dhëmbi? Shpendi tha: duhet të ma japësh sugjestionin: "dita - ditës dhëmbi po të shërohet", dhe atë: 6 herë, e jo më shumë, as më pak. Gjashtë herë i thashë: "dita - ditës dhëmbi po të shërohet" dhe atë, duke i numëruar gishtat, se frikësohesha, mos po harroja e po ia thoja më shumë ose më pak e ndoshta nuk do të kisha sukses. Kur i kreu sugjestionet, e pyeta se a e kishte dhëmbin mirë tash. Ai tha: tash po, shumë mirë. A të nxjerr nga hipnoza tash? Po, tha Shpendi, me gëzim. E nxora prej hipnozës; tash ishte i qetë dhe i gëzueshëm; pa kurrfarë dhimbjeje të dhëmbit. Shpendi tha: më shpëtove, dajë, se isha me të vërtetë në rrezik. Këtu intuita ime e shpëtoi, po edhe e tija po ashtu. He, more dajë, donte të më eksplodonte dhëmbi! Kurrë në jetë këso dhembjesh nuk kam përjetuar ndonjëherë, tha Shpendi. Por,

edhe unë, deri më tash, ende kurrë nuk kisha pasur ndonjë rast të këtillë, i thashë vetes dhe Shpendit.

Lexues të dashur, po e shihni se ç'do të thotë sugjestion i gabueshëm dhe i llojllojshëm?! Sugjestion i jepet vetëm për një qëllim dhe ai sugjestion i vetëm shpesh përsëritet deri kur ai të materializohet te personi. Sugjestion duhet gjithnjë të jepet në kohën e tashme e jo në të ardhmen. P.sh.: nuk i thuhet mediumit se ti do të jeshë mirë, por: ti tash je mirë.

B.V.M - BASHKIMI VULLNETAR I MANGUPVE

Sot e kisha marrë Shpendin me vete te shoku Sabir Krasniqi. Në dhomën e Sabirit, në të cilën pikturonte e lexonte, ne bënim eksperimente me hipnozë, ku shpesh tuboheshim shumë shokë. Sonte te ne kishte ardhur motra e Sabirit me nja dy shoqe, të cilat donin të shihnin drejtpërdrejt se çka është hipnoza dhe ato vetë të hipnotizoheshin, me qëllim që, më vonë, të merrnin autohipnozën e më lehtë t'i mësonin mësimet në Shkollën e Lartë. Pasi që shoku Sabir ua shpjegoi shkurtimisht se çfarë të mirash ka hipnoza dhe autohipnoza, gjatë asaj kohe, e mora Shpendin dhe e hipnotizova. Çdo mediumi, të cilin e hipnotizoja, i jepja posthipnozë apo urdhër posthipnotik që, më vonë, ta vërtetoja saktë se a kishte qenë mediumi në hipnozë të thellë apo jo. Si posthipnozë i jepja diçka që, për rrethanat normale, ishte “pa lidhje”, pa logjikë. Ashtu që ia humbja të mbajturit mend në kohën kur mediumi e kryente posthipnozën: çdo gjë bënte pa vetëdije, por e bënte patjetër, se vendi-vend nuk i zihej, gjersa nuk e realizonte sugjestionin posthipnotik. Për shembull: i thoja “kur të zgjohesh, ke për të bërëtitur sa të mundesh dhe nuk ke për ta ditur se ke bërëtitur”; ashtu bënte mediumi. Po

kur e pyetnim: pse po bërtet ose pse ke bërtitur, ai thonte: “jo, more, çfarë të bërtitne.”

Shpendin, pasi e vura në hipnozë, i dhashë një posthipnozë të këtillë: Kur të zgjohesh nga hipnoza, dhe të jesh plotësisht i zgjuar dhe normal, kur ta përmend fjalën “mollë”, ti, pa vetëdije, ke për t’u ngritur, ke për t’i marrë patericat e Sabirit, ke për t’i vënë në krahë dhe ke për të ecur nëpër dhomë me to. Pastaj, prapë ke për t’i lënë në vendin e vet, ku i ke marrë më parë. Patericat ishin shkopinj të metaltë, që Sabirit ia kishte dhënë ortopedi ushtarak, në Shkup, kur ishte ushtar. Disa ditë pa e kryer ushtrinë, i thehet këmba, dhe për këtë ato i kishte lënë si kujtim, edhe pse, ndërkohë, ai ishte shëruar plotësisht dhe e kishte kryer ushtrinë. Pasi e hipnotizova Shpendin dhe hyri në hipnozë të thellë, i dhashë posthipnozën, siç tregova më lart, e qetësova, i dhashë sugjestionet pozitive dhe e nxorra nga hipnoza; u zgjua i qetë dhe duke qeshur, ku shkoi e u ulë në vendin e vet, ku ishte më parë. Pas disa minutash, ia thashë shifrën posthipnotike “mollë”, e cila automatikisht ndikoi: Shpendi, si i hutuar, u ngrit në këmbë, ngadalë, kinse nuk bënte asgjë, shkoi te dera dhe filloi t’i prekte patericat, thua ishte i interesuar të zbulonte sesi janë bërë ato.

Posthipnoza është një lloj hipnoze apo më mirë: autohipnozë, ku individit, kur i thuhet fjala “e fiksuar” posthipnotike, automatikisht ia ndërron gjendjen psikike, edhe pse deri në atë çast ishte zgjuar; madje, nëse i është dhënë urdhëri që mos të dijë se çka ka bërë kur të zgjohet, normalisht ai fare nuk ka për ta ditur se çka ka bërë gjatë asaj kohe. Është shumë interesant t’i dëgjosh ato mediume, që kanë kryer një veprim të pavetëdijshëm, të cilin ua ka dhënë hipnotizuesi si posthipnozë: ata mundohem, me çdo kusht, t’i bindin të tjerët se me të vërtetë nuk e kanë kryer atë veprim që po u thuhet se e kanë bërë më parë, edhe pse, ta zëmë, atë e kanë parë të gjithë sesi e ka bërë atë gjest. Kur mediumit i

jepet urdhri posthipnotik, ndërdija saktë i kryen urdhërat që i janë dhënë nga hipnotizuesi, qofshin ata edhe urdhëra që nuk kanë logjikë fare. Për posthipnozën kam për të folur më vonë në një kapitull të veçantë.

Kur e pyeta Shpendin se çka është duke bërë, ai tha: “asgjë, veç po i shikoj këto shtaga.” Gjatë kësaj kohe, unë ua shpjegoja atyre vajzave se çka është posthipnoza, sesi nëpërmjet posthipnozës ka mundësi t’i jepet njeriut urdhër që të mësojë pa u lodhur dhe t’i mbajë mend ato që ka mësuar; pastaj, ka mundësi t’i jepet urdhër njeriut që, sipas mundësisë, të mësojë në kohë të caktuar etj. Shpendi i kapi patericat dhe i provonte herë në një krah e herë në tjetrin, kur, më në fund, i vendosi të dyjat ndër krahë dhe filloi të shetiste me to nëpër dhomë. Ishte e kuptueshme se padyshim ndikoi posthipnoza. Gjithashtu, ishte e kuptueshme se Shpendi këtë gjest nuk do ta kishte bërë, sidomos para femrave, cilatdo qofshin ato. E dija se tash ishte në një gjendje tjetër psikike, edhe pse i funksiononte vetëdija. Iu afrova dhe fillova t’i flas: Shpend, të lutem, leji në vend të vet ato paterica dhe eja tek unë këtu. Shpendi i çoi në vend, erdhi para meje, ku i dhashë sugjestionë pozitive. Shoku Sabir iu afrua bibliotekës së vet, ku mori një libër, e çeli në një faqe, me qëllim që t’ia lexonte Shpendit derisa ishte në hipnozë që, më vonë, me urdhër posthipnotik, ta mbante në mend tërësisht atë faqe dhe të na e shpjegonte pasi të dilte nga hipnoza.

Për këtë aftësi isha i njoftuar nga literatura e mëparshme, ku kishin hulumtuar shumë institute botërore, sidomos ato amerikane. Në pyetje ishte mësimi i gjuhëve të huaja me hipnozë, ku thuhej se, me hipnozë, njeriu, mund të mësojë 100-400 fjalë në ditë, pa vështirësi. Aty tregohej sesi, kur kanë shkuar në Kinë, për të gjiruar një film, ku artisti kryesor duhej patjetër ta dinte një dialekt shumë të vështirë të gjuhës kineze, e për ta luajtur rolin në atë gjuhë, e kanë përdorur hipnozën, ku artisti, për 7 ditë, e ka mësuar atë

gjuhë dhe ka luajtur në atë film, duke folur në dialektin e vështirë kinez. Të njëjtën provë në mësimin e fjalëve të huaja e kemi bërë, më parë, edhe unë e shoku Sabir, me shokun Lulëzim Kabashi, të cilit ia dhamë 10 fjalë të gjuhës gjermane, duke ia përsëritur tri herë të njëjtat, dhe i dhamë sugjerimin që, kur të dilte nga hipnoza, do t'i mbante në mend të gjitha ato fjalë, si në gjuhën gjermane, ashtu edhe në atë shqipe. Kur doli nga hipnoza, Lulëzimi, pa problem, i përsëriti të gjitha fjalët që ia lexuam më parë në hipnozë. Kjo ishte një provë bindëse për ne në atë kohë.

Shpendin e lashë në gjendje hipnotike, në këmbë, ku të dy pritnim, derisa Sabiri ta gjente atë fletë që t'ia lexonte Shpendit, të cilën më vonë do ta mbante mend dhe do ta përsëriste tërësisht, për t'i bindur vajzat për fuqinë e të mbajturit mend, të cilën mund ta zhvillojë hipnoza. Por, në atë moment, Shpendi e lëshoi një zë të trishtueshëm dhembjeje. I çeli sytë, duke i zgurdulluar shumë, sikur të ishte befasuar diçka tepër, filluan t'i rridhin lotët dhe filloi të merrte frymë fuqishëm, sikur fëmija që qanë pa zë. Dukej shumë i befasuar. E pyeta se çka kishte, por kurrfarë përgjigje nuk jepte, vetëm rrinte, si një statujë, syhapur, pa i lëvizur as çerpikët, ku vetëm lotët i rridhnin. Ç' ke, Shpend? Të lutem, kthehu! Kthehu, Shpend, dhe mos harro se kudo që je, unë jam me ty! Kthehu!... i thashë, madje pak i shqetësuar. Kthehu, Shpend, dhe, të lutem, mbaji mend të gjitha: çka ke parë dhe çka të ka ndodhur! Shpendi nuk lëvizte fare. Fillova me një koncentrim të madh dhe me qetësi të plotë të mendoja se çka duhej të bëja në këtë rast, që Shpendin ta ktheja mbrapa, pa i ndodhur asnjë e keqe dhe i thashë: Shumë mirë po e ndjen veten, çdo gjë është në rregull te ti, ti po mban mend çdo gjë që të ka ndodhur... Kur të numëroj deri në tre, ti ke për t'u zgjuar. Për çudi, Shpendi u zgjua dhe filloi të qeshë. I fshiu lotët dhe filloi ta prekte nëngjurin e këmbës së majtë. Për fat të keq, kjo çka ndodhi, në këtë moment, ishte

edhe një mësim i madh për mua që, kurrë mos ta lija mediumin pa mbrojtje. Ato femra, në vend se të mësonin për të mirën e hipnozës, ato e morën një frikë të rrejtshme, duke menduar se hipnoza, ndoshta, gjithnjë është e tillë, gjë që fare nuk ishte e vërtetë. Pas pak e pyeta Shpendin, se për çfarë arsye kishte qarë. Shpendi tha: Një idiot më tradhtoi në duel luftarak, ku më gjuajti dhe ma dogji këmbën e djathtë me energji. Po mirë, Shpend, çka të pengonte të flisje dhe të ktheheshe mbrapa? - e pyeta. Më pengonin tri germa. Cilat janë ato germa? Ato germa, tha, janë: BVM, që do të thotë: Bashkimi Vullnetar i Mangupve. Këta dy persona janë të bashkuar në grup dhe çkado që po mund t'u bënin keq njerëzve, po u bënin. I thashë Shpendit: Të lutem, tregomë prej fillimit si i takove këta njerëz dhe si ishte ngjarja në të vërtetë me ty në atë duel luftarak? Shpendi tha: Hyra në një shtëpi ndër tokë. Si e hapa derën, u gjenda në një dhomë të ndritshme. Mbi oxhak ishte i varur, i punuar nga ari, ylli gjashtërrremësh i Solomonit (i profetit Sylejman). Ky yll shkëlqente shumë dhe lëshonte rreze të fuqishme pikërisht në derë të asaj dhome, në lartësinë sa një njeri normal. Ky yll ishte i programuar që, kush të hynte në atë dhomë, të hipnotizohej automatikisht prej tij. Cilido njeri që paska hyrë këtu, qenka hipnotizuar, dhe menjëherë këta dy persona e paskan vjedhur dhe kanë bërë çka kanë dashur me atë njeri të pavetëdijshëm në transin hipnotik, ku ndonjëherë, kur e kanë lëshuar gjallë, atij personi i është fshirë memorja, sa asgjë nuk ka ditur se kush ia ka bërë atë të keqe dhe cilët kanë qenë ata që e kanë vjedhur dhe dëmtuar. Si hyra në këtë dhomë, edhe unë qeshë duke u hipnotizuar. Megjithatë, unë kisha fuqi më të madhe dhe i kundërshtova asaj force, dhe me anë të energjisë që e lëshova nga sytë e mi, e rrëzova atë yll në tokë. Këta dy kriminelë, u habitën shumë dhe i dëgjova kur thanë: Heu, ky ç'na qenka! Këta e ditën menjëherë që unë dhe ti, daja Salih, jemi të caktuar që ta ndalim këtë të keqe që

e kanë shkaktuar deri më tash këta dy persona. Ata menjëherë propozuan: po dalim në duel e ta provojmë se cili jemi më të fortë. Unë u thashë: pse jo, shkojmë! Dualëm në një rrafshirë që t'i provonim forcat. Njëri prej tyre duhej të rrinte si gjykatës. Por, pa e pritur momentin që të fillonim, shoku i tij, gjykatës, i dha shenjë atij, dhe, para kohe, papritmas, më gjuajti me energji, më rroki në këmbën e djathtë dhe ma përzhiti atë pjesë, e cila më dhimbti shumë, sa më rrodhën lotët; por unë, shpejt, me energjinë që e lëshova prej syve, si dy laserë të fuqishëm, i largova të dytë, të cilët filluan të iknin e unë i ndiqja më tutje, deri kur e ndjeva zërin tënd në largësi... Dukej si të vinte prej qiellit apo nga ndonjë dimension tjetër. Atëherë unë u detyrova, si nga mbrapa kodrës, të kthehesha. Por, pasi u ktheva, u detyrova edhe një herë të shkoja e të luftoja, se më thanë: “Nuk kemi për të lënë të qetë asnjëherë”; mirëpo, ata nuk e dinin se ne të dy nuk kemi për t’u lënë vend, derisa t’i zhduknim prej atij dimensionit, ku u bëjnë dëme të tjerëve. I ndoqa deri diku, po zëri yt më urdhëroi të kthehesha mbrapa. Pastaj, u ktheva prapë në këtë dimension dhe u zgjova normalisht. Këta dy persona ishin të shekullit 15-të, e kishin mësuar artin e hipnotizimit dhe e keqpërdornin kundër njerëzve për interes të tyre.

Kjo ngjarje me Shpendin ishte një mësim i madh për mua. Këtë ditë e hipnotizova Shpendin dhe e mësova që të bënte mbrojtjen astrale. Prej këtij momenti, kjo mbronte prej çdo sulmi astral, që i shfaqej ndonjëherë Shpendit, si nga magjistarët e zinj, si prej qenieve të ferrit. Këtë natë, e ndala tek unë, se e ndija se do të ndodhte diçka me të, pasi të flinte, kur spontanisht njeriu del në astral apo, siç shumica e quajnë, në ëndërr. Të nesërmen, Shpendi më tha se diçka nuk ishte mirë, se diçka e kishte sulmuar në gjumë. E hipnotizova dhe e ktheva mbrapa për të parë se çka i kishte ndodhur natën. Ai tha se kishin ardhur ata dy shpirtëra, që shumë herët e kishin

lëshuar trupin, po plotësisht ishin të gjallë, si unë e ti, dhe donin të më mashtronin e të më hipnotizonin në atë botë, astrale, ku u gjenda, pasi rashë për të fjetur. Ata kishin për qëllim me të vërtetë të më mbytnin para se ne t'i zhduknim ata. Por, për fat, ti më kishe bërë mrojtjen e fuqishme dhe nuk mund të më ofroreshin fare nga mbrojtja; i mëshonin vetëm mbrojtjes, e cila ishte si prej kristali, e në të cilën ndodhesha unë; ata mundoheshin ta shkyenin e të më kapnin. Në fillim, para se të më sulmonin, thonin se ishin miq e se dëshironin të shoqëroheshin me mua e të më ndihmonin në hipnozë. Por, për fat, kisha aftësi telepatike dhe ua lexoja qëllimin, meqë ua shihja aurat agresive e, mbi atë aurë, një tjetër, që mundoheshin ta mbulonin natyrën e vërtetë të tyre. Kur e panë se nuk po pranoja dhe se saktë e dija se kush ishin në të vërtetë, filluan të më sulmonin, po nuk arrinin të më bënin pothuaj asgjë. Tash e sugjectionova Shpendin, se, të dytë, së bashku, po shkonim për t'i gjetur se ku janë. “Shpend, dëgjo mirë, në atë dimension apo univers, ku ata janë, jemi edhe ne të dy. Mirëpo, ne kemi fuqi të jashtëzakonshme, dhe nuk ka fuqi të errët që mund të na bëjë diçka. Të gjitha fuqitë e dritës i kemi me ne, a kuptove?” - e pyeta. Po, daja Salih, e di këtë. “Shikoje sa i madh qenka ky univers, po ne kemi fuqi që ta vërejmë të tërin. Tash lart në kupë të universit qenka një e çarë, si derë, ku vetëm këta dy mund të dalin jashtë tij. Ne duhet t'i ndjekim deri kur nuk kanë se çka të bëjnë dhe të dalin jashtë këtij universi, ku ndodhemi ne. Pra, tash filloi ndjekja dhe lufta. Ne po i ndjekim dhe po i gjuajmë me energji, të dytë jemi me mbrojtje të papërshkueshme dhe të fuqishme pa masë. Tash po i çojmë kah dalja. Shpendi tha: dajë, ata po hyjnë nëpër atë vrimë dhe duan të ikin, çka të bëj? Ai pyeti disi me frymë të zënë dhe, në atë moment, edhe unë, me ndërdiqe, pashë qartë atë luftë që e zhvillonim. Nuk po donë të dalin andej vrimës, se po kanë dëshirë ende të ekzistojnë në këtë univers. Më në fund, Shpendi tha: Dualën

jashtë dimensionit tonë dhe me të vërtetë disi e ndjeva që u liruam nga një shtypje e brendshme. I thashë Shpendit: Po e mbyllim atë vrimë që këta kurrë mos të mund të kthehen në universin tonë. E mbyllëm, tha, dhe, disi, shumë u liruam, edhe në trupin fizik. I thashë Shendit se tash je i lirë prej këtyre dy magjistarëve të zinj. A u lirove? - e pyeta. Po, tha, dajë, shumë falemnderit!

Pra, këto qenie më kurrë nuk iu kanë lajmëruar në astral Shpendit. Edhe ky ishte një rast, ku, pa problem, e nxora Shpendin prej rrezikut të vërtetë. Prej këtij rasti, me vite të tëra, më kurrë nuk më ka ndodhur ndonjë rast i tillë, që dikend ta kisha në rrezik, meqë u profesionalizova në këtë lëmë.

Lexues të dashur, nëse mendoni se ka qenë pjellë e fantazisë, gaboheni, se në literaturën botërore përshkruhen eksperimente të ngjashme, ku ka raste kur mediumin e kanë mbytur në atë dimension, dhe, ai, edhe në materie, ka vdekur aty për aty, se hipnotizuesi nuk ka qenë mistik, as magjistar, dhe nuk ka ditur ta mbrojë aspak, së paku t'ia bëjë ritualin e mbrojtjes astrale.

NDODHITË GJATË USHTRIMEVE TË PROJEKSIONIT ASTRAL

“Dashuria është fuqi hyjnore, e cila i shkatërron dertet”

(Satyananda Paramhasma)

“Kush di se nuk di, është më i madhi”

(Lao Ce

SI U BËRA I VETËDIJSHËM, NË ASTRAL,
KUR E VURA NJË LIBËR SHUMË TË VJETËR
MBI BARKUN TIM



Adrian Kryeziu-në katalipsi hipnotike

(fotografoi: Salih Basha-mistik)

Kur kam filluar të ushtroj që të jem i vetëdijshëm në ëndërr apo në botën astrale, gjithnjë, në mbrëmje, i kam dhënë vetes sugjestione që të jem i vetëdijshëm në ëndërr. Kështu p.sh. jepja një sugjestion: “Si të dal në ëndërr, unë do

të jem i vetëdijshëm, kam për të ditur ku jam, çka duhet të bëj dhe çdo send kam për ta mbajtur mend”. Në fillim të ushtrimeve, kisha ndonjëherë vetëdije të shkurtër, në ëndërr, po prapë më humbiste dhe kaloja, pastaj, pa vetëdije, në ëndërr. Bota e ëndrrave është botë astrale - eterike, botë e ndjenjave dhe emocioneve, ku çdo gjë ndodh përpara se të ndodhë në materie. Shumica te ne, në popullin tonë, mendojnë se ëndrra është vetëm “një ëndërr” e jo më shumë, dhe, shpesh, bëhet shaka në favor të saj, duke mos e njohur realitetin e plotë. Bota e ëndrrës është botë e vërtetë, të cilën, ne, për çdo natë, e vizitojmë, dashur e pa dashur. Në këtë botë jeton shpirti pas vdekjes, nëse ky shpirt nuk është mjaft i zhvilluar; pra, mbetet në nivelet më të ulëta të astralit. Këtë dimenzion e vizitojmë edhe ditën. Kjo botë i ka shtatë dimenzione apo shkallë. Në këtë botë ekziston ferri dhe parajsa (Parajsën dhe ferrin resulullah Meher Baba i quan botë iluzore si dhe materjen, apo besimtarët islam e quajn botën fizike botë e rrejshme. Parajsë të vërtetë resulullah M.Baba e quan bashkimin me Zotin). Përveç njerëzve, ekzistojnë edhe shumë qenie të ndryshe, të cilat ne, në materie, nuk i shohim. Në këtë botë çdo gjuhë e botës kuptohet, dhe, me çdo krijesë, mund të komunikosh e të merresh vesh. Në këtë botë ekzistojnë krijesa të ferrit, po edhe të parajsës. Krijesat e ferrit jetojnë poshtë, nën tokë; kurse ato të parajsës, lart mbi tokë, në dritë. Toka është në mes të parajsës dhe ferrit. Bota astrale - eterike i ka ligjet e ndryshme nga ajo që i ka bota e materies, edhe pse bota eterike është një lloj materie, ku vibrimet e energjisë i ka të tjera në krahasim me ato që i ka toka. Në astral nuk ekziston koha as hapësira, për dallim nga jeta në materie; ato, në një mënyrë, ekzistojnë, po me to mund të manipulohet. Me trup astral, ti mund të udhëtosh në çfarëdo kohe dhe dimenzioni, nëse të lejohet. Të gjitha ndjenjat dhe shijet në atë botë ekzistojnë, por ato janë shumë më të fuqishme se të

dimenzionit të materies dhe ato mund të ndërrohen sipas bindjes dhe vullnetit tënd. Në atë botë ekzistojnë qeniet e legendave dhe të përrallave, si të popullit shqiptar, ashtu edhe të tërë botës, duke filluar prej djallit, exhinëve apo demonëve, xhuxhimaxhuxhët, zanat e malit, zanat e ujit e deri te engjujt dhe krijesat e ndryshme të dritës. Pra, në çdo element kosmik, duke filluar prej elementit të zjarrit, ajrit, ujit dhe të tokës, ekzistojnë qenie të ndryshme, të cilat e jetojnë jetën e vet dhe janë të lidhura me natyrën dhe universin, ku secila prej tyre e kryen nga një rol në kosmos. P.sh. një lloj krijesash, që jetojnë në botën e elementit të zjarrit, quhen Sallamandret, e këto qenie janë të gjinisë femërore apo mashullore. Këto qenie e kanë vetëm një element kosmik në vete, elementin e zjarrit dhe kanë fuqi të madhe magjike. Ka magjistarë, që janë fillestarë dhe shpesh dashurohen në këto femra shumë të bukura, për të cilat mund të them lirisht se këso bukurie rrallë haset në tokën tonë, prandaj këta magjistarë çojnë dashuri ose martohen me to në atë botë. Por e keqja është se ato janë tepër xhelozë dhe, po i tradhtove, dashnorin automatikisht e vrasin, dhe ai person e lëshon trupin fizik apo shkon, ndoshta, për të jetuar me to, ose diku gjetiu në astral, ku e ka për detyrë. Këto krijesa në materie shpesh shkaktojnë zjarre, me ose pa qëllim. Disa lloje qeniesh që i takojnë elementit të ajrit quhen Elfet. Këto qenie janë edhe femra, edhe meshkuj, po janë shumë të bukur-a dhe të shpejtë-a; këto e bartin erën prej një vendi në një vend tjetër. Elementit të ujit i takon një lloj krijesash të ashtuquajtura Nikset dhe Nereidet, ku, po ashtu, ka edhe femra, edhe meshkuj, po femrat i ka aq të bukura ky element, sa s'i ka asnjë element tjetër. Shumë magjistarë fillestarë kanë bërë vetëvrasje me qëllim, duke e këputur perin astral, që lidh trupin fizik e astral, dhe shkojnë për të jetuar në këtë botë. Këta magjistarë janë të dobët dhe shtrohet pyetja: Si pranon një njeri, i cili ka në vete katër elementet kosmike,

plus akashën, dhe i cili është një njeri – Zot, të shkojë e të jetojë me një krijesë shumë më të ulët se vetja, që ka vetëm një element kosmik! Në elementin e tokës, gjithashtu ekzistojnë lloje krijesash, si pozitive, ashtu edhe negative; një nga to janë xhuxhimaxhuxhët, të cilët janë 20-50 cm të gjatë. Këto krijesa i donë njerëzit, se, në një mënyrë, jetojnë si njerëzit, në grupe. Edhe te këta ka pjesëtarë me zhvillim të ndryshëm shpirtëror; në mesin e tyre ka magjistarë të fuqishëm. Këto krijesa e kanë një mbret, i cili i sundon. Mbreti i tyre është edhe magjistar i fuqishëm, përndryshe nuk mund të jetë mbret i tyre. Di fshehtësi magjike, që rrallkush prej njerëzve i di ato. Për këto krijesa të elementeve të ndryshme mund të shkruhen libra të tërë, siç janë shkruar në botë. Qëllimi im është diçka tjetër: t'ju tregoj sidomos për përvojat e mia, ku besoj se shumë kanë për t'ju ndihmuar, si në dije, ashtu edhe në praktikë, nëse ndonjëherë e përdorni atë.

Trupi astral del prej trupit në shumë mënyra, po edhe hyn në trup në shumë mënyra. Më ka ndodhur që të dal prej trupit me vetëdije, kah këmbët, dhe fluturoja prapë, ku, këmbët më shkonin përpara e koka prapa; dhe tokën e shihja si po lëvizte, nën mua, si i hypur në qerre apo në veturë; në realitet: ti lëvizë në atë moment, e jo toka. Por, përsëri, kthehesha mbarë, ku, së pari, fluturonin duart ose koka. Dukej shumë pa kuptim të fluturonin së pari këmbët e pastaj koka. Ka ndodhur që të kem dalur nga pleksus solaris-i, çakër mentale te lukthi. Pastaj, më ka ndodhur të kem dalur edhe nga koka, prej çakrës së lartë. Më ka ndodhur që të dal prej tërë trupit e të qëndroj me eterik në tavan të dhomës, ku trupi fizik shihej poshtë, mbi dysheme, i ngrirë, duke fjetur thellësisht ose duke kërrhatur në njëfarë mase. Më ka ndodhur të çohem në këmbë, sikur ngrihesh kur je i shtrirë e don të shkosh diku.

Një natë, pashë ëndërr se isha në një odë me burra, në fshatin Maqitevë. Oda ishte plot njerëz, të njohur e të panjohur. Unë isha ndalur në derën jokryesore të asaj ode, e kisha hapur një orë të tavolinës, me zile, ia kisha nxjerrë gati të gjitha pjesët e saj, dhe i kisha qitur mbi një bez të bardhë. E ndija se në atë vend u pengoja të tjerëve për të kaluar në tjetrën dhomë. Pas pak, i mblodha ato pjesë mekanike, në atë bez të bardhë, dhe dola pranë një stufe, te oxhaku, por duke ecur, më pengonin disa njerëz. Aty ishte natë, kishte vetëm llampa, por, posa u ula në atë vend, u bë dritë, si e ditës, ku menjëherë fillova të gjykoj dhe më erdhi, përkohësisht, vetëdija, por jo aq e plotë, sa saktë të dija se çka po ndodhte. I bëra vetes pyetje: Si është e mundur të bëhet ditë kaq shpejt, gjersa ishte plotësisht natë dhe terr? Pas pak, dola prej asaj ode, fillova të lëshohesha kodrave teposhtë, nëpër rrugë, dhe doja të shkoja në fshatin Vraniq. E pashë veten në bjeshkë, te vendi i ashtuqujtur “Rrafshi i Ahmetit”. Në dorën e djathtë kisha një libër shumë të vjetër, me kopertina të trasha, të cilin e qita mbi bark dhe, automatikisht, u ngrita mbi tokë e fillova të fluturoj me gëzim e me vetëdije. Nën mua ishin malet, rrugicat e kodrat; shihja në perspektivë të shpezve, nga lart - poshtë. Papritmas, u gjenda në një dhomë të mbyllët, po jo aq e vogël; ishte pa mobilje. Aty ishte vetëm një tavolinë dhe një nxerëse e brendshme. Para meje ishin 4 njerëz: dy femra e dy meshkuj. Vetem njërin e njihja, ishte në fytyrë të djalit të dajës Jakup, ishte Qaushi. Unë fillova t’u tregoja këtyre se kisha vetëdije në atë dimenzion, ku e prekja tavolinën i gëzueshëm, si një fëmijë, e u thoja: Shikoni, kjo është tavolinë, qenka e fortë si në materie; po e ndjej shumë mirë kur po e prek me dorë, po e ndjej të ftohtin dhe fortësinë e kësaj tavoline. Pastaj, e prekja një nxerëse dhe u thoja: Shiheni, edhe kjo qenka e fortë si në materie. Doja t’i bindja se unë isha duke e ditur se ku isha, dhe se kisha vetëdije; ata mbeten gojëhapur, meqë unë ata nuk kisha se përse t’i bindja,

kur ata i takonin të njëjtit dimenzion. Në atë mënyrë, ngadalë, e humba vetëdijen dhe kalova në astral (në ëndërr), pa vetëdije.

Kjo natë më la mbresa të thella në vetëdije dhe me të vërtetë pashë se njeriu ka mundësi të qëndrojë në astral, si në materie, me vetëdije; por, disi, ajo vetëdije, pak dallonte prej vetëdijes që ne e quajmë “vetëdije normale”, ku ne jemi “zgjuar” në dimenzionin e materies. Kjo natë më dha vetëbesim të madh që të vazhdoja punën më tutje.

KALIMI NËPËR TERRITORIN E DJAJVE

Një natë, para se të flija, i thashë vetes, se do ta lija trupin të flinte, dhe unë do të dilja, me vetëdije, në dimenzionin astral – eterik, ku, pa problem, do të kisha kontroll mbi veten. Kur rashë, i dhashë vetes sugjestion që, pasi të më zinte gjumi, të zgjohesha në ëndërr (në astral) dhe të isha i vetëdijshëm për atë rreth ku gjendesha. “Kam për ta ditur se ku jam, ç’po bëj, si duhet të veproj dhe kam për t’i mbajtur mend të gjitha, kur të kthehem në botën fizike” – e sugjestionova veten.

Dola në disa kodrina. Ishte një natyrë e bukur dhe e gjelbruar, stina e pranverës. Para meje ishte një dru qershije. Rremat e saj ishin të mbushur fruta qershish, por ende të papjekura sa duhet; aty – këtu veç sa kishin filluar të shenjoheshin. Qielli ishte i kaltër dhe i pastër, dielli nxente; mirëpo, ishte freski e vërtetë; dhe kjo ishte më se reale. E pyeta me zë veten: A paskan filluar të piquen qershitë, a? Këtu, automatikisht, më erdhi vetëdija dhe në këtë moment pashë aty afër bashkëshorten, Kasemën, duke u përparë me dy vetë meshkuj, ku njëri u soll shumë keq me të. Iu ofrova atyre dy meshkujve dhe njëri më sulmoi keq. Meqë unë kisha vetëdije, mora fuqi nga kosmosi, dhe i rashë aq shumë atij personi, të cilin nuk e

njihja, në fytyrë, sa që ai ra përtokë pa vetëdije, edhe pse nuk desha fare ta sulmoja apo t'i bija; por, disi, duhej patjetër ta sulmoja, se ishte i rrezikshëm për rrethin. Mendova se e mbyta. Pas pak, më erdhi një ndjenjë, se duhej ta lëshoja atë vend, të ikja patjetër, sa më shpejt dhe sa më larg atij vendi.

Para meje shtrihej një zabel bingu, të cilin njerëzit e kishin prerë pamëshirë dhe keq, si kur të vjedhësh, e i pret drunj të lart, ku të vie më lehtë e jo në rrënjë, ku duhet. Drunj të ishin të prerë mbi tokë për afërsisht gjysmë metre, trungjet e drunjve të prerë kishin mbetur si brisqe përpjetë. Unë fillova të vrapoja, teposhtë, me shpejtësi, nëpër atë zabel, ku duhej shpesh t'i tejkaloja ata drunj



Trans i thell hipnotik-dora e djatht
plotsisht e bllokuar
(fotografoi:Salih Basha-mistik)

të prerë, dhe lëndohesha nëpër ta, në pjesën e poshtme të nëngjunjve. Kur lëndohesha, më dhembte këmba, dhe një pjesë e vetëdijes më kthehej në trupin fizik, ku edhe e ndjeja dhembjen; por, prapë, e vazhdoja vrapimin në astral, meqë nuk kisha rrugë tjetër, pos të lëshohesha teposhtë nëpër atë

lugshtajë. Poshtë ishte një luginë shumë e errët dhe e panjohur për mua. Në të dy anët ishin kodrat e larta, ku gati aspak diell poshtë në lugshtajë nuk depërtonte; pothuaj ishte errësisë e thellë. Kur mbërrina në atë lugshtajë të trishtueshme, pashë se isha futur në territor djajsh, të cilët aty banonin. Para meje ishte një tubë djajsh, të cilët dukeshin plotësisht të zinj, me fytyrë njeriu, po të errësuar, me lesh fytyrës, me sy të dhijës dhe me veshë të mëdhenj, si të dhijes; kishin këmbë e bisht të dhive, dukeshin të trishtueshëm. Unë kisha vetëdije dhe shpejt duhej të vendosja se çka do të bëja në këtë moment. Bëra pyetje se a thua ishte kjo një sprovë, për mua, se a do të dija të dilja prej këtij rreziku e të shpëtoja, pa problem, apo, mos, vallë, ishte fundi im! Duhej të bëja diçka që të mos më zbulonin se kush isha, se ende ata nuk më kishin parë se gjendesha afër tyre. Ata kishin mundësi të më zinin dhe të më copëtonin, ose të ma robëronin trupin eterik, se kisha hyrë në territorin, ku ishte e ndaluar për të tjerët. Sikur të ma robëronin trupin eterik, sigurisht se – ose do të kisha mbetur në komë, derisa të më kishte kthyer mbrapa ndonjë person që i njeh këto gjëra; ose do të kisha luajtur psikikisht; ose do të ma kishte robëruar trupin fizik ndonjë djall, i cili do t’u bënte dëme, me trupin tim, njerëzve, në materie, e të gjithë do të kishin menduar se unë jam duke i bërë ato e jo dikush tjetër... Në atë moment m’u kujtuan mësimet e adeptit apo të magjistrait më të mirë të shek. 20, Franc Bardonit, në librin “Rruga drejt adeptit të vërtetë”, ku thotë se kur të shkoni për herë të parë në një botë jofizike apo në ndonjë element kosmik, ju duhet patjetër që ta shndërroni trupin tuaj astral në formën e atyre krijesave që gjenden në atë dimenzion apo element, dhe pasi të merrni atë formë, si ato krijesa, nuk guxoni kurrësi të parët të flisni, se ligji është i tillë, se po folët të parët, ato krijesa mund të ju sundojnë dhe për ju çdo gjë mbaron, meqë ato krijesa kanë fuqi shumë të madhe magjike. Si të folin ato të parat, ti mund të flasësh

lirisht, pa kurrfarë pasojash të mundshme, se ti je Zot me pesë elemente kosmike, e ato janë vetëm me një element kosmik. Pas këtij mendimi, shumë të mirë, që m'u kujtua në atë lugshtajë të djajve, unë menjëherë e mora formën e një djalli të zi, pikërisht si ata. U nisa drejt tyre, pa bërë zë, meqë dhe rruga më çonte në atë drejtim. Kur mbërrijta te grupi i djajve, të gjithë u habitën, se nga erdha unë që kurrë nuk më kishin parë aty pari apo në grup të tyre. Fillova të ec drejt tyre, para meje në largësi dukej, në fund të grykës, një dritë; ajo dritë ishte shpëtimi im. Fillova shpejtimin, i tejkalova ata djaj, e kur u largova nja 20-30 metra, njëri bërtiti me zë të lartë, po në gjuhën gjermane: “Er ist falsch – ai është fals”! E ditën se nuk isha djall, po njeri, dhe i kisha mashtruar që të mos më njihnin se kush jam. Ajo bjeshkë ishte territor gjermanësh. Duke vrapur kah drita, u shndërrova në njeri dhe fillova vrapin më të madh; pak pa më kapur, dola në dritë dhe shpëtova nga rreziku. Automatikisht, posa u futa në dritë, u ktheva në trupin fizik, ku u zgjova me “vetëdijen normale” të botës materiale. Kur u zgjova nga shtrati, më dhimbnin nëngjunjtë. Kur i largova pixhamat, dy këmbët, nën gjunjë, m'u kishin bërë gunga - gunga dhe të nxira, verenik; kah i kisha lënduar në astral, ashtu m'u kishin shfaqur shenjat e lëndimit në materie. Ky fenomen njihet shumë mirë në magji si udhëtim me astral. Ata që e njohin mirë okultizmin dhe mistikën, e dinë shumë mirë se çka u ndodh në trupuin eterik, mund t'u ndodhë edhe në trupin fizik.

HYRJA NË VETVETE, ZVOGËLIMI MË SHUMË SESA NJË ATOM NË PLANETIN E DIJES

Udhëtimi në botën astrale bëhet edhe në mikrokosmos, në vetvete. Ushtrim timin kryesor të mistikës e

kam pasur koncentrimin në fotografi të Resulullah (Avatar) - Meher Babës dhe përsëritjen e fjalës: “Unë jam pakufishmëri në mua”. Meher Baba është resulullah- (avatar) i të gjithë resulullahëve (avatarëve), manifestim i Zotit në tokë, ndaj quhet Zoti në tokë.” Në librin e tij “Bisedat”, shumë bukur i sqaron të gjitha llojet e meditimit, që i përkasin mistikës, pra zhvillimit të lartë spiritual. Meditimi kryesor që më përshtatej ishte kur meditoja pesë minuta në foto të Babës, pa menduar gjë tjetër, dhe pesë minuta në vetvete, duke e përsëritur “Unë jam pakufishmëri në mua”, ku hyja gjithnjë e më thellë në mikrokosmos. Kur meditoja në foto të M. Babës lidhesha drejtpërdrejt me Avatarin mentalisht. Meher Baba këshillon që, në qoftë se e zgjidhni një mësues apo Sheh ose Pir, atëherë zgjidheni një mësues të përsosur, që e ka arritur realizimin e Zotit, edhe nëse tash nuk ekziston në botën fizike. Në qoftë se meditonit në një mësues që nuk është i përndritur, ose vetëm mësues me fjalë, atëherë, më mirë mos meditonit në të, se duke medituar në të, i merrni të gjitha karakteristikat e tij, dalngadalë duke u bërë si ai; në këtë mënyrë stagnoni plotësisht në zhvillimin shpirtëror.

Përjetime të mëdha shpirtërore kisha kur hyja në vetvete, pra në qendër të vetes, ku zvogëlohesha sa një bërthamë e atomit, e ndonjëherë më shumë, ku mundohesha ta vizuelizoja ose ta përjetoja pakufishmërinë. Kështu hyja dhe udhëtoja në atë bërthamë, e cila me të vërtetë nuk kishte fund; si dukej, aty ishte fillimi i çdo gjëje që ekziston në Univers. Kur mbërrija deri te bërthama e një atomi në mua, unë prapë zvogëlohesha edhe më shumë dhe ajo bërthamë fillonte të bëhej gadi sa një planet, e jashtë bërthamës shihej vetëm pakufishmëria, fare e pasqaruar me logjikë, por e cila me të vërtetë ishte më e gjallë sesa vetë materia që ne e prekim. Gjatë pesë minutave meditimi, më dukej se koha ishte e pakufishme, më dukej se shumë gjatë po qëndroja në atë gjendje. Shpesh zvogëlohesha edhe më shumë se bërthama e

atomit, ku futesha në të. Udhëtoja me vetëdije të plotë, nganjëherë fare nuk funksiononte logjika, se nuk kisha fjalë t'i përshkruaja ato që shihja në vete, gjuha ishte e varfër për përshkrimin e atyre gjërave të mëdha që i shihja. Kur futesha thellë në bërthamën e atomit, dilja në një hapësirë të pakufishme, ku edhe vetë isha i pakufishëm. Këtu detyroheshja prapë të zvogëlohesha, se në mua e ndjeja një fuqi të papërshkrueshme. Kur bëheshja edhe më i vogël, e shihja si një spirale që po lëvizte prej hiçit dhe shkonte në hiç; ai ishte Universi i papërshkrueshëm me fjalë. Futesha në atë spirale ku zvogëlohesha edhe më shumë dhe e lypja një planet apo yll me jetë. Kur u ofroheshja disa planetëve, aty fare nuk shihja se në planet mund të jetonte ndonjë krijesë, po vërehej se tërë ai planet, si të them, ishte i gjallë, me jetë, kishte një ngjyrë si të kaltërt, dhe shkëlqente si një qelq i tejdukshëm. U zvogëlova edhe më shumë për ta parë saktë atë sipërfaqe. Shihja se, disi, tërë planeti merrte frymë dhe, disi, ishte në rritje e sipër. Mbi planet nuk kishte as krijesa as bimë. I shihja vetëm aty-këtu nëpër planet disa lule të bardha, që u përngjanin luleve, që ne i quajmë zambakë të Prizrenit. Lulet ishin shumë të mëdha, në disa hynte fryma, e prej disave dilte një frymë tjetër. Mbi sipërfaqen e atij planeti ishte krijuar edhe një shtresë e re, ku dukej si të ishte e tejdukshme, si prej qelqi. I përngjante një luleje, e cila së pari e merr formën e vërtetë në botën eterike e pastaj, ngadalë, fillon të rritet në botën fizike. Isha kureshtar të dija se ku po hynte ajo frymë dhe përse ai planet apo yll po e bënte këtë frymim. Interesoheshja për ato lule si Zambaku i Prizrenit apo si lule Orhide, të cilat nuk kishin fletë të gjelbra, as rrënjë. Gryka e atyre luleve të çonte në thellësi të atij ylli. Fillova ta përcillja atë vrimë kah hynte fryma. Diku, thellë në atë yll, mbaronte gryka e asaj luleje, disi prehej dhe vazhdonte një kanal tjetër, që të qonte në qendër të atij Ylli. Kur mbërrina në qendër të atij ylli, pashë një sferë të tejdukshme, si prej

kristali, me një shkëlqim të jashtëzakonshëm, me ngjyrë të kaltër-vjollce, me ngjyrë pjeshke, shkurt: ishte i gjallë plotësisht. Zëri i brendshëm më tha se ky planet ishte Planeti i Dijes. Nuk kishte gjë që kjo sferë e tejdukshme dhe e gjallë nuk dinte, ishte plotësisht e përsosur dhe gjeniale, ku mendja jonë nuk mund ta kapë atë dije. Ajri ishte freski dhe ushqim për këtë sferë të dijes së pakufishme. Mirëpo, kur e lëshonte ajrin e përpunuar në anën tjetër, me këtë pastrohej dhe e zhvillonte trupin e vet planetar, bëhej më e madhe, zhvillohej më shumë. E ndieja fuqinë dhe dijen e atij planeti të pakufishëm. Kisha mundësi t'ia merrja një kopie të sferës me dije të pakufishme dhe ta futja në vete. Kisha frikë, nuk guxoja ta merrja atë dije të madhe, se nuk e dija në do të dija ta përdorja për të mirë apo jo. E ndjeja se ende nuk isha i pjekur dhe i përgatitur për një dije aq të lartë. E dija shumë mirë se edhe trupi fizik, edhe nervat, duhet të jenë të përgatitur për një dije aq të lartë. Në atë moment i dhurova dashuri, ku dhe ai më dhuroi mua dashuri. U ktheva kah kam ardhur, me vetëdije normale. Këso përjetimesh kam pasur shumë e të llojllojshme, tash po i cek edhe disa përjetime të tilla për ju.

Në këtë mënyrë shpesh kam medituar, ku trupin mental, emocional dhe astral i kam zvogëluar derisa arrija të bëhesha sa një bërthamë atomi. Atomi dukej posi një sistem diellor, ku silleshin planetet rreth tij. Shpesh hypja mbi bërthamë të një atomi, si një gjigant, dhe e përcillja pakufishmërinë rreth meje e në mua. Pastaj, e hapja një tunel për udhëtim në bërthamë të atomit, dhe udhëtoja derisa dilja në një dimenzion, ku kisha ndjenjën se isha tepër i madh, sa një univers. Disi, si nën mua, e shihja një spirale të dritës, që fillonte prej hiçit dhe shkonte, duke u zmadhuar, nga poshtë – lart, deri në hiç. Hyja prapë në atë spirale, ku kërkoja një planet me jetë. Duhej më tutje të zvogëlohesha, se në atë madhësi nuk kisha gjasë të shikoja. Kjo i përngjante sikur e

shikon Tokën prej një sateliti apo nga ndonjë anije kosmike, e cila qëndron mbi tokë. Në fillim shihej vetëm planeti i rrumbullakët e, duke iu afruar, fillonin të dalloheshin kontinentet, e duke rënë më poshtë shiheshin detërat e lumenjtë; pastaj, duke rënë më poshtë, shiheshin qytetet, disi katror-katror, të formave e të madhësive të ndryshme, ku banonin njerëzit. E më në fund, kur të lëshohesha në tokë, në një madhësi të caktuar, e shihej me të vërtetë si dukej ajo natyrë e Tokës. Kur zvogëlohesha në atë masë, që të mund të shihja saktë atë planet, unë fascinohesha e mbetesha pa gojë nga ajo bukuri. Ky planet ishte me dy shtresa. Uji jo vetëm që ishte mbi sipërfaqe të planetit, po ishte edhe lart mbi pjesën si të lëngët, ku uji qëndronte pezull mbi planet, nja 20-30 metra mbi sipërfaqe. Uji qëndronte pezull, po edhe bimët rriteshin si në ajër. Në disa vende, rrënjët e atyre bimëve fantastike, me tri shtresa të një flete, ku rrënjët iu kishin dalur nën ujë, rrinin pezull në ajër. Atë e mbante një fuqi e padukshme. Bimët rriteshin në grupe në atë planet dhe kishin pamje fantastike, të cilat unë fare pak mund t'i përshkruaj sesi ishin në të vërtetë ato bimë, të cilat nuk kishin materie dhe nuk ishin të ngurta; toka jonë nuk i ka ato lloj bimësh.

Po ua përshkruaj edhe një udhëtim deri në bërthamë të atomit, ku vetëm pjesërisht do t'ua tregoj ngjarjen, meqë pjesa tjetër mbetet sekret në mua, nga frika se, ndoshta, me këtë dije që posedojmë, dikush mund dhe ta keqpërdorë bërthamën e atomit, duke u shkaktuar dëm të tjerëve dhe vetes, siç është bërë keqpërdorimi i Bombës Atomike në LDB.

Një ditë udhëtova në vetvehte, deri në bërthamë të Atomit, e jo më thellë, ku vendosa që të studioj sipërfaqen e një bërthame të Atomit. E zgjodha një organ në trup fizik dhe aty hyra e u zvogëlova deri në bërthamë të atij organi. Atomet dukeshin të ngjashme, mirëpo disi ndryshonin në mes veti. Dallimi shihej në sipërfaqe të bërthamës së atomit,

atëherë kur e rritja sa një shkëmb të madh apo bjeshkë, apo e zvogloja vehten. Mirëpo, sipërfaqja e bërthamës së atomit bëhej më e qartë kur e rrisja sa një planet, ku lirisht mund të ecje mbi të, si mbi sipërfaqe të tokës. Kur e rrisja bërthamën e atomit, shihja se sipërfaqja ishte e përbërë prej trekëndshave e tetëkëndëshave të lidhur në të gjitha anët në mes veti. Po edhe ky “planet” ishte i përbërë prej atomeve të vogëla deri në pakufi. Këta trekëndështa u përngjanin piramidave të lidhura në mes veti, në të gjitha anët; të lidhura ishin dhe këto grimca piramidale, ashtuqujtur Merkaba. Në shumë vende, në këtë ”planet” kishte hyrje, si shpella, po këto shpella e kishin hyrjen trekëndëshe. Në secilën qoshe të këtij trekëndëshi të shpellës ishin të lidhur disa litarë elastikë, si qime jo shumë të gjata, e në majë të secilës qime ekzistonte edhe një trekëndësh i vogël. Pra, çdo shpellë i kishte nga tri qime, në majë nga një trekëndësh edhe me tri qime të tjera, shumë të shkurtëra, si tre gishtërinj. Këto qime disi e bënë atomin të gjallë. Befasitë ishin të panumërta, më tutje nuk mund të flas...gjene ju vet?!

PËRJETIMI NË KOPËR

“Po e dite se nuk di asgjë, është më së miri; të mendosh se di diçka, në qoftë vërtet nuk është ashtu, është sëmundja më e madhe; por, në qoftë se mund ta njohësh këtë sëmundje të shpirtit, do të thotë se je në rrugë të shërimit”

(Quang Ce)



“Leta engjellushë”

(pikturoi:Salih Basha, mistik)

Qysh në vitet ‘82-‘83 të shekullit të kaluar, në ish-Jugosllavi, kishte filluar të dilte një revistë ashtuqujtur “Tajna”, e cila e kishte kuptimin e fshehtësive. Ishte revistë e ilustruar, shkencore, metafizike, që përfshinte dijet e ndryshme, si të prapsikologjisë, të okultizmit, të magjisë etj. Nga kjo revistë mësoja shumë gjëra të ndryshme; këtu kishte lloj-lloj informatash për zhvillimin e kurseve në ish -

Jugosllavi. Vetëm teoria nuk më kënaqte, atë kohë dëshiroja që të përjetoja edhe praktikën, diçka drejtpërdrejt që ta përjetoja vetë. Duke e shfletuar këtë revistë, më ra në sy një artikull që e kishte shkruar psikologu dhe okultisti , Zhivorad Mihajloviç-Sllavinski, i cili në Kopër të Sllovenisë kishte një ashram për zhvillim spiritual, ashtuqujtur “Kisha e bardhë gnostike”. Edhe pse quhej kishë nuk kishte fare të bënte me kishën. Në këtë ashram mbante kurse të ndryshme për zhvillim spiritual, sidomos kursin e ashtuqujtur ”Kursi intensiv i përndritjes (iluminimit)”. Isha shumë i interesuar për zhvillim shpirtëror dhe menjëherë e porosita librin e tij “Përndritja intensive”, në mënyrë që të njihesha më për së afërmi me atë drejtim spiritual. Këtë metodë të pastrimit shpirtëror, jashtëzakonisht efikase, e kishte zbuluar amerikani , Çarls Berner, i cili edhe vetë mbante kurse të ngjashme në Amerikë. Me përdorimin e kësaj metode njeriu pastrohej prej bllokadave të ndryshme, traumave, streseve dhe sëmundjeve të ndryshme. Në këtë kurs njeriu kishte shans që të përjetonte një blic-iluminimin apo përndritjen, njohjen e vetvetes, Zotin në ne. Edhe pse përndritja bëhej e shkurtër, e nuk ishte e përhershme, mjaftonte për të nxitur më tutje ta hulumtosh të vërtetën.

Në atë kohë vendosa të shkoja në atë kurs me shokun, Sadri Krasniqi, që, siç thamë, mbahej në Kopër të Sllovenisë. Këtë ditë e pritnim pa durim, edhe pse udhëtimi ishte mjaft i largët: një natë udhëtonim deri në Beograd, e pastaj, tërë ditën, deri në Pulë, ku prej aty kalonim në Kopër të Sllovenisë. Në atë kohë udhëtimi ishte shumë i bukur, se çdo kund kishte paqe e rehati jashtë Kosovës. Kroacia dhe Sllovenia ishin dy republika, të cilat e kishin bregdetin e bukur, dhe turizmi botëror i vizitonte pandërpre; po ashtu ndertimi dhe komunikacioni, qoftë ai rrugor, hekurudhor apo detar ishte shumë i zhvilluar. Dallimi në mes të Kosovës dhe të këtyre dy republikave ishte dukshëm i madh. Ne i kishim

informatat e sakta sesi prej Koprit mund të arrinim në atë fshat të thellë, malor të Sllovenisë, ku mbahej kursi i “Përndritjes intensive”. Nga stacioni i autobusëve u nisëm, me autobus, për në atë fshat të lartë malor. Prej atij fshati, zbritej teposhtë kodrinës, nëpër një rrugë, e cila na dërgoi drejt e në ashramin, ku mbahej Kursi i Përndritjes. Në rrugë takuam edhe disa persona, të cilët shkonin në atë kurs. Ashrami shtrihej në një lugshtajë; ishte një shtëpi e stilit slloven, në dy kate, ku shkallët për në katin e dytë ishin të ndërtuara nga jashtë. Sllavinski e kishte blerë atë shtëpi nga një fshatar slloven. Shtëpia ishte e përshtatshme për meditim dhe kurse të tilla, se në afërsi askush nuk banonte dhe, përreth, ishte e mbushur me vreshta, pemë e livadhe të fshatarëve. Si u afruam afër atij ashrami, na përfshiu një ndjenjë paqeje dhe qetësie; dukej si një botë tjetër, e largët për mua, edhe pse e njihja gjuhën e tyre. Posa arritëm, pyetëm, se ku duhej lajmëruar. Njëri na udhëzoi të shkonim në katin e parë. Aty ishte një dhomë e madhe dhe pa mobilje, ku kishte vetëm jastëkë për meditim dhe një, si karrige, si fron, në krye të dhomës. Në atë karrige, si fron, por shumë thjesht e bërë, rrinte një person, i cili shkruante diçka. Ai ishte mësuesi i Përndritjes *intensive*, Zhivorad Mihajloviq – Sllavinski. Ishte një person i moshës mbi 40 vjeçare, me syza, simpatik, i skuqur, dhe shumë aktiv, si në të folur, si në lëvizje. Iu paraqita, ku iu prezentova, i dhashë letërnjoftimin, ku i mori informatat e datëlindjes. Asistenti i tij më tha se mund t’i lija teshat në një qoshe. Sadriu ishte jashtë ashramit, duke biseduar me të tjerët. Atë ditë isha pak i tërhequr në vete.

Reth orës 18, hëngrëm darkë, ushqimi ishte plotësisht vegetarian. Këtë natë, secili tregonte emrin, mbiemrin, datëlindjen, nga ishte, për çfarë qëllimi kishte ardhur në intenziv etj. Sllavinski tha: Nëse ndokujt i është mbushur mendja që të mos ia fillojë kursit, le të tregojë tash e ai, ose

ajo, mund t'i tërheqë të hollat; nesër, edhe po e lëshuat, nuk kthehen të hollat më.

Pas orës 18, filloi kursi; nuk ishin ushtrime, po kjo bëhej vetëm sa për njoftim me anëtarët dhe rregullat e kursit. Ishin këto rregulla: Tri herë në ditë kishim për të ngrënë ushqim të rregullt vegjetarian. Duhej të binim për të fjetur saktë në ora 22 të mbrëmjes. Zgjimi bëhej në ora 5 të mëngjesit; deri në ora 6.30 min. bëhej gjimnastika, pastrimi i fytyrës, regullimi i teshave, shëtitja në ajër të pastër, derisa fillonin ushtrimet medituese. Tërë kohën e lirë duhej të pyetnim veten: “Kush jam unë”. Duhani, alkooli, seksi dhe droga ishin të ndaluara. Nuk guxonim gati fare të bisedonim në mes vete, sepse tërë kohën duhej të meditonim në Koan-in (shiqo fjalorin mbrapa) **Kush jam unë**. Në kopsht nuk guxonim t'i merrnim frutat, edhe pse kishte me bollëk. Ishim mbi 60 vetë, kishte femra dhe meshkuj, të moshave të ndryshme. Ishin nga të gjitha ish-republikat dhe ish-krahinat e ish-Jugosllavisë. Kishte nxënës të vjetër, edhe të rinj, si unë e Sadriu, që ishim për herë të parë. Kishte nxënës që kishin ardhur mbi dhjetë herë në të njëjtin kurs. Duhej të uleshim dy nga dy, në rende, këmbëkryq, ose mbi gjunjë. Njëri partner ishte pasiv, kurse tjetri aktiv. Partneri pasiv duhej që partnerin aktiv ta udhëzonte: „Përfjetoje drejtpërdrejt kush je ti“; atëherë, ai, gjatë 5 minutave, nuk fliste më, veç dëgjonte me vëmendje se çka po fliste personi aktiv. Personi aktiv isha unë dhe duhej që në vete të pyesja: „Kush jam unë“. Si person aktiv i mbyllja sytë dhe prisja se çfarë do të ndjeja apo përfjetoja në vete: ndonjë formë vizuale, ndjenjë, mendim në kokë, shqetësim në vete, dhembje, zhurmë anash; thënë shkurt: paraqitjet e para duhej treguar personit pasiv. Duhej treguar çdo gjë partnerit. Kishte gjëra që ishte tepër vështirë t'ia tregosh personit të huaj, të cilin nuk e njihje; ato ishin gjëra intime që ndoshta askuj nuk kam mundur t'i tregoj dhe, për këtë, shumë përjetime të tilla ndoshta do të mbeteshin

përgjithmonë të varrosura në mua, po të mos ishte ky kurs, e të cilat do të ishin vërtet pengesë për zhvillimin tim shpirtëror.

Në çdo pesë minuta ndërroheshin rolet; asistenti na tregonte me zë të lartë: ndërroni rolet. Tash, partneri pasiv, bëhej aktiv dhe të njëjtat gjëra i përsëriste. Meditimi dhe pastrimi zgjatte 40 minuta, pra për secilin partner duhej 20 minuta; katër herë ndërroheshin rolet. Në sallë dëgjoheshin lloj-lloj fjalësh me tone të ndryshme: sharje, bërtima, qarje me zë, katarza, qeshje, ndonjëherë bërtima të trishtueshme që t'i futnin ethet në trup nga frika. Me këto bërtima liroheshin njerëzit nga të këqijat. Kishte lloj-lloj përjetimesh. Çdo orë duhej t'i ndërronim partnerët. Në sallë lirohej një energji shumë e madhe dhe ndjehej një dashuri e papërshkrushme; secili donte ta njihte veten, ta njihte Zotin në vete, e kjo ndjenjë vërtet ishte e papërshkrushme; ishte një gëzim i madh, por, në anën tjetër, ego-ja në ne apo mendja, bënte pengesë të madhe, meqë nuk i besonte një gjëje të tillë, se këtë gjë kaheerë e kishte harruar në vete. Ego-ja bënte kurthe të lloj-llojshme: të frikonte, të bënte dembel, t'i fshihte gjërat që të lironin e shumë e shumë gjëra të tjera; pothuaj të pakufishme ishin dredhitë e egos në ne. Ndonjëherë kisha dëshirë për ta lëshuar kursin, se më hynte njëfarë frike e pakuptueshme. Por ndjenjat e brendshme të intuitës më thonin të vazhdoja, të pastrohesh, se suksesi do t'ishte imi; edhe pse ishte vështirë, kisha një gëzim të brendshëm. Dikush, ndonjëherë, përndritej duke e njohur veten përkohësisht; në atë çast dukej se tërë salla po bënte dritë. Kur kisha ndonjë problem, ndonjë përjetim, ndonjë frikë apo shihja ndonjë ëndërr gjatë natës, duhej të shkoja te mjeshtri i kursit e t'i tregoja hallin që kisha, pastai kthehesha prapë të vazhdoja kursin.

Të premten në mbrëmje e pashë një ëndërr, ku ndërdiha më tregonte se çka duhej të bëja në kurs që të

përndritesha. Ëndrra ishte kjo: Isha në fshatin Vraniq, duke shkuar kah Reka e Madhe. Isha në lagjen e Velinurve, afër vendit të cilin ne e quanim Vendi i Maçekut. Në këtë vend ishte një kishë shumë e vjetër ilire, por gjurmët i kishin humbur. Me mua vinin disa qenë, të cilët më ruanin, më donin dhe luanin me mua. Kur hypa lart në atë vend, ku ishte një livadh i vogël, e dëgjova një zë. Në atë rrafsh pashë një krijesë si një plazmë, si ngjitës i tejdukshën, por që lëvizte; ishte e gjallë, po nuk ngjitej për toke, e cila më tha: *Në qoftë se i zbulon të gjitha që i ke në vete, si përjetime, që ty të duket se nuk bën t'i zbulosh, ti ke për t'u iluminuar, ke për t'u përndritur, dhe do të bëhesh shumë i lartë e do t'i nevojitesh vetes dhe të gjithëve.*

Unë, disi, u frikësova prej asaj krijese-plazmë të tejdukshme, por intelegjente dhe e gjallë; pastaj, e kapa një gur dhe desha ta godas... Pranë meje ishte udhëheqësi shpirtëror, me të cilin bisedoja...

Të nesërmen shkova dhe i tregova mësuesit, i cili më pyeti: A di se çka don të thotë kjo ëndërr? Po, i thashë. Mirë, shko! tha. Ndërdija, apo Uni i brendshëm më porosiste që të çilesa dhe çka të më vinte, t'i tregoja partnerit, të mos fshihja as ndjenjat, as mendimet. Të nesërmen isha shumë më i çelët ndaj të tjerëve në komunikim, edhe pse shpesh më vinin mendime që ta lëshoja kursin, se më dukej shumë vështirë. Kur dikush e përjetonte në sallë iluminimin, ndihej një gëzim i papërs shkrueshëm, ku secili dëshironte të ketë të njëjtin përjetim. Kohë pas kohe binte energjia te pjesëmarrësit e kursit, ku të gjithë gati shqetësoheshin e nuk kishin vullnet për të punuar. Mjeshtri e diktonte këtë rënie të energjisë dhe në pauzën e parë shfryzonte rastin të na e tregonte ndonjë tregim të dhimbshëm të sufizmit, të budizmit apo diçka tjetër që i përkiste të përditshmes. Ashtu e tregonte atë tregim, sa shumë prej nesh qanim për njerëzit me zë dhe me këtë e ngjallte energjinë në ne, ku kursi fillonte me një

aktivitet shumë më të lartë. Shoku Sadri, atë ditë, e pati një përjetim-blic të iluminimit, i cili ishte mjaft për herën e parë. Më erdhi shumë mirë për të dhe kisha dëshirë që të përjetoja edhe unë iluminimin. Pas dite, e pata një vizion të jashtëzakonshëm, sa mbeta pa fjalë. M'u çel pamja shpirtërore, u bë dritë, dhe doli para meje tërë universi, me të gjithë yjet, planetet dhe galaktikat. **Një plak serioz gjigant**, me mjekër të gjatë e të thinjur si dëbora dhe me flokun e gjatë e të bardhë, rrinte mbi atë univers, i cili e përcillte çdo lëvizje. Atë plak unë e quajta Zot. E shihja vetëm mbi gjunjë e lart, se poshtë dukej si mjegull. Prej gëzimit të madh, që pashë një hyjni të lartë, duke menduar se me të vërtetë pashë Zotin, u ngrita dhe shkova me gëzim e lotë në sy te mjeshtri dhe ia tregova atë vizion të pastër që pashë më parë. Mjeshtri më dëgjoi me vëmendje dhe nuk tha gjë. Mirë, tha, vazhdoje diadën. (Simbas tregimeve të mistikve të përndritur-iluminuar, këtij lloji vizioni i thojnë rahmeti apo mëshira e Zotit, i cili e zgjedh të dashurin e vet që ta afroi ngat vehtes).

Atë natë, të shtunën, pashë një ëndërr tjetër. Isha lart në një ndërtesë shumëkatëshe. Në kulm të saj ishte një bazen për larje, po jo shumë i madh; ishte plotësisht i papastër, i turbullt. Shkova dhe e çela atë bazen, i cili filloi të zbrazet. U zbraz pothuaj tërësisht; mbeti pa u zbrazur vetëm një pjesë e vogël. Në këtë ëndërr disi më udhëhiqte nëna ime, Zarifja.

Të nesërmen, shkova dhe i tregova mjeshtrit për ëndrrën që pashë, i cili më pyeti se a e dija çka do të thoshte. I thashë: jo. Shko tha, sikur donte të më thoshte: e merr vesh, vetë, më vonë. Kjo ëndërr më tregonte se gati isha pastruar tërësisht dhe se kishte mbetur vetëm edhe një pjesë e vogël pa u pastruar, të cilën duhej ta pastroja, se, edhe pse ishte pak, ishte shumë e papastër.

Të dielën, në diadë, për partner e zgjodha një femër, e cila ishte e re dhe e bukur. Kjo femër ishte përndritur dhe e kishte njohur Zotin në vete. Unë e pashë në pushim shumë të

gëzueshme, e cila fliste me çdo send, si me drunj, me gurë, me insekte dhe shpezë. Një moment, e pashë si e kishte kapur një gur në dorë dhe fliste me të, dukej se kishte luajtur menç. E dija se kur njeriu përndritet, ai është gjithçka, i shkriër në tërë universin. Tashi do t'ua përshkruaj disa përjetime njerëzish (marr nga libri I Kultin Riordan Spit: "Rad Gurdjijeva"-serbokroatisht) të cilët e kanë përjetuar përndritjen apo gjendjen më të lartë të vetëdijes kosmike të pastër. Më vonë do t'ua përshkruaj edhe një përjetim timin.

Një nga nxënësit e Gurxhievit e ka përjetuar gjendjen më të lartë të vetëdijes- përndritjen në këtë mënyrë:

"Gjatë kësaj vere kam pasur një përjetim të thellë të vetëdijes më të lartë. Nga tri përjetimet e mëparshme të ndikimit të papritur të fuqive të larta, m'u ka dhënë që të më shfaqet vetëdija për vete. Ky përjetim i tashit ishte plotësisht ndryshe. Një ditë kam dalur nga shtëpia për të shëtitur nëpër fushë, që të lahesha e të freskohesha në lumin Viskonsin. Diku, në mes të rrugës, filloi të hynte në mua një fuqi e mrekullushme dhe e çuditshme që përfshinte tërë qenien time, duke më mbushur me dritë dhe forcë. Jam ndalur, kam qëndruar qetë dhe kam lejuar që kjo fuqi të rrjedhë nëpër mua. Megjithëse isha i vetëdijshëm për rrethin ku qëndroja, fushat dhe malet, dielli që nxente, paraqitnin vetëm prapavijë të përjetimit të brendshëm. Të gjitha shqetësimet e të së përditshmes u zhdukën; në të njëjtën kohë e kam parë veten dhe marrëdhëniet e mia me njerëzit, e kam parë modelin e jetës sime, organizmin tim si po shkon në rrugën e caktuar. Koha më nuk ekzistonte, kurse kuptimi i tërësisë së jetës vepronte si i mundshëm. Kjo ka qenë vetëdija se kam hyrë në jetë të vërtetë, kurse jeta e jashtme, e cila m'u ka dukur shumë me rëndësi dhe e cila ma ka marrë tërë kohën, nuk ka qenë jetë e vërtetë, ka qenë vetëm diçka efemere (kalimtare), një lloj filmi në kino, me të cilin jam identifikuar. Vetëm diçka

*në brendësi ka qenë e vërtetë-**Unë**, vetja ime e vërtetë: **UNË JAM**.*

Këtu po e përshkruaj një përjetim të brendshëm nga nëna (përcjellësja) e Shri Aurobindit:

“...Që të gjendet shpirti, njeriu duhet të tërhiqet prej sipërfaqes, të tërhiqet thellë brenda, e të hyjë, të shkojë poshtë, poshtë në hapjen e thellë, të qetë, paqësore, ku është diçka e ngrohtë, e pasur dhe jashtëzakonisht e qetë, jashtëzakonisht e plotë, sikur ëmbëlsi - e ky është Shpirti. Në qoftë se njeriu është këmbëngulës dhe në qoftë se në vete është i vetëdijshëm, lajmërohet një lloj i caktuar i plotësimit që jep përshtypjen e të Plotës, e cila përmban thellësi të pamatshme. Njeriu e ndjen se po hyri këtu, shumë fshehtësi do t'i zbuloheshin si gurgullimë uji të qetë, diçka që është e përjetshme dhe më nuk ka kufizim kohor. Këtu njeriu e ka një përjetim se ka qenë gjithmonë dhe gjithmonë do të jetë”.

Tash po u jap një përjetim, kur Krishnamurti e ka përjetuar transformimin:

“Ka qenë këtu njeriu i cili e ndriqte rrugën; ai njeri kam qenë unë vetë. Ai që mbante kazmën, isha unë vetë, ai që thente gurin ka qenë pjesë imja; fija e butë e barit ka qenë vetë qenia ime personale; kam mundur të mendoj e të ndjej sikur njeriu që e ndriqte rrugën: kam mundur të ndjej erën që frynte, e cila kalonte nëpër drunjtë, kam mundur të ndjej bubërrecin e vogël që ecte nëpër bar, vrimat, pluhurin, zhurmat – të gjitha kanë qenë pjesë imja. Pikërisht atëherë, në një largësi të caktuar, kalonte automobili: unë kam qenë shofer, motor dhe gomat e automobilit; sa më shumë që automobili largohej nga unë, edhe unë largohesha prej vetes. Kam qenë në çdo send apo, më saktë, çdo send ka qenë në mua, e gjallë dhe jo e gjallë: bjeshkët, krimbi e të gjitha gjërat të cilat marrin frymë. Tërë ditën kam mbetur në atë gjendje të lumtur.”

Tash po përshkruaj një përjetim të drejtpërdrejtë të shenjtit bashkëkohor, Svami Muktananda Paramhansan, i cili thotë:

*“Kam medituar si më parë. I larti, Nitjananda, papritmas më dha një rënie të brendshme. Në të njëjtin moment, rrezet e aurës së kuqe shndritën në gjithë 72.000 nervat e mia, si dhe në rruzat e kuqe të panumërta. Flaka e bardhë u lajmërua me atë që e mbante, në dritën e zezë, dhe pastaj, i dashuri, Margaritari i Kaltër, bazë e çdo gjëje! Në të njëjtin moment, meditimi im u bë më i fuqishëm. Vizioni im u drejtua kah lart. Derisa i kam drejtuar sytë në atë Margaritar të Kaltër, ai filloi të rritej në të gjitha drejtimet, duke i zgjeruar rrezet e veta të kaltra. Tërë hapësira, prej tokës deri në qiell, u shndrit. Më nuk kishte margaritar, veçse shkëlqim, dritë të shkëlqyeshme, të pakufishme. Këta janë autorët e dorëshkrimeve dhe njohësit e të vërtetave më të larta që e kanë përshkruar si dritë të vetëdijshme: **Qiti** (shiqo fjalorin në fund të librit). Pastaj e kam parë sesi universi po lind prej asaj gjerësie, si mjegulla e tymit prej zjarrit. Kosmosi u lajmërua në dritë të vetëdijshme dhe drita e vetëdijshme në kosmos, sikur fijet e penjve në pëlhurë dhe pëlhura në fijet e penjve. Sikur fara që rritet në dru, prej të cilit dalin degët, fletët, lulet dhe frytet - esenca e Qitit ekziston në vetë qenien - te shpeza e shtaza, te krimbi e insekti, te engjëlli e demoni, te mashkulli e femra. E kam parë një dritë hyjnore, të vetëdijshme e të shkëlqyeshme, e cila trokiste qetë në të gjitha anët, si lumturia më e lartë, së jashtmi e së brendshmi, së poshtmi e së lartmi. Edhe pse sytë i kisha të hapur, isha në meditim. Sikur zhytësi, që zhytet në ujë dhe është i rrethuar vetëm me ujë, edhe unë këtu kam qenë i mbështjellë me një dritë të vetëdijshme. Në këtë gjendje, universi humbi dhe unë e shihja vetëm shkëlqimin e pastër, i cili valonte gjithkah rreth meje...”*

Tash po ua përshkruaj përjetimin e një budisti, i cili ka ushtruar zenbudizëm në Zelandën e Re:

“E kam marrë Koani: “Të gjitha gjërat kanë për t’iu kthyer Njërës: ku ka për t’u kthyer Njëra” dhe me kujdes jam koncentruar në të. Së pari, mendja ime ishte e preokupuar me plot mendime, por, dalngadalë, filloi të shihej ndryshimi, derisa nuk kam qenë në gjendje të pastroja mendjen prej çdo gjëje, përveç Koanit. Atëherë më nuk kam mundur më tutje. Çdo send më është dukur e humbur. E kam ndjerë veten të pavlerë dhe të humbur. Pastaj, kam vendosur të tërhiqem në bjeshkë, në vetmi, dhe nëpër bjeshkë kam ecur derisa jam rraskapitur plotësisht, tërë kohën duke e përsëritur Koanin në vete.

Ashtu, një ditë, u ndala para lumit i rraskapitur dhe jam ulur. Papritmas kam ndier, si duket jo me veshët e mi, fëshfërimën e erës nëpër degë. Në të njëjtin moment, prej gjendjes sime të rraskapitjes, kalova në një gjendje tjetër, ku ndjeva se ishte hapur një rrjedhë në mua, jashtë meje dhe rreth trupit tim. Çdo gjë ka qenë e mbështjellë me një rrymë të bardhë, të shkëlqyeshme, më dukej se po shihja si po lindte tërë kosmosi, pa ndërprerë. Si ishte e mundur të kishte aq shumë dritë? Palë mbi palë: dritë. Çdo gjë ishte e shndritshme. Më mbisundonte një ndjenjë që të hyja në vetë thelbin e ekzistimit - pa formë, pa personalitet, pa zotëra, një lumturi e tërë.”

Këta ishin ca nga shembujt e bukur të përshkrimit të përndritjes.

Kjo femër dukej se po shkëlqente nga dashuria. Kjo dukej edhe në fytyrën e saj të bukur. Ishte e qetë. Unë kisha dëshirë të dija më shumë për të dhe përjetimin e saj. Në momentin e fundit e zgjodha këtë femër për diadë (komunikim gjatë meditimit). Edhe unë kisha ndjenja të papërshkrueshme të dashurisë. Këto ndjenja kurrësi nuk mund t’i ndalja, por këto nuk ishin ndjenja seksuale fare,

ishin ndjenja të dashurisë universale. Zemra më gufonte nga kjo dashuri e papërshkrueshme. Gjithë çka përjetoja dhe ndjeja duhej t'i tregoja asaj dhe ajo mua. Në këtë mënyrë filloi diada, ku filluam të dashuroheshim pa vetëdije. Në diadë, gjatë komunikimit, shihej se edhe ajo po më donte. Mirëpo unë isha i martuar dhe i kisha dy fëmijë, si dy drita: Arbenën dhe Arbenin, të cilët i doja shumë. Kështu, një çast, papritmas, prej mallit të madh e dashurisë që kisha për Arbenin, më erdhi Arbeni, me trup eterik, para meje, si i gjallë të ishte. Në atë rast, mbeta pothuaj pa frymë, por, pas pak, ia fillova të bisedoja me të; i thashë: *Ben, erdhe ta shohësh babin...* dhe më shpëtuan lotët prej dashurisë që kisha për të. Kur pa ajo që isha i martuar, u pre në fytyrë dhe në çast e ndërroi temën. E kisha një përjetim-blic të iluminimit, sepse kisha një dashuri të jashtëzakonshme për njerëz, shtazë, bimë dhe për çdo gjë që kishte krijuar i madhi Zot. Ajo më dëshironte përndritje të thellë, por, po ashtu, edhe unë i dëshiroja asaj të njëjtën gjë: përndritje të thellë.

Të shtunën mbrëma, unë dhe shoku Sadri, pasi përfundoi kursi, u ndalëm me dy shoqe në sallë të ushtrimeve për bisedë. Njëra ishte mjeke, nga Sllovenija, e cila gjatë merrej me zhvillim spiritual; kurse tjetra ishte kroate. Gjatë bisedës, mjekja përmendi një sistem të zhvillimit shpirtëror, të cilin e kishte përvetësuar në një seminar në Kanada. Ky sistem ishte shumë i thjeshtë dhe shumë efikas, si për zhvillim shpirtëror, ashyu edhe për shërim: për largimin e streseve, të depresioneve, të bllokadave etj., e i cili të mbushte tërësisht me energji jetësore. Ky sistem quhej Ringjallje (Riberthing). Ishte një lloj frymëmarrjeje e shpejtë, si hiperventilacion. Ky sistem mund të të ndihmonte që ta përjetoje edhe një herë lindjen prej barkut të nënës dhe, me këtë përjetim, shumë të këqija largoheshin prej teje. Mjekja më pyeti se a kisha dëshirë ta provoja këtë sistem. Unë, me gëzim, i thashë se kisha dëshirë ta provoj riberthingun. Na i

tregoi rregullat, ku na tha se, së pari, duhej të shtriheshim e të relaksoheshim; pastaj, duhej të frymonim (të mernim e të nxirrnim frymën) me një ritëm të shpejtë, nëpërmjet hundës, pa u ndalur. Nuk bën të mendoni keq, tha, veçse duhet t'i lëshoni mendimet që të rrjedhin qetas. Çdo ndjenjë, që vjen, duhet ta lëshoni të rrjedhë, pa e penguar fare. Nëse të vjen të qash, mund të qash, nëse të vjen për të bërtitur, mund të bërtasësh; të gjitha duhej lënë të dilnin prej nesh, në mënyrë që të pastroheshim nga këto. Tha: Mirë është mos të ndërpritet ushtrimi derisa vetë, në mënyrë spontane, të ndalet



“Në të andejmen”

(Pikturoi: Salih Basha, mistik)

ritmi dhe të normalizohet frymimi.

Në frymim hymë unë, Sadriu dhe kroatja. Mjekja slovene, e cila ishte me të vërtetë e bukur, inteligjente dhe e dashur, i udhëhiqte ushtrimet e frymimit-riberthingun. Shoku Sadri dhe kroatja e ndërpreu ushtrimin, kurse unë vendosa të shkoja deri në fund, kur, në mënyrë spontane, do të ndalej frymimi i shpejtuar. E kisha humbur ndjenjën e kohës. Herë

qeshja me zë e herë qaja; herë e doja dikë, e herë e urreja. Dikur, vetvetiu, m'u ndal frymimi i shpejtë, m'u duk sikur m'u liruan mushkëritë dhe trupi. Mendova se kisha ushtruar nja 30 min., dhe u habita, kur mjekja sllovene tregoi sa shumë kishte zgjatur. A di se sa ke ushtruar? - më pyeti. I thashë: nja 30 minuta. Rrafsh 2 orë e 20 minuta!-tha. E dija se kisha filluar ushtrimin në ora 23 të natës dhe shikova orën time: Me të vërtetë ishte 1 e 20 minuta e mëngjesit. Mbeteja i habitur. Çdo send më dukej tjetër në atë dhomë.

Ç' ËSHTË PËRNDRITJA (ILUMINIMI): NJOHJE E SË VËRTETËS, NJOHJE E ZOTIT NË NE APO REALIZIM I NJOHJES MË TË LARTË?

Resulullah (Avatar)- Meher Baba për njohjen e së vërtetës thotë: “Kur të vie deri te barazimi dhe përputhja e përsosur e *sanskarave* (*shiqo fjalorin në fund të librit*), atëherë edhe njëra, edhe tjetra, zhduken; e, ajo çka mbetet, është ena e mendjes, e cila mban të vërtetën ashtu si është, të pashtrembëruar. Në shpirt kurrë nuk ka qenë diçka e transkriptuar. Sanskarat kanë qenë të grumbulluara në mendje e jo në shpirt. Shpirti mbetet gjithmonë i papërlyer, por kjo shihet vetëm atëherë kur mendja bëhet pasqyrë e pastër, e cila mban të vërtetën. Kur impresionet - të mira dhe të këqija - zhduken, mendja e sheh shpirtin. *Ky është iluminimi.*

Ndërkaq, kur mendja e sheh shpirtin, kjo nuk është njëjtë si kur shpirti e njeh vetveten; sepse shpirti nuk është mendje, por Zot, i cili e tejkalon mendjen. Sipas kësaj, pasi që mendja të shehë shpirtin, ajo duhet të shkrihet në shpirt, që shpirti të njehë vetveten si të vërtetë. E Ky është Realizimi. Në këtë nivel, të gjitha sanskarat e mira dhe të këqija zhduken. Kjo është gjendje që tejkalon mendjen dhe, për këtë, është mbi të kundërtat e të mirës dhe të së keqës. Në

këtë nivel ekziston vetëm një ekzistencë e pandashme, ku cilësitë e saj janë: dashuria e pakufishme, qetësia, mirësia dhe dituria. Lufta e pandërprerë ndërmjet të mirës dhe të keqës tashmë është ndalur, sepse nuk ka as mirë, as keq; ekziston vetëm një jetë e gjithanshme dhe e tërë e Zotit.” Resulullah (Avatar) – Meher Baba

PËRJETIMI NË TREN

„Të fitojë mbi shprehinë e këqija, njeriu mundet vetëm sot, e jo nesër“

(Konfuqi)

Merresha me zhvillim spiritual një kohë të gjatë; mirëpo, një e keqe ishte se në trojet shqiptare, sidomos në Kosovë, as që lëvizte diçka në këtë drejtim gjer atëherë. Nuk kishte revista për parapsikologji, nuk mbahej ndonjë kurs, thjesht: nuk kishte asgjë në këtë drejtim. Në ish-Jugosllavi kishte revista të ndryshme dhe mbaheshim lloj-lloj kursesh për zhvillim shpirtëror, në çdo republikë, e po ashtu dhe në krahinë të Vojvodinës. Në Beograd mbahej një kurs për zhvillimin spiritual, i ashtuquajtur Intensivi i Përndritjes. Ky të ndihmonte që, pak a shumë, të njihje vetveten, dhe kishte gjasa që, me pastrimin mental dhe të karmës, të mund të përndriteshe përkohësisht. Këtë kurs e mbante gruaja e Zh. M. Sllavinskit, Jadranka Stilin. Sllavinski ishte psikolog, mësues i Përndritjes dhe okultist, i cili kishte shkruar shumë libra në këtë drejtim. Te Sllavinski kisha qenë në kursin e Përndritjes, i cili mbahej në Kopër, e i cili më kishte lënë përshtypje shumë të madhe dhe përjetime të papërshtueshme shpirtore, të cilat i përmenda më sipër.

Meqë kisha mundësi të paguaja, e mora në këtë kurs dhe vëllanë, Muharremin. Ai mezi priti të vinte. Gjysmën e kursit e kishim paguar para kohe. Jadranka ishte një femër e re, simpatike, me një trup të hollë, elegant, flokët të shkurtëra... po, mbi të gjitha, ishte shumë e dashur ndaj të gjithëve. Meqë kisha përjetime të shumta te Sllavinski, në Kopër, e dija se do të përjetoja gjëra të ngjashme edhe te Jadranka. Në mëbrëmje fillonte kursi, prej orës 18 -22 të natës. Nata e parë ishte si hyrje: njoftim se çka do të bënim dy ditët

e ardhshme. Me vete kishim marrë thasë për fjetje natën dhe mjetet e higjienës personale. Sa i përket gjuhës, nuk kishte problem as për mua, as për vëllanë. Sakaq, unë kisha dhe përvojë nga kursi i Përndritjes Intensive. Këtë natë erdhi Sllavinski, i cili u takua me ne dhe na uroi suksese. Për këtë njeri kisha simpati të madhe, e po ashtu edhe ai për mua. Pas kursit në Kopër më pati thënë: “Salih, për ty jam posaçërisht i interesuar. Ti je gjithmonë i mirëseardhur te ne.”

Në fillim, secilin pjesëmarrës e thirrte me rend; personi prezentohej, e tregonte qëllimin pse kishte ardhur në kurs dhe çka priste prej tij.

Pasi u njoftuam plotësisht lidhur kursin dhe secili me secilin anëtar, në mbrëmje, në ora 22 ,të gjithë ramë për të fjetur në atë dhomë të madhe, përpos pjesëmarrësve, që ishin nga Beogradi, të cilët shkuan në banesat e veta. Këtu kishte disiplinë të lartë, kishte rregull; ushqimi ishte vegjetarian, të cilin e përgatisnim vetë, në kuzhinë, e pastaj ua shpërndanim të gjithëve. Këtu nuk guxonte të përdorej alkooli, duhani apo ndonjë mjet stimulues. Duhej të zgjoheshim në ora 5, ku bënim higjienën personale, gjimnastikën e mëngjesit dhe hanim diçka të lehtë me çai. Kursi fillonte në ora 7 dhe përfundonte në ora 22 të natës. I kishim 17 orë meditim intensiv. Dreka zgjatte 1orë e 30 minuta, kurse darka 1 orë. Gjatë gjithë kësaj kohe, madje edhe kur bënim ndonjë pauzë të shkurtër, duhej intensivisht të meditoni mbi premisën “kush jam unë”. Nuk guxonim pothuaj fare të flitnim në mes veti. Nëse dëshironim diçka të pyetnim, atëher duhej pyetur mjeshttrin. Në kurs ishim mbi 30 vetë, femra dhe meshkuj. Kur fillonte meditimi, rregull ishte që të uleshim dy nga dy, mbi gjunjë, ose këmbëkryq, kështu i formonim rendet, deri ku na nxinte dhoma. Në fillim të meditimit e zgjodha Muharremin, që ta mësoja sesi shkon meditimi, meqë unë kisha njëfarë përvojë. Njëri person ishte aktiv, kurse tjetri pasiv. Në fillim, personi pasiv duhej ta urdhëronte personin

aktiv: “Përrjetoje drejtpërdrejt: kush je ti“! Personi aktiv e vënte dorën në gjoks, i mbyllte sytë dhe fillonte ta pyeste veten: “Kush jam unë“! Çkado që t’i paraqitej, qoftë në trajtë dhimbjeje, qoftë si foto, si ngjarje etj., duhej që t’ia komentonim personit pasiv dhe atë, pa fshehur asgjë, edhe pse shumë gjëra ishin tepër intime. Personi aktiv vazhdonte kështu 5 minuta, pastaj ndërroheshin rolet: personi pasiv bëhej aktiv dhe anasjelltas. Për çdo 5 minuta asistenti jepte urdhër: ”Ndërroni rolet”. Kështu vazhdonte meditimi tërë ditën, e po ashtu dhe pastrimi i mendjes, ku dalngadalë fillonim të përjetonim fenomene të ndryshme. Natën ëndrrat ishin të pastra dhe plotësisht porosi shpirtërore. Çdo herë, çkado që përjetoje, duhej që t’i tregoje mësueses. Energjija në atë dhomë vlonte dhe, shpeshherë, spontanisht, çilej syri i tretë. Njëherë, e pata një përjetim interesant. Para m’u paraqit hyjnesha indiane, Vishna, e cila kishte katër duar dhe e veshur ishte me diamante e gurë të çmueshëm, të ndryshëm. Dyshemeja ku qëndronte Vishna ishte plotësisht e shtruar me diamante të bardha. Froni, ku qëndronte, ishte prej arit e argjendit; ajo bënte dritë në tëra anët dhe dukej si një burim drite, por që qeshej me plot dashuri me mua. Këto fenomene zakonisht shfaqeshin para përndritjes dhe quheshin pengesa të përndritjes, sepse këto përjetime të hutonin që të mos e njihje të vërtetën në ty. Edhe pse ishin me domethënie të madhe, shfaqeshin tepër rrallë. Ditën e dytë, edhe Muharremi përjetoi një gjë të tillë: u përndrit, po nuk e dinte se është përndritur. Kur ma shpjegoi, në diadë, e kuptova se diçka e madhe kishte ndodhur, po për këtë duhej të bindej vetë Muharremi, se as mjeshtri nuk do t’i thoshte “je përndritur” derisa njeriu vetë nuk e kupton se është përndritur; edhe pse ai e shihte aurën e vet duke shndritur. Vetëm 10 ditë pasi që kishte kaluar kursi, duke e analizuar te dytë, së bashku, e pamë se ishte përndritur vërtet. Atëherë i kemi shkruar Jadrankës, ku Muharremi i tregonte që e kishte kuptuar se

ishte iluminuar. Jadranka ia ktheu përgjigjen, duke i thënë se ajo e kishte ditur se vërtet ishte iluminuar, po çështja ishte se njeriu vetë duhet ta pranojë atë iluminim.

Në kurs shumë vetë kishin përjetime të ndryshme; disa kishin katarza të mëdha dhe zbrazje të streseve e bllokadave, ku njerëzit liroheshin prej tyre. Pasi e kreu kursin, veten e ndjeja të fuqishëm dhe, disi, në mua rridhte një energji e pakufishme. Në fund të kursit, kur u përshëndetëm me Jadrankën, ajo më tha: Të lutem, Salih, tre muaj mos puno fare me meditim, se këtë që ke arritur, duhet ta përtokëzosh, ta zbresësh në materie. E dija se kisha arritur diçka të madhe, por ajo më dukej normale. Vëreja se çka mendoja, ashtu bëhej, thuaja se çdo send më materializohej aty për aty. Më dukej se bëja dritë.

Më interesant ka qenë në tren. Nga Beogradi treni nisej për Prizren në ora 18. Hymë në një kupe me Muharremin, ku nuk ishte askush tjetër. I thashë Muharremit se do të meditoj pak dhe do të bëj një provë: Dua që derën astrale të kupës ta mbyllë, që askush të mos hyjë në kupe, përveç punëtorëve të hekurudhës. Fillova, në astral, të bëja një bllokadë në derë të kupës me të njëjtin qëllim. Në këtë gjendje kisha ndejur gati gjysmë ore dhe u çova i kthjellët, si është më mirë, duke mos besuar se mund të ndodhte një gjë e tillë. Pas pak harrova çka kisha bërë dhe fillova të bisedoja me Muharremin për kursin. Treni u nis dhe askush nuk hynte në kupe tek ne. Pas një ore udhëtim trokiti dera e kupës, dhe, pasi e urdhërova që të hynte, brenda hyri konduktori i trenit, i cili kontrollonte biletat, dhe më tha: Ju lutem, a bën që një punëtorë jona të hyjë brenda, se ka mbetur në këmbë? Unë, me habi, i thashë: Po, more, nuk ka problem, paska mjaft vend. Kjo plakë ishte punëtorë e stacionit të trenit në Prizren; ishte serbe dhe punonte bashkë me dhëndërrin tonë, Enverin. Unë e njihja, meqë kisha qenë disa herë te vendi i punës së Enverit. Dhe, gjithsesi, çuditësha sesi ishte e mundur që

askush mos ta çilte derën e kupesë e të hynte brenda, kur jashtë korridorit ishte përplot me njerëz, të cilët rrinin në këmbë. Unë kisha harruar që, në meditim, e kisha mbyllë derën eterike të kupesë, që të mos hynte askush tjetër, përveç punëtorëve të hekurudhës, edhe pse në kupenë tonë ishin edhe 4-5 vende të lira. Deri në Prizren askush nuk hyri. Dera astrale ishte vendosur saktë.

Të njëjtën metodë e kam përdorur, me vëllanë, Njaziun, në autobus. Shkonim prej Prizreni për Suharekë. Duhej të ndaleshim në Shirokë, në zyrë të vreshtarisë, ku Njaziu do të pyeste diçka. Mirëpo, kohëve të fundit, në Kosovë, kishte demonstrata dhe tash ishte e pamundur të udhetoje në qetësi, pa u kontrolluar nga policët serbë, të cilët, herë pas here, edhe i maltretonin udhëtarët. I thashë Njaziut, se në autobusin tonë nuk kanë për të kontrolluar, e as që do të mund të hyjë ndonjë polic brenda; ashtu unë dëshiroj dhe ashtu ka për të ndodhur. Hymë në bus, ku, së pari, e pastrova tërë busin nga gjërat negative, se ishte përplot njerëz, të cilët kishin frikë, dhe e bëra një mbrojtje astrale, që në autobus e keqja të mos mund të depërtonte. Busin e mbusha me paqe, qetësi, dashuri e siguri. E forcova mbrojtjen me qëllim që asnjë polic të mos mund të hynte brenda në autobus. Pasi e përsërita ritualin e pastrimit dhe të mbrojtjes shumëherë, i thashë Njaziut, se tash jemi të sigurt: nuk do të kemi kontroll derisa të jemi në bus. Njaziu ishte pak skeptik, se këtë ditë kontrolli nga policët ishte i vazhdueshëm. Si dualëm nga qyteti, kishte qenë një masë policësh specialë, të armatosur, me xhipa policorë e ushtarakë dhe me pancirë. E ndalën edhe busin tonë. Dy policë specialë, të armatosur deri në dhëmbë u ofruan. Por, si e kanë çelur derën e busit, njëri polic e urdhroi shoferin që menjëher të vazhdonte tutje. Asnjëri polic nuk mundi të hyjë brenda. Jashtë, u pa, se policët ranë në kundërshtim me njëri-tjetrin pse nuk e kontrolluan busin. Dukej si rastësi, por, menjëherë, te stacioni i policisë, në

Lubizhdë, njëjtë ishte grumbulluar policia me tanke e autoblanda dhe kishte përplot policë. E ndalën busin dhe i thanë të parkohej anash. Si iu ofruan derës dy policë, dhe e hapën, njëri i tha menjëherë shoferit që të ecte dhe atë menjëherë, edhe pse busi ishte përplot njerëz të pakontrolluar. Njëjtë na ndalën edhe një herë para se të hynim në Shirokë. Edhe këtu policët e çelën dhe e mbyllën derën pa e kontrolluar fare busin. Zbritëm me Njaziun në Shirokë. Moti ishte i bukur. Duke ecur nëpër asfalt, në anën e djathtë të rrugës, në të njëjtën anë vinte një vajzë e re, 7-8 vjeçare, drejt e në ne. Kur mbërriti për afërsisht 9 -10 merta afër nesh, u duk se u tremb, sikur të ndeshte në një mur të padukshëm: U pa saktë se hasi në pengesë dhe u habit çka e gjeti; menjëherë shkoi kah ana e majtë jona, edhe pse kishte mjaft rrugë në trotuarin e anës sonë të djathtë. Ajo bëri një ecje larg nesh, kah ana e majtë, dhe doli përsëri prapa nesh në trotuar. E pyeta Njaziun nëse kishte vërejtur atë fëmijë që u tremb kur erdhi afër nesh dhe nuk mundi të vazhdonte rrugën përsëri, thua hasi në ndonjë pengesë. Njaziu tha: Çudi, ashtu veprojnë vërtet! Po, mos u frikua nga ne ndoshta? Jo, i thashë, kjo ishte ajo aura mbrojtëse, që e kam krijuar në Prizren, para se të niseshim. Ajo mbrojtje ende ka fuqi dhe e ka diametrin pothuaj 10 metra rreth nesh; kjo mbrojtje vjen me mua deri në një kohë.

PËRJETIMI I RITUALIT TË ECJES ZBATHUR NËPËR ZJARR DHE NËPËR XHAMA

*“Që ta zhvillosh dashurinë për Zotin në zemrën tënde,
shfaq dashurinë, ndjeshmërinë dhe shërbimin për gjininë
njerëzore”*

(Satyananda Paramhasma)

Kur për herë të parë kam lexuar për ritualin e ecjes nëpër zjarr, kam qenë i fascinuar shumë me këtë metodë të zhvillimit shpirtëror. Më dukej, në fillim, e pabesueshme dhe thosha: Si është e mundur që njeriu, në ato temperatura aq të larta, 800 -1000 gradë, të ecën zbathur nëpër prush dhe të mos digjet?! Njerëzit, që e kishin kaluar këtë kurs, e kishin shkruar këtë artikull në revistën jugosllave ”Tajna”, gjë që më befasonte mjaft. Këtë revistë e lexoja kohë pas kohe, dhe prisja që kudo dhe kurdo të mbahej ndonjë ritual i ecjes nëpër zjarr, të merrja pjesë dhe ta provoja realitetin e plotë. Thuhej se me kalimin nëpër zjarr, personi fitonte një fuqi të madhe dhe një besim të madh në vete; fitonte fuqi si t’i merrte 100 terapi bioenergjitike. Kështu, pasi e binda veten plotësisht, (edhe pse, kohë pas kohe, shfaqej një frikë e rrezikut nga zjarri), vendosa, siç thashë, që të shkoja kudo që të mbahej një ritual i tillë. Këtë bindje ia mbolla edhe vëllait tim, Muharremit, shokut, Adem Kolgecit, dhe kunatit, Sabir Durakut.

Një ditë, në gazetë, hasa informatën, se në qytetin e Serbisë-Kralevē, po mbahej një kurs i Jogës dhe rituali i ecjes nëpër zjarr. Gjithë të lartpërmendurit u pajtuan dhe vendosëm të shkonim e të merrnim pjesë në ritualin e ecjes nëpër zjarr, edhe pse njerëzit e rrethit ku jetonim bënë shaka me ne, duke

e konsideruar si të pamundur këtë gjë dhe duke shtruar pyetjen sesi është e mundur që njeriu të ecën zbathur nëpër prush e të mos digjet këmbëve! Ne kishim problem udhëtimin, se gjendja ishte e acaruar me Serbinë.

Ishte interesant kur u bashkuam në tren të katër shokët: Unë, Muharremi, Ademi dhe Sabiri. Kohë pas kohe na paraqitej një frikë dhe thonim: ku jemi duke shkuar ne kështu, si budallenj, të digjemi në zjarr apo të mbesim kurban, në Kralevë, nga vendasit. Dhe, kështu, binim në heshtje, kur, pa prituri, ia fillonim me zë të lartë për të folur e për të qeshur. Unë, kisha një frikë të papërshkrueshme në një rrënjë anë, kurse në anën tjetër një gëzim të madh, se do të merrja pjesë në këtë ritual.

Në fillim, kur kam filluar të merresha me zhvillim shpirtëror, kisha problem me familjen dhe rrethin. Kur u tregoja përjetimet e mia familjes dhe rrethit, bija në kundërshtim të madh me ta: nuk më besonin, më kundërshtonin, besa, ndonjëherë, më trajtonin edhe si jonormal. E dija se ky ishte gabimi im që zbulohesha aq shumë para tyre. Mirëpo, këto gjëra, natyrisht, ndodhin në fillim të çdo zhvillimit shpirtëror, dhe, si amator, ke shumë dëshirë të flasësh për përjetimet tuaja shpirtërore, si dhe ke dëshirë që të gjeshë përkrahje në këtë drejtim. Këtë ditë, sakaq, isha shumë i kënaqur që vinin edhe të tjerët në kurs, meqë e dija se kur të përjetonin edhe shokët diçka të tillë, çfarë kisha përjetuar unë, më nuk do të ma shihnin për të madhe dhe nuk do të më përqeshnin. Kur mbërrimë në Kralevë, gjendja ishte ndryshe: Ishte pastër, qyteti i bukur dhe modern, askujt nuk i interesonte për ne. Nuk ishte sikur kishim menduar më parë, nuk kishte kurrfarë rreziku. E gjetëm shtëpinë ku do të mbahej kursi me anë të adresës që kishim. Aty kishin ardhur shumë vetë nga e tërë Jugosllavia, femra dhe meshkuj, të moshave dhe profesioneve të ndryshme. Ishin mikpritës dhe të shoqërueshëm. Aty takuam

edhe një shqiptar nga Prishtina, i cili më parë, dy herë, kish qenë në të njëjtin ritual të ecjes nëpër zjarr. Shpesh e pyetnim me kureshtje: A është e vërtetë se nuk do të digjemi, edhe pse ecim zbathur nëpër zjarr?... Me të vërtetë frikësoheshim nga zjarri të gjithë. Shoku nga Prishtina thoshte se me të vërtetë nuk ka problem, shumë lehtë dhe pa vështirësi keni për të kaluar nëpër zjarr. I jepja vullnet vetes, duke thënë se “kur ky shoku dhe të tjerët kanë kaluar, edhe unë kaloj dhe më vinte një gëzim e një forcë e re.

Kursi zgjatte një ditë e një natë. Ditën ushtruam jogë, kurse në mbrëmje, gjashtë orët e fundit, ushtruam ritualin e ecjes nëpër zjarr. Ushtrimet e jogës më kanë pëlqyer, se ishin të llojllojshme. Kishte meditim, frymim etj. Me ushtrimet e frymimit, mbusheshim shumë me energji. Ishte interesant një ushtrim, në të cilin ne duhej t’i mbyllnim sytë me shami dhe t’i shtrinin duart përpara, sikur donim të preknim diçka me gishtat e duarve. Dëgjohej vetëm një muzikë meditative, e po ashtu ishte i ndezur vetëm një qiri. Qëllimi ishte të dallonim energjinë e femrës dhe të mashkullit. Në lëvizje e sipër dalloheshin energjitë e gjinive. Një rast isha i sigurt se afër meje ishte një femër, dhe ia preka duart e ia mbajta për të vërtetuar konstatimin tim, që e bëra me ndjenja. Edhe pse nuk lejohej që të hiqnim shaminë, unë ia mbajta njërën dorë dhe, me tjetrën, e largova shaminë për të parë a ishte e vërtetë dhe a po më tregonin ndjenjat saktë. Ishte e vërtetë se para meje ndodhej një femër.

Bëmë shumë ushtrime të ndryshme. Ishte një ushtrim, i cili më la përshtypje të madhe: Duhej të flisnim gjuhën të cilën nuk e dinim. Ishim ulur në rreth, po edhe mjeshtri ishte me ne. Mjeshtri urdhëroi që ne ta lëshonim veten dhe të fillonim të flisnim një gjuhë, të cilën nuk e dinim! Aty, shumica kishin përvojë nga ky ushtrim, kurse ne nuk kishim. Si të flasësh një gjuhë që nuk e di, si të flasish “pa lidhje”?! Gati të gjithë filluam të flisnim pa kuptim; ma çonin mallin

sikur isha i vogël, kur flitnim mbrapsht me shokë, qoftë shqip apo ndonjëherë flisnim “pa lidhje”, ndonjë gjuhë të panjohur. Më vinte çudi, si të tjerët mund të flisnin në atë mënyrë dhe atë: pa vështirësi. Më vinte shumë vështirë t’ia filloja të flisja në gjuhën që nuk e dija. Kur filloja të flisja diçka, djersesha dhe vetëm në vete pëshpërisja. Dikur, ndija se të gjithë flitnin diçka; atëherë, fillova edhe unë të flas “pa lidhje”. Filluan të më vlonin djersët, më zihej fryma, por gjithnjë e më me zë flisja... kur, dikur, u lirova i tëri dhe fillova që ta flisja me zë një gjuhë që nuk e njihja. Pas kësaj, në çakrën e ballit, filloi një presion, disi u mbush me energji, dhe filloi të çilej syri i tretë, ku papritmas e pashë një vizion të pastër.

Isha shumë larg prej tokës tonë, disi në një planet apo yll tjetër. Dy krijesa, si njerëz, që nuk ua shihja fytyrat, njëri me trup më të madh, kurse tjetri më të vogël, më treguan me gisht tokën dhe, disi, më dhanë mision special për ta kryer. Pas kësaj, u ktheva përsëri në vetëdije të plotë trupore, edhe pse kisha vetëdije edhe kur e flisja gjuhën, të cilën nuk e njihja. Pas këtij ushtrimi, u lirova shpirtërisht dhe isha i gëzuar. Mjeshtri i Jogës na pyeti se çka kishim përjetuar. Të vetmin përjetim të rëndësishëm e kisha përjetuar unë. Mjeshtri tha se ka pasur edhe të tjerë që kanë përjetuar vizione të ngjashme.

Ushtrim tjetër i rëndësishëm ishte kur të gjitha elementet kosmike i morëm në vete, që prej lindjes së shpirtit e deri më tash, dhe, më në fund, e vibruam mantrën AUM. Ky ushtrim tregonte sesi fillimisht dalim prej Zotit të pavetëdijshëm, sesi zhvillohemi dhe, sesi, më në fund, përndritemi, duke u bërë Zot dhe, si Zot, i kthehemi Zotit Apsolut të pastër. Kishte edhe ushtrime, ku ne merrnim fuqi prej Universi dhe e binim në tabanët e këmbëve, tek të cilët formonim një si pllakë të energjisë, së cilës i jepnim fuqi që as të nxehtit dhe as të ftohtit të mos mund t’i bëjë asgjë. Ishte interesant një ushtrim, ku ne duhej të hynim brenda rrethit,

secili, me rend, dhe t'i bindnim të tjerët (anëtarët e kursit), se, me të vërtetë, kemi për t'ia arritur suksesit, dhe, me zë, përsëritnim: “Do të kem sukses”, “do të kem sukses”... Në këtë rast, kur personi duhej t'i bindte të tjerët, se do të ketë sukses, shihej qartë karakteri i secilit, si me të vërtetë ishte edhe në jetën e përditshme. U krijua një atmosferë shumë e bukur, se, mjeshtri i ritualit të zjarrit me të vërtetë na ushtronte me zemër.

E kishim edhe një detyrë që të merrnim një fletë të pastër dhe t'i shkruanim të gjitha të metat e dobësitë tona, si dhe sëmundjet, që, më vonë, t'ia jepnim zjarrit si pre. Duhej që të mos e tepronim me ato shkrime dhe që shpesh të meditonim për to. Pas pak, mjeshtri (quhej Isa), na tha që t'i merrnim teshat me vete dhe të përgatiteshim, se kishim për të udhëtuar, së paku 2 orë, natën, dhe do të ktheheshim në mëngjes; udhëtimi bëhej gjer në bjeshkë, ku duhej të kallej zjarri dhe të kryhej rituali i ecjes nëpër zjarr.

Ende ishim në ushtrime dhe një nga pyetjet ishte se për ç'arsye kishim ardhur në këtë ritual dhe si po e ndjenim veten. Secili anëtar jepte mendim për vete dhe shihej se çdonjëri kishte frikë nga zjarri. Mua më pyeti: Si po e ndjen veten, kur po të kujtohet ecja nëpër zjarr? Unë iu përgjigja: Një mendim po më frikëson shumë nga zjarri dhe po më thotë se kam për t'u djegur e përzhitur në zjarr; kurse, një mendim po më thotë të mos mërzitem fare, se asgjë e keqe nuk ka për të më ndodhur dhe zjarrin kam për ta kaluar me sukses.

U nisëm pothuaj të gjithë për në bjeshkë, por disa abstenuan nga frika e zjarrit. Sabiri, në mënyrë intensive, frikohej dhe, nganjëherë, donte të kthehej. E shikonte rrugën mbrapa, dhe ishte me dy mendje. Gjatë asaj kohe, unë i jepja kurajo dhe pak i kalonte frika. Ishte një rrugë e gjatë. Natë. Nga lart shihej qyteteti. Dukeshin tuba tuba dritash. Ishte një qetësi e ftohtë nate. Ishim në një vend të panjohur dhe... natë... bjeshkë... dhe ftohtë! Plus mendimi se duhej të ecnim

nëpër zjarr! Pas dy orësh të plota, mbërrimë në bjeshkë. Atje ishte edhe më ftohtë. Ishte një rrafshirë e ngushtë, sakaq anash kishte një përrua; nuk kishte drunj fare, se i kishin prerë të gjithë. Drunj të, që duhej të ndizeshin, ende nuk ishin grumbulluar dhe ne, të gjithë, duhej t'i sillnim nga mali në atë rrafshirë. Kështu filluam të gjithë të bartnim drunj. Ishin mbi pesë metra drunj dhe ata tërësisht të njomë. Mjeshtri dhe asistenti i tij i rregullonin dhe i renditnin simbas rregullit që ata dinin. U bë një grumbull drunjsh i gjatë mbi 5 metra dhe i lartë gati dy metra. Mjeshtri na urdhëronte të nguteshim, se ishte bërë ora 24. Dhe, më në fund e ndezëm zjarrin.



Unë duke u lutur e duke ia dhënë të këqijat
kurban zjarri

Pasi që u ndez zjarri, mjeshtri i ritualit, Isai, na renditi të gjithëve, duke na thënë: Tash, merrni secili, me rend, ato fletë që keni shkruar dhe jepjani zjarrit kurban. Mbi turrë të drunjve mjeshtri kishte vënë një pako, ku ne i qitnim letrat e shkruara, që duhej t'ia jepnim zjarrit. Secili afrohej para turrës së drunjve, që digjej, ku i lutej zjarrit dhe ia jepte ato

shënime. Pasi u kallën ato shënime të metash, disi e ndjeva një lehtësi në shpirt. Pas këtij rituali, të gjihtë u shpërndamë anash zjarrit, ku duhej intensivisht të meditonim për të, që sa më shumë kontakt të vinim me zjarrin. Unë kisha një batanie, në të cilën u shtrimë unë dhe shoku Adem. Ishim mjaft larg



Dhënia e të këqijave tona zjarrit Bjeshkët e Krallëvës,
1988

zjarrit. Bënte mjaft ftohtë; njëra anë e trupit nirthte, kurse ana tjetër kallej nga zjarri, i cili vazhdonte të ndizej. Zgjati mbi dy orë derisa u kall turra e drunjve. Lloj-lloj mendimesh frikësuese vinin kur e shikonim zjarrin; dukej si një përbindësh i madh që çdo gjë do të përbinte para vetes. Bisedoja ndërkohë me shokun Adem: Shiko! - i thashë Ademit, duke marrë një degë druri, me rrema, dhe e hodha në zjarr, e cila u bë shkrumb për disa sekonda. Çfarë fuqie, Adem! Si do të ecim nëpër këtë zjarr?!...

Dikur, flaka pothuaj veç ishte shuar; kishin mbetur vetëm gacat. Asistenti u ngrit në këmbë dhe filloi që ta shtrijë prushin e ta ndreqë si tepih. Dukej si një tepih i shtruar me

gaca të skuqura. Mjeshtri na kishte thënë se temperatura, të cilën e kishin matur të tjerët, më parë, mund të ishte 800 - 1000 gradë celcius. Tërë ajo bjeshkë bënte dritë prej gacave të spërkuqura; shkëlqimit të zjarrit i ndihmonte era e veriut, e cila frynte pandërprerë. Papritur mjeshtri dha urdhër që të gjithë të zbatheshim plotësisht, deri në gjunjë. Kur e dëgjova këtë zë, më hyri një frikë edhe më e madhe në palcë dhe i thashë shokut Adem se nuk doja të zbathesha, se ndoshta do të kallesha në zjarr. Dridhesha si “thupra në ujë”. Një mendim më thoshte se nuk do të ketë problem, por kur filloja të zbathesha, tjetri mendim më pengonte dhe më frikësonte. Të gjithë ngadalësoheshin dhe ndjehej një atmosferë pasigurie. Mjeshtri bërtiti: Ngutuni, se nuk bën të na zërë mëngjesi, nuk kemi kohë më, nxitohuni. Duke u zbathur, përsëri mendimet se kam për t’u djegur më sulmonin... Por, si i lëshova këmbët e zbathura mbi tokë të ftohtë, e pata një ndjenjë se mbi pambuk po shkeli e jo mbi tokë të ftohtë! Nuk ishte fare ftohtë; as që më dogjën ca gaca, kur i shkela anash, pasi mjeshtri na tha të formonim një rreth anash zjarrit dhe ta futnim zjarrin në rreth. Në atë rast sundonte një heshtje varri, nuk ndihej asnjë zë prej askujt. U kapëm dorë për dorë të gjithë sa ishim aty, mbi 22 veta. Mjeshtri hyri brenda rrethit, sepse ishte rregull që mjeshtri apo mësuesi të kalonte i pari zjarrin. E mori një pozitë të lutjes dhe tha: Ju lutem, thuani të gjithë fuqishëm mantrën AUM. Për çudi, asnjë person, asnjë zë nuk mundi ta lëshonte nga goja. Unë e kisha një ndjenjë se m’u kishte mbyllur fyti dhe dridhesha ngapak. Edhe një herë mjeshtri dha urdhër që ta thonim këtë mantër. Tash vetëm njëri e lëshoi një zë të vogël si të një maceje. Dha urdhër edhe për herën e tretë, por prapë u dëgjuan vetëm dy-tre zëra të ulët. Mjeshtri nuk priti më, vetë kaloi nëpër prush dhe doli në anën tjetër të zjarrit, i hapi krahët drejt kah ne dhe tha: “Ejani, tash ju pres juve që të kaloni!” E urdhëroi njërin përballë tij: Dil ti! Njëri doli prej rrethit dhe hyri brenda

rrethit para “tepihut” prej gacash, u kryqua disa herë dhe eci nëpër prush deri te mjeshtri pa problem. Nuk mund ta merrni me mend se çfarë fuqie na erdhi të gjithëve kur kaloi mjeshtri i pari dhe doli njëri prej nesh. Filluam të thonim mantrën AUM me një zë thuaja tërbues. Frika ishte zhdukur mbi 50 %; morëm fuqi dhe guxim të madh. Në këtë mënyrë filloi ecja nëpër zjarr, ku gëzimi ishte i përzier me një frikë; çuditërisht dominonin dy ndjenja të kundërta. Nga shokët i pari kaloi Muharremi. Në ato çaste, nga gëzimi i suksesit të tij, më shpëtuan lotët. Pas Muharremit kaloi Ademi dhe tash qaja nga gëzimi, se bile një shok e kisha që do të më besonte në rrugën spirituale, të cilën e kisha filluar. Pastaj më erdhi rendi mua. Dola prej rrethit, u ndala para “tepihut” të prushtë, i cili ishte mbi pesë metra i gjatë dhe fillova t’i flas vetes sime: *“Qëndro i qetë dhe kur të vjen momenti nisu. Zjarr, tash ty po të dorëzohem dhe krejt të këqijat po t’i jap kurban”*. Ishte ligj që kur të filloje ecjen nëpër zjarr, duhej ngritur dy duart lart, kah qielli, të shikoje lart dhe ta thojë mantrën AUM. Pas pak, tek unë, vetvetiu u ngritën dy duart lart dhe fillova për të ecur nëpër prushin e skuqur, duke e thënë mantren. E kisha një ndjenjë se nën këmbët e mia ishte një mbrojtje e madhe, ku fare nuk e ndjeja nxehtësinë e zjarrit. Vetëm në dy vende, kur i shkela disa maje të gacave, pak e ndjeva nxehtësinë. Në gjysmë të stazës, u aktivizua një energji e papërshekrueshme dhe eca drejt e te mjeshtri, të cilin duhej ta përqafonin, si shenjë nderimi për mësimin që na e kishte dhënë dhe suksesin që e arrinim. Pas këtij sukse si shumë të madh, e kisha një ndjenjë se do të mund edhe të fluturoja, po të doja... Kjo ishte nga energjia e madhe, që u lirua tek unë dhe nga pastrimi i frikësimeve të ndryshme. Ishte një gëzim për tërë grupin. Vetëm Sabiri ende nuk kishte dalur të ecte nëpër zjarr; ai kishte frikë dhe e shtynte rendin. Unë vura kontakt me të, e shikoja intensivisht dhe, në mënyrë telepatike, me zë të brendshëm, i thoja: “Dil, se ti mundesh,

dil se ti mundesh”! Kështu, këtë sugjestion telepatik, e bëra disa minuta rresht, ku, pas pak, Sabiri doli dhe eci nëpër zjarr. Për këtë rast u gëzova shumë dhe, nga gëzimi, përsëri më shpëtuan lotët, se kështu u bë edhe një person, i cili tash do të më besonte në rrugën time të zhvillimit shpirtëror, sepse shumë probleme kisha me rrethin e miqve e të shokëve, kur bisedoja për këto gjëra. Prej tërë grupit, vetëm njëri, nga Zagrebi, nuk pati guxim të ecte nëpër zjarr. Pasi e përfunduam ritualin e ecjes nëpër zjarr, bisedonim të gëzuar. Sabiri, i cili po ashtu kishte kaluar stazën e zjarrit, ishte shumë i gëzuar, por, kur e pyeta se pse nuk dilte në fillim, ai tha: “Frikësohesha, por, një zë e ndija, kur më thoshte: Dil, se ti mundesh! Dil, se ti mundesh!” Unë vetëm heshtja dhe asgjë nuk thoja për këtë rast.

Kur u përfundua rituali, e shuam zjarrin dhe, me gëzim të papërshkrueshëm, duke biseduar zellshëm për gjëra shpirtërore, u lëshuam në qytet. Pas pak, doli agimi me shumë entuziazëm për jetën dhe zhvillimin e mëtutjeshëm shpirtëror.

Kur erdhëm në shtëpi, unë, më, nuk flisja; shokët flisnin për mua. Tash unë isha i lirë, shokët i bindnin të tjerët për sukset që kishim arritur. Ata i vërtetonin përvojat e mia dhe të vetat.

Kur e lëshova Kosovën dhe erdha azil në Gjermani-Mynich, menjëherë, pas një muaji, u regjistrova në shkollë për ta mësuar gjuhën gjermane. Me entuziazëm fillova të mësoja gjermanishten për të folur, shkruar e lexuar. Fillova të lexoja revista për parapsikologji. Pas shtatë muajsh, kreu shkallën e parë të reiki-t, shërim me bioenergji. Në një revistë lexova se në rrethin e Frankfurtit mbahej një kurs njëditor për autohipnozë, ku u lajmrova.

Në kurs ishim 10 veta, dhe tërë ditën ushtruam lloj-lloj teknikash meditative. Në fund të kursit, mjeshtri, pa na rekuar fare më parë, e mori një thes të madh, të cilin e kishte

përgatitur më parë, me xhama të thyer nga shishet e gjelbra të ujit të thartë, të thërrmuara copë-copë dhe shumë të mprehta. Na tregoi se si fakirët, në Indi, dhe nëpër botë, bijnë mbi xhama dhe nuk prehen fare, bijnë mbi gozhda dhe nuk shpohen... dhe tha: *"Edhe ju keni për të ecur zbathur nëpër xhama"*! Te të gjithë anëtarët lindi një frikë dhe një mosbesim në vete. Fillova edhe unë të frikësohesha, por, kur m'u kujtua se kisha ecur nëpër zjarr, e nuk isha djegur, m'u largua frika. Mjeshtri i shtriu xhamat dhe bëri një si "tepih" të vogël, nja një metër e gjysmë të gjatë. Ne u ngritëm dhe i vërtetonim xhamat, të cilët i preknim me kujdes, se vërtet ishin me maje e të mprehtë si brisk rroje.

Ecjen nëpër xhama e filloi një femër, e cila kaloi pa problem. Kështu më erdhi rendi mua, ku dola dhe fillova të ecë, nëpër xhama, asnjë xham duke mos më prerë fundin e këmbëve. U ndala me qëllim në mes të stazës dhe fillova të kërceja lart mbi xhama si të doja me qëllim të prehesha. Interesant: Asnjë xham nuk më prente, as më shponte fare, ku dola pa u lënduar asnjë grimë. Mjeshtri e mori njërin pjesëmarrës dhe e shtriu me shpinë mbi xhama, kurse një tjetër e hypi mbi të, duke e shtypur sa mundte. Fare nuk u shpua nga xhamat. Me këtë ushtrim u bindëm, secili prej nesh, se kemi aftësi të ecim nëpër xhama.

Në këto çaste m'u kujtua i nderuari sheh Nexhati, i tarikatit Halveti, nga Prizreni, cili na tregonte për një sheh nga Tirana, i cili kishte hyrë në furrë për pjekjen e bukëve, që ishte plotësisht e skuqur, dhe kishte dalur fare pa u djegur në trupin fizik. Kuptohet se për ta bërë këtë gjë, duhet një fuqi shumë më e madhe shpirtërore, sesa për të ecur mbi xhama. Po ashtu, m'u kujtua sesi në Indonezi, në ujdhesat Bali, Sufit, dervishët, për çdo javë, ecin nëpër gurë të skuqur, për t'u pastruar shpirtërisht.

Këto rituale jo vetëm që të japin fuqi dhe energji, por edhe të ndihmojnë që të ecësh me vetëbesim në rrugën drejt njohjes së të Vërtetës.

PËRJETIMI NË MIKROKOZMOS NË PLEKSUS SOLARIS – TE SEJANTOLOGU, RIKARDO REGACIO

“Kush s’e ruan shëndetin, e ruan krevatin”

(S. Basha, mistik)

Në shumë raste vetë shëruesi nuk mund ta shërojë vetveten. Një nga ta isha edhe unë, i cili kisha disa probleme me lukthin dhe veshkët. Kështu, gjatë leximit të librit të Sllavinskit “Kreaton”, në të përmendte një person, sejantolog të aftë, nga Zvicra, ashtuquajtur, Rikardo Regacio. Pasi që isha në Zvicër, vendosa ta gjeja këtë person; besoja se mund të më ndihmonte. Tek mikja ime, qartëpamëse, Shandra, e gjetëm në kompjuter adresën e Rikardos dhe numrin e telefonit. Ky person, fillim e mbarim, më pëlqeu, se ishte njeri i mirë, stabil dhe i drejtë. Rikardo e kishte një aparat, zbuluar prej Habartit, formues i dianetikës (sejantologjisë). Ky aparat quhej E-metër dhe matte ndryshimet emocionale në ndërdije. Aty ku kishte frikë ose presion, gjilpëra treguese, shumë e ndieshme, tregonte shkallën. Unë e kisha kapur E-metrin për dy dorëzat prej bakri, të cilat ishin të lidhura me dy tela të hollë për aparati.

Para se të fillonte terapinë, si zakonisht, nëpërmjet pyetjeve, bënte si një lloj psikanalize: Ku kisha probleme, ku po më dhembte etj. Gjithnjë dhe më testonte me psimetër, duke e ditur saktë problemin. Pas shumë bisedash, disi fillova të çlirohesha në çakrën emocionale (e dyta me radhë, te kërthiza). Rikardo ishte shumë i aftë dhe mbi 25 vjet kishte qenë anëtar i Shoqatës së Sejantologjisë, por, më vonë, ishte

tërhequr dhe kishte kaluar në sejantolog privat, meqë sejantologjinë në të vërtetë e kishin marrur në dorët e tyre dhe shkatërruar të këqinjët. Dinte shumë për prijësit e magjisë së zezë, duke filluar nga ata kryesorët, në Bazel, të cilët kishin dashur ta prishnin botën. Dinte për shumë planetë, ku jetonin intelegjenca të mëdha.

Mos t'ju vjen çudi, që do t'ju rrëfej një udhëtim fantastik, të cilin e kam përjetuar në këto terapi, e i cili, me të vërtetë, më ka ndihmuar dhe më ka shëruar plotësisht prej lukthit, ku tash, më, fare nuk vuaj nga dhembjet, edhe pse, me vite, nuk më kishte lënë rehat, duke më dhembur. Ky do të jetë një udhëtim me të vërtetë fantastik në mikrokozmosin tim, ku pashë qenie që mezi do t'i përshkruaj dhe të cilat më shkaktonin dëme në mënyrë telepatike, të cilat i merrnin urdhërat krejtësisht nga një vend i largët, në mua ose jashtë meje.

Pasi që u ula në një karrige, ku i mora në të dy duart shkopat e E-metrit, u qetësova dhe hyra në nivelin e ndërdijs, në valët theta, me vetëdije të plotë. Rikardo më udhëhiqte me fjalë. Sot më urdhëroi që t'i shihja bllokadat në shpinë dhe në veshkë dhe t'i përshëndetja ato. Në anën e majtë pashë si një pllakë të zezë dhe djathtas një pllakë me vrima të zeza. Unë duhej që së pari atë bllokadë ta përshëndetja me "hello", ku edhe bllokada duhej të ma kthente në të njëjtën mënyrë. Derisa e merrja kontaktin me bllokadën, tjetër send nuk mund të punoja. Kur ma kthente përgjigjen, duhej që unë atë ta nderoja. Tash ishte një bllokadë në shpinë, ku ndodheshin veshkët. Ajo bllokadë filloi të më jepte përgjigje. E pyeta se kah kishte ardhur dhe, menjëher, në mënyrë të pastër vizuele, e pashë një tunel të zi, i cili më çoi përpjetë te një shtresë tjetër. Në atë shtresë pashë dy sy të mirë dhe gjigantë, të cilët urdhëronin disa si qenie për t'i prishur veshkët. Në një pllakë të zezë, djathtas, ishin shumë qeliza të gjalla, të cilat bënë dëm; nuk flisnin, vetëm i

hanin qelizat tjera të shëndosha të veshkëve. Doja kontakt me to, por nuk flisnin fare, veç punonin; shkatërronin. Dikur, njëra foli. Ishte e rrumbullakët, si një top i vogël, me sy të mëdhenj dhe gojë të madhe e dhëmbë të mëdhenj. Ishte më e butë se të tjerat dhe filloi të më tregojë për bllokadat. Por njëra qelizë, gjigante, u ngrit dhe i bërtiti me fuqi, sa të gjitha qelizat tjera, që punonin, e ulën kokën, dhe filluan të futeshin më thellë nëpër disa vrima që i kishin pranë, por unë, megjithatë, i shihja ato. Rikardo gjithnjë më udhëhiqte dhe më mësonte çka të pyes. Pyeta se kush prej jush është udhëheqëse kryesore. Gati të gjitha u përgjigjën dhe thanë se të gjitha ishin kryesore. Vetëm njëra, më e butë, më tregoi se urdhërin e merrnin prej së larti. Mbi mua ishte një tunel, i cili i tërhiqte lart të këqijat dhe i sillte poshtë prej atij vendi. Atyre të këqijave u thashë që të shkonin lirisht e të mos kthehen më. Ai tunel, që më parë i kishte sjellë të këqijat, tash i merrte ato. Dikur atë tunel e mbylla përgjithmonë që të këqijat të mos mund të vinin më në atë vend. Prej lart, erdha poshtë, te veshkët, ku pashë disa qenie që i hanin ato. Njëren e pyeta se a po i hanin veshkët, e cili m'i tregoi dhëmbët dhe m'u përgjigj: A nuk po sheh si m'u ka thyer dhëmbi duke ngrënë veshkët! Këto qeliza gati ishin zbehur; veshkët kishin filluar të shndrisnin; ajo pllaka e zezë, në dy anët e trupit, gati ishte hjekur, e njëra pllakë (bllokadë) ishte bërë dritë. Nën pllakë ishin dy sfera të bardha dhe të shndritshme. Pas pak Rikardo më urdhëroi që t'i lija ato ku ishin e të kthehesha.

Dëshiroja të mësoja se nga kishte ardhur kjo sëmundje. Dikur Rikardo më urdhëroi që të hulumtoja fëmijërinë time, të kthehesha në fëmijëri. Menjëherë më doli një plakë, e quajtur Hana e H... , kushërirë dhe fqinje e parë, e cila më kishte marrë një teshë, fshehtas, shumë kohë më parë, dhe më kishte bërë magji të zezë. Kjo plakë më doli para me një fytyrë të zezë dhe të trishtueshme, si një demon; hundën e kishte të hollë e të gjatë si shtrigë e keqe. Nga kjo

plakë, si fëmijë, kisha shumë ëndrra të trishtueshme dhe shumë herë jam zgjuar me frikë e bërtima të mëdha. E shihja si ajo më kishte inat, se unë si fëmijë, isha i bukur, kurse fëmijët e saj ishin të këqij në dukje. E shihja se ajo kishte pasur frikë shumë të madhe prej babait, Azemit. Pashë se ajo, një maçorrit tonë, ia kishte prerë bishtin, për ta përdorur në ritualet e magjisë së zezë. Më udhëhoqi edhe më larg në jetërat e kaluara për të parë se nga kur isha në hasmëri me këtë femër. E pashë veten në mesjetë; e kisha një këmishë të metaltë, si rrjet, po ashtu dhe kapelën dhe kisha dalë në duel me shpata dhe rroksha me një person. Për çka luftoja me këtë person? Për një femër shumë të bukur, të cilën të dytë e donim. Ky person ishte i keq, me hundë të madhe, sy të vegjël, mustaqe të holla, si të minit, dhe mjekrën si cjan. Posa e njoha hasmërinë në mes meje dhe këtij personi, menjëherë e lash luftën dhe atë femër. Shpirti i atij mashkulli të hollë, me mustaqe, tash ishte reinkarnuar në këtë plakë, e cila na bënte dëm mua dhe tërë lagjes sonë me magji të zezë. Dy herë gjatë kësaj kohe rashë në një gjendje tejet të thellë, por isha me vetëdije; trupi më humbte, nuk e ndjeja më, kurse vetëdija më zgjerohej shumë dhe më dukej sikur kisha hyrë në një sferë pa kufij. Kisha rënë në një trans autohipnotik, shumë të thellë, ku, pas pak, një zë i brendshëm, më tha: Kthehu, është mjaft! Dhe u zgjova normalish.

Pastaj, Rikardo më pyeti se a po ndjeja dikund, në trup, ndonjë shtypje apo bllokadë. E ndjeja një shtypje dhe dhembje në “Pleksus Solaris”. U futa në meditim të thellë dhe u koncentrova me shikim të brendshëm kah “Pleksus Solaris”-i, ku pashë një bllokadë në territor të lukthit. Dukej e rrumbullakët, si një pjatë e zezë, së cilës veç një pjesë iu kishte hequr, në një qoshe, si gjysmërreth. Duhej që, këtë bllokadë, e cila i përngjante një pjatë fluturuese, ta përsëndesja me “hello”. Kështu vazhdova duke i thënë “hello” derisa vura kontakt me të. Pasi që vura kontakt,

Rikardo më tha: Shiko në atë pjtë, a mos ka ndonjë qenie, duke punuar. Kjo u bë si një pjtë fluturuese, ku në mes ishin disa krijesa shumë të vogla, me duar e këmbë, por jo si njerëz, disi ishin të zez, me veshë të gjatë e me maje, në kokë kishin siflokë me tri maje, mjekrën po ashtu me maje, po dhe sytë anash me maje, si kinezët, sy të vegjël e të kuq. Këto krijesa punonin në atë dhomë tepër moderne, disi si me kompjuterë dhe ekrane. Intensivisht bënë diçka. Ka qenë çudi e madhe, se në atë moment, kur e përmenda këtë bllokadë, më kapi një frikë shumë e madhe, në "Pleksus Solaris" filloi dhimbje e madhe, sakaq frika ma përfshiu tërë trupin, sa dridhesha prej një ndjenje tepër të keqe.

Më urdhëroi Rikardo që të pyes se cili ishte shefi kryesor i tyre. Prej këtyre krijesave të zeza, me sy të kuq e këmbë të holla, dhe duar të holla, nuk done askush të përgjigjej. Duke e shikuar atë dhomë supermoderne, ku kryheshin shumë punë, dikur pashë një ekran, i cili ishte më i madh se gjithë ekranet tjera. Pas pak, pyeta se çka janë duke bërë. Njëri m'u përgjigj: Jemi duke bërë punën tonë, e cila na urdhërohet. Kush ju urdhëron? - i pyeta. Nuk u përgjigjën, por në atë ekran të madh, pashë një palë buzë të mëdha e të gjelbra, që jepnin instruksione. Duke shikuar në atë ekran, kalova brenda ekranit, si në kozmos. Atje larg pashë një planet, i cili kishte një lidhje me këtë ekran, si një dritë e hollë e kuqe laserike. Iu ofrova këtij planeti shumë të largët, i cili në fund të boshtit, ku sillej, në polin jugor, kishte një dritë të kuqe, si një lloj hologrami, i cili merrte instruksionet prej poshtit të planetit. Poshtë dukej si një bazë e madhe, në formë të rrumbullakët, si prej metali të përhimë. Në mes të asaj baze, në thellësi, qëndronin disa krijesa në rreth, të cilat kishin duar e trup, por kokën pa flokë, pa sy, pa vesh, si dhe pa gojë; koka e tyre ishte si një sferë, vetëm me disa vija përmes. Në mes të rrethit qëndronte një sferë e kuqe në të çeltë, e cila rrinte në ajër, po lidhjen e kishte me planetin

poshtë. Këto krijesa i merrnin instruksionet në mënyrë telepatike prej asaj sferës që rrinte pezull para tyre. Dhe, kur i merrnin urdhërat, i dërgonin tek ajo sfera që rrinte pezull mbi planet, e prej kësaj dërgoheshin tek këto qeniet në territor të lukthit tim, në mikrokozmos. Ajo sfera në mes të bazës i merrte informatat prej qendrës së planetit. I përcolla ato rreze deri në qendër të atij planeti. Në qendër ishte një sferë, si e kristaltë, me ngjyrë të kuqe të çelët dhe e gjallë. U futa brenda saj. Aty ishte shefi kryesor, i cili jepte urdhëra e instruksione drejt e në mua. Ky fare nuk donte të fliste; dukej sikur shumë ishte i zënë, se kishte edhe shumë tunele, me të cilat kishte lidhje të njëjta si me mua. Pra, i shfrytëzonte edhe ato, si deri më tash mua. E pashë se kjo krijesë, shumë e keqe në dukje, më kishte shfrytëzuar shumë gjatë. Para tij ishte një sferë e kristaltë, e kuqe, ku unë shihja çka dëshiroja në të. E pashë veten si shpirt të lirë, duke udhëtuar nëpër kozmos. Pashë kur kjo qenie e keqe, e hodhi një plazmë drite të zezë, si ngjites, e cila më kapi dhe më robëroi; më imponoi mendime të këqija dhe, tani, më shfrytëzonte për çka donte. Në atë sferë pashë kur më çoi ta shkatërroja një planet, i cili prej meje eksplodoi dhe u shkatërrua përgjithmonë. Pashë në atë sferë, kur doli një numër shumë i madh: 120.000.000.000... vjet më kishte shfrytëzuar pa mëshirë, deri më tash, dhe atë, në mënyrë mentale, për mua të pavetëdijshme. E dinte shumë mirë se më kishte humbur dhe bëhej kinse nuk po më shihte; punonte në lidhje me shpirtërat tjerë që i shfrytëzonte. E ndjeva zërin e Rikardos, kur tha: Kthehu më. Unë i thashë: Jo, jo ende nuk e kam kryer me këtë idiot; ky më ka marrë fuqinë, të cilën duhet prapë ta kthej. Fuqinë time e kishte futur në një piramidë të gjat kah maja e saj të kristaltë, të dritës, e cila ishte në formë të konit po me tri qoshe. Fuqia ime bënte dritë; ajo kishte formën e një çelësi. Unë shkova dhe, nëpër atë piramidë, si kon, e futa dorën, e kapa çelësin, dhe e futa në ballin tim, ku

automatikusht u bëra, i tëri, dritë e fuqishme. Si njoha të vërtetën dhe mora përsëri fuqinë time, unë, ashtu si dritë, tërhiqesha nëpër atë lidhje të dritës së kuqe apo tunel, kah kisha ardhur më parë; tërhiqesha mbrapa dhe, kah shkoja, shkonte lidhja me atë krijesë dhe me atë planet të mbyllur në "Pleksus Solaris". U ktheva në trupin fizik dhe ajo frikë e madhe u hoq menjëherë; dhimbja m'u largua si me dorë dhe u qetësua plotësisht. Pastaj, më kapi një gëzim i madh, ndjehesha sikur pas një lufte të gjatë të vjen liria përgjithmonë; ashtu i kisha disa ndjenja në ato momente.

RRITJA DHE ZVOGËLIMI I ASTRALIT

*“Dija është pasuri e cila të zotin e vet e përcjellë gjithkrah”
(Quang Ce)*

*“Nuk dua që të jem gjuetar i forcave okulte, por gjuetar i të
metave të mia”
(Salih Basha, mistik)*

ZVOGËLIM DHE ZMADHIM DERI NË PAKUFI

U zhyta në meditim të thellë dhe e ndryshova gjendjen psikike në të ashtuquajturën autotrans. E nxora trupin astral-eterik prej trupit fizik dhe shkova në bjeshkën tonë të fshatit Vraniq, që quhet Bjeshka e Zezë. Kjo bjeshkë më tërheq shumë: Është e lartë, uji është i ftohtë, ajri i pastër dhe pamja prej saj jashtëzakonisht e bukur. Kur njeriu hyp në majë dhe të shpalosen vetëm livadhe të bukura, njeriu fascinohet nga bukuritë që i shikon rreth vetes së vet. Nga maja e ashtuquajtur ”Maja e Ftohtë”, nga të dy anët, shihej Kosova. Në njërën anë shihet Rrafshi i Dukagjinit, kurse në anën tjetër Rrafshi i Kosovës deri në Shkup, me Bjeshkët e Lybetenit. Astralin e projektova mbi majë, ku është një rrafsh i vogël. Prej atij vendi, me sytë astral, e shihja plotësisht rrethinën, ashtu si ishte edhe në botën fizike; edhe pse, shpesh, është vështirë të dallosh botën eterike prej asaj fizike, thuaja të gjitha karakteristikat janë të ngjashme; vetëm se ka banorë apo qenie të cilat kurrë nuk shihen në botën fizike, kurse në botën eterike i sheh shpesh. Kisha mësuar prej shumë mësuesve shpirtërorë dhe mistikëve të ndryshëm,

se ne jemi mikrokozmos: d.m.th. çkado që ekziston në tërë universin, ekziston edhe në ne, duke përfshirë natyrën, shtazët, qeniet e ndryshme, deri te Zoti i Lartëmadhërishëm, faktikisht ne jem brenda Zotit. Mirë e dija, po ashtu, se trupi eterik ka mundësi për t'u zvogëluar, si dhe për t'u rritur deri në infinit. Atëherë i thashë vetes: Pse unë nuk e provoj këtë realitet që ekziston... Por, para se t'u tregoj përjetimin tim, dua një tjetër përjetim të shkurtër t'ua tregoj.

Kisha lexuar në librat e Karlos Kastanedës, sesi mësuesi i tij shpirtëror, indiani i Amerikës, Don Huani, i kishte shpjeguar, se ekzistua në një vend, një mur, në mes të dy dimensioneve apo botërave, ku uni ynë, apo ne, mundkemi për ta parë (atë mur) dhe mundkemi për të vendosur se në cilën anë do të shkojmë.

Një natë, gjatë meditimit, hyra në autotrans, ku në çast pashë veten në atë mur. Dukej sikur ana e një xhami të prerë, si në të gjelbër, dhe shkëlqente; unë isha në mes të tij si mbi një urë të qelqit. Në njërën anë, në të djathtë, ishte një botë e gjallë, e gjelbër, me natyrë të bukur e gjelbërime fantastike; kurse, në anën tjetër të murit, ishte një diell i fuqishëm, që natyrën e kishte shkrumuar: Nuk kishte pemë, as gjeth, vetëm shkretëtirë me gurë dhe toka e shkret, nën diell të fortë. Kur vendosja të dilja në anën e djathtë, kah ishte jeta, automatikisht humbte muri dhe gjendesha në mes të natyrës, ku dominonte bukuria, ajri i pastër e një frymë e lehtë, një freski e mrekullueshme. Dilja përsëri lart në mur, ku i shihja dy anët, dhe tash kaloja në anën e majtë, në shkretëtirë. Muri humbte, ishte nxehtë, të zihej fryma prej së nxehti; edhe pse dukej fantastikë e bukur, se, dielli dukej i kuq, në të artë, po, disi, nuk kishte jetë; njeriu shumë shpejt kishte dëshirë ta lëshonte atë vend, ku dielli çdo gjë kishte shkrumuar (këto ishin ndjenja fizike jo ato të pastra shpirtërore). Kështu kalova disa herë: Herë në njërën anë, herë në tjetrën; sa për t'i provuar ndjenjat dhe dimensionet.

Sot, në këtë ushtrim me astral-eterik, që e kam bërë, kam pasur mundësi që astralin (eterikun) ta ndaj në dy pjesë. Në shkencën okulte kjo quhet bilokacion. Astrali (eteriku) ka mundësi për t'u ndarë në shumë pjesë, jo vetëm në dy, ku të gjitha kopjet i kryejnë punët si është më së miri, njëjtë, si të urdhërojnë vetëdija kryesore jotja. Këso fenomenesh ndodhin shumë në botë, sidomos në botën e rretheve mistike. Edhe për këtë po u tregoj një ngjarje të vërtetë, e cila ka ndodhur në fshatin Vraniq të Suharekës, me të nderuarin, sheh Halili, i cili ka qenë sheh i tarikatit Sinani, i degës Halveti, të Prizrenit. Për sheh Halilin duhet të shkruhet një libër i tërë, se ky, me mugjizet (mrekullitë mistike), që i ka lënë te rrethi i vet dhe në kohën e vet, e ka merituar këtë.

Fshatarët e tregojnë një rast kur kishte qenë ditë Bajrami. Është ditur se imam më të mirë, në atë kohë, nuk ka pasur, ai rreth, se Sheh Halili i Vraniqit; ndaj, secili, ka pasur dëshirë që këtë ditë, në xhaminë e tyre, atë ta kenë si imam. Është zakon te ne që për Bajram të vizitohen miqtë e dashamirët, pa marrë parasysh se në cilin fshat janë ata. Kështu janë tubuar në fshat, shumë veta, dhe, në odë, kishte rënë biseda se kush kishte qenë imam në xhaminë e fshatit të tyre. Fshatarët e Vraniqit e dinin mirë se imami që u kishte prirë dhe ligjëruar kishte qenë, këtë ditë, sheh Halili. Por, ngrihet njëri, i një fshati tjetër, dhe thotë se nuk ishte e vërtetë: Imam në xhaminë tonë ka qenë vetë sheh Halili! Unë, para tij, jam falur në xhami. Një tjetër fshatar, i një fshati krejtësisht tjetër, edhe ai thotë: Mos bëni shaka, sot në xhaminë tonë, me të vërtetë, si imam, ka qenë sheh Halili. Dhe, kështu, fillon shamata në mes të këtyre njerëzve, meqë, secili, me të vërtetë, e kishte parë sheh Halilin në fshatin dhe në xhaminë e vet. Si ishte e mundur kjo gjë, ata këtë fare nuk e dinin, e as që do të kishin për ta ditur ndonjëherë, se kjo ishte fuqia e një mistiku të ngritur lart shpirtërisht. Kur e kanë takuar sheh Halilin, e kanë pyetur, se a ishte e vërtetë kjo çka

kishte ndodhur. Ai ishte përgjigjur shkurt: “Rahmeti i Zotit”. Si do t’ua shpjegonte sheh Halili fshatarëve të thjeshtë një gjë kaq të lartë?...

Në dimenzionin eterik, në majë të kodrës, provën e parë e bëra me një bimë, gjegjësisht me një lule, e cila çelë lule të verdha, e gjatë mbi një metër, fletët të gjera; në botanikë quhet *Gentiana*. Ishte shumë afër meje dhe thashë të provoja sesi do të dukej të futesha e të identifikohesha me këtë lloj luleje të bjeshkës. U zvogëlova dhe, pa problem, u futa në këtë lule të bukur. Si hyra brenda, ia pashë dritën e saj, dritë e cila dinte, kishte inteligjencë. U zvogëlova edhe më, dhe atëherë pashë disa kanale, prej të cilave vinte uji prej tokës për ushqim të saj. Kur zvogëlohesha edhe më shumë, i shihja atomet e ujit, të cilat bima i absorbonte nga toka, të cilat i dërgonte në trup, degë e fleta. Shkova deri në fletë, po aty u ndërrua ngjyra, sepse, si duket, vinte nga jashtë një lloj ngjyre, si vitaminë, prej diellit. Fleta i kishte disa vrima dhe kanale shumë të imëta, nga i merrte disa kokrra, si të dritës, nga dielli. Kjo bimë i përngjante një krijese të organizuar dhe primitive. Dikur, e rrita eterikun pikërisht sa ishte kjo bimë, dhe u shtriva aq sa ishte ajo. U bëra plotësisht lule-*Gentianë*. Në ato momente e ndjeja një presion nga jashtë, ku diçka ma gjuante trupin herë në njërën anë, e herë në anën tjetër. Ajo ishte fryma, e cila frynte në bjeshkë. Isha lule dhe mundohesha të forcohesha, se frikësohesha mos po më shkulte era. Kur, papritur, m’u kthye astrali në trupin fizik, pashë se pikërisht kishte qenë trupi im fizik duke u luhatur njëjtë sikur lulja në bjeshkë, që shkonte herë në njërën, e herë në anën tjetër. Por prapë dola prej trupit dhe shkova tek e njëjta bimë, por tash, prej anësh, e shikoja si po e luhatte era e bjeshkës me fuqi. Era dukej e gjallë, ajo kishte një qëllim të caktuar. Pas pak, e lashë këtë ushtrim dhe përjetimin me këtë lule të bukur, e cila vazhdonte të jetonte dhe t’i qëndronte erës me forcë.

Pastaj, fillova që trupin astralo-eterik ta mbushja me elemente kozmike. Atë së pari e mbusha me element të ajrit, gjë që automatikisht reflektohej në trupin fizik, të cilin e kisha lënë në dhomë, e në të cilin ndihesha i lehtë shumë. Pas kësaj fillova që të mbushesha me element të zjarrit, dritën e merrja prej diellit; mirëpo, në këtë rast, nuk munda t'i qëndroja nxehtësisë së diellit, si në eterik, ashtu edhe në trupin fizik, ndaj u detyrova që të zbrazesha nga kjo energji e fuqishme. Qëllimin e kisha krejtësisht tjetërkund, doja që të zvogëlohesha në infinit dhe të shihja se ç'do të ndodhte me mua dhe çfarë do të përfetoja nga ky udhëtim.

E projektova kopjen e dytë të trupit eterik para vetes, dhe u bëra "dy". Njëri, i cili rrinte në këmbë, dhe tjetri që sillej rreth trupit tim, i cili e kishte marrë gati tërë vetëdijen dhe ndjenjat me vete. Në trupin me vetëdije fillova që të zvogëlohesha. Sa më shumë që zvogëlohesha, aq më i madh bëhej trupi tjetër, që rrinte pa lëvizur në këmbë. U zvogëlova shumë dhe vendosa që me trupin tim tjetër të futesha në mikrokozmos, nën gjunjë. Kur fillova të merrja një pikëqëndrim te këmba e djathtë e trupit të dytë eterik, ai filloi të merrte tjetër formë; u bë një bjeshkë e lartë, me lugje e natyrë. Kur u futa në të, fillova që të fluturoja mbi atë natyrë të bukur në mua, mbi kodra, male e lugina. Poshtë, në luginë, pashë një lumë me pak ujë. Vazhdova të zvogëlohesha edhe më tutje dhe u futa në një gur, tek ai lumë. Duke u zvogëluar shumë e më shumë, hyra në një zbrazëti, ku vetëdija nuk funksiononte; por, disi, shpejt më erdhi vetëdija dhe, në këtë rast, kisha një ndjenjë papërshtueshmërisht të mirë; isha bërë Univers i pakufishëm. Kisha ndjenjën se isha i pakufishëm, dhe, më, asgjë nuk shihja, përpos pafundësisë.

E dija se tash isha i pakufishëm dhe se duhej të zvogëlohesha gjithnjë e më shumë. Duke u zvogëluar, disi, dukej një simjegull, me yje të panumërt. U zvogëlova edhe më, dhe erdha në një pikë, prej nga shumë larg shihej toka

jonë. Toka shkonte duke u zmadhur, derisa e gjeta anën e tokës ku e kisha lënë trupin fizik, si dhe trupin tjetër eterik. Trupin tim e shihja, në fillim, vetëm si një pikë, sikur të shikoje prej aeroplanit, derisa erdha e u zvogëlova pikërisht sa e kisha trupin normal dhe u ndala para trupit tim eterik të dytë.

Tri herë e kam përsëritur këtë udhëtim dhe tri herë i kam përjetuar të njëjtat ndjenja e përjetime; dallonte vetëm vendi ku hyja dhe natyrat apo vendet e reja që shihja. Po gjithnjë zvogëlohesha deri në pafundësi, ku vetëdija nuk funksiononte në një pikë, dhe bëhesha një infinit i madh, dhe e përjetoja pafundësinë. Me anë të zvogëlimit më të skajshëm, të cilin mund ta përcillja me vetëdije, mbërrija deri në një pikë, ku pas kësaj, më, mendja nuk funksiononte. Si duket këtu fillonte mbidija apo dija kozmike, për ç'gjë ende isha i papërgatitur për ta njohur këtë vlerë të latrë hyjnore. Dua të theksoj se udhëtimi në infinit ishte një rrugë e lakuar; dukej si një numër tetë i rrëzuar, thjesht: si shenja e infinitit në matematikë. Ku përputheshin dy pikat, aty nuk funksiononte logjika, as mendja; pra, ishte krejt tjetër dije. Kur dola prej kësaj gjendjeje, isha pothuaj tjetër njeri për nga dija dhe qetësia shpirtërore.

SI DERVISH DESTANI NA SHPËTOI TË GJITHËVE PREJ FATKEQËSISË

*“Aty ku është e keqja më e madhe, fillon e mira më e vogël”
(Salih Basha, mistik)*

Një shok imi, mjeku B... nga Lubinja e Epërme, një ditë, kërkoi ndihmë prej meje që t'i ndihmoja; në shtëpi kishte probleme nga magjitet e zeza. Unë ia preferova për ndihmë të nderuarin, mistikun, dervish Destanin, sepse ky ishte prof dhe qartëpamës i lartë për zbulimin e magjive të zeza. Shoku B... erdhi në Prizren dhe më mori mua, e pastaj shkua në Hoçë të Vogël që të merrnim dervish Destanin të na ndihmonte në këtë drejtim. Për fat e gjetëm te shtëpia, të cilit i erdhi mirë që shkua. Na priti këndshëm dhe na gostiti me shumë gjëra. I hypëm veturës dhe u nisëm për në Prizren. Por, për çudi, dervish Destani filloi të lutej me tespihe dhe nuk fliste me ne; ai vetëm bënte lutje në vete. Ne kishim dëshirë ta pyetnim për shumë gjëra, por ai thoshte: Vazhdojeni rrugën, ju lutem; ju folni në mes veti dhe mos më pengoni... Isha me të vërtetë kureshtar të dija se çka bënte gjatë tërë kohës me tespihe. Tash mbërrimë gati në Lubinjë të Epërme; hymë në fund të fshatit, afër shkollës dhe afër varrezave, ku ishte një kthesë e madhe. Duke hyrë në kthesë, një kerr i kuq erdhi pa pritur e pa kujtuar, drejtpërdrejt e në ne. Ishte kthesë e madhe dhe nuk shihej se çka po vinte. Kerri vinte ballë për ballë me një shpejtësi të palejueshme në atë vend. Ndeshja ishte e pashmangshme. U pa se më nuk ka shpëtim. Në pyetje ishin sekondat. Kur u dëgjua një zë i fuqishëm i dervish Destanit, i cili tha: “Ndihmo, o Allah!” Kur, papritur, si prej një dore të padukshme, kerri përballë u lakua, sikur të kishte ndeshur në një mur të padukshëm dhe u

gjuajt anash, duke i prekur vetem pak telat e varrezave; i preku dhe shkoi anash nesh pabesushmërisht. Shpëtoi dhe vetë pa lëndime. Dervish Destani luajti vendit e tha: “Faleminderit, o Allah, që na shpëtove! Faleminderit, o baballarë, që na shpëtuat!” Atëherë e kuptuam të gjithë se dervish Destani qysh në fillim e kishte parë rrezikun e madh që do të na vinte dhe për këtë arsye, tërë kohën, lutej pandërpre që të shpëtonim të gjithë nga ajo ndeshje e mundshme. U gëzua shumë dervish Destani dhe tha: “Tash mund të folni...” dhe mori një cigare e e ndezi. Këtë ditë, te shoku B... gjeti shumë magji të zeza dhe i bëri mbrojtje asaj shtëpie; i tregoi se kush po e sulmonte me magji të zezë dhe sesi do të duhej mbrojtur; i dha edhe këshilla të mira shokut B. Në këto momente mu kujtua se kur kishte ardhur Bab Destan te ne në fshatin Vraniq dhe se asnjë orë tri ditë nuk kishte fjetur. Tër naten rrinte kamkryq me tespi në dorë me hynte në Ziqër në heshtje. Sa her që më dilte gjumi natën dhe ate shpesh e ndëgjojsa në heshtje si dervishi bënte ziqë. Ditën dukej sikur se tërë natën kishte fjetur dhe dukej shumë i kthjelt në mendje.

POSTHIPNOZAT E NDRYSHME

“Ai i cili jeton për vete, është i vdekur; ai i cili vdes për

Zotin, është me të vërtetë i gjallë

(Resulullah-(Avatar)- Meher Baba)

Shpeshherë tek mediumet e ndryshme i kam provuar posthipnozat e ndryshme, të cilat, me tëvërtetë, më kanë fascinuar pa masë.

Ç’ është posthipnoza?

Posthipnoza është një urdhër që i jepet personit, i cili është në hipnozë të thellë apo të mesme. Posthipnoza më e sigurt dhe më e fuqishme bëhet kur mediumi është në hipnozë të thellë, sepse sugjestionit posthipnotik është 100 % efektiv. Sugjestionit posthipnotik gjithmonë duhet të jetë pozitiv dhe të jepet me kohë të kufizuar, në mënyrë që të mos ndikojë te mediumi në mënyrë negative dhe tërë jetën; se mund t’i kushtojë shtrenjtë atij personi. Hipnotizuesi duhet që të jetë i ndershëm, përndryshe mos lejoni të hyni në dorë të çdo hipnotizuesi, se mund të manipulojë me jetën tuaj. Këto që po ju them janë të vërtetuara te çdokush që merret me hipnozë, dhe shumë shkencëtarë, psikologë e hipnotizues e kanë vërtetuar këtë. Çdo send varet prej vetë hipnotizuesit dhe moralit të tij. Ka shumë shembuj negativë, të cilët kanë ndodhur tek hipnotizuesit amatorë apo të pandershëm, që i kanë shkaktuar dëme - jo vetëm një individ, por edhe tërë një mase, e mund të them lirisht edhe tërë një popull. Një nga shembujt konkret ka qenë Hitleri, i cili sa herë ka dalur në binë, ka pasur shumë medime në gjendje transi të zgjutë, ku tërë masën popullore gjermane aty ku ka mbajtur fjalim e ka hipnotizuar dhe e ka futur në luftë botërore. Çdo herë në fjalimet e tij, në radio e shtyp, ka pasur sugjestion

posthipnotike të luftës, kinse po luftonte për të mirën e popullit.

Posthipnoza mund të jetë pozitive dhe negative. Posthipnoza pozitive është kur i jepet sugjestionin pozitiv personit të sëmurë, që ai, për çdo ditë, të bëjë mirë e më mirë, derisa të shërohet plotësisht. Apo, nëse i jepet një nxënësi të dobët që, sa herë ta merrë librin në dorë, të ndjejë gëzim të madh, që po mëson, dhe çdo gjë që do të mësojë do ta mbajë në mend, me lehtësi. Thjesht, çdo fjalë pozitive, që i jepet personit, është posthipnozë pozitive.

Sakaq, si posthipnozë negative do të ishte çdo urdhër, realizimi i të cilit do të bëhej përkundër vullnetit të njeriut. Unë ju kisha lutur, me shpirt, që kurrë të mos e keqpërdorni hipnozën, sepse, së pari, e prishni karmën tuaj dhe shpirtin tuaj dhe, pastaj, e dëmtoni ndokë, i cili do të vuante tërë jetën ose, së paku, derisa të gjente ndonjë hipnotizues të mirë që t'ia fshinte atë urdhër negativ posthipnotik. Mundi të bëni ndonjë eksperiment, por në marrëveshje me mediumin, ku, pastaj, pasi që ta provoni efektin negativ, do t'ia fshini sugjestionin posthipnotik negativ dhe do t'ia jepni një pozitiv. Mediumit duhet gjithnjë t'i jepen sugjestionë pozitive. Pra, posthipnozë negative është çdo sugjestion negativ që i jepet personit për ta bërë pa dashjen e atij vetë. Për posthipnozë kam shumë shembuj konkretë. Posthipnozën negative kurrë nuk kam guxuar ta përdor, vetëm në raste të lehta, me lejen e mediumit. Zakonisht, posthipnozën e përdori për shërimin e njerëzve dhe për të mirën e tyre në jetë. Ja, disa shembuj praktikë, si të posthipnozës pozitive, ashtu edhe të asaj negative që, ndoshta, mund t'ju ndihmojnë.

P.sh. nipit tim, Shpend Gashit, sa herë që kam punuar me hipnozë me të ia kam dhënë sugjestionin posthipnotik, se ky, shumë shpejt dhe me ëndje të madhe ka për ta mësuar gjuhën angleze dhe ka për t'u bërë piktor i rangut të lartë në të ardhmen. Shpendi brenda një viti e mësoi, në fillore,

gjuhën angleze, si arsimtari i vet, dhe sot e di për mrekulli. Në art, për një kohë të shkurtër, është bërë nxënësi më i aftë dhe, gjithnjë, ka zënë vendet e para në shkollë, ku janë fascinuar të gjithë me punën e tij si piktor i ri.

Ka pasur njerëz që, në mënyrë paranoike, janë frikësuar prej gjarprit; atyre u kam dhënë posthipnozë që, në të ardhmen, kur do të dalin në natyrë, fuqia e ndërdijes së tyre, para kohe, ka për t'i lajmëruar se po u del gjarpri, dhe kanë për të qenë të përgatitur dhe aspak të frikësuar. Më vonë, te këta persona, pamja e një gjarpri ka qenë krejt normale dhe pa kurrfarë paniku.

Një femre, e cila kurrë nuk kishte pirë duhan, i kam dhënë një posthipnozë negative që, kur do të zgjohej nga hipnoza, unë do t'ia përmendja fjalën “laps” dhe ajo, pa vetëdije, do të merrte një cigare mbi tavolinë, do ta ndizte dhe do ta pinte, gjithnjë pa e ditur se ka pirë cigare. Pasi që është zgjuar, ka ndejtur pak; unë ia kam përmendur fjalën “laps”; ajo, pa vetëdije, është ngritur, e ka marrë mbi tavolinë pakon e cigareve, e ka nxjerrë një, e ka ndezur dhe ka filluar ta pijë. Pasi që e ka pirë deri në gjysmë, e kam zgjuar dhe ajo, me cigaren të ndezur në dorë, ka mbetur e befusuar sesi po pinte duhan, kur ajo kurrë nuk kishte pirë cigare; dhe, kur e kam pyetur se pse po e pinte cigaren, ajo m'u ka përgjigjur: “Jo, kurrësi, unë nuk e pi duhanin; as që kam pirë tash...” Kuptohet, të gjithë kanë qeshur në prani të saj, se e kishte pirë më se gjysmën e cigares, pa e ditur se është duke pirë cigare.

Një herë Shpendit i kam dhënë një posthipnozë që, kur do të zgjohej nga hipnoza dhe kur do t'i thoja “mollë”, ai duhej të ngritej dhe ta puthte djalin tim, Arbenin; por nuk kishte për ta ditur që e ka puthur. Pasi që doli nga hipnoza, pas disa minutash, i thashë fjalën “mollë”. Shpendi u shtang dhe filloi që ta shikonte Arbenin, i cili qeshte e ikte prej tij. Ai donte që ta puthte në faqe, po Arbeni ikte. Te Shpendi u

duk një shqetësim, i cili shihej në fytyrë: Donte, patjetër, që ta kryente urdhrin dhe filloi të skuqej në fytyrë, gjersa e kapi tërbimi. E ndala Arbenin dhe i thashë ta lejonte për ta puthur. Posa e puthi, Shpendi u qetësua plotësisht.

Ka pasur raste kur njeriun e dehur me alkool e kam kthjellë me sugjestion posthipnotik, ose: personin esull e kam dehur me gotë të ujit.

Kur personit i jepet një posthipnozë, ai duhet patjetër ta kryejë atë, herdokurë, se po s'e kreu atë urdhër, për asnjë moment nuk mund të jetë i qetë. Keni kujdes kur ta provoni posthipnozën, ju lutem; kontrollojeni mediumin derisa e kryen urdhrin, se përndryshe nuk është puna mirë me të. Mos luani me të tjerët, as me veten, me posthipnozë para se të bëhei mjeshtër në këtë drejtim, se mund të shkaktoni dëme në të dy anët.

Nga posthipnoza kam shumë shembuj, sidomos në lëmin e shërimit të sëmundjeve të ndryshme dhe në sjelljen e së mirës tek njerëzit; por, besoj se vetëm këta pak shembuj mjaftojnë sa për ta kuptuar rëndësinë e tyre.

SHKAKTIMI I NJË SENZACIONI NË NJË KURS TË ZHVILLIMIT PSIKIK

*"Nuk gjendeni ju brenda kozmosit, por kozmosi gjendet
brenda jush"*

Resulullah (Avatar)- Meher Baba)

I kisha marrë disa informacione, të cilat m'i kishte dërguar Kisha e Bardhë Gnostike e Sllavinskit. Në ato informacione kishte paralajmërime se po mbaheshin shumë kurse, që po i organizonin bashkëpunëtorët e Sllavinskit. Një nga kurset, që figuronte aty, ishte ai i zhvillimit psikik. Në këtë relacion ishte bërë një reklamë e fortë, e cila të tërhiqte shumë t'i shijojë kurset e tyre. Nuk kushtonte dhe aq shumë, ndaj vendosa që të merrja pjesë në të. Në bisedë e sipër me shokun Adem Kolgeci, vendosi edhe ai që të vinte me mua në këtë kurs. U bë shumë mirë për mua, se do të kisha shoqëri gjatë tërë kohës, sakaq me shokun Adem kalonim bukur. Kursi zgjatte dy ditë dhe mbahej në Beograd. Shkuam si ishte më së miri.

Në kurs kishin ardhur mbi 20 vetë, si femra, ashtu edhe meshkuj, të moshave të ndryshme dhe prej vendeve të ndryshme. Kursi filloi, si zakonisht, me prezentim e njoftim. Si ushtrime të para, patëm disa lloj ushtrimesh të lehta, si të koncentrimit, të frymimit etj. Mirëpo, të shumtën e kohës e kalonim duke përcjellë një kasetë të incizuar me fjalë dhe muzikë të lehtë, të cilën duhej ta përcillnim me vëmendje, e ajo duhej të na çonte në alfa-gjendje. Kështu erdhëm në fund të kësaj dite, pa asnjë përjetim; as unë, dhe asnjëri prej pjesëmarrësëve, nuk përjetuam asgjë. I thashë shokut Adem se atë çka e kemi pritur, këtu nuk po e haskemi dot; veç reklama paska qenë në nivel. Unë e Ademi, atë natë, nuk

kishim se ku të shkonim, ndaj mbetëm për të fjetur në atë dhomë; ne i kishim thastë, në të cilët mund edhe të flinim. Me ne mbetën edhe 7 veta, femra dhe meshkuj. Pasi që shkoi udhëheqësja e kursit, e cila ishte një femër mbi 50 vjeçare, ne, anëtarët e kursit, filluam bisedën në mes veti për shumë gjëra të zhvillimit shpirtëror. Siç e pashë, atë natë, në atë drejtim, unë kisha më së shumti përvojë. I pyeta se a donin të përjetonin diçka që ende nuk kishin përjetuar. Ata me dëshirë thanë: po. A keni dëgjuar për një teknikë frymimi, ashtuquajtur riberthing apo ringjallje? – i pyeta, dhe, duke parë se të shumtëve u mungonin njohuritë, u shpjegova se riberthingu është një lloj frymimi i shpejtë dhe dinamik, i cili të mbushë me energji, të pastron shpirtërisht dhe me anë të tij mund të përjetosh gjëra të ndryshme shpirtërore dhe mentale. Këtë teknikë e dinin vetëm dy vetë, të tjerët jo. Të gjithë pranuan t'i udhëhiqja në këtë përjetim. Vetëm shokun Adem e ndala si asistent, që të më ndihmonte, në qoftë se, eventualisht, tek ndonjëri, do të paraqitej ndonjë vështirësi, qoftë si gërq, qarje, vjellje, traumë etj., ku do të duhej të isha pranë e ta nxirrja prej asaj gjendjeje. Të gjitha këto mund të ndodhin gjatë këtyre ushtrimeve, sepse këtu bëhen pastrime të mëdha shpirtërore. Ushtrimi në grup bëhet shumë më mirë sesa individualisht, se qëllimi është i njëjtë për të gjithë. Njëri qante, tjetri qeshte; njëri dridhej, tjetri kërkonte ndihmë, se ishte futur në një gjendje psikike e nuk dinte të dilte. Kjo ishte një femër, të cilës shpejt ia dhashë shifrën për hipnozë, që më vonë të punoja më lehtë me të dhe ta pastroja. E qetësova dhe i thashë që t'i ndërpriste ushtrimet. I dhashë sugjestionë pozitive dhe e nxora prej hipnoze, se duhej të punoja me të tjerët. Të gjithëve u jepja sugjestionë pozitive dhe i shtyja që të ushronin më tutje, se disa veç donin të flinin ose të binin në trans hipnotik. Pas 40 minutash ushtrime, i qetësova të gjithë dhe i lashë nga 10 min. që të pushonin në qetësi. Shumica, me të vërtetë, përjetuan lloj-lloj përjetimesh,

të ndryshme dhe interesante. Njëri tha: Deri më tash, në jetën time, ende vizione më interesante nuk kam përjetuar! Të shohësh, pastër, gjëra me sy mbyllur veç këtu, këtë natë, me ju, përjetova. Tjetri tha: Qe 7 vjet që shkoj në lloj-lloj kursesh dhe ende këso përjetimi nuk kam përjetuar, si sonte; tash po e ndjej veten të lirë dhe të fuqishëm; m'u kanë liruar koka dhe trupi. Kam parë e përjetuar gjëra, si kurrë deri më tash në jetën time. Shkurt, të gjithë ishin të kënaqur. I thashë shokut Adem të bënim edhe një senzacion tjetër. Kursistëve u thashë se në kurs kishim ardhur të gjithë për të përjetuar diçka, por, mjerisht, asnjëri asgjë sot nuk ka përjetuar. A doni të shihni me të vërtetë se çka është zhvillimi psikik dhe çfarë force ka ndërdijs? Natyrisht, se u pajtuan të gjithë dhe pritnin se çka do të bënim. U thashë se do ta bëja vetëm me një kusht, që udhëheqëses së kursit, Mirës, të mos i tregonin, se do të mund të ndjehej e nënçmuar. U pajtuan të gjithë. Një femër tjetër, që nuk tregova për të më lart, me qëllim që tash të ju tregoj, quhej Jelena, dhe gjatë ushtrimeve të frymimit kishte probleme dhe e kërkoi ndihmën time. Iu afrova dhe e pyeta se çka kishte. Ajo më tha se vetëm dritë po shihte dhe kishte hyrë në një tunel drite, i cili e kishte dërguar në një dritë edhe më të madhe. E dija se kjo gjendje ishte e jashtëzakonshme dhe shumë e mirë. E qetësova dhe i dhashë sugjerime pozitive, duke e kthyer përsëri në vetëdije normale. Jelena kishte rënë në një gjendje autotransi, por nuk dinte se ku ishte dhe si ta udhëhiqte vetveten.

Para të tjerëve e thirra Jelenën që ta hipnotizonim. I thashë Ademit: Merre dhe hipnotizojë, me qëllim që edhe ky të aktivizohet në ngjarje; unë që më parë i kisha dhënë shifrën, për hipnozë, Jelenës dhe mundja pa problem ta hipnotizoj, por ishte interesant për ne që edhe ky të tregonte para të tjerëve aftësitë tona. Pasi e hipnotizoi, e mora që të punoja vetë me të. Në atë kohë e mësoja shokun Adem si të hipnotizonte dhe si punohet me mediumin. E qita në

autohipnozë, por përsëri vetë e udhëhiqja, se ajo fare nuk dinte çka të punonte në atë gjendeje. Të gjitha ato ushtrime që i kishim ushtruar ditën me mësuesen e detyrova, shkurtimisht, t'i përsëriste në autohipnozë, me qëllim që ta shihnim dallimin e madh në mes të përjetimit mental dhe atij astral. Me këtë provë u befasua shumë ajo dhe të tjerët. E mësova përkohësisht që të ishte qartëpamëse. Në fillim, kur zura të punoja me të, e pyeta se mos kishte ndonjë problem. Dhe ajo tha se e kishte një problem me beben e saj, në bark, se ishte shtatzanë. E pyeta nëse i kishte bërë dëm bebes me frymëmarrje. Jo, tha, aspak; përkundrazi, te dyve na ka bërë mirë. E pyeta nëse dinte se çka e kishte fëmijën në bark - djalë apo vajzë. Jo, tha, nuk e di. E pyeta nëse donte ta dinte se çka e kishte fëmijën. Po tha, kam dëshirë. Ia dhashë aftësinë që të shihte në vete, me sytë shpirtërorë, dhe pa se e kishte vajzë. E udhëzoja që të kontaktonte me shpirtin e vajzës së vet dhe të bisedonte me të. Jelena u gëzua shumë për vajzën që do ta lindte. Ajo tha se kishte edhe një problem: Kishte frikë kur do ta lindte fëmijën. I dhashë sugjestione pozitive dhe ia largova frikën që kishte për lindjen e fëmijës. I dhashë sugjection posthipnotik që, kur të vjen koha e lindjes, ajo të jetë e qetë, e lumtur që po lind fëmijë dhe pa kurrfarë problemi ta lindë atë.

Jelena, pasi që e ka lindur fëmijën, ma ka dërguar një letër falënderimi dhe më shkruante se e ka lindur vajzën pa frikë, pa dhembje dhe pa asnjë problem; pra, ka lindur vajza ashtu siç e kam parë në hipnozë, kur ke punuar me mua në kurs, më shkruante.

Shumica prej të pranishmëve, deri vonë, lypnin kontakt me mua, shpesh duke bërë biseda telefonike dhe duke kërkuar këshilla të ndryshme.

SI E SHËROVA LULJETËN PREJ ZORRËS QORRE

“Kur mendja fluturon në hulumtimin e gjërave që gjenden në hapësirë, e gjen veç zbrazëtinë; por kur njeriu zhytet thellë në vete, e përjeton tërë plotësinë dhe ekzistimin”.

(Resulullah (Avatar)-Meher Baba)

Shkova një të hënë në fshat për të vizituar të afërmit. Në odë, mbi një shilte shpuze, ishte shtrirë motra, ishte mbuluar me batanie dhe afër vetes kishte një enë për vjellje. Në kokë mbante një peshqir të lagët; ishte e lodhur dhe e skuqur në fytyrë. E pyeta se ç’kishte, që kishte ardhur në atë gjendje, meqë para 4-5 ditësh e kisha lënë si ishte më së miri. Lulja tha se po vuante prej zorrës qore: Po i dhimbte barku, këmba e djathtë po i mpihej, po villte dhe, nganjëherë, po i dhimbte koka. Faktikisht i kishte të gjitha simptomet e zorrës qorre. Lulja tha se dje, pas dite, ia kishte filluar. I thashë të ngrihej ngadalë, të përgatitej, të merrte librezën shëndetësore me vete dhe do ta dërgoja në Prizren te mjeku. Si mbërrimë, e lajmërova si rast urgjent, duke menduar se mos i kishte plasur zorra qorre. E pranuan shumë shpejt në spital, ku ia morën gjakun dhe urinën për analiza. Pas gjysmë ore dual një mjek me rezultate në dorë dhe më thirri të m’i tregonte rezultatet. Lulja qante dhe thoshte se donte të bëhej operacion e ta hiqte zorrën qorre, se nuk shërohej ndryshe. Mjeku më tha se, sipas analizave, Lulja fare nuk ka problem me zorrën qorre. Sakaq, ajo qante edhe më tutje. E luta mjekun që edhe një herë t’ia bënte analizat, meqë i kishte të gjitha simptomet e zorrës qorre: Po i mpihej këmba e djathtë, po villte, kishte dhimbje në bark etj. Mjeku pranoi që edhe një herë t’ia bënte analizat. Kështu, pas gjysmë ore prapë doli dhe më tha: Vajza nuk

është e sëmurë prej zorrës qorre, çoje në shtëpi! Lulja edhe më tutje qante; tash vaji iu shtua edhe më shumë. Mjeku më tha: Shok, për mua një operacion i zorrës qorre zgjatë vetëm gjysmë ore... Por, nuk ka nevojë motra të hyjë në brisq. Në këtë çast m'u kujtua një ide brilante dhe i thashë mjekut: Sonte po e marrë te unë, në banesë, e po qe se i vështirësohet gjendja, nesër e sjell në operacion. Mirë, tha, mjeku; ashtu po e lëmë. Lulen e binda të shkonim tek unë, e si t'i vështirësohej gjendja, do ta dërgoja në operacion. Mjeku, i thashë, siç e dëgjove edhe vetë, po thotë, se nuk e ke të sëmurë zorrën qorre.

Lulja ishte medium i mrekullueshëm, me të cilën shpesh punoja me hipnozë. Kur erdhëm në banesë, e hipnotizova dhe i thashë: Tash ke për të shkuar drejtpërdrejt në të kaluarën dhe ke për të parë se kur ke dëgjuar, të parën herë, për zorrë qorre, që ekziston, dhe prej kujt. Lulja tha: Po, për herë të parë e kam dëgjuar fjalën “zorrë qorre” prej shoqes sime, vajzës së kumbarës. I thashë: Trego tërësisht se çka ke dëgjuar. Ajo vazhdoi: Vajza e kumbarës, një ditë, ishte e sëmurë; unë shkova për ta vizituar. Kishte kokëdhimbje, villte, i dhimbte ana e djathtë, poshtë nën bark, dhe i mpihej këmba e djathtë. Vuante nga zorra qorre. Babai i vet e ka dërguar te mjeku, i është dhënë udhëzimi për spital dhe është bërë operacion. Pas operacionit ka bërë mirë dhe është shëruar plotësisht. E pyeta lulen se përveç kësaj a kishte dëgjuar diçka tjetër për zorrën qorre. Gati dy vjet, tha, gjithnjë i ka përsëritur shoqja ime këto përjetime për zorrë qorre. Mirë, i thashë, të lutem, tash më dëgjao mirë. Kur të numroj deri më tre ti, para vetes, ke për të parë një ekran të bardhë e të zbrazët, e kur të them: tre, kanë për të filluar të dalin në ekran të gjitha fjalët apo fjalitë që për zorrën qorre i ke dëgjuar ndonjëherë; ato çka i ke dëgjuar prej shoqes tënde dhe prej të tjerëve. 1, 2 , 3... Tash po fillojnë fjalët për t'u paraqitur në ekran, të lutem lexoji me vëmendje dhe mbaji

mend të gjitha. Lula filloi të shihte në ekranin e brendshëm fjalët dhe fjalitë për zorrën qorre. Unë pritja me durim dhe me vëmendje dhe, kohë pas kohe, e testoja duke e pyetur: Tash, momentalisht, çfarë po të del në ekran për zorrën qorre? Lulja tha: "Është keq po të dhimbti zorra qorre." Vazhdo, të lutem, lexo më tutje në ekranin tënd, i thashë. "Po vjellë prej zorrës qorre", po i thotë e ëma shoqes sime. E kam pritur nja 5 minuta, derisa erdhi Lulja në fund dhe iu mbaruan fjalët. E pyeta Lulen: A ke më fjali për zorrën qorre që gjenden në ty? "Jo, u mbush ekrani plot, kanë mbaruar të gjitha." Mirë, Lule, tash, të lutem, të gjitha ato fjali për zorrën qorre, në ekran, fshiji dhe mos le asnjë në të! Filloi t'i pastrojë nga ekrani dhe i pastroi të gjitha. E pyeta edhe një herë, se a i kishte fshirë të gjitha. "Po, tha të gjitha." Mirë, i thashë; tash, atë ekran të zbrazët, mbushe me fjali pozitive për veten dhe për zorrën qorre; p.sh. shkruaj në ekran: "Dita - ditës, zorra qorre po më shërohet"; pastaj: "zorrën qorre e kam plotësisht të shëndoshë"; "Unë jam e shëndoshë dhe e lumtur" etj. Shkruaj, Lule, të lutem, e, kur ta mbushësh ekranin me fjalë pozitive, tregomë. Mirë, tha Lulja, dhe vazhdoi punën e brendshme në ndërdije, tash për ta mbushur me fjalë pozitive. Pas një kohe tha: E mbusha ekranin plot me fjali pozitive për mua dhe për zorrën qorre. E pyeta: A je, tash, shëndosh prej zorrës qorre? Po, plotësisht, baci Salih. A mos ka mbetur, rastësisht, edhe diçka që mund t'i pengojë zorrës qorre? Jo, asgjë; tash jam plotësisht e shëndoshë. Mirë, i thashë; tash, kur të numroj deri në tre, ti ke për t'u zgjuar e kthjellët, e disponuar dhe e shëndoshë, plot fuqi dhe energji; koka jote është e kthjellët dhe e lehtë, çdo gjë është në rregull me ty. 1,2,3... Tash zgjohu!

Lula u zgjua plotësisht e shëndoshë dhe e kthjellët. Këtu konstatova se ajo ishte sëmurë prej sugjestionëve të gabueshme negative të huaja dhe zorra qorre në të vërtetë më

kurrë nuk i ka penguar dhe nuk ka pasur kurrë nevojë të dërgohet te mjeku për zorrën qore.

Ka shumë njerëz që sëmuren pa pasur sëmundje; ata me fuqinë e besimit të vet, të krijuar gabimisht, si dhe nga sugjestionet negative, e sjellin veten në atë gjendje që, me të vërtetë, të sëmuren pa pasur nevojë. Sikur të mos kisha qenë unë, respektivisht të mos kisha ditur se çka duhej bërë me ndërdijen e Lules, (siç ia pastrova dhe ia programova pozitivisht), me siguri, pa nevojë, Lula do të duhej të operohej.

SI MË DËRGOI UNI I VËTRETË QË TA PËRJETOJ TRUPIN E PARË, TRUPIN E DYTË DHE PAFUNDËSINË

*“Dashuria është i vetmi ushqim për tokën e jetës”
(Satyananda Paramhasma)*

Pasi që e kisha mësuar mirë ushtrimin e frymimit, hyja vetë, pa më udhëhequr askush, në riberthing (ringjallje). Me anë të këtyre ushtrimeve kam pasur përvoja të shumta spirituale. Sot vendosa që të ushtroja derisa ritmi i frymimit të ndalej vetë. Pse të ndalej vetë ky ritëm? Është rregull që kur të fillosh ushtrimin me këtë metodë të frymimit, mos të ndalesh vetë, duke u bazuar në faktin se vetë fuqia e brendshme të udhëheqë drejt e ndalesh vetvetiu kur të pastrohesh dhe kur të vie momenti. Këso përjetimesh kam pasur disa herë, kur vetë trupi e lyp që të ndalet ushtrimi; por, përjetimi është i mrekullueshëm. Posa që trupi vetë ta ndalë procesin e frymimit të shpejtë, hapen mushkëritë aq, sa ke ndjenjën se po merr frymë me një grykë shumë të gjerë, si të them: me një grykë kace, dhe, ke ndjenjën se fryma askund nuk po ndalet. Fyti apo ndjenjat e fytit janë zgjeruar aq shumë, sa nuk mund ta përshkruash. Është një gjendje me të vërtetë e mrekullueshme dhe paqësore pa masë. Mirëpo, sot, ishte përjetimi krejtësisht tjetër dhe shumë i lartë shpirtërisht, sa që mund të them se rrallëkush e përjeton, po dhe rrallëkush di të tregojë se çka ka përjetuar.

Pasi ushtrova gjatë dhe isha në vetmi, se kështu e lyppte ky ushtrim, koha ishte zhdukur, siç zakonisht ndodh në këto raste; nuk dija sesa kohë kishte kaluar. M'u ndal ritmi i

frymimit vetvetiu dhe më mori dikush tjetër në duart e veta. E dija: Tash më mori në duart e veta Uni i Vërtetë. Në mes të ballit, te syri i tretë, më shkuan sytë e brendshëm. Si gjë të parë që pashë nëpërmjet syrit të tretë ishte një ngjyrë e kaltër, e qartë dhe e shkëlqyeshme. Drita e kaltër filloi të zmadhohej dhe të lëvizte përpara. Pas pak, m'u shfaq qartë vizioni i universit të pakufishëm. Unë me Unin e vërtetë udhëtoja përpara. Para meje, në largësi, m'u paraqit, shumë qartë, një planet, i cili ishte i rrumbullakët, në ngjyrë të arit të bardhë dhe me pika të rrumbullakëta të zeza nëpër të. I përngjante një topi të bardhë argjendi, stolisur me pika të zeza. Ky objekt, siplanet, rrotullohej si prej meje e përpara; lëvizja e tij tregonte jetën në lëvizje; disi e tregonte kohën. Një moment jam munduar që me mendjen time ta ndërroj ngjarjen, por nuk kishte mundësi fare. Mendja ime dhe vullneti im, në këtë rast, ishte me një forcë pakrahasueshmërisht më të vogël, ndaj asaj që pasha para vetes. Pretendimi i mendjes sime, në këtë rast, që të ndërroja ngjarjen ishte sikur me krahët e forcës së trupit tim të mundohesha ta luaja nga vendi një bjeshkë të madhe, gjë e cila do të ishte apsolutisht e pamundshme. E pashë që një fuqi në mua po më udhëhiqte dhe vendosa që të vazhoja e ta përcillja atë vizion të pastër e fantastik. Para planetit me pika të zeza, i cili rrotullohej në vend, qëndronte një objekt nja 10 herë, së paku, më i madh se ky planet i argjenditë me topa të zi. Ky planet ishte i tëri në dritë të bardhë në të artë, dritë hynjore thuaja e papërshtkrueshme, dhe rrinte në vend pa lëvizur, ku në fund të tij kishte lëshuar disa maje të energjisë, të cilat u përngjanin majeve të akullit, sikurse bëhen, dimrit, nën strehë të shtëpive tona; por këto ishin të arta dhe shkëlqenin prej energjisë së madhe, duke e ushqyer këtë planetin që i përngjante një topi të artë, me pika të zeza, që shkëlqente si ari i bardhë dhe që lëvizte pandërprerë. Ky lloj trupi gjigant, i cili nuk lëvizte, ishte më i gjallë se objekti, i cili lëvizte më poshtë. U futa në

këtë dritë të papërshkrueshme. Isha vetëm dritë! Isha bërë një me atë dritë. Këtu nuk punonte më logjika; ishte kënaqësi e papërshkrueshme. Udhëtoja nëpër atë dritë, derisa dola në anën tjetër, ku filloi të përfundonte dhe e cila dukej tash si mjegull e rralluar, e cila dukej se gjithnjë po shkonte lart e më lart, duke u rritur. Tash dola në një hapësirë me ngjyrë të zezë, gjegjësisht në ngjyrë indigoje, e cila nuk kishte kufij. Ishte paqe e papërshkrueshme; ishte pafundësi e papërshkrueshme; ishte vetë Pafundësia. Një zë i qartë dhe i butë, në mua, më tha: “Mjaft, më, kthehu!” dhe papritur u ktheva në trup me të njëjtën vetëdije e me ndjenja të pastra, i lumtur, se tash kisha trup fizik dhe po jetoja në të, këtu dhe tash. E kisha një ndjenjë jashtëzakonisht të madhe të paqes, rehatisë dhe të harmonisë me vetveten. Nuk dija se ku kisha qenë para disa sekondash, çka kisha parë; deri tash, ende, një gjë të tillë nuk e kisha përjetuar; ishte diçka e madhe ajo që kisha përjetuar. Mundohesha të dija të vërtetën e përjetimit tim: A ishte ky një iluminim, një përndritje... Besoj se po. Shpesh e kam diskutuar me shokë, po kurrë nuk isha i kënaqur me interpretimin. Kisha pyetur shumë mistikë, po askush nuk dinte të më jepte përgjigje. Kisha pyetur mësues të shumë kurseve, po askush nuk më kishte dhënë përgjigje. Përgjigje më të kënaqshme dhe më të saktë se prej të nderuarit dhe të lartit, Mehmet Selaj, ende prej askujt nuk kam marrë. Ai më tha: E ke përjetuar Trupin e Parë, Trupin e Dytë dhe Pafundësinë. Sipas të nderuarit, Mehmet Selaj, për të cilin jam nxënësi i parë i tij dhe jam duke ia shkruar librat e tij, unë kam përjetuar diçka shumë të lartë hyjnore, si përjetimi i Ferrit, i Parajsës dhe Pafundësisë.

UDHËTIMI NËPËR BIMË DHE DRUNJ

“Triumfoje gjumin në çdo mënyrë”

(Satyananda Paramhasma)

Është ndjenjë interesante kur njeriu hyn i zvogëluar me trup astaral në ndonjë bimë apo dru. Je tërësisht në një botë tjetër, që në jetën normale nuk ke mundësi ta përjetosh. Qysh në fillim, kur të hysh në këtë botë, fillon të shohësh një botë mikroskopike, po shumë të zmadhuar; nuk është sikur ti të shikosh prej një mikroskopi një objekt të zmadhuar, po është krejtësisht tjetër. Këtu ti zvogëlohesh në vogëlsinë e qelizave bimore apo, edhe më shumë, deri në atom. Kur të bëhesh sa një atom, më nuk sheh asgjë, përveç bërthamës së atomeve ose produktet tjera të atomit që lëvizin rreth bërthamës. Për të parë qartë, duhet të zmadhohesh, ose të zvogëlohesh në atë masë, që ti me të vërtetë të mund të shohësh atë që dëshiron në mikrokosmos të atij objekti ose bime; se përndryshe nuk mund të shohësh gjë, as të dish se ku je. P.sh. kur të futesh në ndonjë bimë, e të zvogëlohesh në atë masë, që brenda asaj bime të qëndrosh në një kanal ku bima e sjellë ujin nga toka, këtu duhet që t'i japësh vetes sugjestion, që asnjë fuqi e brendshme nuk mund të të dirigjojë ose të të bartë askund pa vullnetin tënd; po ti je ai që trupin tënd mund ta dirigjosh. Sepse ndodh që një pikë ujë, e cila vjen prej rrënjëve, të të bartë lart deri te fleta dhe ti, më, nuk mund ta studiosh atë vend ku ke qenë më parë. Kur je stabil, ti nuk lëvizë, sepse uji në atë botë është ujë eterik ose energji e ujit. Pastaj, ka mundësi që të depërtosh në dritë të bimës apo në inteligjencën e saj; në atë dritë mund të shohësh historinë e asaj bime, si në të kaluarën, ashtu edhe në të

ardhmen. Nëse ajo bimë ka fara, ti mund të depërtosh në energjinë e asaj fare dhe të shohësh ardhmërinë e saj... dhe, jo vetëm të një fare, po të farave të pakufishme - si po mbijnë në tokë e deri në vdekje. Është e pakuptimtë ndjekja e rritjes së bimëve nga farët, në të ardhmen, sepse janë me numër të pakufizuar. Është interesant të njihet vetëm historia e asaj bime. P.sh. ajo bimë e di saktë se çka i ka ndodhur në të kaluarën e afërt, se a e ka dëmtuar koha, fryma, ndonjë shtazë apo njeriu dhe kush është ai njeri. Për të ardhmen tregon se kush ka për ta dëmtuar, nëse veç ka për t'u dëmtuar. Tash do t'ua përshkruaj sesi të tjerët kanë bërë prova me bimë, ashtu siç edhe unë kam bërë me anë të hipnozës apo pa të.

Pasi që kisha mësuar se bima di të komunikojë, vendosa të komunikoj me to; këtë komunikim mund ta bëjë njeriu, kuptohet, kur drejtpërdrejt lidhet me ndërdijen e vet dhe me ndjenjat e bimëve.

Në qytetin tonë ishte mbjellë një dru i ri, jo aq i trashë; mirëpo, ishte në një vend i lënduar rëndë. Isha afër tij dhe mora kontakt energjitik e psikik, duke thënë se po i ndihmoj këtij druri që të shërohet dhe e ofrova dorën e djathtë e, me gishtërinjtë e mij, fillova të prek vendin e lënduar të drurit, duke i dhënë energji. Papritmas fillo një energji e madhe të rridhte prej gishtërinjve të mij, kurse bima ma thithte energjinë; kisha ndjenjën sikur një thithëse elektrike po ma thithte energjinë prej trupit tim. Pata ndjenjën se kjo bimë po donte tërësisht të ma thithte energjinë dhe, shpejt e shpejt, e ndërpreva këtë proces.

Në fillim, kur kam dashur të vërtetoj se a ka edhe druri energji, jam afruar në fushë të fshatit, te një bagrem, jo i trashë, dhe, afër tij, jam koncentruar symbyllur në një largësi 30-40 cm. I shtriva duart drejt tij dhe fillova t'i lëvizë, sikur të ishin në ujë, herë kah bagremi e herë kah unë, kur, papritmas, m'u duk se diçka po m'i tërhiqte duart; thjesht: kur largohesha prej tij, druri më tërhiqte kah vetja. Më në

fund, fillova të tërhiqesha mbrapa, derisa humbi kontakti me të. Largohesha në një largësi të caktuar dhe filloja, duarhapur, t'i afrohesha përsëri. Posa hyja në fushën energjitike të tij, brenda aurës së tij, menjëherë e ndjeja një sinxehtësi dhe një tërheqje kah druri në duart e mia.

Pra, edhe ju, lexues të dashur, mund ta provoni këtë metodë dhe të bindeni për këtë të vërtetë.

Një herë, duke shkuar në bjeshkë, te stani, me nipin, Shpendin, thashë t'i bëja disa eksperimente hipnotike me bimë dhe drunj.

Ishim ndalur nën një hije të flladitshme të një druahut, që të pushonim pak. Shpendin e hipnotizova dhe e vura në autohipnozë, që më mirë të komunikonim për gjërat që doja t'i studioja. Para nesh kishte mjaft bimë fieri. Afër kishim një trup fieri të lënduar dhe një tjetër të shëndoshë.

E lidha Shpendin, përmes ndërdijes, me fierin e lënduar. I thashë që të pyes se çka i kishte ndodhur që ishte lënduar ashtu. Shpendi tha që fieri po thoshte se e ka shkelur një djalë para një javë ditësh. Pyete fierin se a do të përmirësohet në atë vend ku është lënduar, i thashë Shpendit. U përgjigj: Jo, po thotë fieri; nuk kam për t'u përmirësuar, sepse, javën që vjen, së bashku me atë fierin e shëndoshë, kanë për të na shkatërruar plotësisht disa çobanë! Pyete, Shpend, se për çka kanë për t'i shkatërruar. Kanë për të ardhur këtupari dy djem të rinj, çobanë, dhe kanë për të na dëmtuar plotësisht me shtagat e tyre, me të cilat i trembin lopët.

U çudita me përgjigjen e ndërdijes së Shpendit, nëpërmjet së cilës përgjigjeshin ata dy fierat, dhe, aq isha kureshtar, sa mezi prisja të kalonte java e të mësoja se ç'do të ndodhte vërtet me ata dy fierat, të cilët folën ashtu qartë për fundin e jetës së tyre.

Kur kam shkuar pas një jave, fare duke mos e harruar vendin, ata fierat me të vërtetë i kishin zhdukur me rrënjë,

vetëm fletët e thara e të dëmtuara, nëpër bar të njomë, kishin mbetur.

Është një rast interesant me një lis bingu, të cilin e kemi pasur lart te stani në bjeshkë. Me Shpendin, siç përmenda disa herë më parë, hulumtoja në autotrans shumë gjëra për bimët. E gjetëm se shumë pemë ishin mbjellë nëpër vende të gabueshme, sepse aty ku ishin mbjellë, toka ishte e papllëshme ose kishte rrezatime nëntokësore, të cilat e pengonin rritjen e tyre; ndodhte të ishin mbjellë afër ndonjë peme tjetër, që fare nuk përshtateshin në mes veti. Vendi ku banonim ishte shumë i bukur, me pemë të ndryshme, me ujë të pastër, me lisa të rritur; në bahçe rriteshin perimet më të shëndosha e më të mëdha sesa në rrafshin ku jetonin fshatarët. Para shtëpisë kemi pasur shumë lisa të bungut dhe të qarrit. Në mes tyre, e kam pasur një tavolinë druri, shumë të bukur, ku pushonim dhe hanim bukë verës. Sot dëshiroja të di sesi po rrezatonin këta drunj, cili lis po lëshonte rreze të mira e cili të këqija. Shpendi tha se ky lisi i bukur i bungut, afër kronit, po lëshonte rreze të këqija dhe tash, prej tij, nuk po e ndjente veten mirë. I thashë Shpendit që ta pyes këtë lis bingu se për çka po rrezatonte aq keq kundër njerëzve. Shpendi tha: Ky bung qenka i mbushur me gozhdë të ndryshkura, të cilat, njerëzit, më parë, i kanë ngulur pa mëshirë dhe pa nevojë. Bingu po ankohet, se intensivisht po ka dhembje prej tyre, meqë ato i kanë shkaktuar plagë. Pastaj, e pyetëm bingun sesi t'i ndihmonim, që ai ta ndjente veten më mirë. U përgjigj: m'i shkulni gozhdat prej meje dhe unë do ta ndjej veten mirë. Pas kësaj, i mora një parë dana e një teslicë dhe çka gjeta gozhdë nëpër të, i hoqa dhe e lirova nga ai presion që kishte. Pas këtij pastrimi, që i bëmë, filloi menjëherë procesin e vet të shërimit dhe, gjithashtu, të lirimit të rrezeve pozitive rreth vetes.

Një herë, në meditim, së bashku me shokun Kadri, që ishte prej Tetovës, dhe përkohësisht gjendej në Noihauzen të

Zvicrës, kemi hyrë në një dru. Shokun Kadri e udhëhiqja për t'ia shtuar vizualitetin e brendshëm. Mirëpo, u detyrova edhe vetë që të zvogëlohesha, me astral, dhe shkova, së bashku me shokun Kadri, thellë në tokë, ku fillonin rrënjët e një druri. Maja e rrënjës së tij ishte e gjallë dhe e bardhë; dukej si të ishte një krimb i tejdukshëm. Në mes të saj ishte një vrimë, nëpër të cilën e thithte ujin prej toke; dukej si një gojë e vogël krimbi. U lëshuam në atë vrimë, si tunel; e lëshuam veten që të na bartte uji përpjetë, deri në trung. Nëpër tunel kishte edhe disa vrima tunelesh të tjera, sipas nevojës, për të marrë ujë, minerale dhe energji nga toka, të cilat hapeshin kohë pas kohe. Dukej një botë fantastike. Kur erdhëm në mes të trungut, këtu shiheshin poret e drurit, shiheshin qelizat e tij, shiheshin ato kanale që bartnin ujin dhe mineralet nëpër atë dru; shihej dhe ku po deponohej uji me minerale. Shihej se diçka po vinte nga poshtë e diçka nga lart; si dukej, ishin vitaminat. Shihnim sesi druri tepër ngadalë po rritej. Brenda ishte një sferë e dritës, dukej si të ishte shpirti i drurit, i cili thuaja çdo gjë dinte. Kjo dritë depërtonte edhe jashtë trungut; jashtë dukej si një lloj aure e ndritshme. Edhe kjo energji i kishte disa lloj shtresash, me lloje të ndryshme ngjyrash. E ndjeja këtë dritë dhe një dashuri të madhe ndaj natyrës. Kjo energji dukej si të ishte fëmijërore, e pastër, e pasherr, vetëm paqe pa kurrfarë të keqeje. Kishte gjëra që kurrë nuk i kam parë dhe nuk mund t'i shpjegoj; ishte pamje fantastike, të cilën, ndoshta, fare nuk ka mundësi ta përshkruash me fjalë. Vendosa që të shkonim kah kurora e drurit, deri tek një fletë, ku dukej një dritë e madhe në ngjyrë të gjelbër. Te fleta kryhej një proces i madh. Në njërën anë, prej drurit, dilte një energji, ku druri disi lirohej nga ajo energji në ngjyrë argjendi. Sakaq, në një kanal tjetër, vinin disa kokrra të imta të dritës, të cilat vinin nga dielli, me lloj-lloj ngjyrash. Aty ndodhte një harmoni e madhe në mes drurit dhe natyrës, në mes natyrës dhe universit.

Këso udhëtimesh kam bërë edhe nëpër shtazë dhe kristale të ndryshme; po ashtu edhe në njerëz. Në çdo udhëtim që kam bërë, gjithmonë kamë qenë i fascinuar nga bukuritë fantastike të këtyre botërave mikroskopike.

PËRJETIMI I NJË REINKARNIMI SI FEMËR

“Që ta gjejmë veten, duhet ta humbim veten. Ashtu humbja bëhet fitim. Që të jetojmë në Zotin, duhet të vdesim për veten. Ashtu vdekja bëhet jetë.”

Resulullah-(Avatar)-Meher Baba)

Në literaturën e mistikës botërore shkruan se ekziston reinkarnimi, që do të thotë se shpirti bën ritrupëzime prej një jete në një jetë tjetër dhe prej një trupi në trupin tjetër. Në realitet shpirti apo Drita në ne, Zoti në ne, kurrë nuk lëviz prej vendit, vetëm krijon medime të reja, që të mbledhë përvoja të ndryshme, të ashtuquajtura Sanskara (që në gjuhën sanskrite don të thotë: impresione). Kjo zgjatë derisa një te njeri të fillon involucioni ku njeriu shkon në zhvillim të lart hyjnor, këtu sanskarat filloj të zhduken deri sa njeriu ta arrinë gjendjen e Zotit dhe ta njeh vehten plotsisht, Zotin në vete, apo: ta realizojë të Vërtetën. Për këtë temë mund të lexoni më së miri në librin e Avatar Meher Babës: **“Zoti Flet”**. Kjo temë është e veçantë dhe zë shumë vend në këtë libër. Do t’u them më poshtë diçka për reinkarnimin - ç’ thotë Resulullah (Avatar)- Meher Baba dhe një mistik rus, Gurxhievi.

Nxënësi i Meher Babës, Eruqi, thekson se, si i ka treguar Meher Baba, për pesëdhjetë (50) **Crora** (në gjuhën hinduse: **karora** = 100 lakha:10.000.000) pushim në vdekje, me të cilat një shpirt duhet të kalojë përmes evolucionit gjatë reinkarnimit, përmes ndërrimit të medimeve, në të vërtetë përmes lidhjes nëpër forma të ndryshme dhe lloje të ndryshme , respektivisht nëpërmjet ndërrimit të trupave.

“Tetëdhjetë e katër (84) **lakha** dridhje apo reinkarnime janë në formë të njeriut”. Pesëdhjetë (50) **crora** pushim në vdekje, duke përfshirë ngjitjen dhe shëkputjen prej medimeve, që i tejkalojnë format njerëzore dhe i përjetojnë impresionet e tyre. Pastaj, thuhet:” *Njeriu nuk duhet të vdesë shumë herë, para se të mund të lindë! Njeriu njëherë lind me lindjen e mendjes, dhe një herë vdes, me shkatërrimin e mendjes. Meqë është ashtu, reinkarnimi në të vërtetë nuk ekziston: kjo është vetëm proces i **crorës**, pushim në vdekje të mendjes, e cila vetëm një herë është lindur dhe e cila vetëm një herë vdes. Me lindjen e mendjes tërhiqet me vete procesi i evolucionit, reinkarnimit dhe involucionit. Vdekja e mendjes paraqet njohjen e Unit të Vërtetë”.*

Pastaj thuhet se shpirti kalon nëpër shumë medime. Kur të lidhet me trupin e vrazhdë fizik, shpirti fillon t’i harxhojë impresionet e mëparshme; por, në këtë drejtim, shumë rrallë ka sukses. Ngjan në të vërtetë e kundërta, ai grumbullon impresione të reja e të kundërta. Forma e vrazhdë gati në tërësi i harxhon impresionet, për shkak të të cilave është krijuar; ajo tash hidhet. Impresionet e mëparshme, të mbetura, e çojnë shpirtin në parajsë apo në ferr, varësisht prej asaj se këtë shpirt e ka mbisunduar mirësia apo keqësia-mëkati. Në formën jotrupore të ekzistimit, të gjitha impresionet e mëparshme tentojnë të harxhohen nëpërmes përjetimeve subjektive të impresioneve të ngjallura. Por edhe atje, në gjendjen e parajsës apo të ferrit, drejtpeshimi i gjendjes pa impresione gati bëhet i arritshëm, por nuk realizohet, dhe, ashtu, impresionet e mëparshme të mbisunduara, e shtynë mendjen që të lidhet me mediumin e vrazhdë, me një trup të ri fizik. Drejtpeshimi i plotë nuk është i shfaqur as gjatë vdekjes, as me rastin e lindjes. Ai mund të arrihet vetëm në botën fizike. Dhe, nga kjo, zinxhiri i pafund i jetës, në botën fizike, vazhdon, duke iu falënderuar impresioneve të mëparshme që i kemi pasur, derisa vetëdija

arrin që të forcohet në drejtpeshim pa impresione. Dhe, prej kësaj, në procesin e reinkarnimit, shpirti njerëzor, me vetëdije të plotë të zhvilluar për materien, duhet, patjetër, që të përjetojë lloj-lloj impresionesh të kundërta - impresione, të cilat, në mënyrë diametrale janë të kundërta - në një zinxhir të dukshëm e të pakufishëm të përjetimeve të arritura.

Prandaj, prej kësaj, se shpirti njerëzor plotësisht i vetëdijshëm, i cili posedon vetëdije për materien fizike, përjeton përvoja të kundërta në botën fizike, vetëdija e shpirtit duhet të identifikohet (d.m.th.: të reinkarnohet) shumëherë si mashkull, pastaj si femër; dhe, e kundërta: në lloj-lloj grupi të njerëzve, në lloj-lloj besimi, nacionaliteti; në lloj-lloj ngjyre të lëkurës, në lloj-lloj vendesh; njëherë si i pasur, e pastaj si i varfër; ndonjëherë si njeri i shëndoshë, e ndonjëherë si i sëmurë, etj. Dhe tërë kohën përjeton impresione të ndryshme, krijon impresione të ndryshme në të njëjtën kohë dhe i harxhon impresionet e fituara më parë.

Vetëm nëpërmes të këtyre impresioneve të kundërta dhe të kalimit të vazhdueshëm përmes tyre, shpirti i njeriut, i cili posedon vetëdije për materien fizike, me siguri që një ditë, në botën fizike, pas një milion lindjesh e vdekjesh, do të jetë në gjendje që, përmes përjetimeve të kundërta të lindjes e vdekjes, të arrijë t'i drejtpeshojë impresionet e veta.

Në të vërtetë, ky cikël përsëritjesh të lindjes dhe vdekjes, si dhe i përsëritjes së vazhdueshme të formës njerëzore, i jep shtytje shpirtit të njeriut kah evoluimi i mendjes, e cila posedon vetëdije për materien dhe e invulon mendjen deri në ato thellësi, ku mendja plotësisht e *involuar*, e njeh të vërtetën për *Pafundësinë*, gjendjen e përjetshme të *Unit të Vërtetë*.

Kurse në librin "Puna e Gurxhievit", Gurxhievi thotë: Në terminin e rrezeve të krijimit, trupi i parë (fizik) është i krijuar prej materies së këtij planeti; dhe, për këtë arsye, është e caktuar që t'i kthehet tokës. Trupi i dytë është i përbërë prej

materialit kualitativ shumë të imët, realisht prej nivelit 24, i cili mund të ekzistojë edhe pas vdekjes së trupit fizik; mirëpo, nëse flasim të vërtetën e saktë, ky trup nuk është i pavdekshëm. Këtë trup e mbijeton trupi i tretë, në qoftë se ai ekziston. Trupi i katërt është i pavdekshëm në rrethana të sistemit diellor, pasi që përbëhet prej materies, e cila nuk i përket këtij sistemi diellor, veç një niveli më të lartë. Simbas kësaj, një person mund të jetë i pavdekshëm, kurse tjetri është i dënuar me dezintegrim të plotë me rastin e vdekjes. E tërë kjo varet prej shkallës së zhvillimit të brendshëm. Mundësitë e nivelit të pavdekësisë relative, të cilat qëndrojnë në sferën e brendshme, e zgjojnë idenë e reinkarnimit, pikërisht të kthimit të përjetshëm, i cili, në shumë versione, vërteton (në varshmëri prej kontekstit teologjik dhe kosmologjik, i cili kyqet) se diçka, në çdo qenie njerëzore, duhet pandërprerë të kthehet në jetë pas vdekjes, derisa tendenca psikologjike dhe lidhja plotësisht të mos neutralizohen.

Pastaj, nxënësi i Gurxhievit, Uspenski, për reinkarnimin thotë: *“Kjo ide e përsëritjes”, ka thënë Gurxhievi, “nuk është e vërtetë e plotë, absolute, por është e vërteta e mundshme e aproksimacionit. Në këtë rast, e vërteta nuk mund të përshkruhet me fjalë. Ajo çka thua është e përafërt me të. Në qoftë se e kupton se pse, për këtë, nuk po flas, ke për të qenë me këtë edhe më afër. Çfarë dobie është që njeriu të dijë për kthimin e përjetshëm (reinkarnimin), në qoftë se nuk është i vetëdijshëm, dhe në qoftë se edhe vetë nuk ndërrohet. Mund të thuhet se, në qoftë se njeriu nuk ndërrohet, përsëritja (reinkarnimi) për të nuk ekziston. Në qoftë se i thua diçka për rikthim, kjo ka për t’ia zgjatur gjumin e tij”.*

Për këtë arsye, siç e përmendi më lart Uspenski, profetët ua kanë fshehur njerëzve të thjeshtë ekzistimin e reinkarnimit, që njerëzit mos të fundosen më thellë në gjumë

të iluzionit, edhe pse mistikët islamë dhe të tjerë shumë mirë e njohin reinkarnimin.

Shumëherë me mediumë të ndryshëm kam provuar, dhe atë me sukses, me anë të hipnozës, për t'i regresuar deri në fëmijëri e, pastaj, edhe para kësaj jete. Shpeshherë ndodh që një person, kur kthehet në fëmijëri, edhe pse është i rritur, fillon të flasë me gjuhën dhe zërin e fëmijës. Në qoftë se kthehet para kësaj jete, në bisedë spontanisht e ndërron personalitetin, gjininë, moshën, gjuhën, kombësinë, racën, vendbanimin.

Studimet që janë bërë në kohët e fundit, e kanë vërtetuar se ekziston ritrupëzimi apo reinkarnimi.

Një herë në Mynhen kam punuar me një djalosh të quajtur S. Kolgeci, i fshatit tim, i cili ishte medium shumë i mirë e i cili kishte një dhembje në krahun e majtë; nuk dinte se përse i dhimbte dhe si ta shëronte. Kishte bërë te mjeku një kontroll dhe kishte vërtetuar se e kishte pasur ashtin e krahut të majtë të çarë afër 10 cm.; ndaj, ia kishin futur në gips për ta shëruar. Qëllimi i hipnotizimit ishte që t'ia ndalja dhembjet në krahun e majtë. Ai fare nuk e dinte se ku e kishte çarë ashtin. Në hipnozë e regresova deri në atë moment kur e kishte lënduar krahun. U kthye disa vite më parë, ku e pa veten se kishte qenë i regjistruar në një ekip të futbollit, për të rinjë, në Mynhen. Në lojë, para portës, dikush ia qet këmbën, ku rrëzohet dhe i çahet ashti i krahut të majtë; në këtë rast, ky, e ndjen vetëm dhembjen, por nuk e di se iu ka çarë ashti i krahut dhe, kështu, i mbetet deri më tash. Në hipnozë i dhashë fuqi dhe dije që ashtin e thyer ta sheh më mirë se me rentgen; po ashtu, në dorën e djathtë ia formova një aparat, i cili është zbuluar “në të ardhmen”, të cilin ky tash mund ta përdorë dhe i cili ka aftësi që eshtrat e thyera e të çara t'i ngjet, t'i saldon, me një ngjitës biologjik, të përbërë prej gjeneve të veta. Me këtë aparat e saldoi ashtin e vet dhe e shëroi aty për aty. Po ashtu, i pastruam edhe shumë bllokada

të ndryshme që kishte. Si doli prej hipnozës, menjëherë iu ndal dhimbja. Pas disa ditësh jam takuar me të te Sherifi, një shok i fshatit tim, ku më tha, në shaka, se “ma kishte parë sherrin”, meqë ishte shëruar dhe i kishte humbur tri javë pushim mjekësor. Të nesërmen, kur kishte shkuar në spital, për kontroll, mjekët ia kishin fotografuar krahun në rentgen dhe ashti i çarë plotësisht ishte ngjitur; madje, tash, kurrfarë gjurmëçarjeje nuk i kishte mbetur, edhe pse, më parë, të gjitha incizimet dëshmonin çarjen e ashtit në krahun e majtë. Mjekët ishin befasuar sesi ishte e mundur që aq shpejt, vetëm për dy ditë, të shërohej krah, i cili vite me radhë e kishte munduar. M’i kishte sjellë fotot e rentgenit, të mëparshmet dhe të tashmet; një parë me asht të çarë dhe të tjerat, bërë pas dy ditësh, me asht të shëruar plotësisht.

Me këtë person, këtë natë, e bëra një eksperiment: E hipnotizova dhe e regresova para kësaj jete. Së pari, e ktheva në stadin derisa ka qenë në bark të nënës, pa lindur ende; atëherë, kur i kishte ardhur shpirti si dritë me vetëdije në trupin e sapoformuar (fetus) në barkun e nënës së vet. Pastaj, e dërgova para kësaj jete dhe e urdhërova që ta shihte veten në moshën mesatare... Tha: ”Po jetoj në një fshat malor, ku po e punoj tokën si një bujk primitiv; tokën e punoj me një parmendë primitive dhe një lopë po e ngre këtë parmendë. Jam Holandez. I kam dy djem të vegjël dhe gruan. Vetë po jetoj në këtë bjeshkë, se tjetërkund nuk po kam kushte për të jetuar. Me të njëjtën lopë po lavrojmë dhe po ushqehemi nga qumështi i saj; disi po mbijetojmë... Emrin e kishte holandez, po edhe gjuhën e kishte si një gjermanishte të pakuptueshme.

Tash po u tregoj një përjetim timin të një reinkarnimi.

Një natë, para se të flija, i dhashë vetes sugjectionin se “kam për të parë saktë një reinkarnim se çka kam qenë, si e kam humbur jetën dhe për çka; pa marrë parasysh se në cilën kohë ka ndodhur ajo.”

Dola në botën astarle, me vetëdije, në një kohë, ku e pashë veten se isha një femër e bukur, me flokë bionde dhe të drejta. E kisha për qëllim që të ngjitesha në një kodër jo fort të lartë dhe të kryeja një ritual magjik, ku doja t'i thërrisja fuqitë e ujit. Poshtë shtrihej një peizazh shumë i bukur: Një liqe jo aq i madh, i cili ngapak avullohej. Anash kishte shkëmbinj; para meje ndodhej një rrafsh i vogël. Rashë në dy gjunjë dhe fola diçka. Para meje e vizatova një trekëndësh të vogël, mbi tokë. I ngrita dy duart kah qielli, në drejtim të atij liqeni, dhe kreu një lloj rituali, i cili kishte forcë t'i thërriste fuqitë e ujit. Siç pashë, aty i thërrisja fuqitë e errëta të liqenit, ato të elementit të ujit. Pas një momenti, mbi liqe filloi të mblidhej avulli në mes, dhe, pas pak, filloi të lëvizte, si një dredhë, duke u fuqizuar e duke u rritur përpjetë pandërpre. Një fuqi e madhe ngrihej lart dhe mori drejtimin tim. Shakullima vinte me frymë të fuqishme, që hidhej drejt e në mua, ku flokët e gjata, bionde, m'i bënte të valonin me fuqi mbrapa shpinës sime. Ajo fuqi e madhe donte të më rrëzonte e të më largonte prej atij vendi. E pashë rrezikun e madh, i cili më afrohej gjithnjë, dhe e urdhërova që të kthehej mbrapa. Por fuqia e papërshtueshme fare nuk dëgjonte. Ajo vinte gjithnjë e më afër meje. Në këtë çast, mora frikë të madhe, edhe pse nuk do të duhej ta kisha në këso rastesh; u ngrita në këmbë që të ikja prej asaj fuqie. Ai ishte një demon i fuqishëm uji, i cili tash mori formën e fytyrës së një mashkulli të trishtueshëm, një fytyrë e kuqe dhe e sakatosur si më keq. Unë e vazhdoja ikjen, derisa mbërrita te disa shtëpi të fshatit. Demoni i fuqishëm i ujit vazhdonte të më ndiqte; hyra një një shtëpi, u ngjita në tavan të saj. Kur mbërrita në tavan, më nuk kisha se ku të shkoja dhe ai demoni i ujit, i cili kishte sytë e kuq dhe fytyrën të sakatosur, më mbyti; trupi më mbet në tavan, kurse unë u ngrita kah qielli i lirë, pa dhimbje, pa frikë. Këtu e ndërrova një jetë.

Në këtë jetë isha një femër e bukur, rreth 25 vjeçare, pa martuar. Dikush ma kishte mësuar gabimisht këtë ritual për thirrjen e krijesave të errëta të elementit të ujit, ku gjatë asaj thirrjeje, me ritual, nuk kisha bërë mbrojtje; unë nuk dija se duhej të bëja një rreth për qark meje, kur t'i thërrisja ato fuqi. Po ashtu, nuk e kam ditur se kur t'i thërras ato fuqi, duhet të kem mjaft dije dhe njohuri për këto gjëra të larta. Kjo mosdije më ka kushtuar një jetë, ku në moshën më të mirë e humba jetën prej mosdijes nga një fuqi e errët, meqë nuk dita ta sundoj dhe ta udhëheq si doja unë.

FRIKA GJATË USHTRIMEVE SPIRITUALE

*“Ligji i Zotit është dashuria, gjuha e Zotit është qetësia”
(Satyananda Paramhasma)*

KUSH MA NGJITI PËR FYTI NË TË ANDEJSHMEN

Shpesh isha i detyruar të ushtroja kudo që gjendesha, ta zëmë kur shkoja te babai, në fshat; në banesën time të ngushtë, ku banoja, në Prizren, e gjetiu. Gjatë ushtrimit, në meditim e sipër, spontanisht dilja në botën astralo-eterike, me vetëdije. Në këtë kohë isha një nxënës pa mësues, që punoja vetë me atë çka dija. Pra, nuk kisha askend që të pyesja për vështirësitë dhe pengesat, të cilat mund të më shfaqeshin gjatë ushtrimeve spirituale. Në fillim nuk kisha njohuri të duhura për botën astralo-eterike dhe nuk i njihja sa duhet pengesat apo rreziqet, që mund të më paraqiteshin. Shpesh kisha frikë dhe pyesja veten se ç'do të bëhej me mua kur do të dilja në të andejshmen. Shpeshherë, duke bërë pyetje të tilla, më lindtke edhe një frikë, gjithnjë duke mos e ditur se me shfaqjen e frikës, formoja dhe bllokada e pengesa të mëdha drejt zhvillimit të mëtutjeshëm shpirtëror.

Një natë shkova në fshat te babai. Unë, për çdo natë, e kisha bërë shprehi të meditoja për udhëtimet astrale jashtë trupit tim fizik. Në mbrëmje, nuk kisha vend se ku të ushtroja i qetë, siç e lypin rregullat e ushtrimeve astrale, prandaj më duhej të ushtroja kudo aty ku isha, edhe pse kjo nuk lejohej dhe për këtë u binda më vonë. Dhe, kur nuk kisha vend se ku të ushtroja, ushtroja aty ku bija për të fjetur.

Këtë natë rashë për të fjetur në odë të burrave; me mua në odë ishte babai, Azemi, dhe dy vëllezërit; unë isha në mes tyre. Babai ishte kah ana e djathtë. Pasi ramë, unë fillova të ushtroja shëtitjen astrale. Dola në botën astrale të dhomës, u ngrita mbi trup fizik dhe shkova në tavan të odës, ku kurrsesi nuk mund të dilja, nuk më lente tavani. U ktheva në trupin fizik dhe përsëri dola prej tij, por tavani nuk më linte; kisha ende bindjen e vetëdijes së materies, se trupi nuk mund të delë nëpër mur. Si m'u kujtua kjo, menjëherë dola në korridor të shtëpisë, që ishte krejtësisht ndryshe, e kalova derën dhe dola si në një dhomë tjetër më të gjerë, me shtylla. Mirëpo, fillova të ndija një zë të trishtueshëm në atë vend. Dukej se donte të më përpinte. E mora pozitën mbrojtëse të karates, sepse më parë kisha ushtruar karate dhe dija të mbrohesh. Asgjë nuk shihja, kur zëri i brendshëm ma përkujtoi zërin e babait, Azemit, i cili gjendej në anën e djathtë të trupit tim fizik dhe po kërrhatte. E ktheva trupin eterik në trupin fizik dhe, me të vërtetë, babai kërrhatte me një zë trishtues. Dola edhe një herë me astral, po zëri ishte i padurueshëm dhe u detyrova të kthehesha prapë në trupin fizik, ku konstatova se me të vërtetë këto eksperimentime duhej kryer kur je vetë dhe kur trupin fizik e ke në siguri të plotë, sepse çkado që ndodh në trupin fizik, e ndjen në trupin astral dhe botën astrale.

Një natë tjetër, po ashtu te babai, në të njëjtin vend e në të njëjtën dhomë, u relaksova thellë dhe spontanisht hyra në një gjendje autotransi, ku dola në botën eterike të shtëpisë ku banomin, në korridor të saj. Korridori dukej më i gjatë dhe i vjetër. Duke e shikuar atë, me vetëdije, fillova t'i bëja pyetje vetes, se pse ai korridor ishte i vjetër dhe i palyer me gëlqere. Kur, papritmas, në fund të korridorit, doli një person. Ky person ishte vëllai, Muharremi, apo dikush tjetër që unë nuk e identifikoja dot, por disi dukej fytyra e Muharremit. Edhe pse ishte larg meje, ai e zgjati dorën, sikur ajo dorë të ishte prej

gome, ma ngjiti për fyti dhe më shtrëngonte, thua donte të ma ndalte frymën. Në këtë rast, mora një frikë dhe menjëherë u ktheva në trupin fizik. Mirëpo, me vetëdije, kthehesha përsëri në të njëjtin vend dhe të njëjtën figurë e shikoja: Përsëri ishte Muharremi, i cili prapë e zgjatte dorën e vet si prej gome dhe ma ngjitte për fyti, sikur donte të më furte; por kësaj here më i tërbuar, më sulmonte më me shumë fuqi. Unë nuk e dija se përse më sulmonte, dhe a ishte vërtet Muharremi, që nuk lejonte ta vizitoja atë botë, në të cilën unë kisha dalur me vetëdije. Me intuitë e ndjeja se Muharremi nuk mund të ishte, po dikush tjetër, sepse Muharremin e doja dhe më donte. Megjithatë, kjo krijesë e shëndrruar në fytyrë të vllaut Muharrem, më pengonte të vizitoja me vetëdije atë botë të panjohur, sakaq në atë kohë nuk dija të mbrohesha nga ky sulm i papritur.

Përveç këtij përjetimi, kam pasur edhe shumë raste të ngjashme që i kam përjetuar.

Zakonisht ushtrija natën, që të mos më pengonte askush gjatë ushtrimeve. Në banesën time të vogël fëmijët shtriheshin nëpër kanape, anash, kurse unë shfrytëzoja një hapësirë në mes të dhomës për të ushtruar, ku shtrihesha mbi dysheme, vetëm me një jastëk të vogël nën kokë, dhe relaksohesha aq sa, pas pak çastesh, me vetëdije, dilja në eterikun e dhomës ku ushtrija. Këtë herë pashë veten si u ngrita nga trupi fizik, e pashë trupin fizik, i cili ishte shtrirë, i shtanguar, merrte frymë dhe nuk lëvizte; kisha rënë në katalepsi të plotë; vetëdije nuk kisha fare në trupin fizik; ajo më kishte ardhur tërësisht në trupin astralo-eterik. I shikova fëmijët, Arbenën e Arbenin, si dhe bashkëshorten, Kasemën. Arbena e kishte pasur trupin astral në trupin fizik, kurse Arbeni me Kasemën kishin dalur në botën astrale për t'i kryer disa punë që kishin pasur. Kur, papritmas, para meje doli një hije, e cila ma ngjiti për fyti dhe donte të më furte. Ndjeja se gjithnjë e më shumë më shtrëngonte. Në atë moment m'u

kujtua dhikri, të cilin shpesh e përdorja për mbrojtje dhe në ushtrimet e përkujtimit të Zotit: “La ilahe ilallah” (Nuk ka Zot tjetër, përveç Allahut). Sa herë e përsërisja këtë mantër të fuqishme, hija shkonte duke ma lëshuar fyti. Kur e përsërita tri herë, më lëshoi plotësisht dhe u ktheva në trupin tim fizik. Më erdhi inat, se pse nuk më lejonte hija e panjohur të qëndroja në atë dimenzion; dola përsëri në të njëjtën botë eterike; u ktheva në të njëjtin vend; prapë ajo hije ma ngjiti për fyti, ku gishtërinjtë e dorës së saj i ndjeva me forcë. U detyrova që të njëjtat fjalë mbrojtëse t’i përsërisja tri herë, ku më lëshoi dhe u ktheva në trupin fizik. Mirëpo, tash, me një frikë më të madhe, duke mos ditur sesi të mbrohesha në këso momentesh rreziku nga bota astralo-eterike.

Një rast i ngjashëm më ka ndodhur edhe gjatë një ushtrimi tjetër. Këtë herë për çudi dola te një shtëpi e vjetër, e panjohur, ku kisha ndjenjën se duhej të shkoja në WC. U lëshova bodrumit teposhtë, ku vetëm një WC kishte. Si iu afrova këtij vendi, nga bira e WC-së doli një djallë i vogël, ngjyrëgjelbër, me sy të kuq, me bisht, këmbë dhe brirë si të dhijes. Më këceu në qafë e ma ngjiti për fyti. Mirëpo, me dhikrin “La ilahe ilalla” më lëshoi menjëherë dhe u zhduk.

Pas këtyre përjetimeve, jo të mira, që ishin pengesë për mua, fillova t’i pyes të tjerët se çka po ndodhte në këtë mënyrë, po askush nuk dinte të më jepte përgjigje. Askund dhe te askush nuk gjeta përgjigje adekuate. Pas një kohe më ra në dorë libri i amerikanes, Xhejn Roberts, e cila kishte kontakt me një shpirt të një dimenzioni tjetër, i ashtuquajtur Seth, të cilin ajo e kishte kanalizuar, e i cili thoshte se kishte ardhur prej dimenzionit 51, me mision special që këtë dije t’ua sillte njerëzve në dimenzionin fizik, ku ne jetojmë tash. Rast të ngjashëm në botën astralo-eterike kishte pasur edhe mediumi, Xhejn Roberts, ku një bishë e trishtueshme ia kishte “ngjitur” për fyti dhe kishte dashur ta copëtojë. Sethi, për këtë rast, i thotë Xhejn Roberts-it, se ajo qenie e

trishtueshme është frika jote, të cilën e ke krijuar vetë me vite për këtë botë, frika se “çka do të më gjejë, kur do të dal në botën astrale”! Droja e tillë ka marrë formë të caktuar dhe është bërë elementar i gjallë, i cili tash e mbronë botën e vet. Për t’i shpëtuar kësaj krijese që po të sulmon, ose shko më lart, në një dimenzion tjetër, i cili kësaj qenie nuk i takon dhe e cila nuk ka mundësi të të ndjek mbrapa, ose kthehu në trupin fizik që të mbrohesh. Si e kam kuptuar këtë të vërtetë, më nuk kam pasur sulme të tilla, siç kam pasur më parë; faktikisht i kam ikur atij dimenzioni apo asaj qenie mentale, të cilën e kam krijuar vetë. Thjesht: këtë qenie nuk e kam ushqyer më me energji të frikës dhe nuk ia kam mundësuar që ajo të merrë në mua lloj-lloj formash; është zhdukur nga ajo botë.

Këso elementarësh psikikë njerëzit shpesh i krijojnë pa vetëdije, të cilët nganjëherë mund të bëhen shkatërrimtarë të atij individi, që vetë i ka krijuar. Rëndom, këso elementarësh njeriu i krijon pa vetëdije. Po ta dinte njeriu se duke mendur intesivisht keq, si me urrejtje, xhelozë, dhe në shumë baza tjera të errëta, kurrë nuk do të mendonte ashtu, as për vete, as për të tjerët. Këto mendime negative të errëta, në botën tjetër bëhen krijesa shumë të errëta, të cilat marrin formën e atyre mendimeve dhe pastaj i bëjnë dëm atij personi, si dhe rrethit ku gjendet personi.

Këta elementarë, të cilët njerëzit i krijojnë pa vetëdije, shumë bukur i përshkruan Franc Bardoni - adept shumë i njohur dhe magjistari i bardhë më i ditur i shekullit 20, në librin e etij *“Rruga drejt adeptit të vërtetë”*. Bardoni në një rast e përshkruan formimin e pavetëdijshëm të elementarëve mentalë nga ana e të rinjve dhe të rejave, kur fillojnë të hyjnë në fazën e pubertetit e deri në moshën madhore. Këtë po e cek si njohuri dhe mbrojtje, për të rinjtë e të rejat, të cilët hyjnë në pubertet, e të cilët janë të detyruar intenzivisht të masturbohen nga mbledhja e tepërt e energjisë seksuale.

Energjia seksuale është energjia më e fuqishme, e cila ekziston, si në botën fizike, ashtu edhe në atë eterike. Këtu e kam fjalën vetëm për masturbimin, e jo edhe për marrëdhëniet seksuale normale. Shumë mirë dihet në shkencën e Magjisë e të Okultizmit, se marrëdhëniet normale seksuale në mes të një mashkulli e të një femre, e forcojnë njeriun, ia forcojnë sistemin nervor dhe energjistik; ata e rinojnë veten me këto marrëdhënie. Kurse masturbimi e dobëson njeriun, e lodhë dhe ia shkatërron sistemin nervor.

Adepti, Franc Bardon, sqaron: Një i ri apo e re, i cili në mënyrë intensive masturbon, duke e paramenduar para vetes, me vizion psikik, një femër apo një mashkull, të cilën apo të cilin e zgjedh për “marrëdhënie seksuale”, ai i ri apo e re, dalngadalë, në botën mentale dhe astrale, fillon të formoj një elementar, i cili për çdo ditë shkon duke marrë formë dhe ushqehet nga ai person, i cili e bën masturbimin e rregullt dhe të përditshëm, duke menduar në atë fotografi të personit që i pëlqen për ”seks”. Kështu ky elementar femër apo mashkull fillon të marrë jetë dhe të bëhet i gjallë. Kur ta mbërrijë një shkallë të zhvillimit, ky elementar bëhet i vetëdijshëm dhe kërkon shumë e më shumë energji seksuale të masturbimit. Ky e detyron personin që të masturbojë edhe atëherë kur fare nuk ka nevojë, duke menduar në figurën e cila i sjellë kënaqësi. Kur elementari merr vetëdije, shkon dhe i paraqitet në ëndërr personit, me të cilin bën marrëdhënie seksuale të rregullta, duke ia marrë energjinë. Një ditë ndodh që personi të lodhet psikikisht dhe fizikisht, të humbë energjinë e jetës, nuk e ndjen veten mirë psikikisht dhe shpesh këta të rinj përfundojnë në psikiatri. Kurse ky elementar, tash i formuar si krijesë (prej këtyre personave), kur nuk ka më energji nga ai individ, shkon dhe lypë një person të ngjashëm, i cili lirohet me masturbim dhe fillon t’ia marrë energjinë pandërpre, derisa ta lodhë ose ta shterrë tërësisht. Më në fund, ky elementar bëhet si një dhampir, i cili ushqehet me energji

të ngjashme nga personat e ndryshëm. Shumë magjistarë të zinj i shfrytëzojnë këta elementarë për qëllimet e veta të errëta, si elementarët e seksit, të tërbimit, të hakmarrjeve etj. Ka magjistarë të bardhë, të cilët i zhdukin këta elementarë - i shpërndajnë, për t'i shëruar njerëzit.


Kam pasur disa raste shërimi të të rinjve pikërisht nga elementarët e tillë, të cilët kishin arritur në një shkallë shumë të lartë negative psikike dhe i urrenin femrat, meqë nuk mund të kishin marrëdhënie të mirëfilltë seksuale, përveç se të masturbonin.

HARRIMI I EMRIT PERSONAL E TË TJERA

“Asgjë nuk është rëndë, veç duhet të duash”

(Konfuqi)

Një nga eksperimentet me hipnozë ishte edhe prova që t’ia fshija emrin e vërtetë nga ndërvoja mediumit, i cili, pas këtij procesi, fare nuk e dinte emrin e vet të vërtetë. Kur ia ndërvoja emrin, pasi që emrin e vërtetë ia fshija përkohësisht nga ndërvoja, kur dilte prej hipnoze e thoshte emrin e ri, të cilin ia kisha regjistruar në gjendje hipnotike. Këso provash kam bërë edhe me shkronja e numra të ndryshëm. (Me anën e kësaj teknike munden të fshihen traumat ma të mëdha psiqike të përjetuar gjat



Pacienti duke i pastruar gjurmët e kancerit

(fotografoi: Salih Basha-mistik)

lufrave apo traumave familjare et.)

P.sh.: Shpendit, një herë, në hipnozë, ia fshiva kuptimin e numrit pesë dhe në vend të numrit pesë ia regjistrova emrin “lakër”. Ky proces zhvillohej në këtë mënyrë: Shpend, ti di të numërosh deri në dhjetë? - e pyeta Shpendin, i cili ishte në hipnozë. Po, tha Shpendi. Numëro, të lutem, njëherë deri në dhjetë. Shpendi numëroi deri në dhjetë. Tash, dëgjo mirë, Shpend: Fshije prej mendjes tënde numrin pesë; ai më nuk ekziston për ty. A e fshive? e pyeta. Po, tha, e fshiva; ai nuk ekziston më tek unë. Tash, në vend të pesëshit regjistroje fjalën “lakër”. A kuptove? Po, tha, kuptova. Mirë, Shpend, të lutem tash numëro deri në dhjetë. Po numroj, tha Shpendi, dhe filloi : Një, dy, tre, katër, “lakër”, gjashtë, shtatë, tetë, nëntë, dhjetë. Ishte shumë interesant. Numëro, të lutem, edhe një herë, i thashë. Shpendi të njëjtat fjalë i përsëriti si më parë. I thashë: Shpend, sa bëjnë $3+2$? Shpendi tha: “lakër”. Natyrisht se të pranishmit qeshnin me këtë anomali artificiale, të cilën ia kisha shkaktuar sa për eksperiment. Edhe kur e zgjova nga hipnoza dhe tashmë ishte në gjendje normale, nuk dinte të thotë numrin pesë dhe në vend të pesëshit thoshte “lakër”. Pasi që e hipnotizova edhe një herë, ia fshiva fjalën “lakër” dhe në vend të saj ia regjistrova përsëri numrin pesë. (Pshtjellimi psikik rrjedh kur të fillon të llogaris me numra me të mëdhej ku për të tjerët është jo normale, po mediumi kët fjalë të re e merr si normale, sepse njeriu flet ate çka e ndëgjön për herë të parë dhe e njejta fjalë i përsëritet me mija herë për të njejtin simbol siqë është fjala për numrin pesë të shëndrruar në lakër).

Eksperiment të ngjashëm kam bërë edhe në Mynhen të Gjermanisë. Në hipnozë ishte shoku Hamit dhe shokëve u thashë se Hamitit kam për t’ia fshirë emrin e vet, dhe ai, më, nuk ka për ta ditur që, ndonjëherë, e ka pasur këtë emër; sakaq, emrin e ri kam për t’ia lënë “Adem”!

E hipnotizova dhe në posthipnozë i thashë: Të lutem, trego si e ke emrin. Ai tha: e kam Hamit. Prej këtij momenti po fshihet emri yt i vërtetë dhe më nuk e ke emrin Hamit, por kjo ka për të zgjatur vetëm një orë. Mirë, tha. E pyeta se a e fshiu. Po, tha. A ke emër tash, e pyeta. Jo, tash jam pa emër. Prej këtij momenti, saktë një orë, ti e ke emrin Adem e jo Hamit; pas një ore ka për t'u kthyer emri i mëparshëm, si e ke pasur në të vërtetë. A kuptove tash si e ke emrin? Hamiti tha "Adem" e kam emrin. Mirë, tash, kur të numëroj deri në tre, ke për t'u zgjuar nga hipnoza. Një, dy, tre... tash je zgjur. U zgjua Hamiti me emër të ri. E luta një shok që ta thërriste në emrin e vërtetë, si e ka pasur; e thirrte në emër: o Hamit, o Hamit, ai nuk përgjigjej. E thirri edhe një shok tjetër në atë emër, po ai nuk u përgjigj. I thashë shokut që ta thirrte në emrin e ri. Hamiti u përgjigj dhe tha: Urdhëro, çka po don? E pyetnin të tjerët sesi e kishte emrin, ai përgjigjej "Adem"; i tha njëri: A s'e ke emrin Hamit? Jo, more, çfarë Hamiti, kush po të thotë se e kam emrin Hamit? iu drejtua shokut me seriozitet Hamiti. Kuptohet se të gjithë qeshnim kur mendohej të na bindte për emrin e ri, që gjëja e ka pasur përgjithmonë. Çka po qeshni? Adem e kam emrin, thoshte me bindje edhe më tutje, dhe nervozohej që ne kinse donim t'ia ndërronim emrin.

Si kaloi një orë, e luta një shok që ta thërriste shokun Hamit "Adem". E thirri, po Hamiti nuk përgjigjej, veç shikonte se kë, tjetërkë, po e thirrte. Tash thirre në emër të vërtetë, i thashë shokut afër meje. Kur e thirri: Hamit! ai u përgjigj: He, bre, pse po më thirrni gjithnjë. Shoku e pyeti: A s'e ke emrin Adem? Jo, more, çfarë Ademi; kush po të thotë? Unë kurrë nuk e kam pasur emrin Adem. Kuptohet të gjithë qeshëm me zë.

Një natë shkuam me vëllanë, Qazimin, te shoku Ismet Aliu e te daja i tij, Mehmet Kokaj. Biseduam për shumë gjëra, madje edhe për parapsikologji e hipnozë. Dikur ra fjala

për bindjet tek njerëzit. E dija se çfarë bindjesh kemi në ndërdije, ashtu e shohim dhe e shijojmë botëm fizike. Pa ekzistuar bota fizike në ne, atë as në materie nuk e shohim; po ashtu, pa ekzistuar një person në ne, as në materie ne nuk e shohim. Sikur një send të fshihet në botën tënde të brendshme, për ty nuk ekziston më ai send në materie dhe fare atë nuk e sheh, edhe po ta kesh para hundës; edhe pse ekziston për të tjerët, për ty nuk ekziston fare.

Iu tregova, pastaj, një rast sesi kisha bërë eksperiment me një medium në Prizren. Këso provash kisha bërë shumë. P.sh. Një mediumit ia pata fshirë prej mendjes të gjitha objektet që ishin në atë dhomë, duke përfshirë këtu edhe njerëzit. Ia kisha lënë të shihte vetëm një jastëk ngjyrë të kaltër dhe vetëm zërin tim ta dëgjonte. Kur doli nga hipnoza, e ndjente veten të vetmuar në atë dhomë. E luta një shok që ta merrte atë jastëk të kaltër, ta ngritte lart dhe të ecte me të nëpër dhomë. Mediumi filloi që me sy ta përcillte, i habitur, jastëkun kah lëvizte. E pyeta se ç' ishte ajo që po shihte e po habitej. Pyeti me habi sesi ishte e mundur që jastëku të fluturonte lart nëpër ajër, vetë! E luta shokun që, mediumit, t'ia ofronte jastëkun afër kokës dhe ta ndiqte me të nëpër dhomë. Mediumi ishte zgjuar, por filloi të frikohej dhe më pyeti se çka kishte ky jastëk që po e ndiqte nëpër dhomë atë. Pas pak, e qetësova dhe e hipnotizova përsëri; ia hoqa frikën dhe e solla në gjendje normale, ku i sqarova gjithçka që kishte ndodhur.

Shokët në dhomë nuk besonin sa duhet për këso gjërash; për ta ishte apsurde një gjë e tillë; ata lypnin fakte të drejtpërdrejta. U thashë: Mirë, nëse lejon Rexha ta hipnotizoj, se ky është medium i mirë, atëherë do të shihni vetë. Rexha pranoi që të punoja me të.

Në hipnozë Rexhës i thashë që t'i çilte sytë dhe të na shihte saktë të gjithëve, ashtu si ishim në realitet. Kjo metodë ishte një lloj autohipnoze që e përdori në raste të rralla e të

veçanta. E luta Rexhën që të na numëronte të gjithëve dhe të na thirrte në emër. Rexha herën e parë kundërshtoi, se iu duk pa kuptim kjo gjë. Por e luta të bënte si i thoja dhe të më ndihmonte, se isha duke bërë një provë që shokët të bindeshin për diçka. Rexha filloi t'i numërojë dhe tha: Të gjithë ju, me gjithë mua, jemi shtatë vetë. Mirë, Rexhë, i thashë, shihe ku po qëndron Ismeti. Po, po e shoh; ja, atje! dhe tregoi me gisht kah ai. Mirë, tash mbylli sytë! Rexha i mbylli. Shikona tash edhe një herë të gjithëve, me shikim shpirtëror. E pyeta se a i shikoi të gjithë, edhe veten. Po, tha Rexha, i shikova të gjithë, edhe veten, jemi shtatë veta. Tash prej mendjes tënde fshije Ismetin, mos të ekzistojë më. Tash ai nuk ekziston më për ty. Dhe e pyeta se a e fshiu. Po, e fshiva, tha. Mirë, tash, kur të numëroj deri në tre, ti ke për t'u zgjuar nga hipnoza. Një... dy... tre... Zgjohu, dhe do të jesh normal, si çdo herë. Tash je zgjuar, me vetëdije normale, si çdo herë. Rexha doli pa problem prej hipnoze. Të tjerët pritnin me kureshtje të madhe se a do të realizohej kjo; kurse unë, natyrisht, se e dija saktë se kjo veç ishte realizuar. E pyeta edhe një herë Rexhën se a ishte mirë. U përgjigj se ishte shumë mirë. "Mirë jam, Salih, çka po më pyet shumë herë?" u përgjigj Rexha me një nervozë të lehtë. E pyeta se a po na shihte të gjithëve në dhomë. Po, të gjithëve po ju shoh, se nuk jam qorruar, u përgjigj ai, prapë pak me nervozë të lehtë. Të lutem, Rexhë, mos prito dhe tregona sesa veta jemi në dhomë. Edhe këtë herë kundërshtoi, se i dukej pa kuptim që e pyesja shpesh për gjëra të njëjta; mandej, t'i numëronte shokët në dhomë... E luta përsëri që të mos pritonte e të na numëronte të gjithëve, edhe veten, e të na tregonte me emër: Kush e sa veta ishim në dhomë. Rexha filloi të numëronte dhe tha: Të gjithë, me gjithë mua, jemi gjashtë vetë. I thashë: Mirë, Rexhë, numëroj edhe një herë dhe trego me emra. Ishte shumë interesant: Duke i numëruar e duke ua thënë emrat, Ismetin fare nuk e shikonte. Shikimi i Rexhës, kah Ismeti, ishte i zbrazët; edhe

pse Ismeti ishte në të njëjtin vend. I thashë: Mirë, pse nuk e numërove Ismetin, ti harrove për ta numruar atë dhe nuk ia the emrin. Rexhë, shiko më mirë! Ismeti është para teje e ti nuk po e sheh! Shiko mirë, të lutem, edhe një herë. Jo, more, u përgjigj, si nuk po e shoh! Ai nuk është këtu! Ka qenë më parë, po tash nuk është më këtu... Rexha fliste me bindje se Ismeti nuk ishte më aty, edhe pse Ismetin pikërisht para hundve e kishte.

U thashë shokëve, se një gjë kur nuk ekziston brenda nesh, as jashtë nesh, për ne, nuk ekziston. Çfarë bindjesh kemi brenda në ne, ashtu e shohim edhe botën materiale dhe i krijojmë ngjarjet dhe realitetin tonë, si pozitiv ashtu edhe negativ, në botën fizike. Si ta shohësh botën në ty, ashtu është edhe bota për ty. Nëse mendon veç keq, ti botën nuk mund ta shohësh mirë; nëse mendon pozitivisht e mirë, ashtu për ty është edhe bota e mirë. Shokët u bindën në masë të konsiderueshme për këto, pas kësaj që panë sonte me Rexhën, të cilin, më vonë, e ktheva prapë në hipnozë dhe e kthjella për ta parë Ismetin si më parë, në mënyrë reale, siç e shihte më parë.

I DEHUR ME UJË TË ZAKONSHËM

“Balta margaritarin mund ta përlyejë, por nuk mund ta shndërrojë atë në baltë”

(Konfuqi)

Një ditë, shoku, Ismet Aliu, më lajmëronte në telefon, se miku i tij, Jakupi, i cili banonte në periferi të Pasaut të Gjermanisë, do ta bënte djalin synet dhe na ftonte të merrnim pjesë në festë. Unë banoja në Mynih; po ashtu dhe shoku Ismet me familje të ngushtë. Dita ishte e caktuar për të shtunen e parë që do të vinte, kështu që këtë ditë, Ismeti me të shoqen dhe dy fëmijët dhe unë, me kerr të tij, u nisëm për Pasau, për te Jakupi.

Te Jakupi ishin mbledhur shumë shokë dhe miq të tij. Ishte krijuar një atmosferë e bukur. Dikur vonë filloi disi të bie disponimi. Kështu, Ismetit, iu kujtua një ide dhe u ngrit në këmbë e, pa lejën time, filloi të flasë në emrin tim për mua. Po ua prezentoj shokun, Salih Basha, i cili është parapsikolog, hipnotizues dhe merret me shërimin e njerëzve. Unë nuk kisha dëshirë që të prezentoheja para një mase të tillë të madhe, ndaj e luta Ismetin që të heshte; po ai nuk u ndal dhe vazhdoi të flasë. Tha: Gjërat që i di dhe i punon shoku, Salih Basha, janë shumë interesante, ndaj kush ka të pyes diçka lidhur me magjinë e zezë, hipnozën, shërimin, etj., le të pyesë lirisht; ky është i gatshëm t’ju përgjigjet. Dikush, pas pak, më pyeti se çka është hipnoza, ç’ do të thoshte kjo, se nuk po ia dinte kuptimin. U shpjegova se ç’ është hipnoza, çfarë roli luan në jetën e njeriut, çka mund të bëjë njeriu me të, çka mund të shërojë hipnoza etj. Dikush pyeti për magji të zeza se a ekzistojnë me të vërtetë. Iu thashë se magjia e zezë ekziston pavarësisht se u besojmë apo nuk u besojmë ne; dhe tërhoqa vërejtjen se kjo është një temë e veçantë, e cila do

shpjegim të gjatë. Një djalosh rreth 25 vjeçar u ngrit, erdhi afër meje dhe më tha se ai me të vërtetë besonte në magji të zezë e në hipnozë. Unë kam pasur me vite probleme psikike. Kam përjetuar gjëra të cilat nuk mund t'i përshkruaj. Medicina asnjë sëmundje në trupin fizik nuk ma ka gjetur. Kam qenë gjatë në psikiatri dhe, që të më shëronin, më kanë hipnotizuar dhe kanë bërë shumë hulumtime me mua, por as në këtë mënyrë nuk kanë mundur të më shërojnë dhe prapë kam mbetur i sëmurë psikikisht; edhe pse e kanë përdorur hipnozën. Para gjysmë viti kam qenë në Kosovë te një sheh i Ravecit, i cili, kur më ka parë se në çfarë gjendje isha, ma ka shkruar një hajmali që ta baj kudo me vete dhe kështu kam ardhur në vete dhe jam shëruar; deri më tash ende nuk m'u ka lajmëruar ajo llahtari e madhe që kam pasur me vite; i vetmi problem që kam është kokëdhimbja dhe atë mbrapa koke.

Dikush pyeti se a të ndihmojnë hajmalitë. Po, u thashë, nëse bëhen prej personit të dijshtëm, i cili di si t'i mbushë ato. Dikush pyeti se çka duhet bërë që hajmalia ta ketë atë fuqi shëruese. Iu thashë: ja, si p.sh. shehu i Ravecit, i cili e ka shkruar një hajmali të fuqishme dhe e ka shëruar shokun e, ndoshta, edhe shumë të tjerë, nga magjijtë e zeza. Hajmalia mbushet me shkrime të Kur'anit dhe varësisht prej rastit të personit shkruhet edhe lutja në të. Ka persona në botë që përveç hajmalive i mbushin edhe talismanët, të cilët kanë fuqi shumë më të mëdha se hajmalitë; se mbushen me rituale speciale, si nga Kur'ani i shenjt, Bibla e shenjtë, ashtu edhe nga librat tjerë, të shenjtë, si Tivrati dhe Zeburi; e po ashtu mbushen edhe me rituale të shumta të shumë besimeve të ndryshme në botë. Ka talismanë që mbushen me fjalë të fshehta, që mbahen sekret nëpër shumë sekte të ndryshme botërore. Talismani, i cili mbushet me dije speciale dhe me rituale speciale, bën ndryshime të jashtëzakonshme te personi, po ashtu mundet dhe në tërë shoqërinë ku gjendet ai.

Personat, të cilët janë të sulmuar nga magjitet e zeza, psikiatria nuk mund t'i shërojë, se, së pari, ajo këtyre gjërave fare nuk ju beson. Magjia e zezë bëhet në botën fizike, astrale dhe mentale. Shehu, ta zëmë, i njeh mirë këto gjëra; ai është qartëpamës, i cili sheh në nivele të tjera jofizike, ndaj e di përnjëherë se çka ka personi dhe çka duhet shkruar nga Kur'ani që t'i neutralizojë energjitë negative që dikush ia ka dërguar personit të caktuar. Shehu merr një letër, ku shkruan ose fryn ndonjë dovë a sure nga Kur'ani i shenjtë, duke e lutur Zotin që personit të caktuar t'ia heqë atë të keqe. Këto sure kanë fuqi të jashtëzakonshme për zhdukjen e së keqes në shpirtin e njeriut. Tash kjo hajmali mbushet me energji të fuqishme të sures kuranore kundër energjive të këqija dhe, pastaj, kjo, posa të bie në kontakt me personin për të cilin është shkruar, vetvetiu i neutralizon ato ndikime të dëmshme dhe personi, ndodh menjëherë, apo më vonë, lirohet nga ato magji të zeza. Personi e bartë me vete atë hajmali derisa të bëhet imun ndaj atyre sulmeve magjike dhe, pastaj, lirohet prej tyre. Ndodh që personi e harron hajmalinë, e lë jashtë trupit, dhe prej atij momenti fillon ta sulmojë magjia e zezë; këto nuk janë hajmali të forta, se hajmalia e fortë të mbronë edhe nëse nuk e bartë me vete. Talismani është i këtillë.

Pse ndodh kjo që personi prapë të sëmuret? Personi derisa e ka hajmalinë me vete, nuk sëmuret, por posa ta largojë apo ta harrojë atë, prapë sëmuret! Këtë e di shumë mirë, sepse magjia e zezë, që është programuar për ta sëmurë një person, ekziston ende në vendin e fshehur dhe ajo, në mënyrë intensive, ndikon tek personi, mbi të cilin, si ndonjë central, lëshon rreze të dëmshme; ato i dërgohen në vazhdimësi personi të dedikuar. Kjo ndodh derisa personi nuk ka mbrojtje; posa ta marrë mbrojtjen, personi qetësohet, sepse rreth trupit astral bëhet një mbrojtje e padukshme për syrin e njeriut; kurse për sytë astralë të qartëpamësit është plotësisht e dukshme. Derisa të mos gjendet se ku është i fshehur

burimi i rrezatimit apo magjia e zezë, personi ka për të qenë nën ndikim të saj të vazhdueshëm, varësisht nga programimi i magjisë. Posa të gjendet magjia e zezë, personi lirohet nga ajo. Mirë është që njeriu të bëjë mbrojtje të përhershme nga magjitet e zeza, qoftë përmes hajmalive apo talismanëve.

Ky person që besonte në magji dhe në hipnozë kërkoi që t'i ndihmoja për t'ia shëruar kokën. E hipnotizova dhe, menjëherë, ia hoqa dhimbjen nga koka. Shoku Ismet kërkoi që të punoja me këtë person diçka tjetër, që të tjerët të shhnin se çfarë fuqie ka hipnoza. Ismeti më luti që këtë person ta dehja me ujë të zakonshëm. Të pranishmëve iu shpjegova shkurtimisht se çfarë fuqie ka ndërdija e njeriut. Iu thashë se kur diçka i urdhërohet ndërdijes, sidomos kur personi është në gjendje hipnotike, ai urdhër, edhe në qoftë se fare nuk ka logjikë, ndërdija atë e kryen pa problem. Duke punuar, unë fare nuk e kisha vërejtur që shoku Ismet po incizonte me kamerë.

Këtë djalosh e hipnotizova dhe e futa në hipnozë të thellë; pastaj, fillova të pyes: A ke pirë ndonjëherë alkool?! Po, u përgjigj, kam pirë. Po a ke qenë ndonjëherë i dehur nga alkooli? Po, kam qenë i dehur; u përgjigj thjesht. Pra, ti, po e ditke saktë se çka do të thotë dehje nga alkooli. Unë tash kam për ta dhënë një gotë alkool, shumë të fortë, i cili ka për të dehur menjëherë, dhe do të jeshë shumë i dehur; as nuk do të mund të flasësh si duhet, as të ecësh, as nuk ke për të ditur mirë...

Në këtë moment, mora një shishe me ujë mineral, të cilën ua tregova të gjithëve, që të shihnin se me të vërtetë ishte ujë e nuk ishte alkool i vërtetë. Pastaj, mora një gotë të zbrazët dhe qita pak ujë në të, të cilin përsëri ua tregova të tjerëve, për ta vërtetuar se ky ishte vërtet vetëm ujë e asgjë tjetër. I thashë mediumit të çilte sytë e të merrte këtë gotë me alkool shumë të fortë. Posa ta pishë këtë gotë, ke për t'u dehur plotësisht dhe mezi ke për të folur e për të ecur. Pije! e

urdhërova mediumin. Posa e ofroi gotën, me ujë, në gojë, tha, duke rrudhur fytyrën: Qenka raki e fortë, bre, dhe dukej sikur nuk po mund ta përbinte prej fortësisë. E përpiu me vështirësi ujin dhe tha përsëri: Qenka me të vërtetë raki e fortë... Dhe filloi të luhatej, sikur i dehur totalisht. E pyeta: ç’ke që po luhatsh ashtu? Tha, duke belbëzuar: Jam dehur dhe nuk po e ndjej veten, mezi po qëndroj në këmbë. Kurrë në jetën time më shumë nuk jam dehur; çfarë rakije ishte kjo, bre?! I thashë, duke qeshur: Është “raki rrushi” e bodrumit të Suharekës... ku gjithë të pranishmit qeshën, gjithnjë të habitur sesi ishte e mundur që njeriu me ujë të dehej. I thashë se kur do të numëroj deri në tre, ti ke përt të dalur nga hipnoza; numërova dhe mediumi u zgjua plotësisht; menjëherë fillova bisedën me të; e pyeta: çka pate, bre burrë, që u dehe aq shumë? Tha: Ma ke dhënë një gotë raki të fotrë dhe kur e kam pirë, jam dehur aq fort, sa kurrë nuk kam qenë më i dehur në jetën time. E mora shishen me raki rrushi, që ishte mbi tavolinë, e mbushur deri në gjysmë; e pyeta mediumin: A ishte kjo rakia e fortë, e cila të dehu menjëherë? Mediumi u përgjigj me një ton serioz: Jo, more, çfarë! Këtë raki e kam pirë përditë, po kjo nuk më ka dehur... Ajo tjetra ishte raki shumë e fortë, që e piva më parë. Mediumi u ngrit në këmbë dhe shkoi e mori shishen me ujë mineral, me seriozitetin më të madh, duke u munduar të na bindte se me të vërtetë ishte ajo që e kishte dehur. Të gjithë qeshnin me zë të lartë, kur mediumi, me shishe të ujit mineral në dorë, mendohej të na bindte, të gjithëve, se kjo ishte “rakia e fortë” që e kishte dehur më parë.

E hipnotizova drejtpërdrejt edhe një herë dhe mora një gotë të zbrazët e ia dhashë mediumit në dorë, duke i thënë: Kjo gotë është me një ilaç, të cilin, posa ta pish tërësisht, ke për t’u kthjellë, ka për të dalur dehja plotësisht dhe ke për t’u zgjuar normalisht, si çdo herë deri më tani. E mori gotën e zbrazët dhe filloi “ta pinte”... Dhe, si e piu, tërësisht, mori

frymë lirisht dhe tha: ”Eh, shyqyr që u shpina se isha shumë i pitë”!

Pas këtij gjesti, nxora mediumin nga hipnoza, pasi që, më parë, i dhashë sugjestionë pozitive. Personi u zgjua i kthjellët dhe i disponuar. Të pranishmit filluan t’i bënin pyetje provokative: Si, bre burrë, u dehe me ujë?! Ai thoshte: Çfarë uji, bre burra, po a e dini se çfarë rakie të fortë kam pirë!... Natyrisht, të gjithë qeshnin, meqë e kishin parë se ai vetëm ujë kishte pirë, e jo raki të fortë. Po mediumi kurrësi të bindej për ato që të tjerët i thonin. Tash mora të njëjtën shishe, me ujë mineral, për të cilën, më parë, mediumi kishte pohuar se kjo ishte “rakia e fortë” që e kishte dehur. Por, tash, mediumi, me bindje, thoshte: Jo, mor burrë, kjo shishe është me ujë mineral... Jo, kjo ishte ajo rakia që e kam pirë, ja, kjo... e tregoi tash shishen me “Llozë”. Të pranishmit e kapën barkun duke qeshur.

Kështu filloi një luftë e padukshme në mes të mediumit dhe të pranishmëve në dhomë, të cilët mundoheshin ta bindnin njëri-tjetrin për “të vërtetën” e tyre. Mediumi filloi të bie në një konfuzion, në një habitje me vetveten; filloi të mendonte se kishte filluar të çmendej dhe unë, duke e vërejtur shpejt këtë rrezik, i këshillova të gjithë që ta bindnin mediumin për atë çka vërtet kishte ndodhur në hipnozë. Fillova t’i flas qetas dhe i thashë që të mos brengosej fare, se unë vetëm kisha bërë me të një eksperiment. E vërteta është se unë të kam dhënë ujë mineral e të kam sugjestionuar në ndërdije se ky ujë është raki shumë e fortë që posa ta pish, ka për të dehur aq shumë, si kurrë deri më tash në jetën tënde. Ne tërë rastin e kemi incizuar me kamerë dhe ti vetë ke për ta parë si ka ndodhur në të vërtetë. Pastaj, vazhdova që t’ua shpjegoj të gjithëve, edhe mediumit, domethënien e këtij eksperimenti: Ky eksperiment i përngjan magjisë së zezë, por në këtë rast ne jemi marrë vesh në mes veti të të deh me ujë; dhe unë i kam dhënë urdhër ndërdijës

tënde që, posa ta pish këtë ujë, të dehes me të vërtetë, sikur të pije alkool të vërtetë, me përqindje të lartë alkooli. Të njëjtat gjëra magjistarët e zinj i bëjnë me magji të zezë, po në mënyrë të tërthortë. Unë magjitet e zeza i quaj "virues artificiale mentale". Kur magjia programohet për një qëllim të caktuar, duhet që atë program t'ia ofroni afër trupit të personit të caktuar, në mënyrë që aura e tij ta përpijë në vete; e këtë e bën pa vetëdije ndërdija e personit të dedikuar; këtë urdhër mental të fortë ndërdija e personit të dedikuar, posa ta pranojë në vete, fillon aty për aty ta zbatojë në praktikë, dhe personi sëmurët (në qoftë se është magji e zezë) aty për aty ose më vonë; kjo ndodh varësisht nga magjia që është bërë: me çfarë qëllimi, me çfarë force dhe me çfarë dije. Magjia e zezë hiqet njëjtë prej ndërdijes, siç unë të dhashë urdhër që të zhdehes; thjesht, pastrohet aura nga sulmi dhe bëhet mbrojtja e mëtutjeshme kundër magjive të zeza, forcohet imuniteti ndaj tyre.

Ty, kur të kanë bërë magji, ndërdija të ka sëmurë; mjekët për këto gjëra fare nuk besojnë dhe nuk mund t'i shërojnë njerëzit; për këtë arsye edhe ti ke mbetur deri vonë pa u shëruar. Por, kur ke shkuar te shehu i Ravecit, i cili drejtpërdrejt ka parë se ku është problemi yt dhe me ç'dovë shërohes, pra cila dovë e shkatërron atë magji, ai ta ka dhënë hajmalinë që ta bash me vete. Si t'u ka futur ajo energji, tash pozitive, në aurë (qarku energjitik), ndërdija jote e ka pranuar dhe menjëherë ka filluar pastrimin e urdhërit negativ (magjisë së zezë) dhe ti ke filluar të shërohes, si unë kur ta dhashë një gotë me "ilaç" dhe ti u zhdehe menjëherë; a më kuptove tash? Po, tha, plotësisht po të kuptoj, po të besoi; tash jam plotësisht i qetë dhe i lumtur se paska dikush që di t'i heqë magjitë e zeza dhe t'i shërojë njerëzit në këto kohëra. Magjia e zezë shërohet edhe me hipnozë.

Ismeti e lëshoi kamerën në TV që të shihnim, prej fillimit, se çka kishim bërë gjatë hipnotizimit; dhe, prapë, si

prej fillimit, filloi ai interesimi dhe qeshja me zë të lartë e me gëzim; kjo, për të gjithë, ishte shumë interesat, për mua ishte gjë normale dhe thuaja e përditshme.

Kam pasur rast tjetër, më parë, kur një person të dehur me të vërtetë me alkool, e kam hipnotizuar dhe, me një gotë ujë të zakonshëm, e kam zhdehur plotësisht, i cili pas hipnozës ka ecur dhe ka folur plotësisht normal.

Fuqia e ndërdijes është shumë e madhe, me mundësi thuaja të pakufishme. Në bazë të eksperimenteve, që kanë bërë, shumë shkencëtarë dhe hulumtues të hipnozës thonë se hipnoza dhe fuqia e ndërdijes bëjnë mrekullira. E kanë marrë një medium para hipnotizimit dhe e kanë matur në peshore: ai ka pasur 66 kg. peshë fizike. Në hipnozë i kanë sugjeruar se, tash, ka për t'i pirë dy litra ujë të zakonshëm dhe në dorë i kanë dhënë një shishe plotësisht të zbrazët njëlitërshe. Mediumi është deklaruar se po e pi ujin dhe këto janë dy litra ujë të zakonshëm. Pasi që është kryer eksperimenti, mediumin e kanë nxjerrë prej hipnoze dhe e kanë matur përsëri në peshore, ku, për çudinë e të gjithëve, pesha trupore i është ngritur për dy kg.; pra, ka peshuar plot 68 kg. Pastaj, i ka urinuar dy litra urinë. Këtë eksperiment e kanë përsëritur disa herë, ka dalur i njëjti rezultat.

Kam pasur eksperimente, ku mediumit (në gjendje hipnotike) ia kam forcuar dorën aq sa, pasi ka dalur nga hipnoza, askush nuk ka mundur t'ia thyejë dorën, deri në një kohë të caktuar. Këtë eksperiment e kam bërë me Sokolin, të cilin e thirrnim Kolë; ishte vëllai i shokut, Sabir Krasniqi.

Ishim te shoku, Sabir Krasniqi, ku shpesh bënim eksperimente të tilla. I thashë shokut Sabir, se do ta bënim një eksperiment me Kolën. Me të bënim shpesh eksperimente, se ishte medium shumë i mirë. E pyeta Kolën, i cili në atë kohë ishte i ri, se a dëshironte që t'ia bënim dorën të fortë, që askush të mos mund t'ia thente. Në atë kohë për të ritë ishte në modë që t'i rroknin duart dhe të tregoheshin se cili i kishte

duart më të forta. Kola tha me gëzim të madh: po, dhe na luti që t'ia lenim dorën ashtu “të fortë” për kohë sa më të gjatë. Në gjendje hipnotike i dhashë sugjestionin posthipnotik se kjo fuqi kishte për t'i zgjatur vetëm një orë, e pas një ore, do të ishte normal, siç ka qenë më parë. Nuk kisha guxim t'ia lija më gjatë posthipnozën, meqë nuk dija se çka do të mund të ndodhte, nëse unë nuk do të isha me të. Programimin posthipnotik e bëra kështu: I thashë se, posa të delë prej hipnoze, ne qoftë se dëshiron ta rrokë dorën e djathtë me dikë, spontanisht ka për t'i ardhur një fuqi jashtëzakonisht e madhe në dorën e djathtë, si një ngjyrë e kuqe, dhe ka për t'ia forcuar krahun aq shumë, sa që nuk do të mundet kush, gjatë asaj kohe, t'ia thyejë krahun e djathtë, pavarësisht nga fuqia që posedon. Pra, si ta kapësh dorën e tjetrit, i thashë, në ty ka për t'u aktivizuar kjo forcë e madhe, në krahun e dorës së djathtë, sa nuk do t'ia delë të të mund kush. Para se të punoja me Kolën, e provova sesa i fortë ishte dhe e kuptova se ky ishte i ri, të cilit lehtë mund t'i rrëzohej dora pa problem. Pastaj, pas sugjestionit posthipnotik, e nxora nga hipnoza dhe i thashë: Kolë, a i rrokim duart tash? Po, kur të duash, tha Kola, dhe zgjati dorën mbi tavolinë. Por, për çudi, si ia kam kapur dorën Kolës, as që kam mundur t'ia lëviz nga vendi; ai, si të ishte ndonjë gjigant, ma rrëzoi dorën, duke qeshur; nuk më dha fare afat; fuqia ime për të ishte një asgjë. Ia kapa dorën e djathtë me të dy duart e mia, po prapë, të dy duart m'i rrëzoi shumë lehtë. Erdhi shoku Sabir dhe mbi duart e mia i qiti të vetat dhe i dhamë me sa fuqi patëm, të dytë, po nuk mundëm as prej vendit t'ia lëkundnim dorën e tij të fuqishme. Ia lëshuam dorën, por Kola me gëzim krenohet dhe na provokonte: ejani, ejani, provojeni fuqinë! Nuk ka kush që mund të ma thyejë dorën! E provuam me shokun Sabir edhe një herë, por pa kurrfarë suksesi. Ishte në dhomën tjetër një djep i vjetër nga metali, shumë i rëndë. Sabiri i tha Kolës: Provoje këtë djep, a ke për ta ngritur! E ngriti djepin, si të

ishte prej letre, kurse ne mezi e ngritnim. Kola klithte: Unë jam njeriu më i fortë në botë, ejani kush do ta rrokë doren me mua! Nuk ka njeri që mund të ma rrëzojë dorën time!

Ishte afruar momenti kur duhej të bëhej një orë. E shikojta orën time, duke e ditur se ndërdisa saktë, me sekonda, e zbaton urdhrin e hipnotizuesit. U bë një orë e plotë dhe i thashë Sokolit: Kolë, eja tash se dua t'i rrokë duart. Ai me gëzim tha: Po, more, eja i rrokim. Kola nuk e dinte se deri në këtë moment kishte vepruar sugjestionin posthipnotik, që ai ta kishte dorën "të fortë". Siç mund të nënkuptohet, dorën ia rrëzova pa kurrfarë problemi; se tash ishte Sokoli i mëparshëm, me forcë normale. Kola habitej sesi ishte e mundur, që, pak më parë, të dytë, me tërë forcën, nuk arrinin t'ia rrëzonin dorën, kurse tash, vetëm unë ia rrëzoja...

Me shokun Sabir e nxitëm që të provonte atë djepin e rëndë, të cilin, pak kohë më parë, e kishte ngritur si të ishte prej letre. E provoi, por më kot: nuk mund ta lëkundte fare nga vendi. Ia shpjegova fenomenin se çfarë mundësish dhe fuqish kishte ndërdisa.

SI E REGRESOVA LULEN DERI PARA LINDJES

*“Ari e ka çmimin e vet, kurse çmimi i dijes është i
pallogaritshëm”*

(Quang Ce)

“Vera nuk e deh njeriun, por njeriu e deh veten”

(Konfuqi)

Motra, Luljeta, kishte disa probleme me një lloj frike të padukshme në vete. Jam munduar t’ia zbuloj atë frikë, në mënyrë që të lirohej prej saj. Pasi që e bëra hulumtimin me hipnozë nëpër vite, derisa e kishte një vit, e pashë se ai lloj frike nuk ekzistonte tek ajo; kjo ishte - *frika për humbjen e vetvetes*. M’u kujtua se kishte mundësi ta këtë bartur këtë lloj frike nga ndonjë jetë tjetër, ose ndoshta kur ka qenë në bark të nënës.

Lulen fillova ta regresoj, duke i thënë se ajo, tash, po shkonte duke u bërë gjithnjë e më e re dhe gjithnjë e më e vogël. Kur e solla deri në një vit, e pyeta se ku gjendej në këtë moment. Më tha se tash e kishte nëna Zarë në krah dhe po luante me gëzim të madh me të; është shumë e lumtur që më ka mua vajzë. Tash po frikësohem, se nëna po më gjuan në ajër e unë po frikësohem mos po i bie nga dora. I thashë se tash ke për t’u bërë gjithnjë e më e vogël; tash i ke 8 muaj; po bëhesh edhe më e vogël, tash i ke 1 muaj; po bëhesh edhe më e vogël... Sa muaj i ke tash? e pyeta. Ajo tha: E kam vetëm një muaj. Si po të duket bota e materies në këtë moshë, si fëmijë njëmuajsh? e pyeta përsëri. Po shoh tepër dritë, nuk po mundem t’i dëgjoj zëret e të rriturve, kur po bërtasin; po ashtu, kur po më qesin në diell, nuk po mundem ta duroj këtë dritë të fuqishme. Sakaq, kur po më kapin të rriturit, kur unë

jam cullak, po më shkaktojnë dhembje, e unë po qaj; po ashtu nga, kinse dashuria, po më bijnë shuplaka dhe po më shkaktojnë dhembje e tronditje në kokë. Nganjëherë po mundohen të më japin ushqim me zor, kurse unë po detyrohem ta vjellë. Të rriturit po kanë shumë mendime të këqija, të cilat unë, të gjitha, po i ndjej. I thashë: Lule, ke për të shkuar mbrapa deri në çastin, kur e ke ndier rrezikun për mosekzistencë dhe atë deri në bark të nënës. Tash u ktheve, je në bark të nënës Zarë; si po e ndjen veten? e pyeta. Keq, tha Lulja, po e ndjej veten duke m'u dridhur trupi (i rritur) fizik. Pse po e ndjen veten keq, Lule? Çka je duke ndier e parë që po e ndin veten keq. Nëna Zarë po qan, tha Lulja, duke u dridhur. Të lutem, Lule, trego tërësisht si është puna me nënën Zarë. Lulja vazhdoi të folurit me emocione të frikës.

Nëna Zarë është shtatzanë me mua. Kjo nuk po e di sakt në jam vajzë apo djalë. Meqë ka bërë shumë fëmijë, lokja Xhemile dhe baba Rasim po i thonë ke bërë mjaft fëmijë dhe po i rekomandojnë ta heqë fëmijën që ka në bark; po e qesëndisin dhe lloj-lloj fjalësh të këqija po i thonë. Po e detyrojnë të shkojë te mjeku e ta lë terminin për ta hequr fëmijën. Po nëna nuk po ka dëshirë të më heqë, po ka qejf të më lindë, e po thotë ishalla është vajzë. Shpirti i saj po i tregon të vërtetën, po kjo nuk po beson me mendje. Tash nëna me lot në sy po niset për te mjeku, por zemra po i thotë e ke vajzë. Të gjitha këto ndjenja edhe unë po i përjetoj plotësisht; edhe unë po kam frikë mos po më aborton, se mua më duhet të lind në këtë kohë, se e kam një punë shumë të rëndësishme ta kryej për njerëzimin. Nëna Zarë erdhi te mjeku dhe me lotë në sy po pret jashtë, fare nuk po don të hyjë brenda te mjeku. Po pret, por, ndërkohë, vendosi t'i gënjej vjehrrinë, kinse mjeku nuk ka qenë aty. Tash u kthye e lodhur në shtëpi, ku menjëherë filluan t'i bërtasin (lokja Xhemile dhe baba Rasim) pse nuk është interesuar më tepër për ta hequr fëmijën. Në këtë moment, po vjen nga puna baba

Azem, i cili punon si rojtar i pyjeve dhe po e sheh nënën Zarë duke qarë; në këtë çast po e pyet se çka ka që po qanë. Nëna Zarë po i thotë se prindërit e tij, Xhemilja dhe Rasimi, po i thonë që ta abortojë fëmijën që ka në bark. Kur ndjeu ai këto fjalë, i tha nënës Zarë se kurrësi nuk guxon ta abortojë fëmijën; “edhe po i bëre 20 fëmijë, asnjë nuk guxon ta abortosh”-po i thotë. Nëna Zarë u gëzua pa masë dhe ka dëshirë ta përqafojë babën Azem, po nuk e lë marrja!!!. Po ashtu, edhe unë u gëzova shumë që shpëtova pa më abortuar.

Me këtë përjetim Luljetës iu hoq frika që kishte, *frika për mosekzistim*.

Këto fakte asnjëri nuk i kemi ditur, as unë, as Lulja; më vonë, kur e kemi pyetur babain, atij i kujtohej shumë mirë ajo ditë; të gjitha që i tha Lulja në hipnozë për veten, si bebe në bark të nënës Zarë, ishin plotësisht të sakta.

Shumë hulumtues e kanë vërtetuar se, edhe pse fëmija gjendet ende në barkun e nënës, ai di, dëgjon dhe sheh (me sy eterik) çdo gjë që ndodh rreth vetes, dhe të gjitha i mban mend. Disa shkencëtarë japonezë kanë bërë këtë eksperiment: Një nëne, e cila ka qenë shtatzanë, ia kanë incizuar kasetën me fjalë pozitive, e cila i është dedikuar fëmijës që ta dëgjojë në bark, derisa ka qenë pa lindur. Pas lindjes, ky fëmijë ka lindur i shëndoshë dhe me aftësi të veçanta fizike e shpirtërore. Pra, këtu, mund t’iu preferohet nënave që të flasin me bebet e tyre, edhe kur i kanë ende në bark, edhe kur të lindin; le t’u japin sugjestione pozitive, të shëndosha, që më vonë fëmijët e tyre të bëhen si është më së miri, të aftë, inteligjentë dhe të shëndoshë në trup.

I VDEKURI NUK DINTE QË KA VDEKUR

“Njeriu i urtë i harron lëndimet e të tjerëve, sikurse njeriu i pandershëm që i harron të mirat e të tjerve”

(Lao Ce)



“Kthimi në shtëpi pas lirimt të trupit fizik”

Pata dëgjuar se kushëriri ynë, Sh. Basha, ishte i sëmurë. E mora vëllanë, Muharremin, dhe vendosa të shkoja e ta vizitoja derisa ishte ende gjallë. Baci Sh., me familjen e ngushtë, banonte në Prizren, në një banesë tridhomëshe dhe komode. Mbërrijtëm te shtëpia e tij, ku ishte edhe shoku i fëmijërisë, A., me të cilin kohën e fundit isha distancuar shumë, për çështje personale. Posa i ramë ziles së shtëpisë, doli A. të na presë dhe na dërgoi drejt e ku ishte baci Sh. i sëmurë. Baci Sh. Ishte i shtrirë në një krevat të pastër,

mbuluar me një jorgan të ri. Fytyrën e kishte kthyer kah dritarja dhe ishte plotësisht i zbehtë dhe pa energji. Sipas pozitës, që kishte, ai fare nuk shihte se kush është në dhomë. Posa hyra, baci Sh. tha me zë: Oh, lumi baci! A erdhe, Salih, a...? Iu afruam te krevati me Muharremin dhe u përshëndetëm me të, i cili me sy hapët, i zbehtë, pa energji jetësore, në shikim të parë dukej si i ngrirë, si të ishte në një gjendje transi. Muharremi u ulë afër A., kurse unë tek ai, te krevati, dhe fillova të bisedoja me të. E pyeta bacin Sh.: A je mirë? U pëgjigj me mundim e tha: Jo, pasha bacin, nuk jam mirë; jam sëmurë e dua të vdes! E ngushëllova, duke i thënë se ka për t'u shëruar plotësisht. Pastaj e pyeta se, kur do të shëndoshej, a kishte dëshirë të vinte tek ne, meqë tash ishin pjekur qershitë, lart, te stani, në Vraniq. Tha se do të vinte, posa të bënte më mirë e do të hante qershi.

Unë e vëreja se baci Sh. nuk ishte me eterik në trupin fizik, se, kohë pas kohe, nervozohet. I thashë: Ku je, baci Sh., tash, momentalisht? Tha se gjendej te Xhaferi, në Mynhen, “dhe fëmijët e Xhaferit janë të halitshëm e po më nervozojnë shumë”. Në këtë kohë, në dhomë, djali i tij, A., ma tërhoq vërejtjen: Hiqiu tij, se ka luajtur menç dhe bëri me dorë, sikur të thoshte: Ka luajtur krejt! I thashë se nuk ka luajtur, po, me shpirt, ka shkuar për ta vizituar Xhaferin me familje, dhe po e përjeton tërësisht atë vend dhe atë kohë. Kuptohet se djali i tij nuk besonte...

I thashë bacin Sh., se a do të kthente tash në shtëpi dhe në trupin e vet. Po, tha, baci Sh. E urdhërova të kthehej në trup dhe, si u kthye, e drejtoi kokën e më shikoi, duke më thënë: Lumi baci, që ke ardhur të më vizitosh! E pyeta se ku po i dhimbte në trup. Po më dhemb gjoksi, tha. Ia qita dorën e djathtë në gjoks dhe i thashë se tash dhimbja po i largohej e ai vend po shërohej. Pas një minute, me gëzim, baci Sh. tha se iu çlirua gjoksi dhe dhimbja iu largua! Tash filloi të flasë fjalë shumë të mira për mua, por A., djali i tij, mendonte se

mos po i bëja diçka keq dhe më urdhëroi të largohesha prej tij. U largova dhe, pas pak, u përshëndeta me bacin Sh., duke i uruar shërim të shpejtë, kurse ai më uroi çdo të mirë në jetë e më tha: Qëndro i tillë si je, Salih!

Pas dy ditësh baci Sh. kishte vdekur - e kishte lëshuar trupin fizik dhe botën fizike. Mirëpo, në fshat, te baba Azem, ishte krijuar një frikë. Dikush vinte edhe natën, edhe ditën; natën dukej se dikush po e çilte derën dhe po hynte brenda; nganjëherë trokiste dera dhe korridorit ndihej se dikush po ecte. Gruaja e vëllait (Njaziut) shpesh e shihte në ëndërr bacin Sh., i cili, tash sa ditë, kishte vdekur. Fëmija i vogël i Njaziut, Durimi, i cili kishte filluar të fliste, bënte me gisht kah oborri dhe thoshte: Qe baci...! Aty nuk ishte askush që të shihej dhe për njerëzit e tjerë nuk kishte gjë, po për Durimin, po, ishte astrali i bacid Sh., i cili para se të vdiste, e kishte dëshirën e fuqishme që të vinte te ne e të shkonte në stane për të ngrënë qershë. Po ashtu edhe qeni ynë turrej në oborr pa pasur njeri aty. Shtazët dhe fëmijët e vegjël shikojnë drejtpërdrejt në të dy botërat, si në atë fizike, ashtu edhe në atë eteriko-astrale; prandaj, nuk është çudi si kanë reaguar këto dy lloj krijesash - fëmijët dhe qeni gjatë pranisë së hijes së bacid Sh. të vdekur.

Është një metodë shumë efikase, të cilën e kam përdorur atëherë, kur ende nuk isha qartëpamës sa duhet. E mora motrën Lule dhe e hipnotizova, ku nga hipnoza e thellë e vura në autohipnozë, nën udhëheqjen time; se amatori nuk di si ta udhëheqë veten në autotrans; e, në këtë rast, duhet patjetër ta udhëheqë një hipnotizues me përvojë, se mediumi mund t'i bëjë dëm vetes dhe të tjerëve. Në autotrans, e urdhërova që të shikonte se kush po vinte te ne, që fëmijët po e shihnin dhe qeni po lehte “në të zbrazët”, pa qenë askush në oborr. Lulja tha: Është baci Sh. I thashë Lules që ta pyette bacin Sh. se përse po vinte te ne kaq shpesh! Lulja u përgjigj: Po thotë se po ka qejf për të ngrënë qershë, se koha e tyre

është. I thashë Lules: Pyete, të lutem, se a e di që ka vdekur; por, para se ta pyesësh, thuaji që të mos frikësohet, se, siç po e sheh: vdekje nuk ka... Pas pak, Lulja tha se baci Sh. nuk e di se ka vdekur dhe po më thotë: Kush po të thotë se kam vdekur? Unë jam i gjallë dhe tash jam i shëndoshë. Thuaji: Po na vjen mirë që je i shëndoshë, po ti, para një jave, ke vdekur, e ke lënë trupin fizik dhe tash je në botën astralo-eterike; po, mos u frikëso, se vdekje nuk ka. Lulja tha: Filloi të frikësohej dhe ta rrokte një panik, kur i thashë se ka vdekur. Lule, të lutem, thirri udhëheqësit shpirtërorë të bacit Sh. le ta marrin dhe thuaju atyre se baci Sh. nuk di se ka vdekur, ndaj po vjen te ne shpesh, ku po e shohin fëmijët në oborr, kurse të tjerët po e shohin shpesh në ëndërr dhe po frikësohen prej tij. Lulja tha: Erdhën engjëjt e bacit Sh. dhe ata po thonë: Ne dimë për këtë! Kur erdhën engjëjt, baci Sh. u qetësua plotësisht, e morën ata dhe e dërguan në vendin ku e ka merituar gjatë kësaj jete. Prej asaj dite më askush as në ëndërr, as në ndonjë formë tjetër, nuk e ka ndjerë praninë e tij te shtëpia jonë në Vraniq.

ITALIANI DONTË T’I GRABISTE ME DHUNË NOTAT MUZIKORE, TË CILAT PAS 100 VJETVE DO TA MAHNISNIN BOTËN

*“Mendja i ushqen njëmijë gojë, kurse forca fizike e ushqen
vetëm një person”*

(Mumoni)

Shoku Brahë ishte edhe muzikant, i cili, kohë pas kohe, bënte muzikë me një kitarë. Braha e kishte dëshirë muzikën, po nuk ishte i shkolluar. Me shokun Brahë shpeshherë punoja në hipnozë, se ishte medium shumë i mirë dhe shihte pastër në astral. Një ditë Braha më telefonoi e më luti të punoja me të, se diçka nuk ishte mirë: pothuaj tri netë nuk po flinte! Dikush nuk po e lejonte të flejë natën dhe në gjumë po i kërkonte diçka! “Dikush, tha, po më lypë diçka në gjumë, e unë nuk po i jap asgjë atij!” Braha nuk e dinte se kush ishte ai person që donte t’i merrte diçka me dhunë. Kështu, një ditë, e lamë takimin te unë, në banesë, ku erdhën edhe dy shoqe; njëra ishte Shpresa, të cilën e kisha mësuar ta përdorte autohipnozën, meqë edhe ajo ishte medium i mirë. E hipnotizova Brahën dhe e futa në një trans të thellë, të cilin e udhëhiqja unë.

Fillova të punoja me të dhe e pyeta: Brahë, para disa ditësh, më ke thënë se dikush po të sulmon në gjumë dhe po të lypë diçka; tregomë kush është ai, të lutem. Po, tash një njeri më ka futur në një dhomë të rrumbullakët, pa qoshe dhe nuk po kam se kah të ik. I thashë: Dëgjo mirë, Brahë, tash je nën kontrollin dhe mbrojtjen time; çdo gjë që sheh dhe çkado që të ndodhë, tregomë. Mirë, tha Braha, ashtu do të bëjë.

Braha filloi të djersitej në fytyrë dhe tha: Po më detyron, me dhunë, t'i jap diçka. Po çka është ajo “diçka”, Brahë? Janë nota muzikore, tha, e ky don të m'i vjedh, të m'i marrë me dhunë. Kush është ky, Brahë, që don t'i merrë notat muzikore? Është një italian, edhe ky muzikant, i cili e ka mësuar artin e autohipnozës, po e di se unë kam nota të rëndësishme muzikore dhe po don të m'i marrë. Braha filloi të bërtasë: Të lutem, ndihmomë, nuk po më lësho, po i do notat muzikore! E luta Shpresën të shkonte në astral e t'i ndihmonte, po ajo atëbotë ishte amatore dhe nuk dinte si duhej t'i ndihmonte; u detyrova vetë ta udhëhiqja Brahën. Kush është ky italian? i thashë. E ka emrin Xhyzepe, don me dhunë të m'i merrë notat muzikore... dhe shihej se Braha vërtet po mendohej në astral me atë italianin. I thashë: Jepja notat dhe lirohu vetë! Braha u përgjigj: Jo, nuk bën, m'i morën notat, në pesë fletë, engjëjt e mi; se këto nota janë shumë me rëndësi; janë pesë fletë, por vetëm edhe dy persona të tjerë në botë i kanë këto fletë me nota shumë të rëndësishme; me këto nota dhe me muzikën, të cilën ne të tre kemi për ta qitur në dritë - një lloj muzike fantastike që të kënaqë shpirtin e mendjen, pas njëqind vjetësh, kemi për ta mahnitur botën. Engjëjt nuk po lejojnë që dikush tjetër t'i merrë; vetëm unë duhet t'i ruaj ato. Atëherë, duke parë rëndësinë e atyre notave, më erdhi një ide fantastike që ta mbroja Brahën nga ai person i keq e i dhunshëm italian, që donte me dhunë t'ia merrte notat muzikore. I thashë Brahës: Tash në gjoks, po ta jap një talisman prej ari, mbi të cilin shkruan fjala Allah; ky talisman ka fuqi të jashtëzakonshme për mbrojtje nga e keqja. Ia vura talismanin në qafë, në botën astrale, dhe e urdhërova që, posa të ofrohej italianin, t'ia drejtonte, dhe ai përgjithëmonë do të largohej. Braha ia drejtoi talismanin me fjalën Allah dhe tha: U zhduk! Më kurrë nuk ka për t'u kthyer tek unë!

Këtë natë më interesoi pse Braha ishte i interesuar për muzikë aq shumë.

E regresova dhe e ktheva në një kohë shumë të lashtë. Braha filloi të flasë: Gjendem në një pallat mbretëror të Greqisë së vjetër. Unë jam një muzikant dhe po e argëtoj vajzën e mbretit. Në dorë kam një si lloj gitareje, por kokën e ka të rrumbullakët dhe, në vend të telave, ka qime të kalit, me të cilën po e argëtoj vajzën e mbretit, Atilën, e bukur dhe intelegjente, e cila po më do shumë e unë po i bëj muzikë dhe po i këndoj.

Pas këtij rasti, Brahës nuk i ka ndodhur më që ai italian, Xhyzepe, të mundohej t'ia merrte notat muzikore, të cilat, pas 100 vjetësh, do ta mahnisin botën.

IDENTIFIKIMI ME ELEMENTET KOSMIKE DHE ME DIELLIN

*“Mësimi pa të menduar është i zbrazët, të menduarit pa
mësim është i rrezikshëm”*

(Lao Ce)

Në një meditim të thellë, vendosa që të bëj një provë me veten time dhe të identifikohem me elementet kosmike. U futa thellë në vete, ku vendosa të identifikohem me elementin e ujit. Me fuqinë e mendjes dhe të astralit fillova të identifikohem e të bashkohem me ujin e tërë botës; së pari me lumenj, pastaj me liqene, detëra e oqeane dhe, më në fund, me tërë botën. Kështu fillova të ndjehem se jam bërë i tëri vetëm ujë dhe e ndjeja peshën e rëndësisë e të lagështisë në vete. Mirëpo, ajo çka ishte shumë interesant: Aso çastesh ndjeja ndjenjat e gjithë krijesave të botës që jetonin në ujë dhe në të gjitha dimenzionet; një ndjenjë papërshkrueshmërisht e mirë; po ashtu, ndjeja edhe një fuqi shumë të madhe në vete. Në një moment e ndjeja veten, me atë fuqi, si të ndarë prej tokës, e pastaj u bëra një sferë e madhe, në ngjyrë të kaltër, që rrezatoja atë ngjyrë dhe një dashuri për tërë universin. Prej peshës së madhe që fitova, mendoja se do të më lëshonte karrigia ku meditoja.

Dikur u identifikova me elementin e tokës dhe me tokën. Edhe në këtë rast, pata një ndjenjë shumë interesante, por pesha ishte më e lehtë sesa me element të ujit. Fillova të ndjeja jetën e të gjitha krijesave, të cilat jetojnë në të gjitha dimenzionet e tokës; edhe të njerëzve në përgjithësi. E ndjeja një fuqi të papërshkrueshme në vete.

Pas pak, m'u shtua dëshira që të provoja të identifikohesha me diellin dhe fillova që tërësisht të bëhesha

diell, i cili po shkëlqente dhe po i jepte universit dritë. Por kisha temperaturë të lartë dhe, në trup, fillova të djersitesha shumë. Mirëpo, më erdhi një ide të futesha në diell, ku ishte disi ngrohtë dhe në atë vend e ndjeja një siguri të madhe dhe një fuqi e një dashuri të papërshkrueshme. E ndjeja se diellin po e mbanin disa fuqi shumë të mëdha, të cilat më lejonin që të isha me to. Pas pak, fillova t'i lëshoja dritë tërë universit dhe tokës. Ato rreze ishin disi si qenie të vogla që i afroheshin tokës për ndihmë dhe për të ringjallur çdo gjë në të; kjo gjendje ishte e papërshkrueshme.

Pas pak u indentifikova me element të ajrit. Posa u bëra si ajër, filloi trupi të më lehtësohej aq shumë, sa më dukej se do të ngrihesha nga toka dhe do të humbisja dikund mbi tokë. Ndjeja ndjenja qeniesh të elementit të ajrit dhe gëzohesha shumë për to. Ndjeja sesi ajri ishte shtresa-shtresa, që bashkë me mua e kishim rrethuar tërë tokën. Ishin pesë shtresa. Shtresa e parë ishte më e rrallë, rreth tokës; Një shtresë më poshtë ishte më e trashë; një pjesë shumë më e trashë (mbi tokë, deri në një thellësi), dhe dy shtresa të tjera shumë më të rralla, që çonin deri në qendër të tokës dhe nën tokë, si në një dimenzion tjetër. Ishte një përjetim i rrallë.

UDHËHEQËSI SHPIRTËROR MË KËSHILLON

“Në qoftë se dikush dëshiron të dijë se çka ka përjetuar nga jeta e kaluar, ai ka për ta ditur me atë se çka tash po i ndodh; në qoftë se dëshiron të dijë se çka ka për t’i ndodhur në jetën e ardhshme, mund ta dijë me atë se çfar vepra bën në jetën e tashme.”

(Mësim budist)

Shpesh futesha në vetvete për të pyetur për shumë gjëra, si për veten time, ashtu edhe për të tjerët. Sonte vendosa të hyja në vetvete dhe të pyesja për veten, meqë kisha një problem me veshkët. Kështu hyra në vetvete: E paramendova një shtëpi, e cila simbolizonte ndërrijen time. U futa në atë shtëpi, që ishte shumë e bukur dhe moderne. Ishte një derë, që të çonte në bodrum. E çela dhe para meje dolën disa shkallë. Fillova të zbres nëpër to: Zbrita 9 shkallë dhe kur e kalova shkallën e fundit, para meje doli një korridor me tri dyer: Dy ishin djathtas, njëra majtas. E hapa derën e majtë. Brenda ishte një dhomë e bukur, e bardhë, dhe e pastër; me dritare të mëdha e perde të bardha. Në mes të dhomës ishte një tavolinë, në ngjyrë kafeje të çelët, me pesë karrige. Papritmas te tavolina doli një qen i bardhë, i vogël, i dashur dhe me një lidhëse të kuqe në qafë. Filloi të luante e të kërcente mbi këmbët e mia. I thashë atij qeni: Të luten, largohu tash, se nuk kam kohë të luaj me ty! Ai menjëherë u zhduk. Para meje doli një hije e bardhë (doli disi si prej murit). Ishte me rroba të bardha, disi pa ngjyrë në fytyrë dhe rrinte pezull në ajër. Nuk i shiheshin këmbët dhe kishte flokë të gjata, të bardha dhe mjekër të bardhë e të gjatë. Po ashtu, kishte një kapelë të bardhë, në formë konike, në tre kat. E

përschëndeta dhe ai ma këtheu përschëndetjen. Pa ngurrim, e pyeta për shërimin tim! Menjëherë ma ktheu përgjigjen: Ne po punojmë për shërimin tënd, vetëm duhet të jesh i durueshëm. Në këtë moment fillova t'i shihja disa gjëra interesante: Në këtë kuadër pashë veten sesi po shërohesha dhe ngadalë po bëhesha i shëndoshë. Më këshilloi për shumë gjëra të dobishme dhe tha se Ai është gjithmonë me mua dhe gjithmonë vjen kur të më nevojitej. Po ashtu më tha se edhe unë duhet vetë të punoja për shërim. Pas pak, udhëheqësi më mori dhe më çoi në shumë dimensione të larta, domethëniet e të cilave, nëpërmjet vetëdijes nuk munda t' i sqaroj. Më në fund u ktheva prapë në atë dhomë, në vetëdije normale, dhe prapa meje e mbylla derën e ndërrijes për qeniet dhe personat tjerë që donë të hulumtojnë në mua, pa lejen time; këtë derë vetëm unë mund ta hap dhe vetëm atij që unë ia lejoj mund të hyjë në mua.

Pas këtij udhëtimiti në mua, kam bërë edhe udhëtime të tjera, ku udhëheqësi shpirtëror më ka këshilluar për shumë gjëra.

Gjithmonë shkoja te shtëpia ime dhe hyja brenda. Drejtohesha kah bodrumi, e çilja derën, lëshohesha shkallëve teposhtë. Shkallët ishin disi të rrumbullakta dhe çonin thik teposhtë. Nuk shihja mirë. Në anën e djathtë ishte një ndërpres elektrik. E ndizja dritën, ku korridori bëhej i tëri dritë dhe çdo detaj e shihja me saktësi. Kur mbërrita në njërin prej kateve, aty nuk kishte derë. Në një qoshe filluan shkallët tjera. Ishin sikur shkallët e para, veçse korridori ishte i lyer me ngjyrë të verdhë. Mbërrita në një korridor, ku më nuk kishte shkallë. Aty ishte një derë e madhe prej hekuri. Në anën e majtë të saj ishte një objekt i metaltë, si një tangar prushi, por i stilizuar bukur. Më erdhi ideja se në atë tangar duhej të jepja diçka, si kurban, që të mund të më çilej dera. E mora një pjesë, si të hijes sime –diçka të keqe, dhe e qita mbi tangar, të cilën ai e përpiu dhe dera u çel menjëherë. Para

meje doli një dhomë e bukur, e ndritshme. Në mes të saj ishte një tavolinë. Mbi tavolinë ishin dy gjëra: në anën e majtë ishte një kuti prej druri, e dekoruar bukur. Kur e hapa kutinë, brenda ishte një sferë e kristaltë, ku të vizatuara ishin shenjat “Jing - Jang”, e po ashtu ishte dhe një peshore e vogël prej arit të bardhë. E kuptoja se këto simbole ma bënin me dije, se unë duhej veten ta sillja në peshore dhe të balancoja të mirën e të keqen në mua; kështu të vihesha në drejtpeshim të plotë shpirtëror. Mbi tavolinë ishte një kupë e argjendtë, e vjetër, dhe në të ishte një pergamenë, e lidhur në rreth. E mora dhe e shpalosa: në të ishin të shkruara 7 këshilla: Ushtro! Beso! Vepro! Hesht! Puno (me njerëz)! Piramidë-stabilitet i energjisë, tek unë dhe te nxënësit! Rrjet -transmetim-rrotull-dijen për ta mbrojtur. Në këtë rreth futeshin edhe 6 fjalë të tjera. Pas pak, më erdhi udhëheqësi shpirtëror, me rroba të bardha, mjekër dhe flokë të gjata e të bardha, me një kapelë të bardhë, konike, në tri kate. Tash plaku erdhi disi ndryshe, meqë e dija se ky deri këtu më kishte udhëhequr dhe e kishte kryer mësimin dhe punën me mua. E çoi dorën përpara dhe ma tregoi një krijesë tjetër, me rroba të bardha; ishte femër shumë e bukur, flokët në të zeza dhe krela-krela. Pak më tutje, një krijesë tjetër, po ashtu me rroba të bardha, ishte mashkull. Mbrapa tavolinës, kah muri, ishte një karrige, disi mbretërore, e cila qëndronte mbi një tepih të bukur, mbushur me rubinë të kuq. Mbi kokë të karriges ishte një gur i çmueshëm. Majën e kishte të kthyer kah unë, drejt e në çakrën e dytë, dhe i lidhte çakrat tjera me energji poshtë e lart. U ula në karrige dhe menjëherë filloi të më vinte fuqia. Para tavolinës ishte një njeri patulak, i vogël e i hollë; më tutje, një krijesë femër - e bukur, e vogël, me flatra; ishte sa një shpend i vogël; kishte edhe më tutje disa krijesa, të cilat nuk i shihja mirë e të cilat, që të gjitha, ishin të gatshme të ndihmojnë. Pas pak erdhi plaku, i cili më dha një libër të vjetër me dije të lartë, e cili ishte veç për mua.

MBROJTJE

“Fati gjendet në çdo gjë. Duhet vetëm të dish që ta ndashë anash”

(Konfuqi)

KUR SHKUAM TË KËRKONIM GURË TË MURMURIMËS: ÇKA I NDODHI SAMIUT, KUR DESHI TË MA SHQYENTE ME BRISK ASTRAL TRUPIN ETERIK?

Kisha dëgjuar shpesh kur flitej për fuqitë magjike shumë të mëdha të të ashtuquajturit “Guri i murmurimës” dhe në këtë bazë mundohesha që sa më shumë të dija për të dhe, simbas mundësisë, të vija deri tek ai gur.

Shpesh e kisha dëgjuar nënën Zarë të fliste për aso gurësh; se ajo ishte prej fshatit Dolloc, i cili gjendej jo fort larg fshatit tonë, respektivisht disa kilometra mbi fshatin Mushtisht. Është një fshat malor dhe shtrihet në një lugshtajë karakteristike. Fshati ka dy lumenj të vegjël, të cilët bashkohen në mes të fshatit dhe, së bashku, zdirgjen teposhtë në drejtim të fshatit Mushtisht. Shpesh nëna Zarë e përmendte se është një gur i murmurimes, i cili të jep fuqi, shëndet dhe të mbron prej të këqijave. Si i ri, shpesh pyesja sesi është e mundur që një gur të të jap fuqi, të të shëndoshë dhe të të mbrojë! Në fshatin Dolloc disa njerëz dinin për këtë gur, po për ta gjetur ishte shumë vështirë.

Një herë, me shokun, Sadri Krasniqi, shkuam për një punë në kooperativën bujqësore, të ashtuqujtur (në atë kohë) “Progresi”, ku punonte axha i tij. Por, atë pasdite, si roje, kishte qenë një njeri, kah të 50-tat, i quajtur Pren. Me të, në bisedë e sipër, u prek dhe çështja e magjisë. Ky person dinte

shumë gjëra për magjinë dhe botën astrale, se ky merrej vetë me shërimin e magjive dhe me parashikimin e fatit, ku, më vonë, mësuam se si ndihmës, kishte dy shpirtëra nga astrali, që i jepnin ndihmë në dije. Këtë ditë, me shokun Sadri ishim të interesuar më shumë për “Gurin e murmurimës”, për të cilin Preni kishte dije të madhe. Thoshte se “e di njeriun në Amerikë, i cili nuk ka qenë i pasur dhe me gjetjen e “Gurit të murmurimës” ka marrë fuqi të madhe psikike dhe ka arritur të bëhet shumë i pasur”. Thoshte se atë gur nuk është mirë të ta dijë askush. Ai gur të mbronë prej magjive të zeza dhe shtrigave të këqija; të jep fuqi në mendje e koncentrim dhe të drejton e të çon tek ai qëllim që e synon në jetë.

Kështu, edhe në një revistë, e gjeta se në muzeun e Athinës, ekzistonte një Gur murmurime, të cilin e kanë gjetur priftërinjtë e një kishe të Athinës. Aty tregohej edhe sesi mund të gjendej. Shkruante se gjatë vetëtimës dhe murmurimës, shkaktohet një zbrazje shumë e fuqishme e energjisë, e cila drejtohet dikund në tokë: në ndonjë pemë, shtëpi, a gjetiu. Kështu, në atë vend ku zbrazet ajo energji, lë gjurmë të dukshme dhe shihet vrima në tokë, ku është zbrazur energjia. Ajo (energjia) futet thellë në tokë dhe merr formën e një guri të rrumbullakët. Ai gur i formuar nga kjo energji nuk del përnjëherësh mbi tokë, po pas 40 ditësh. Ata që donë ta gjejnë atë gur, duhet ta gjejnë atë vend ku ka gjuajtur vetëtimën dhe mbi atë vrimë të lënë të gozhduar një letër pakoje; kështu, pas 40 ditësh, del guri mbi tokë; del i butë dhe ti mund t’i japësh formën që dëshiron, i cili për një kohë të shkurtër, për disa sekonda, ngurtësohet e më s’mund t’ia ndryshosh formën. Ai gur bartet me vete dhe menjëherë të mbushë energji, sa ndonjëherë duket i padurueshëm nga energjia.

I kam gjetur disa informata në internet, ku një Institut i Parapsikologjisë merrej me shitjen e gurëve të murmurimës. Ata thonë se guri nuk bën të shitet dhe jepet falas. Por, ata

shesin ritualet, të cilat nevojiten që atë gur ta bësh për veti dhe ta orientosh në drejtimin e caktuar. Kishte rituale për shëndet, për financa dhe për zhvillim të lartë spiritual dhe një ritual kushtonte 500-900 marka gjermane.

Tash po ju tregoj sesi, një herë, unë, shoku Sadri Krasniqi, vëllai, Muharremi dhe vëllai i vogël, Samiu, jemi nisur për të lypur Gurë të murmurimërs në fshatin Dolloc, të cilin si fëmijë shpesh e kam vizituar, se dajhtë i kam pasur në atë fshat.

Ishte mesi i verës; kishim vendosur që sot të shkonim në Dolloc - edhe për të shëtitur, por edhe me shpresë se, ndoshta, do të mësonim diçka ose do ta gjenim Gurin e murmurimës. Ishim, siç thashë, 4 vetë: Unë, Sadriu, Muharremi dhe Samiu. Për në Dolloc nuk kishte autobus, se ishte vend malor dhe shteti nuk e kishin ndrequr rrugën si duhet, meqë nuk i kishte interesat e veta. Ishte përpjetëz, po të mbante natyra e bukur dhe ajri i pastër. Këtë ditë kishte rënë shi. Vëllai, Muharremi, ishte teknik i pylltarisë, por punonte si rojtar pyjesh dhe të gjithë fshatarët e këtyre fshatrave e njihnin, se me ata njerëz kishte punë. Ai kishte vendosur që të na çonte tek një person që e njihte mirë në fshatin Dolloc. Gati na zuri nata dhe, më në fund, arritëm në fshatin, i cili ma përkujtonte plotësisht fëmijërinë. Ndihehin shumë qenë, duke lehur; lopë duke pallur; dhe aty-këtu ndonjë njeri thirrte dikend me zë të lartë. Fshatin e kishte mbuluar tashmë terri. Në krye të fshatit mbërritëm te një shtëpi, ku në sokak rridhte një krua i madh me ujë të ftohtë si bora. Muharremi thirri një emër para dyerve të shtëpisë; u ndez drita e oborrit dhe u ndi lehja e qenve të asaj shtëpie. Kjo pamje m'i përkujtonte vitet gjashtëdhjetë të fëmijërisë, vetëm se atëherë nuk kishte rrymë ky fshat; e ndjeja njëjtë aromën e fshatit dhe freskinë e bjeshkës. Edhe pse ishte mesi i verës, ne filluam të nirthnim në atë lartësi. Doli një person dhe na tha: Urdhëroni, o burra, bujrum! Ejani brenda! Kur e

pa Muharremin, i tha: Çka po pret, bre burrë? Shtëpia jote është... Ne hymë në një odë, e cila thuaja aspak nuk kishte ndryshuar prej kohërave të mëparshme; asgjë e re nuk ishte ndërtuar në atë vend, po kryesorja ishte e nxehtë dhe i zoti i shtëpisë ishte mikpritës i mirë. Menjëherë e ndezi stufën dhe filluam të nxeheshim. E ndjenim veten mirë, se kishim nirth pak më parë, duke ardhur në fshat. Unë mbaja në dorë gazetën “Rilindja” dhe isha mbështetur pak larg stufës dhe lexoja. Samiu dhe Sadriu ishin afër meje në anën e djathtë, kurse Muharremi ishte pak më larg. Duke lexuar, nga ngrohtësia e zjarrit, fillova të kotem, po, megjithatë, isha zgjuar dhe rrija në një gjendje autotransi. Dëgjoja çdo gjë që flitej. E dëgjoja shokun Sadri, kur po i thoshte Samiut që të binte në autohipnozë dhe të më hipnotizonte mua. Unë, edhe Samiut, edhe Sadriut, ua kisha dhënë autohipnozën që nëpërmjet saj të mësonin e mos ta keqpërdornin; faktikisht ishin të dytë nxënësit e mi. Duke harruar se unë kisha dije shumë më të mëdha sesa ata dhe se isha mësuesi i tyre, ata, megjithatë, vendosën ta bënin një eksperiment me mua, duke mos ditur se çka do ta gjejë atë i cili tenton të bëjë një gjë të tillë.

Sadriu, siç thashë, po i thoshte Samiut që të binte në autohipnozë dhe të futej në trupin tim e të më hipnotizonte. Unë i dëgjoja fort mirë, por i lejoja që të veprojnë. Kur ra Samiu në autohipnozë, i tregoi Sadriut se është në gjendje të ndryshueshme të vetëdijes. Unë menjëherë bëra mbrojtjen astrale. Samiu i tha Sadriut se unë paskam bërë mbrojtje dhe nuk po mundka të më futej në trup. Sadriu e urdhëroi Samiun që të merrte një brisk astral dhe të ma shqyente aurën mbrojtse, me qëllim që të më futej më lehtë në trup. Samiu tha: E mora briskun. Sadriu e urdhëroi që të prente mbrojtjen. Unë, në atë moment, në shpejtësi, bëra një mbrojtje të fuqishme kundër çdo të keqeje; e bëra rrethin dhe katër yje me kokë përpara, të cilët simbolizonin katër engjëjt kryesorë.

Posa e bëra këtë mbrojtje, trupi astral-eterik i Samiut u refuzua prej meje me një fuqi shumë të madhe, sa Samiu e lshoi një zë trishtues, me bërtimë, dhe tha: O bacë, çka më bëre, bre?! Dhe merrte frymë me shpejtësi e dridhej. Unë i çela sytë, i qetë, e i thashë: O budalla! Si guxon ti me brisk astral të ma shqyesh mua trupin eterik? A e di ti se unë, së pari, jam mësuesi yt e, së dyti, t'ia shqyesh trupin eterik, është ngjashëm si njeriut t'ia shqyesh trupin fizik me thikë. Tjetër herë mos tento se të robëroj në mua e të lë në materie, si budalla. Këto fjalë ia thashë veç sa për ta frikësuar, që tjetërherë të mos provonte - as tek unë, as tek të tjerër, se një gjë të tillë unë nuk do ta bëja kurrë, këtë e bëra veç sa për mbrojtje.

Megjithatë, këtu kaluam një natë shumë të mirë, me muhabet e hare dhe bëmë një gjumë të thellë e të këndshëm në këtë vend malor, me ajër të pastër. Të nesërmen vendosëm të shkonim në një mal të fshatit ku më parë Muharremi kishte hulumtuar një vend ku kishte goditur energjia e vetëtimitës. Në një zabel privat, ishte një mal bungajë me lisa jo të trashë. Në të disa lisa bingu i kishte tharë vetëtima. Një lis ishte ende i njomë, por e kishte goditur energjia e rrufesë. Përveç këtij lisi, kishte edhe lisa të tjerë, të qëlluar, në atë vend. Unë iu ofrova një druri të bungut, të cilin e kishte goditur kjo energji dhe e kishte çarë për gjysmë, një 10 metra lartësi. Gjurma dukej si një lavrim i lëkurës së lisit deri brenda drurit, ku lëvoren e kishte çarë plotësisht. Gjurma vazhdonte deri në tokë, e në sipërfaqe të tokës dukej një gjurmë, si të kishte eksploduar diçka, që kishte bërë një gropë e cila vazhdonte për në thellësi të tokës. Fillova të hulumtoja në atë vend. E largova dushkun e tharë të bungut dhe fillova të lypja atypari ndonjë gur karakteristik. Hapa një gropë, po nuk kisha mjete për ta thelluar tokën. Ishte interesant se menjëherë fillova të ndjeja një energji të madhe në atë vend ku kishte goditur vetëtima. Çakra e syrit të tretë filloi të vibronte shumë dhe

ndjeja presion të madh në kokë; ndjeja saktë rrotullimin e çakrës dhe vibrimin me një zhurmë të hollë. Dikur filloi të shtohet presioni i energjisë; u largova pak nga ai vend dhe posa dola nga ajo fushë, filloi të më stabilizohej gjendja. Meqë pamë se nuk po mund të gjenim gjë, vendosëm të ktheheshim; se filloi edhe të rigonte shi. Zbritëm teposhtë te një stan, ku takuam një plak, i cili ruante lopët e, i cili, kur i treguam për qëllimin tonë, tha se ai e kishte kërkuar atë gur tek ai dru bungu. I bëra vetes pyetje: Vallë, a s'janë këta magjistarë të popullit tonë, të cilët, ndoshta, as që e dijnë se janë magjistarë!...

Ç' MË NDODHI NË BJESHKË TË KRISTALEVE DHE NË MAJËN E LYBETENIT

“Fati vjen vetë, kurse fatkeqësia ne shoqëri”

(Kung Fu Ce)

Gjatë punës me ezoteri e parapsikologji kisha lexuar dhe mësuar rëndësinë e gurëve të çmueshëm e të kristaleve. Kisha dëshirë që dikund, nëpër bjeshkët tona të gjeja ndonjë vend ku do të kishte kristale të bukura që t'u ndihmoja njerëzve të shëroheshin. E dija se në Mitrovicë ka mjaft, meqë në minierën e Trepçës nxirreshin ato. E dija po ashtu se në Kosovë ka jo vetëm gurë gjysmë të çmueshëm, po edhe të çmueshëm. Njëherë, në një gazetë të ish-Jugosllavisë, lexova se në Novisad të Vojvodinës, mbahej një kurs për kristale dhe gurë të çmueshëm dhe vendosa t'i thërrisja në telefon, që t'i pyesja sesi janë kushtet e atij kursi dhe sa kushton ai. Pasi e mora lidhjen telefonike, dual një zë femre, e cila më priti shumë mirë. Në bisedë e sipër, i thashë se unë jam nga Kosova dhe se te ne ka kristale e gurë të çmueshëm. Ajo e konfirmoi: Te ju ka jo vetëm kristale natyrore, po edhe gurë të çmueshëm, duke filluar prej diamanteve, rubinëve, smaragdve, xhevahirëve etj.

Një ditë, në bisedë e sipër, me shokun Raif Kasi, nga Lubinja e Epërme e Prizrenit, lidhur me rëndësinë e kristaleve dhe shërimin me to, më tha se ai kishte gjetur një kristal në bjeshkën e tyre dhe se kishte ende nëpër tokë; një ditë, Raifi ma solli për ta parë. Dhe, një ditë, me shokët, Raif Kasi, dhe, Sadri Krasniqi, shkuam për ta shëruar një person në fshatin Lubinjë të Epërme, aty takuam edhe babain e atij djalit të sëmurë, i cili, në bisedë e sipër lidhur me kristalet, na

tha se bjeshka e tyre kishte kristale mjaft dhe se, dikur, kur kishte shkuar me dhen e kur i kishte lënë dhentë për të mrizuar, nganjëherë, duke shpluar ndonjë gur, kishte gjetur kristale me ngjyra. Plaku tha se kur isha me dhen në atë bjeshkë të lartë dhe fillonte të vrahej, të vetëtonte e të murmuronte, duhej patjetër që të zbrisje me dhen poshtë, se atë bjeshkë shumë e rrahin vetëtimat dhe se ndodh shpesh që, kur të bijnë vetëtima e murmurimë mbi të, gjysma e bjeshkës të skuqet dhe këtë pamje e ruan disa minuta. Këtë dukuri shumkush i ka parë nga fshati ynë, tha plaku.

Kështu, një herë, vendosëm që ta vizitonim këtë bjeshkë, unë, vëllezërit: Muharremi e Samiu, shokët: Ylber Cahani, Sadri Krasniqi dhe Raif Kasi. Të gjithë ishim shokë, që shpesh tuboheshim e bisedonim për parapsikologji dhe bënim ndonjëherë eksperimente me hipnozë. Shoku Raif ishte i po atij fshatit, përndryshe: magjistar- hipnotizues, dhe tek ai kishim lënë takimin. Te shoku Raif shpeshherë kemi bujtur dhe kemi qenë shumë mirë të pritur nga familja e tij e ndershme. Kishim blerë ushqim, se lart në bjeshkë hahej buka më shumë se zakonisht, meqë ajri dhe uji ishin shumë të thekshëm. Kishim marrë disa mjete pune: një kazmë të vogël, një daltë e një çekiq, porse këto nuk ishim mjete origjinale për punë me kristale. Kështu u ngjitëm ngadalë bjeshkës përpjetë dhe mbërritëm në një rrafsh, ku ishte një livadh i bukur, me lloj-lloj lulesh; kishte dredhëza të egra, të cilat i mblidhnim dhe i hanim; kishte mjedra të kuqe dhe qershiza të kaltra; kjo kohë ishte mesi i verës. Këtu gjetëm dhe një krua të ftohtë si bora; ishte aq i ftohtë, sa t'i mpinte duart dhe dhëmbët; po uji ishte shumë i shijshëm për pije. Pasi që hëngrëm bukë, filluam të ngjiteshim edhe më përpjetë bjeshkës; tashi ishim rrënzë bjeshke dhe, kur shikonim lart, dukej e paarritshme ajo bjeshkë. Dalngadalë, për një orë e gjysmë, mbërritëm lart, në majë të asaj bjeshke. Poshtë, si në shuplakë të dorës, shihej Rrafshi i Dukagjinit; shihej gati e

tërë bjeshka e Sharit dhe fshatrat në të. Dita ishte shumë e bukur dhe pozita ku ishim, lart, ishte më se fantastike. Shoku Raif bëri me dorë, poshtë, drejt fshatit të tyre, kah një breg, dhe tha: Shikoni në atë kodër, aty, gjendet një spirancë prej hekuri, e anijeve; është shumë e vjetër dhe askush nuk mund ta dijë sesi ka ardhur këtu. Pas pak, shoku Ylber Cahani, e pranoi një vizion të pastër me ndërdije, ku pa se i tërë ky vend, që ne e shihnim, së bashku me Prizrenin e të gjitha fshatrat e atij rrafshi, nuk kishin ekzistuar dhe tërë kjo sipërfaqe e madhe kishte qenë e mbuluar me ujë, deri te kjo spirancë që gjendej mbi fshatin Lubinjë dhe se mbi këtë liqe të madh kishin lundruar anije të ndryshme...

Mbërritëm lart në një vend, ku një pjesë e kodres ishte rrëzuar, porse gurët përreth ishin shumë të fortë dhe shihej se vetëm një fuqi e madhe i kishte copëtuar. Posa mbërritëm në atë vend, e tërë lodhja e katër orëve udhëtim, për një kohë të shkurtër, u largua. Menjëherë filluam të mblidhnim kristale të pastra dhe shumë të bukura, si të ishin prej qelqi dhe me forma të ndryshme. E ndjenim veten shumë lehtë dhe shumë bukur. Nëpër gurë e shkëmbinj shiheshin kristalet që nuk kishim mundësi t'i nxirrnim. Megjithatë, aty gjetëm mjaft kristale të bukura e të mëdha. Me Muharremin vendosëm të ngjiteshim në majë të bjeshkës; mirëpo, çka ishte interesant, pa ndërprerë në syrin e tretë më dilte një kristal i rrumbullakët e i bukur; dhe, çuditërisht, si me sytë hapur, si me sytë mbyllur, e shihja këtë kristal në ballë. Poshtë, i lamë shokët, duke lypur kristale nëpër dhe. Duke u ngjitur lart, i thashë Muharremit që të ndaleshim e të shikonim se për çfarë po më paraqitet ky kristal në ballë, te syri i tretë. U ula mbi një shkëmb. Para meje ishin vetëm bjeshkët. Krejt në anën tjetër i kishim lënë shokët. Posa i mbylla sytë dhe e shikova kristalin në ballë, përnjëherësh m'u shfaq një pamje jo e zakonshme. Poshtë i pashë qartë vëllanë, Samiun, si dhe Ylberin, duke kërkuar kristale dhe qartë e dija se çka po

mendonin për këto kristale. I hapa sytë dhe para meje dualën vetëm bjeshkët; kur i mbyllja sytë, drejtpërdrejt, pas kodre, i shihja qartë shokët, si po hulumtonin kristale. Muharremi më tha: Bac, të lutem, ngrihemi se po na zë nata, meqë kemi shumë deri në majë për të ecur. Posa i çela sytë, ia pashë Muharremit aurën, të kaltër në të çelët, dhe tërë bjeshka, respektivisht maja e saj lëshonte një aurë ngjyrë vjollce, të pastër dhe të hijshme. U fascinova me këtë pamje dhe i tregova Muharremit. Deri në majë bëmë 45 minuta. Duke u kthyer, morëm kristalet që i kishim futur në një çantë, e cila peshonte rëndë. Ai që barte çantën, e ndjente një energji shumë të madhe! Një herë e mori shoku Raif, të cilit ia zgjoi një energji të madhe në kurriz dhe ajo energji ia zgjoi pjesërisht *kundalinin*, ndaj u detyrua që ta hiqte çantën, se pothuaj e trullosoi në kokë. Energjia e Kundalinit është energji, e cila aktivizohet në çakrën e parë dhe, si gjarpër, ngjitet nëpër kurriz e deri te çakra e kurorës, në majë të kokës, ku njeriu mund të përndritet (iluminohet). Kur mbërritëm në Prizren, e hulumtuam me qartëpamësi se çka kishin ndikuar kristalet dhe ajo bjeshkë në ne. Secilit i ishte pastruar aura dhe i ishte mbushur me energji të pastër; secila aurë jona kishte ngjyrë kthjellësisht të kaltër. Në këtë bjeshkë kam shkuar shpeshherë dhe gjithmonë jam fascinuar.

Pastai kam filluar t'i hulumtoj bjeshkët e shenjta nëpër Kosovë dhe një nga to është edhe Maja e Lybetenit. Disa sufi apo shehlerë të fshatit Vraniq e kanë ditur fuqinë e madhe të kësaj bjeshke dhe kanë thënë se vizita kësaj bjeshke, shkuarja tri herë në këtë bjeshkë, herët në mëngjes, si dhe falja e lutja në këtë majë të Lybetenit, është njëjtë sikur një herë të shkosh në Qabe. Dhe, vërtet, kam parë shumë fshatarë të shkojnë, para Shëngjergjit, në këtë bjeshkë dhe të falen e të bëjnë lutje.

Kështu, një herë, patëm vendosur të shkonim e ta vizitonim këtë bjeshkë me vllanë, Muharremin, me nipin,

Shpend Gashin, dhe me një plak të quajtur Daut. Shpendi e mori kamerën dhe u nisëm, me bus, kah Ferizaji. Muharremi ishte rojtar pyjesh atë kohë. Në bus, kah Brezovica, takuam një fshatar nga fshati Shushiq, që shtrihej mbi Brezovicë, e i cili i kishte miqtë në fshatin Vraniq dhe e njihte babanë tim. Këtë natë bujtëm në këtë fshat e, të nesërmen, djali i tij, me një vëlla, mori traktorin dhe na ngjiti gjer në Brezovicë. Brezovica ishte fascinuese: Nuk isha mësuar të shihja vende aq të bukura në Kosovë; dukej sikur ishim në Alpet zvicerane apo të Austrisë. Ajri ishte i pastër, uji i pastrër dhe bjeshkët fantastike. Para nesh shtrihej Bjeshka e Lybetenit dhe dukej se ishte tepër afër. U nisëm nëpër ato bjeshkë të bukura dhe mbërrimë në një vend ku në mes të verës kishte borë. Shpendi na incizonte, se nën borë, afër, kishte lule dhe bar. Ne gjuheshim me borë dhe kënaqeshim me këto pamje. Mbërritëm te një liqe, shumë i bukur, nën majë të Lybetenit, ku ndalëm për të ngrënë bukë. Deri te bjeshka bëmë 6 orë dhe një orë derisa u ngjitëm në majë; gjithsej: shtatë orë udhëtim. Kur mbërritëm në majë, me të vërtetë mbi atë majë lirohej një energji shumë e madhe dhe e pastër, sa që përnjëherësh u mbushëm me energji të madhe. Ishte shumë karakteristike, se te maja vinin një lloj bubërrecash, me flatra, llojin e të cilëve kurrë më parë nuk e kisha parë; ishin si ngjyrëkafe, të mëdhenj, po kokën e kishin shumë të vogël. Vinin, binin në tokë, mbusheshin energji, dhe fluturonin. Kur të preknin në trup, duar apo fytyrë, aq shumë digjte, si kur të zë rryma, sa nuk duroheshin. Ne kishim qëlluar në kohën kur ata vinin për t'u mbushur energji dhe nuk na linin të qetë, se ku të preknin, të digjin me energji. Para nesh dukej një pamje e rrallë: Shihej Shkupi, Ferizaji, Rrafshi i Kosovës... Këtu e pata për qëllim të tregoj fuqinë e Bjeshës së Lybetenit.

SI LUFTOVA KUNDËR TË KEQES DHE SI ERDHËN SHENJTËRIT NË NDIHMË

“Mos të brengosë ajo nëse bota nuk di për aftësitë e tua, por mund të jesh i brengosur nëse nuk i ke ato”

(Konfuqi)

Isha në dimenzionin eterik, me vetëdije të plotë; saktësisht e dija se çka jam duke bërë. Isha si në një stacion hekurudhor të vjetër, në Prizren. Kishte vagonë të trenit dhe në një vagon të vjetër pashë një kerranik fëmijësh, ku kërkoja diçka. Vendi ishte i ndaluar për personat që nuk punonin në hekurudhë. Në atë kerranik kishte shishe njëlitërshe, me alkool, që simbolizonin energjinë dhe ishin me shumë ngjyra. Unë ruhesha se mos po më shihte kush dhe kjo i përngjante hajnisë, edhe pse nuk ishte hajni. Mora katër shishe, njëlitërshe, me katër ngjyra: kuq, kaltër, përhimt dhe verdh. Ishin si katër elementet kosmike, se edhe ngjyrat ishin të tilla: elementi i zjarrit, i ajrit, i ujit dhe i tokës. I futa dy në një xhep, dy në xhepin tjetër. Prej këtu kalova disi si në fshatin Vraniq, te



Pacienti i pastron dhimbjet e fundit të migrenës
(fotografoi: S.B-mistik)

rruga afër varreve, e cila çon për në qendër të fshatit. Te kjo rrugë takova një vajzë të vogël që ishte 9 -10 vjeçare; për dore kishte një kalë të bardhë, po ky e kishte kokën të trashë dhe dukej i trishtueshëm, si një bishë e egër. Kur më pa (kali), mori turr dhe donte të më sulmonte; ofrohej gjithnjë e më afër. Por kur ofrohej, ndalej e nuk më sulmonte. Kështu veproji tri herë. Pas herës së tretë, u ndala para tij, e shikova drejt në sy dhe i fola si një njeriu: “Lermë rehat dhe shko rrugës tënde”! Më shikoi drejt në sy dhe eci rrugës së vet në qetësi. Në të njëjtin moment, afër ca kaçubave, pashë disa fëmijë duke luajtur; por më tutje, në kaçuba të tjera, pashë tri krijesa të vogëla, me fytyrë njeriu, porsi fëmijë të vegjël, por fytyrat u dukeshin të vjetra; ishin nja 20-30 cm. të gjatë. I pyeta fëmijët që luanin se a i panë ata tre patulakë në kaçuba, ata u përgjigjën: jo. Tri herë i pyeta, tri herë mora përgjigje të njëjtë. Pra, vetëm unë i shihja në atë dimenzion ato krijesa të vogëla, të tjerët nuk i shihnin. Desha të dijë se cilat ishin ato krijesa dhe fillova t’i ndjek pas. Tash isha plotësisht me vetëdije astrale, e dija saktësisht se çka po ndodhte rreth meje. E hapa një dimenzion tjetër dhe dola në një lugshtajë. Në këtë lugshtajë pashë njerëzit e mirë duke luftuar kundër të këqijve; kundër demonëve, shtrigave dhe shejtanëve. Pashë sesi ishin mbledhur shenjtërit dhe përgatiteshin për të luftuar kundër së keqes. Fuqitë e dritës e kishin formuar një rreth magjik, me të cilin mbroheshin dhe luftonin kundër të këqijve. Unë u futa në rreth, ku ishin forcat e dritës, dhe fillova t’i mbroja e të luftoja në krah të forcave të dritës. Prej dorës së djathtë lëshoja energji të fuqishme si me ndonjë laser, ku, posa godisja ndonjë demon, ai shkrihej, e thithte toka, zhdukej dhe më nuk kthehej në sipërfaqe. Në këtë kohë filluan shumë forca të errëta t’i afroheshin rrethit tonë ku ne luftonim kundër tyre. Erdhi një zë urdhërues, prej një Adepti, se këtë vend duhej ta lëshonim dhe të lëviznim, me gjithë rreth, kah fusha; kah ishin shenjtërit me armatë të

pakufishme. Detyra ime ishte që të këqijtë t'i njihja e t'i shkatërroja dhe rrethin ta mbroja. Duke shikar se kah erdhi urdhëri, para meje, jo më larg se një kilometër, pashë shumë shenjtër të veshur me rroba të bardha, me flokë të gjata, me mjekra të gjata e të bardha. Në dorë kishin nga një shkop druri me disa simbole në kokë të shkopit. Mbrapa tyre qëndronte një armatë e armatosur me shpata, shtiza e parzmore. Ishin të zgjuet, kishin një madhësi, e të veshur ishin me rroba të argjendta, të shkëlqyshme, dhe vetëm urdhrin prisnin; kjo ushtri ishte e pakufishme.

Në këtë moment ndjeva se po më zvogëlohej energjia, dhe shikova drejt në tokë, ku shihja sikur me rentgen. Aty gjeta një arkë të vjetër, në të cilën kishte armë të vjetra, që ishin të bekuara. Më sulmoi një shtrigë e trishtueshme, së cilës ia lëshova energjinë veç nga gishti tregues, meqë e kurseja energjinë. Ajo u shndërrua në një dredhë dhe e përpiu toka. Para meje doli një tjetër demon. Unë mora nga arka një mburojë të metaltë dhe ia gjuajta atij demoni para këmbëve, me ç'rast mburojtja e thithi dhe e futi në tokë. Energjia filloi të më sosej. Unë kërkoja një kristal-sferë, të cilit doja t'ia merrja energjinë që të lufoja më shumë. Nga lugina vinin më shumë forca të errëta. E ndjeva një zë, i cili më urdhëroi që të kthehesha në trupin fizik. U ktheva menjëherë në trup, me vetëdije, po kisha dëshirë që prapë të shkoja atje e të luftoja; megjithatë, një gjë e tillë, nuk më lejohej më; duhej të pushoja e të qetësohesha. Kur u ktheva në trupin fizik, u ktheva me gëzim të madh, meqë e dija se fuqitë e dritës po fitonin dhe bota do të shpëtonte nga e keqja.

SI HYRI LETAFETJA NË NJË DIMENZION KOSMIK KU KISHTE MUNDËSI TË NDËRRONTE ÇKA TË DONTË NË MATERIE N FIZIKE

*“Ai i cili i njeh të tjerët, është i mençur; ai i cili e njeh veten,
është i përndritur; ai i cili mundet t’i mundë të tjerët, është i
fortë; ai i cili mundet ta mundë vetveten, është i fuqishëm”*

(Lao Ce)

Këtu do t’u shkruaj për një femër, të cilën e kam adhuruar dhe e adhuroi shumë si njeri, me të cilën kam punuar gjëra të rëndësishme spirituale dhe quhet Letafete-Leta dhe këtë në qytet të Mynhenit të Gjermanisë. Ajo ishte femër shumë e bukur, me sy të kaltër e trup sportiv, dhe me një inteligjencë të lartë, por shumë e vuajtur shpirtërisht dhe fizikisht. Nëse pyetni se për çfarë arsye po shkruaj për këtë femër, arsyeja thjesht do të ishte kjo: kam punuar me shumë njerëz, të cilëve iu kam ndihmuar në zhvillim shpirtëror; por person-femër më të aftë se Letën unë ende deri më tash nuk kam muandur të gjej, sidomos si një medium - pothuaj e lindur qartpamëse, edhe pse në fillim lidhje nuk kishte me okultizmin, magjinë, hipnozën apo përgjithësisht parapsikologjinë. Kur kam filluar të punoj me Letën, e pashë se ishte medium shumë i mirë dhe i kapte gjëtar shumë shpejt. Ajo shumë shpejt e mësoi autohipnozën dhe filloi të bëhej qartëpamëse e nivelit të lartë. Shumë shpejt e mësoi projeksionin astral dhe leximin e gjërave me **psihometri** (shiqo fjalorin në fund të librit). Fati i saj ishte se unë kisha dije të gjera për këto çështje, sidomos e njihja mirë udhëtimin në vetvete dhe arritjen në një vend, në ne, ku çdo gjë ishte e

mundur; pastaj udhëtimin në vete, në qendër të dritës, ku veç njëherë njeriu të arrijë në atë nivel e veç njëherë të të paraqitet udhëheqësi plak i dijes në ty, zhvillimi shpirtëror do të jetë shumë i shpejtë, thua marramendës. Për të hyrë njeriu në vete duhet që streset të jenë të zvogëluara në minimum, se në vete apo në tempullin më të shenjtë, ku ekziston dashuria dhe drita më e madhe, duhet të hysh i pastër dhe pa strese. Kur e futja në nivel të dritës dhe e urdhëroja që të ngrihej në nivelin e yjeve e të galaktikave, në ne, dhe që tërë krijesave që ekzistojnë në univers t'u lëshonte dashuri, kuptim, harmoni, paqe dhe kur kthente në nivelin tonë normal të ekzistimit, Leta atë javë ishte shumë e qetë, e dashur, plot energji dhe kishte një gëzim fëmijëror të hareshëm. Kur shëroja ndonjë pacient, e ushtroja edhe atë të shëronte ndokë dhe e detyroja që të përcillte shërimin te pacientat, ku, kohë pas kohe, jepte këshilla shumë të mira, thua edhe kjo kishte punuar me vite në shërimin e njerëzve. Ja, disa këshilla të thjeshta, po shumë të rëndësishme, që i ka dhënë Leta:

“Kur një mësues shpirtëror merr për ta mësuar nxënësin apo nxënësen, ai atë nxënës apo atë nxënëse duhet ta dojë. Pa i dashur mësuesi, nxënësi apo nxënësjë nuk mund të mësojnë”. “Në qoftë se ti Salih, një pacienti apo pacienteje, i tregon me dorë se ku është sëmundja, d.m.th. e prek në trupin fizik, atëherë preke edhe një herë dhe thuaj se ky organ apo pjesë e trupit tash është e shëndoshë, në rregull, dhe tash ti je i shëndoshë (apo e shëndoshë); se: nëse pacienti e ndien këtë fjalë, ai këtë e regjistron në ndërdije dhe fillon të bëjë më mirë. Nëse pacienti apo pacientja është brenda ndërdijes i shëndoshë, atëherë edhe në materie apo në trupin fizik shërohet”. “Kur e shëron dikë me frymëmarrje, kurrsesi nuk bën në atë rast t'i dalësh përpara trupit të tij; është mirë t'i rrihet pak më larg, se të mbush me të këqija”. ”Kur e shëron pacientin, ti duhet vazhdimisht t'i flasësh: Mirë je; mirë ke

qenë; mirë do të jeshë”. “Kur fillon ta shërosh pacientin, është mirë nganjëherë t’i flasësh me zë të rreptë; atëherë dhimbja apo bllokada do ta ndjejë frikën, se ti e ke në dorë pacientin dhe çka të duash bën me të, pra e frikëson dhimbjen apo frikën, e cila iu ka formuar pacientit, se sëmundja di, dhe kur ta pyesësh, ajo të jep përgjigje. Në këtë mënyrë, njeriu çdo send që ka në trupat e brendshëm, mund t’ia heqësh pa problem”. “Kurrë mos i trego tjetrit se çka ka pacienti, para pacientit të cilin po e shëron. Tjetrit person mund t’i tregosh për sëmundjen e pacientit vetëm nëpërmjet sugjestioneve indirekte”.

Një ditë Leta kishte vendosur që të shkonte te mjeku i dhëmbëve, për ta hequr një dhëmb të arit dhe për ta zëvendësuar me një të porcelanit; sepse dhëmbët e tillë ishin më të bukur dhe më të fortë. Leta ishte vetë ndihmëse e mjekut të dhëmbëve; kjo i dinte të gjitha punët lidhur me dhëmbët. Para se të shkonte te mjeku, e mësua sesi të hynte në autohipnozë, t’ia bënte dhëmbit një anestezi, që të mos kishte nevoj të merrte injeksion kundër dhimbjeve. I thashë që, kur të binte në autotrans, të paramendonte se ka bërë një bllokadë rreth dhëmbit, ku asnjë prekje apo lëndin nuk ka për ta ndjerë; e, pas kësaj, të shihte veten në një natyrë të bukur, ku ajo po dëgjonte muzikë e po kënaqej; po mjekun dhe rrethin prapë po e dëgjonte. Kësisoj, unë mendova se ajo të gjitha i kuptoi dhe i besova plotësisht.

Erdhëm te mjeku, i cili menjëherë filloi punën me instrumentet e veta moderne, duke i besuar Letës plotësisht se kjo tash do të dijë ta udhëheqë veten e vet. Unë shkova në dhomë të pritjes dhe, meqë me vete kisha marrë një libër, fillova të lexoj. E ndija një zhurmë, në sallë, te mjeku, po nuk interesohesha shumë se çka po ndodhte, meqë lexoja. Pas pak, e dëgjova zërin e mjekut, i cili më thirri në emër dhe me një frikë në fytyrë. Të lutem, Salih, eja, se diçka nuk është në rregull me z.Topalli (e thirrte në mbiemër). U ngrita me

shpejtësi, kur pashë Letën të zbehtë në fytyrë, thua ja të humbur. Ç'u bë? e pyeta mjekun, i cili tha se “është e pamundur, zoti Salih, që tri injeksione të anestezisë po ia jap, po nuk po i mpihet dhëmbi dhe, papritmas, filloi ta humbë vetëdijen”. Leta ka harruar t'i thotë mjekut që të mos i jepte anestezion, se ajo vetë e kishte bërë këtë; sakaq, anestezioni i tepërt, në autohipnozë, iu ka shumëfishuar; leta ishte në rrezik. Në këtë moment e kuptova se çka duhej bërë me të, duke konstatuar njëkohësisht se kisha gabuar që i kisha besuar Letës dhe e kisha lënë vetë me mjekun. E mora shpejt komandën dhe fillova t'i flas e ta urdhëroj Letën që të bënte çka t'i thoja unë. Së pari, i thashë, tërë atë anestezi që ta ka dhënë mjeku duhet ta largosh prej trupit eterik, të pastrohesh. E pastroi dhe menjëherë u qetësu, i erdhi fytyra në vetë. Mjeku më pyeti: “çka i bërë?! Si është e mundur të qetësohet menjëherë!” Qesha pak, u largova anash, dhe mendoja sesi do t'ia shpjegoja atij mjeku fuqinë e ndërdijes, në atë kohë. Mjeku vazhdoi punën që dhëmbin e vjetër të arit t'ia largojë. Kurrresi nuk mund t'ia hiqte atë dhëmb të arit, edhe pse nuk ishte dhëmb i plotë, po vetëm një shtresë; mjeku çuditej e thoshte: “ende në praksën time, 20 vjeçare, nuk më ka ndodhur që një dhëmb të butë prej ari të mos mund ta heqë me një makinë shpuese prej çeliku; ç'mos ndodhka në jetë!” Kaloi një kohë, më kot; pas pak, një burgi iu thye në gojë të Letës; shtresa e arit nuk dilte jashtë. Mjeku tha: Edhe kjo më ndodhi: u thy burgia në dhëmb të arit! Salih, të lutem, tregomë çka po ndodh këtu me Letën!... Unë i thashë: nuk ka problem, edhe këtë e rregullojmë. Iu afrova Letës, e pyeta: çfarë ke bërë me dhëmbin? A mos ke bërë bllokadë të fuqishme? Ajo, tha: po kam bërë. Për këtë nuk mund ta nxjerrë dhëmbin mjeku kurrresi, i thashë. Tash, të lutem, tërhiqe bllokadën ngadalë. Tërhiqe! A e tërhoqe? e pyeta. Leta tha: po, tash e tërhoqa. I thashë mjekut: Tash zonjushës mund t'ia heqësh dhëmbin. E mori burginë, e ofroi te dhëmbi

dhe ia nxori pa problem. Mjeku mbeti pa fjalë. Pasi e kreu punën, e cila kishte zgjatur sa të kishte shëruar dy-tre pacientë të tjerë, filloi të interesohej për hipnozën dhe autohipnozën, ku biseduam nja gjymë ore me të.

Ç' PËRJETOVA ME DIELLIN

“Kush e ndjek shumë popullaritetin, nuk bëhet dot i popullarizuar”

(Lao Ce)

Gjatë studimeve të shumta, qoftë në astrologji, përgjithësisht në literaturë apo me përvojë direkte, kam parë se dielli ka ndikim shumë të madh, si në botën fizike, ashtu edhe në atë shpirtërore të njeriut. Dielli i prodhon vitaminat më të fuqishme dhe më të ëmbla, që toka i pranon nëpërmes të eterit. Këto vitamina vijnë në tokë si energji e pastër, e pastaj frutat e ndryshme i marrin dhe i shfrytëzojnë për rritjen e vet. Po ashtu, edhe njeriu i merr këto drejtpërdrejt dhe tërthorazi nga ky yll gjigant dhe pozitiv, përndryshe shumë me vlerë për tërë njerëzimin dhe për token tonë me të gjithë banorët e saj, deri tek ata në miniaturë.

Shumë grupe për zhvillim shpirtëror e shfrytëzojnë dritën e diellit për zhvillim të lartë shpirtëror. Dielli e ka shpirtin e vet, me të cilin adeptët mund të komunikojnë dhe prej tij të nxjerrin përvoja dhe dije të papërshkrueshme. Disa thonë se për të marrë kontakt me shpirtin e diellit, njeriu duhet t'i jepë një gjë kurban atij; si, p.sh. një pamje vizuale, të cilën ti më së shumti e don në tokë. Do t'ju tregoj një ushtrim me të cilin mund të lidheni me fuqinë e diellit. Ky ushtrim, edhe pse duket shumë i thjeshtë, fare nuk është për t'u nënçmuar. Me këtë ushtrim bëhet përsëritja dhe thirrja e fuqisë më të madhe e më të lartë në këtë botë, e cila fillon të hapet në ju.

1. Ushtrimi fillon në mëngjes, herët, kur yjet fillojnë për të humbur shkëlqimin e deri kur të fillojë dielli të ngritet në horizont; si dhe në mbrëmje, kur dielli fillon ta humbasë dritën dhe kur yjet fillojnë të shndrisin.

Është mirë të ushtrosh në një vend, ku ti nuk vërehesh prej të tjerëve gjatë kohës së ushtrimeve. Duhet të ulesh në një karrige me shpinë të drejtuar, pa i kryqëzuar duart apo këmbët. Duhet të jesh afër dritares, nëse ka mundësi; me fytyrë, në mëngjes, kah lindja; kurse, në mbrëmje, kah perëndimi. Nëse nuk ke mundësi që ta shohësh diellin, ose atë ditë është mjegull, atëherë ktheje trupin dhe fytyrën kah lindja ose perëndimi.

Koncentrohesh drejtpërdrejt në diell. Të gjitha mendimet tjera i ndalë dhe vetëm në atë fenomen fizik të diellit koncentrohesh. Nëse ka mundësi, është mirë që rrezet e diellit të të bijnë në fytyrë.

2. Stadi i dytë fillon kur ti tenton që tërë atë diell apo tërë sistemin diellor, plotësisht, ta observosh në ty, dhe kjo fuqi tëra mendimet e tua tërësisht i qetëson.

3. Në stadin e tretë dhe të fundit, nxënësi kërkon që tërë atë energji diellore dhe tërë atë dritë ta lëvizë mentalisht dhe ta zgjerojë, ashtu mentalisht dhe me shpirt, derisa t'i përfshijë të gjitha planetet me atë dritë që ka marrë në vete. Pra, ju duhet që në fillim të paramendoni një diell, që po shkon gjithnjë duke u rritur në një qenie të pastër trupore, me vetëdije të pastër, pa formë, i cili është ndarë prej trupit fizik e i cili po identifikohet me të gjitha format dhe qeniet që ekzistojnë në Univers.

Në këtë kohë nuk guxon kurrsesi të humbësh vetëdijen; duhet të luash rolin e një dëshmitari në atë shfaqje që po merr një pikë shumë të lartë. Imagjinata duhet të jetë sa ma e pastër. Në këtë kohë duhet të keshë një besim të fortë, se ti je një shpirt e jo materie, me një bindje të fortë se je i lidhur ngusht me veten e jeten e Universit. Mendimet tuaja pandërprerë duhet të kumtojnë se ti je i pakufishëm.

Ushtrimi bëhet një vit, asnjëherë pa u ndërpre. Mirë është që para ushtrimit vetvetes t'i japësh sugjestione pozitive, se ti je i fortë, se ke në vete dritë, se ke gjetur dhe

njuh të vërtetën etj. Kurse në mbrëmje ndjell paqe, qetësi, liri, vetëbesim etj. (lutesh për to).

Ky ushtrim të sjellë të mira të papërshkrueshme, nëse e bën me zemër dhe me rregull.

Po u tregoj sesi më ka ndodhur disa herë me diellin, kur iu kam dorëzuar dhe e kam dashur. Zakonisht ky ushtrim bëhet kur dielli fillon të humbë forcën rrezatuese, para mbrëmjes; se ai mund të t'i dëmtojë sytë, edhe pse në këso rastesh shpirti ka forcë mbrojtëse të syve.

Isha një herë duke udhëtuar për te miqtë e vëllait, Njaziut, për në Gelacë. Duke udhëtuar, nëpër fusha të bukura, vetë, pa asnjë njeri, kënaqesha me bukuritë e natyrës dhe ishte një kohë kur dielli kishte filluar të dobësohej. Në mes të fushave, në një kodër të vogël, jam ndalur dhe m'u ka kujtuar si një shoqe sllovene më kishte mësuar t'i drejtohesha diellit me dashuri dhe të shikoja në të drejtpërdrejt, duke i thënë: Diell, unë të dua! E në kët rast duhet t'i ngritësh duart kah dielli e pandërprerë të shikosh atë. E bëra të njëjtën gjë dhe me besim të plotë i thashë ."Diell i dashur, unë të dua"! Fillova ta shikoja me koncentrim të plotë, duke pritur se çka do të ndodhte më tutje. Një herë m'u duk vështirë ta shikoja direkt, se drita e tij më dukej shumë e fortë; por, dikur, papritmas, sytë e mij bënë një perde, e cila shumë lehtë ma mundësonte shikimin në diell. Pas pak fillova të shoh disa lloj ngjyrash dhe atë pastër; pas një minute koncentrim të plotë, u hap një mrekulli, thua e papërshkrueshme për mua. U hap një tunel drite, me ngjyra tejet të thekshme dhe të mrekullueshme. Tuneli i dritës shtrihej prej meje e deri në diell. Ky tunel i përngjante sikur njeriu dëshiron të udhëtojë nëpër botëra të ndryshme astrale, siç kam udhëtuar shumë herë, po këso tuneli ende nuk kisha parë deri më tash. Tuneli lëvizte disi, po ishte i papërshkrueshëm. Unë ndjeja një kënaqësi, një rehati e dashuri të papërshkrueshme. Vetëdija ime ishte plotësisht e qartë. Një herë e bëra një provë, duke e

larguar shikimin prej atij tuneli ngjyrërash mahnitëse dhe e shikova fushën rreth meje me gjelbërime, por prapë pata aftësinë të vazhdoja atë shikim, i cili nuk më humbi fare. Në këtë rast iu falënderova Perëndisë për këtë të mirë që ma mundësoi një shikim fantastik të këtillë, i cili më qetësoi trupin dhe shpirtin, e i cili më mbushi me vetëbesim për punën spirituale të mëtutjeshme. Pasi që shikova mjaft në këtë mrekulli, Tuneli i Dritës u zhduk dhe unë përsëri vazhdoja rrugën me atë kënaqësi të madhe shpirtërore. Kjo ngjarje më la gjurmë të mira e të thella shpirtërore.

SI, ME VETËDIJE, E NDRYSHOVA ËNDRRËN, E CILA, MË VONË, MË NDODHI NË REALITETIN FIZIK

*“Ai i cili e di që ka mjaft, gjithmonë ka për të pasur mjaft”
(Konfuqi)*

Isha në botën eterike me vëllanë tim, Qazimin, si të them duke ëndërruar, por kisha vetëdije. Isha në një vend të panjohur në botën eteriko-astrale, mirëpo e kisha për detyrë që një femër të re, e cila kishte rreth 22-25 vjet, e bukur, si një japoneze, ta përcillja dhe ta ruaja. Tre persona të veshur njëjtë e përcillnin mbrapa dhe donin t’i bënë dëm. I thashë Qazës se këtë femër duhej ta përcillnim, se unë duhej ta ruaja. Qaza me gjak të nxehtë deshi t’i kapte e t’i rrihte këta tre vetë. Unë nuk e lejova. Vajza ngutej që të ikte prej tyre, ata nguteshin ta zinin, ne nguteshim ta shpëtonim; kështu që të gjithë nguteshim. Dikur ajo hyri në një shtëpi, ashtu që pas saj hynë edhe ata tre; veç unë e Qaza nuk hymë, meqë e dija se këta persona nuk mund t’i bënë asgjë brenda. Pas pak doli vajza jashtë, e po ashtu edhe ata tre personat prapa saj; e përcillnin dhe e pritnin momentin e duhur. Qaza, përsëri, tha: Po i rahi të tret; por unë e luta që të mos rrihej me ta, se nuk ishte mirë. Megjithatë, Qaza, papritmas, ia ngjiti njërit, i ra me grushta dhe e shtriu përtokë, duke e lënë pa vetëdije. Kur e pashë Qazën duke u rrah me ta, edhe unë ndërhyra, duke ia ngjitur njërit me fuqi e duke e hedhur si një thes letre në largësi. Por në atë moment m’u kujtua se unë isha në botën eterike, me vetëdije, dhe unë isha krijues i realitetit tim, ndaj unë mund ta ndryshoja ngjarjen. Në çast, me fuqinë e mendjes, plotësisht e bllokova atë ngjarje. E ndala ngjarjen, kohën dhe lëvizjen: Qaza u shtangua; edhe ata tre personat po

ashtu; vetëm unë kisha mundësi të lëvizja e të bëja çka të doja (të tjerët ishin plotësisht të palëvizshëm). Kjo pamje i përgjante një epizode filmi në video-rekorder, të cilin e ndalë në pauzë. Dhe, prej atij momenti, e ktheva ngjarjen mbrapa, deri aty ku Qaza ende nuk kishte filluar të rrihej. Në këtë moment ngjarja e mëparshme u fshi dhe unë fillova të krijoj ngjarje të re, si unë doja vetë. E bëra sikur Qaza po i ndalte ata tre vetë, po i pyeste se çka po donin dhe po i luste që të mos e ngucnin atë femër, se ishte detyrë jona ta mbronim; kështu ata, pa problem, shkuan pa bërë fjalë me ne. Pasi e krevea këtë në eterik, u zgjova në materie me shpresë se e kisha ndërruar realitetin...

A doli kjo “ëndërr” në realitet? Po, u bë realitet dhe pikërisht kështu përafërsisht veq me Qazen e tre personat më ka ndodhur: Një ditë, në Mynih të Gjermanisë, erdhi Qaza te unë, në banesë, të më vizitonte. Në atë kohë doja që, në banesën ku banoja, të bëja një mbrojtje kundër rrezatimeve të ndryshme teknike, kosmike dhe nëntokësore; për këtë duhej që vetë ta ndërtoja një mjet mbrojtës prej druri të fortë, ku duhej vetë të gatroja në dru disa simbole të veçanta. Mbrojtja quhej “Atlanta” dhe e kishte prejardhjen prej Egjiptit të lashtë. Po ashtu më nevojiteshin edhe dy tela bakri, për radiestezi, që të bëja të ashtuquajturat antenat “L” (të cilat i përngjajnë germës L), për hulumtimin e rrezatimeve negative në banesë, tek unë dhe tek të tjerët; dëshiroja që edhe shokun, Musë Arapi (Fatos ne e quanim), nga Ferizaji, ta ushtroja në këtë lëmë me hipnozë dhe radiestezi.

E luta Qazën që të më dërgonte, me kerr, deri në një vend, ku gjuheshin mbeturinat: dërrasat, telat e lloj-lloj gjërash të ndryshme. Qaza e parkoi kerrin në vendparkim dhe u futëm brenda në atë vend të madh, ku kishte kanta të mëdha, ku hidheshin lloje të ndryshme mbeturinash; mirëpo, këtu kishte rregull dhe dukej pastër. E lash Qazën në oborr, duke pritur, dhe shkova t’i gjeja gjërat që më nevojiteshin.

Ishte rregull që kur e gjeje atë send, duhej të shkoje në byro e ta paguaje, me çmim të volitshëm, pothuaj simbolik. Telin e gjeta, por më nevojitej një dërrasë e fortë, e shkurtër dhe “e shëndoshë”. Në kantën e madhe kishte vetëm dërrasa të buta të qamit e të tjera nuk mund të gjeja. Rastësisht, shikova se ku gjendej Qaza, dhe ç’të shohësh: në mes të oborrit e kishin rrethuar tre vetë (punëtorë të atij vendi), ku njëri e shtynte Qazën për gjoksi, kurse ai refuzonte të dilte jashtë. Shpejt vrapova deri te ta. Kur më panë, pak u tërhoqën, se kujtuan mos po i sulmoja. I pyeta se çka ishte puna? Njëri tha: ky njeri nuk do të dalë jashtë oborrit, e këtu është i ndaluar qëndrimi pa punë. Iu thashë se Qaza po më priste mua dhe se ishte vëllai im. Nuk ka nevojë që të nervozoheni e të përdorni dhunën, ne tash po shkojmë... U qetësuan të gjithë, se Qaza veç ishte bërë gati të rrihej me ta; ai ende shante në vete. Pasi hypëm në kerr, Qaza tha më ndalte diçka përbrenda meje që mos të rrihem... se ata kishin qenë idijotë të vërtetë është dashur ti rrah ata.

Fillova të qesh. M’u kujtua se para një jave e kisha ndërruar ëndrrën dhe për këtë arsye nuk ka pasur gjasa të rriheshin; përndryshe, me siguri, po të mos e kisha ndërruar ëndrrën, ne do të ishim rrahur me ta, pa arsye, si në ëndrrën paraprake. Pra, ëndrra doli realitet.

SI HYRA NË NJË TUNEL DRITE TË KALTËR DHE DOLA NË NJË DIMENZION KU ISHTE ÇDO GJË E MUNDSHME

“I varfër, plak dhe i sëmurë, është kulmi i fatkeqësisë në këtë tokë”

(Lao Ce)

Shpesh kam dyshuar në një grua të një kushëririt tim, e cila quhej Cv...Ishte malazeze dhe i dinte fshehtësitë e artit të zi - magjisë së zezë. Një natë, vendosa të shoh në ëndërr, me vetëdije, se a më kishte bërë ajo magji dhe kush m'i kishte dhënë ato magji të zeza, nëse ajo nuk m'i kishte dhënë drejtpërdrejt.

Në botën tjetër pashë dy fëmijët e rritur të asaj femre, A... (djalë) dhe D...(vajzë). Nëna e tyre ua kishte dhënë një letër të vogël, të shkruar dhe mirë të mbyllur, të ma binin mua. D., motra, ia jep A., vëllait të vet, atë “letër” të vogël, ku A. e hap dhe ma jep letrën të hapur. Në këtë moment, posa e preka, e ndjeva se është e ndalueshme kjo letër dhe e rrezikshme për mua dhe ai person nuk kishte guxuar ta bënte këtë gjë me mua. Posa e mora letrën në dorë, ku shkruante diçka që unë, në atë kohë, fare nuk e merrja vesh, filloi diçka e padukshme, si hije e zezë, të më ndiqte. Unë nuk e shihja fare këtë hije, e cila më sulmonte e nuk më linte askund vend e rehati. Duke ikur kalova nëpër një vend, ku një femër e re dhe e bukur, ua shikonte ardhmërinë njerëzve dhe i shëronte ata. Ajo më thirri prej së largu në emër dhe mbiemër: O Salih Basha, a nuk po sheh, a ?! Unë e kuptova që tha se nuk po e shihja atë hije, që po më ndiqte. Ktheva kokën dhe pashë atë

femër që ishte ulur në një vend, këmbëkryq, dhe i shkonin njerëzit, me rend, për t'u shëruar. U ula në dy gjunjë dhe shikova kah qielli, ku, me fuqinë e mendjes, e hapa një tunel të dritës së kaltër, i cili filloi të hapej dhe sillej si një dredhë e kaltër. U ngrita në këmbë dhe u futa në të, ku fillova udhëtimin eterik nëpër atë tunel, derisa dola në një dimenzion, ku e takova udhëheqësin tim shpirtëror, i cili më priste, së bashku me një fëmijë të vogël, 5-6 vjet, që dukej aq i ri nga mosha. Ky fëmijë ishte i dashur dhe dëshironte disi të më mësonte të luaja me të së bashku me mësuesin. Mësuesi shpirtëror ishte si një njeri 50-60 vjeçar. I hollë në trup, me fytyrë pak të gjatë dhe simpatik, serioz e shumë i mençur, i cili më mësonte si të punoja në atë botë dhe në botërat tjera; më mësonte si ta shfrytëzoja energjinë psikike dhe si të manipuloja me të. Mësuesi merrte lloj-lloj formash dhe më sulmonte që unë të mbrohesha dhe të dija, aso çastesh, se çka të bëj. Së pari, me dorë të djathtë manipuloja me objekte, pastaj në dorë mora një kamxhik, po dredha e hollë e kamxhikut ishte nga energjia. Me këtë shkop, me telepati, i tërhiqja objektet e ndryshme kah vetja, ku pastaj duhej t'i ktheja në vend, pa e huqur pikën e mëparshme. Po, isha duke u mësuar, dhe kur e ktheja me fuqi të mendjes objektin mbrapa, në fillim nuk mund t'i ndalja në vendin e duhur dhe ai shkonte e thente diçka (bënte ndonjë dëm). Kështu ushtrroja derisa mësohesha plotësisht të ndalja objektin në vëndin e caktuar. Disa objekte i shkatërroja, por prapë i riparoja. Engjëlli-djalosh i vogël kënaqej me mua kur kisha sukses, po edhe kur gaboja. Ishte plotësisht i pasherr, i pastër në mendime dhe sjellje, fliste butë dhe qartë. Mësuesi merrte forma jashtëzakonisht të ndryshme, herë bëhej i fortë e i dijsëm pa masë, po ndonjëherë merrte edhe forma trishtuese dhe shfaqej si ndonjë gjigant i pathyeshëm. Një rast, brenda në mua, pa folur, e ndjeva mësuesin, me telepati, kur tha se “tash po bëjmë gara se cili prej nesh po del më shpejt në anën

tjetër të tokës!” Mësuesi që në atë moment kishte një formë të papërshkrueshme gjiganteske u zhduk, dhe unë tash i bija përmes tokës dhe dilja në anën tjetër të botës. Dola në një bregdet. Para se të dilja në sipërfaqe të ujit, u ndala dhe shikova ngadalë mos kam dalur unë para mësuesit. I nxora veç sytë mbi ujë dhe pashë mësuesin se kishte marrë formë normale, të njeriut, dhe qeshte me dashuri në breg të detit e më priste që të dal tek ai. Pasi dola edhe unë, e pyeta sesi kishte ardhur kaq shpejt. Mësuesi m’u përgjigj thjesht e me dashuri: I kam rënë “Rrugës së Qumështit”!

SI I SHËRUAM HELMET UNË E SAMIU DHE SI E ZBULUAM SE ATO ISHIN PASTËR MAGJI E ZEZË

*“Helmin që fut në gojën tënde, mund të të helmojë vetëm ty,
por helmin që nxjerr nga goja jote mund të të helmojë ty vet
dhe mijra të tjerë”*

(Salih Basha-Mistik)

“Në qoftë se dëshiron ta ndërrosh botën, fillo prej vetes”

(Konfuqi)

Helmet, të cilat Serbia (e asaj kohe) i hodhi në mënyrë misteroize në Kosovë, shkaktuan dëme të mëdha në rininë shqiptare kosovare, si fizikisht, ashtu edhe psikikisht; siç dihet, pati një numër të madh të helmuarish. Shtypi një kohë të gjatë shkruante se njerëzit nuk kishin gjurmë helmimi në gjak. Kah fundi dolën disa ekspertë botërorë, të cilët konstatuan se qenka një lloj helmi luftarak. Simbas hulumtimeve që kam bërë në atë kohë, kam konstatuar se ato nuk ishin helme, por pastër magji e zezë. Kah fundi i eksperimentit është hedhur një lloj helmi i lehtë ushtarak, i cili ka lënë gjurmë helmimi në gjak, sa për ta mbuluar të vërtetën tjetër. Ky ka qenë një lloj eksperimenti i një arme psikike. Në atë kohë, nuk kam guxuar të flas, sepse, së pari, askush nuk do t'më kishte besuar dhe, së dyti, kisha frikë, meqë nuk isha i mbrojtur sa duhet nga disa magjistare e priftërinj të zi të Serbisë (magjistar të magjisë së zezë). Këto “helme” në fillim kanë qenë pastër magji e zezë; se a do të besojë dikush apo nuk do të besojë, kjo është çështje personale e secilit prej jush. Magjia e zezë njihet shumë mirë te populli shqiptar, por edhe në mbarë botën. E di populli ynë

sa shpesh ka ndodhur që, natën e martesës, kur nusja dhe dhëndëri, pa pasur mbrojtje psikike (hajmali) kanë shkelur në magji të zezë, i ka kapur llahtaria psikike, ku pothuaj të dytë kanë luajtur nga mendja dhe simptomet kanë qenë të ngjashme si te rasti “i helmimit” te ne në Kosovë (dhe në disa vende të botës). Raste të tilla të sëmurësh nga magjia e zezë kam shëruar vetë; në këto raste është sëmurë dhëndërri, nusja ose te dytë. Simptomet e sëmundjes, pra, kanë qenë të ngjashme me ato “të helmimit” të të rinjve tek ne në Kosovë.

Vëllanë, Samiun, e kisha mësuar që ta zotëronte e ta përdorte autotransin dhe të shikonte në dimensionin eteriko-astral. Te ne, në Kosovë, kishte filluar llahtaria e “helmimeve” misterioze, të cilën e aplikonte Serbia (e asaj kohe). Vëllai atëbotë ishte duke i vazhduar mësimet në shkollën e mesme të Suharekës. Ai e tregonte rastin sesi nxënësit ishin helmuar, ndër ta edhe ai vetë; nxënësve iu binte të fikët, i kapte llahtaria; kishin kokëdhembje; u dhimbte trupi; kishin shqetësime e frikë shpirtërore etj. Samiu filloi të tregonte sesi me autotrans iu kishte ndihmuar nxënësve të ndryshëm në shkollën e tij. Ai kishte rënë në autotrans dhe kishte filluar t’i shikonte trupat energjistikë të nxënësve. Rreth trupave energjistikë të tyre ishte mbledhur një mjegull e ndytë dhe e programuar. Ajo ndikonte në ndërrijen e nxënësve. Dhembja ua humbte vetëdijen. Ajo energji e programuar ua bllokonte çakrat, i mbushte me mjegull të zezë ato ose ua ndërronte drejtimin prapa. Me dijen e vet dhe fuqinë që kishte në atë kohë, si amator në këtë lëmë, nxënësve “të helmuar” ua largonte pa problem ato “mjegulla” dhe nxënësit ngriheshin në këmbët e veta për pak kohë.

Të nesërmen Samiu shkon në shkollë dhe në gjendje transi fillon ta kontrollojë objektin shkollor; kalon në të kaluarën e afërt, ku sheh si, nëpër errësirë, katë vetë, të maskuar e të veshur zi, vijnë, ku kuriri i shkollës ua lë derën çelur, me qëllim, dhe ata hyjnë nëpër disa klasë shqiptare dhe

e gjuajnë ”helmin”. Para se të hynin në klasë shokëve u thotë se në klasën e tyre kishin qitur helm mbrëmë, ndaj do të ishte më mirë të mos hynin, se do të mund të helmoheshin; po askush nuk i beson dhe hyjnë të gjithë në klasë, e, ndër ta, edhe Samiu. Posa hyjnë në klasë, pas disa minutash, i rrok ”helmi”, dhe nxënësit fillojnë të bijnë pa vetëdije.

Këto raste i kam hulumtuar dhe kam konstatuar se këto ”helme” nuk ishin helme të zakonshme, po ishin pastër maxhi e zezë, e cila ishte programuar nga disa magjistarë të zinj dhe ekspertë të këtij lëmi nga Serbia (e asaj kohe). Këta e kishin marrë për punë elementin e tokës dhe e kishin shndërruar në pluhur, duke i shtuar një aromë kimike për t’i humbur gjurmët dhe dyshimin e për t’u kënaqur njeriu duke i marrë erë, derisa ta thithte mirë atë ”aromë”. Këtë magji e kishin programuar veç për shqiptarë. Ky program ishte bërë në botën astrale, ku çdo popull e liron një energji mentale të besimit se i takon atij populli të veçantë. Ky lloj magjie ka qenë edhe si eksperiment magjik dhe si armë psikologjike sekrete.

Me hipnozë i kam shëruar shumë persona të ”helmuar”; vetëm një ose dy seanca hipnotike, më nuk i nevojiteshin personit të ”helmuar” dhe shërohej përgjithmonë; kurse ata që nuk hipnotizoheshin me 1, 2 ose 3 terapi të frymimit shëroheshin plotësisht.

SI KRIJOHET REALITETI OBJEKTIV NË JETËN TONË NËPËRMJET SUGJESTIONIT

“Vetëm dy kategori njerëzish mund t’i largohen çdo ndryshimi: njerëzit shumë të mençur dhe njerëzit budallenj.”
(Konfuqi)

Sugjestionet në përgjithësi gjithnjë më kanë interesuar, si ato pozitive, ashtu edhe ato negative. Më ka interesuar ndikimi i tyre në jetën tonë të përditshme, më ka interesuar se çka mundet njeriu të arrijë me anën e tyre. E kam parë se çdo lëmë i jetës sonë është nën ndikimin e sugjestionëve. Kur një sugjestion i jepet njeriut, qoftë pozitiv apo negativ, tek ai person, në qoftë se beson thellë në atë që i është thënë, atëherë tek ai kanë për t’u bërë ndryshime të thella dhe rrënjësore në jetën e tij, si për mirë, ashtu edhe për keq. A thua munden prindërit ta dëmtojnë fëmijën e vet duke i dhënë sugjestionë, si p.sh.: “ti je dembel”, “ti je idiot”, “ti je i pavyeshëm” etj. Po, besa, edhe shumë e dëmtojnë; bile aq sa, më vonë, vështirë që ai fëmijë edhe të mund të përmirësohet.

Po nëse prindërit i thonë fëmijës një sugjestion pozitiv, p.sh. “ti je i mirë”, “ti je i dashur”, “ti je punëtor”, “ti je trim” etj., a do të bëhet fëmija i tillë? Po; do të bëhet, por me kusht që këto sugjestionë pozitive të përsëriten shpesh te fëmija. Tepër rrallë prindërit i përdorin sugjestionet pozitive te fëmijët e vet. Ne marrim edhe prej rrethit ku jetojmë lloj-lloj sugjestionesh, si pozitive, ashtu edhe negative; zakonisht ne marrim më shumë sugjestionë negative sesa pozitive. Në popullin tonë njihet një fjalë e urtë që thot: “Me kë shkon, ashtu bëhesh.” Kjo është e vërtetë, se

nëse një njeri i dobët në karakter rri me një person që ka karakter të fortë, fuqia e fjalëve apo e sugjestionëve do të ndikojë tek personi i dobt dhe ai fillon të emitojë personin më të fortë, me apo pa vetëdije. Tema e sugjestionëve është lëmë në vete, ku ka shumë për t'u sqaruar e folur; po këtui unë do të ju flas për një përjetim të drejtpërdrejtë që kam pasur njëherë, kur kam rënë në gjendje autotransi vetëm e vetëm për të parë sesi do të ndikojë fuqia e një sugjestionit, qoftë pozitiv apo negativ, në ne dhe jashtë nesh.

U futa vetëdijshëm në një nivel të thellë të ndërdijes. Qëllimi im ishte që saktë të shihja sesi do të ndikonte një sugjestion, i cili mbillet me bindje te ne, në ndërdije, dhe çka do të ndodhte në jetën e përditshme, në materie, me ne.

Hyra me një zbrazëti, ku nuk kishte asgjë; asgjë ende nuk ishte krijuar, asgjë nuk kishte filluar në jetë. Në atë vend dhe në atë gjendje po fillonte jeta jonë, e mirë dhe e keqe, varësisht si ne e krijojmë. Unë kërkova të di sesi ndikojnë sugjestionet pozitive dhe negative në ne. Këtë herë e zgjodha një sugjestion pozitiv, por e shihja edhe sugjestionin negativ si po zhvillohej; se nuk kishte mundësi që vetëm një sugjestion i vetmuar të zhvillohej, por, për krah të mirit, ekzistonte edhe sugjestionit i keq, se ishte ligj kosmik i iluzionit, ligj kosmik i botës materialo-eterike. Njëra pa tjetrën nuk shkonin, po në mes të së mirës e të së keqës, njëra triumfonte dhe bëhej realitet i jetës sonë të përditshme.

E mora sugjestionin pozitiv, i cili erdhi prej mendjes si një top i bardhë, si një këpurdhë e bardhë e rrumbullakët, e cila u lëshua në atë zbrazëti dhe u mboll e lëshoi "rrënjë". Sa herë që unë mendoja pozitivisht për atë sugjestion, ajo këpurdhë rritej e zmadhohej. Mirëpo, ndonjëherë e mendoja të kundërtën e atij sugjestionit, anën negative, dhe, përkaj këpurdhës së bardhë, spontanisht mbinte një këpurdhë e zezë, po ishte pak më e vogël se këpurdha e bardhë. Këto dy ngjyra dhe forma m'i jepte ndërdija, që unë të kuptoja më mirë

formën e sugjestionëve; mirëpo, sugjestionet ishin plotësisht të gjalla, ishin jetë, rrugë krijimi apo shkatërrimi. Sa herë që mendoja pozitivisht për atë, këpurdha e bardhë rritej, po sa herë që mendoja negativisht dhe dyshoja në sukses, këpurdha e zezë rritej. Kështu bëhej një luftë e vërtetë në mes të dy sugjestionëve. Rritja e këpurdhave e kishte një kufi. Kur këpurdha e bardhë arriti pjekurinë e vet dhe triumfoi, këpurdha e zezë u bllokua në rritje dhe mbeti disi në pritje për të ardhmen, me shpresë se do të kultivohej si duhet. Posa e arriti kulminacionin e pjekurisë, këpurdha e bardhë u hap dhe u bë si një tunel i përbërë prej natyrës, rrugëve, njerëzve, bjeshkëve; në fakt: si materia në realitetin tonë objektiv, por ajo materie nuk shtrihej siç ne e shohim materien në jetën tonë të përditshme, po ishte e shtrirë në gyp; sikur një gyp e shikon në njërën anë dhe e sheh daljen në anën tjetër të gypit; po rreth gypit shihej e ardhmja kah kisha për të shkuar, respektivisht ardhmëria që sugjestionin pozitiv, apo unë me bindjet e mia e kisha formuar. Shkoja duke ecur nëpër atë tunel, ku shihja ardhmërinë, ende të pakrijuar plotësisht; në një pikë të atij gypi, që ajo këpurdhë e kishte formuar, papritmas u çel plotësisht gypi dhe u shtri për tokë; dola në materie, dhe fillova jetën si unë e kam formuar, si tash, në mënyrë pozitive me njerëz, i lumtur, i shënoshë, pa probleme. E nëse do të hapej këpurdha e zezë, edhe tuneli njëjtë hapej, dhe jeta shihej me mundime pa kuptim.

SI I BËRA DISA SHËRIME INTERESANTE ME HIPNOZË

*“Të gjitha fatkeqësitë dhe çrregullimet në botë rrjedhin nga
mungesa e dashurisë në mes veti”*

(Mo Ce)

*“Fatkeqësia hyn vetëm në ato dyer, të cilat ne ia kemi lënë të
hapura*


(Mo Ce)



Pacient i ri, N. Prenki, gjatë një seance të shërimit me
hipnozë
(fotografoi: Salih Basha, mistik)

As vetë nuk di sesa njerëz kam shëruar. Prej se jam duke e shkruar këtë libër e përpara kanë kaluar mbi 20 vjet që punoj në shërimin e njerëzve. Në këto vite jam duke shëruar në mënyrë intensive; përpara nuk kam qenë aq intensiv, po

kam pasur shumë suksese në shërimin e njerëzve, qoftë me hipnozë, qoftë me metoda tjera të ndryshme, si me bioenergji, masazhë, frymim e metoda të tjera personale. Mund të them lirisht se kam shëruar sëmundje që mjekësia nuk ka mundur t'i shërojë, e që janë të lloj-llojshme, duke filluar prej migrenave e kokëdhembjeve të ndryshme, dhembjeve të shpinës, të barkut, të lukthit, të fytit, të tërë trupit; pastaj, mundimet e ndryshme, qoftë fizike apo psikike etj.



Pacienti në trans të thellë i largon
blokadat në trupin e vet eterik
(fotografoi: Salih Basha, mistik)

Sëmundjet psikike (që i kam shëruar) janë po ashtu të ndryshme, duke filluar nga frika prej vdekjes, frika në vozitje, frika në tunel, frika prej natës, frika prej ujit e lartësisë etj. Kam zbuluar me hipnozë dhe me fuqinë time të mbrendshme, magjitë e zeza dhe i kam shkatërruar ato; kam shëruar streset e ndryshme dhe depresionet deri në shkallën më të lartë, gati deri te çmeduria; paharmoninë në jetë e familje; varshmërinë prej drogës, alkoolit e

duhanit; po ashtu i kam shëruar njerëzit që u është bërë

shprehi të luajnë në “lojë të fatit” e nëpër automate të ndryshme e shumë e shumë të tjera. Me përsosshmërinë dhe marrjen e përvojave të shumta jetësore dhe duke e përdorur hipnozën mistike, kam arritur që pacientin, me pak terapi, ta shëroj për 1, 2 deri në 5 terapi dhe këte shumë rrallë kaqë terapi. Meqë kam kontakt edhe me hipnotizues këtu në Zvicër, tek këta terapatë, nëse sëmundja është akute, mund të ketë deri në 10 terapi, e kjo varet nga personi; sakaq nëse ndonjë sëmundje është kronike, këtu terapatë mund të zgjasin edhe me muaj të tërë deri te shërimi i plotë.

Do t’ju shkruaj për disa persona, qofshin femra apo meshkuj, të cilët kanë qenë të sëmurë prej sëmundjeve të ndryshme dhe në shkallë të ndryshme të sëmundjes. Pacientët kanë qenë prej nacionaliteteve të ndryshme, si dhe në moshë të ndryshme. Unë, si shërues natyror: Mistik-hipnotizues, nuk guxoj kurrsesi të bëj dallime në njerëz, as në racë, as në kombësi, as në gjini, as në moshë. Çfarëdo patienti, i çfarëdo nacionaliteti - për mua janë të njëjtë, siç janë edhe para Zotit, i cili nuk bën dallime.

Lloje të shumta shërimesh kam bërë në Kosovë, në Gjermani si dhe këtu në Zvicër. Kur kam qenë në Mynih të Gjermanisë kam pasur shumë suksese në shërim. E kam shëruar një person nga Gjilani: H.M., i cili kishte qenë disa muaj në burg dhe e kishte marrë një sëmundje të lëkurës, ashtuquajtur “sporiaza”, të cilën mjekët nuk kishin mundur ta shëronin. Këtë person e kam hipnotizuar dhe e kam dërguar në ardhmëri, ku e ka gjetur një ilaç, si yndyrë, dhe ka filluar ta lyejë trupin me të. Ky ilaç, pas terapisë së parë, ka filluar të ndikojë dhe ia ka zvogëluar sëmundjen. Në të tretën terapi është shëruar dhe më nuk i është lajmëruar; herën e fundit në telefon tha se nuk ka më sëmundje në lëkurë.

Ka qenë një rast shumë interesant me një plakë nga Bosna, ashtuquajtur Martinović Hajrija, e lindur më 7. 09.

1928, në Bosne. Kjo paciente jetonte në Mynhen dhe i kishte këto vështirësi:

1. Dhembje të këmbëve, nuk mund të ecte vetë, gati i ngrihte këmbët zhagas; për krahësh e çonin në banjo dhe për të fjetur.
2. Duart i dhimbnin, i dridheshin, nuk kishte forcë, vetë nuk mund të vishej as të hante.
3. Kishte frikë për çdo gjë.
4. I dhimbte shpina.
5. Nuk mund të merrte frymë si duhet.
6. I dhimbte lukthi.
7. E kishte sheqerin të rritur shumë në gjak.
8. Nuk kishte forcë fare.
9. Mjekët ia kishin dhënë diagnozën: “Sëmundje e Parkinsonit”.

Kjo plakë ishte plakë simpatike, e dashur dhe e mençur; prej vuajtjeve të mëdha që kishte përjetuar në luftën e Bosnës, ishte sëmurë edhe më shumë. Rrinte në dy dimensione, ishte shpesh e lidhur me ndërrijen e vet drejtpërdrejt. Me këtë plakë i kam punuar veç katër terapi. Kur kam filluar punoj, në terapinë e parë e kam pastruar prej streseve dhe bllokadave në tërë trupin fizik dhe në atë astaral. Natën e parë e ka ndjerë veten menjëherë më mirë, ka hëngër bukë më shumë e më me shije; ka fjetur më mirë dhe i ka ardhur forca më shumë. Me këtë plakë kam punuar në botën e engjëjve, ku engjëlli udhëheqës e ka mësuar çka të bëjë dhe si të shërohet. Në terapinë e dytë ka filluar pak të rri në këmbë dhe të ha vetë me lugë. Në terapinë e tretë e të katërt ka qenë më e fortë, dhimbjet iu kanë zvogëluar, forca iu ka shtuar, duart nuk i dridheshin më. Pas terapisë së katërt, vajza e vet më ka telefonuar e më ka thënë se për herë të parë ka filluar vetë të ecën dhe ka shkuar vetë në WC. Me këtë plakë nuk kam pasur mundësi të punoj deri në fund, se e kam lëshuar Gjermaninë dhe jam shpërngulur në Zvicër.

Një ditë, në Mynhen, m'u paraqitën një femër e një mashkull, burrë e grua, të Bosnës, ashtuquajtur Milica Popoviç (e lindur më 11. 1.1949, në Bosne) dhe Stevo Popoviç (i lindur me 8. 4.1945, po ashtu në Bosne). Milica kishte kokëdhembje mbi 15 vjet pandërprerë; askush nuk kishte mundur t'i ndihmonte deri tash; kurse Steva e kishte gishtin e madh të këmbës së majtë të sëmurë, nuk i qarkullonte gjaku dhe i rrinte i mpirë tërë kohën; mjekët i kishin preferuar ta prente dhe të ja largonte nga trupi. Me Milicën kam punuar vetem tri terapi dhe ajo më, me muaj, nuk ka pasur kokëdhembje, është shëruar; kurse me Stevën kam punuar vetem dy terapi dhe gishtit të tij kanë filluar t'i vijjnë ndjenjat, mos t'i mpihej, t'i qarkullonte gjaku normalisht dhe, më, nuk ka pasur dhimbje; d.m.th. e ka shpëtuar gishtin para se mjekët të ja operonin dhe të ja largonin përgjithmonë.

Një djalosh 30 vjeçar, i qujtur Haxhiq Safet, kishte probleme të mëdha shpirtërore. Ky kishte ardhur prej luftës, ku kishte pasur fat të shpëtonte gjallë nga llogori, ku serbët i kishin burgosur dhe torturuar pa masë. Përjetimet fizike dhe psikike ishin shumë prekëse dhe të paimagjinueshme. Kishte marrë trauma luftarake, frikë, fliste jerm natën, ku shpesh binte nga krevati; thjesht: ishte i humbur si person, i pashoqërueshëm, kishte dhimbje në kokë, trup, bark, lukth,shpinë; ishte pa forcë, nuk mund të flente rehat etj. Me këtë person kam biseduar dhe i kam sqaruar se unë mund t'i ndihmoj, po duhej ta përdorte hipnozën. Posa ia kam përmendur emrin "hipnozë" Safeti u zbeh në fytyrë, dhe me zë të lartë tha: "unë nuk dua me hipnozë, se mjaft serbët kanë punuar në Bosne, në llogor, me ne; lloj-lloj eksperimentesh kanë bërë me ne..." dhe u ngrit të shkonte. E qetësova, duke i thënë se nuk do të punoj me të me hipnozë, nëse ky nuk dëshiron; po nëse dëshiron të shërohet, unë do ta përdorja vetëm një teknikë relaksimi dhe gjumi të vetëdijshëm, e cila

do të kishte sukses. Pranoi të punoi në këtë mënyrë pa e përmendur fjalën hipnozë. Dhe, u relaksua e u fut në gjendjen alfa të thellë, ku fillova t'ia pastroja bllokadat, traumat, dhimbjet e, kështu, pasi u zgjua, u lirua dukshëm në trup e në shpirt. Me të i kam bërë edhe disa terapi dhe personi plotësisht i është kthyer jetës normale, të shëndoshë.

Për herë të parë kur erdha në Zvicër, kërkova që të njoftohesha me ndonjë shoqatë apo institut të zhvillimit shpirtëror. Duke kërkuar, u njoftova pikërisht me kryetarin e Shoqatës Parapsikologjike dhe të Shërimit Natyror të Zvicrës, të quajtur "Natur Heilen" (Shërimi natyror) dhe "Schweizer Parapsychologische Gesellschaft" (Shoqata Zvicerane e Parapsikologjisë) me drejtorin e përgjithshëm për tërë Zvicrën, profesor Aleks Schneider. E bëra një termin me profesor, Aleks Shneiderin, dhe shkova në bisedë me të. Ai mbeti i kënaqur me mua dhe e bëmë që në muajin që do të vinte, ta mbaja unë një ligjëratë të shtëpia e tij, të cilën e kishte si një lloj instituti, ku mbaheshin ligjëratat dhe kurse të ndryshme për drejtime të ndryshme të zhvillimit shpirtëror. E lamë që unë, pas një muaji, të mbaja ligjëratën për të interesuarit zviceranë, me temën: "Zhvillimi i mistikës-Tarikati në trojet shqiptare, magjitë e zeza e të bardha, hipnoza dhe shërimi me të". Në këtë ligjëratë erdhën shumë zviceranë, e në mesin e tyre kishte edhe mjekë, si dhe profesione të ndryshme. Këtë natë punova pa ndërprerë 4 orë; orën e fundit e mora një femër, e cila ishte prej qytetit St.Galles dhe quhej Erika Lanc, të cilën e hipnotizova dhe, përkohësisht, ia dhashë aftësinë qartëpamëse; në autotrans e udhëhiqja vetë. Të gjithë mbetën të kënaqur me mua dhe ligjëratën time, ku menjëherë u lajmëruan disa vetë për shërim dhe disa për biseda të ndryshme.

Një femër e quajtur Manuela Kim më thirri në telefon dhe më luti që t'i ndihmoja një shoqeje të saj nga St. Galla, e cila quhej Lea Shvager dhe e cila kishte probleme të mëdha

psikike: kishte frikë të jashtëzakonshme, ishte 12 vjet e sëmure, 6 vjet merrte hapa kundër depresionit dhe frikës, kurse tri vjetët e fundi nuk guxonte të dilte vetë prej frikës, sepse në ditë i merrte 6 hapa kundër depresionit - hapa, të cilët e kishin sjellë në një gjendje shëndetësore të pashpresë për jetë. Këta hapa nuk i kishin ndihmuar për ta shëruar, po, përkundrazi, ia kishin shtuar frikën. Ajo thoshte se “kur, ndonjëherë, dilja në qytet, për të provuar a mos jam më mirë, kur e ndija një zhurmë sado të vogël, aq më rritej zhurma, sa që mua donte të më lëshonte zemra nga frika”. Kur kam punur me Lea-n për herë të parë, frikohej edhe prej meje dhe mezi kam punuar 15 minuta, dhe atë: me sugjestione dhe frymim. Në terapinë e dytë e kam hipnotizuar, edhe pse i frikohej hipnozës. Me 4 terapi plotësisht është liruar prej frikës, depresioneve dhe për herë të parë ka dalur në qytet. Më vonë më tha: “Ma ke shpëtuar jetën! Për herë të parë pas shumë viteve po e ndjej se jam zgjuar prej një gjumi të thellë dhe po mundem ta shijoj jetën si duhet.”

Ka qenë një rast shumë interesant me një femër shqiptare, e qujtur I. B. Ishte e kantonit Graubinden të Zvicrës, vajzë 22 vjeçare, e fejuar, dhe donte këtë vit të martohej. Qysh herët, duke punuar, në një fabrikë, ishte rrëzuar dhe e kishte vrarë pak kryet. Kishte qenë te mjeku dhe i kishin bërë disa kontrollime, por dilte plotësisht e shëndoshë. Një herë vetvetiu i kishte rënë të fikët, po prapë ishte përmirësuar. Pas shumë muajsh sëmuret edhe një herë, po këtë herë i merret zëri plotësisht dhe nuk mund të fliste fare; ishte bërë memece. E çojnë te mjekët këtu në Zvicër, i bëjnë lloj-lloj kontrollimesh, por kot; dhe, më në fund, i thotë mjeku: “Nuk keni shans më të flisni, veç duhet të shkoni në shkollë të shurdhëmecëve dhe ta mësoni alfabetin e shurdhëmecëve me gishta. Një të shtune shkova me një shoqe në një bjeshkë për pushim dhe të dielën e mora një telefonatë, ku një vajzë më lutte që t’i ndihmoja shoqes së

vet, e cila e kishte humbur të folurit. I thashë të më thirrnin para dite, të hënen, dhe doja të flisja me babë të saj. E pashë shqetësimin e babës së I. dhe i thashë: "Sillma, po nuk garantoj për shërim, kësaj as ndokuj tjetër, se Zoti i ka tëra punët tona në duart e veta; dijen që ma ka dhënë Zoti do ta zbatoj tek i sëmuri. E lamë një termin, ku erdhi I. me babanë e vet, Q. dhe një shoqe e saj. I luta që të më linin vetëm me të e ata të prisnin jashtë, ose të shkonin në ndonjë restorant, edhe pse punoja me hipnozë në prezencën e personit të tretë. E mora telefonin e babait të saj, që, kur ta kryeja terapinë, ta thërrisja që të vinte për ta marrë.

I. nuk fliste. E pyeta se a më dëgjonte. Bëri me kokë se po. E pyeta a mund të fliste. Me gjest tha se jo. E luta tash të merrte fletoren dhe kur ta pyesja, të shkruante përgjigjen në fletore. Ajo e mori lapsin e fletoren dhe kështu merreshim vesh me shkrim. Para se të punoja me të, unë i dhashë shpresa dhe i thashë se Allahu ia ka mundësuar njeriut edhe shërimin dhe, tash, në emër të Allahut, ti ke për të folur, po, para së gjithash, unë kam bërë ujë të bekuar dhe ky ujë të gjitha të këqijat ia largon njeriut (ujin e bekuar bej në atë mënyrë që une së pari duhet plotsisht si fizikisht dhe shpirtisht të jam i paster e pastai e këndoi në uij një apo më shumë lutje shumë të fuqishme kundra të këqijave nga Kurani dhe lutje të zgjadhura të mistikve të ngritur shumë lart shpirtisht për këtë drejtim); merre këtë gotë në emër të Allahut dhe laj sytë pak; laje fytyrën dhe mbetjen tjetër të ujit pije. Ashtu bëri. Pastaj i thashë: Emër më të madh se emri i Zotit Allah nuk ka? Padyshim: jo. Atëherë fillo dhe thuaje këtë emër: Allah! I. filloi vetëm buzët t'i luante. Unë i thoja: thuaje me bindje vetëm germën e parë: A! Ti mundesh! Thuaje me forcë, se ky emër i madh i largon të këqijat! Thuaje germen A! Pas një mundimi e qiti një zë tepër të ulët ku mezi se ndihej. Thuaje më shumë! Edhe më shumë! Edhe më shumë! Dhe filloi gjithnjë e më qartë ta thoshte germën: A

, e më vonë tërë fjalën “Allah”. Si e ke emrin? e pyeta. Tha I... Të lumtë! - i thashë. U lirove! Ti mund të flasësh. I falimnderoi Zotit për ndihmën që na dha. Mua më pushtoi një gëzim i madh dhe më erdhi të qaja. Qajtëm së bashku për suksesin e arritur. I. filloi të flasë normalisht. Unë punova edhe me hipnozë, gjysmë ore, dhe e lirova prej dhimbjeve e streseve që i kishte pasur nëpër aurë. Ishte shumë prekës rasti, kur i tregova babës së saj, në telefon, dhe kur erdhën te unë me shoqen e I. Nuk dinin të ndaleshin as babai i saj, as



Agroni qanë dhe e përjeton fëmijërinë me vuajtje
(fotografoi: Salih Basha, mistik)

shoqja, duke qarë; falënderimet ishin të shumta. Me këtë vajzë kam punuar edhe dy terapi dhe plotësisht është shëruar. E kam pasur një rast interesant me një djalë 12 vjeçar, i lindur më 30.9.1989, i quajtur Adrian Burri. Babanë e kishte me dervishët. Tash jetonte këtu, në St. Gall të Zvicrës. Një ditë më thirri nëna e tij dhe kërkoi ndihmë për të birin, ndaj lamë një termin që t’ia bëja një terapi. Si çdo pacienti, edhe këtij ia

bëra një psikanalizë të shkurtër; kishte këto probleme: I dhimbte koka pandërprerë (më vonë e konstatova se flinte në një dhomë ku kishte rrezatime të këqija nëntokësore), i dhimbte barku, syri i djathtë nën vetullë, shpina; ishte nervoz; kishte frikë për të fjetur vetë, se e sulmonte gjithnjë diçka natën dhe në gjumë. Si fëmijë ishte trembur shumë se po e sulmonte diçka në gjumë. Terapinë e fillova prej kokës, duke ia pastruar aurën, duke ia hequr dhimbjen e kokës e kështu me rend. Adriani ishte medium shumë i mirë. Ai i pastroi të gjitha bllokadat me lehtësi dhe i sigurt. Mua më interesonte se kush e sulmonte në gjumë (tash dhe kur ka qenë fëmijë). E ktheva në kohën e kaluar dhe ia dhash aftësinë që të shihte ngjarjen. Adriani filloi të fliste: Po më sulmojnë disa djaj. E pyeta se përse po e sulmonin dhe kush po ia dërgonte. Adriani tha se “është një grua zvicerane, e cila punon me djaj, dhe po m’i dërgon këta djaj, se unë kam në dorë mundësinë për të shëruar në të ardhmen shumë sëmundje të rënda, si alkoolizmin, diabetin, infarktin e shumë të tjera. Kjo grua me këta djaj i sëmuron njerëzit, ndaj nuk don të ketë pengesa për t’i sëmurë në të ardhmen. Adrianit i bëra mbrojtjen e duhur dhe e dërgova, me astral, në shtëpinë e vet, ku gjeti një vend pozitiv dhe neutral, ku do të ishte i sigurt për të banuar e për të jetuar në të ardhmen. Adriani u shërua plotësisht dhe më nuk ka pasur nevojë për terapi shërimi.

Është një rast shërimi i një fëmije dymbëdhjetë vjeç. Quhej Shpëtim Gashi, i lindur me 30.8.1989. I kishte këto probleme: Kishte frikë thuaja nga çdo send; belbëzonte dhe urinonte natën në shtrat. Shpëtimi filloi t’i flasë në hipnozë ato që nuk ishte në gjendje t’i fliste para prindërve kur ishte zgjuar. Kështu që me zbulimin e frikësimeve dhe njohjen e tyre ky u shërua nga urinimi, nga frika dhe belbëzimi. Tregoi sesi kur kishte qenë i vogël, 4 vjeçar, te dajhtë e vet, e kishte frikuar shumë një qen dhe prej këtu kishte filluar të belbëzonte e të urinonte intensivisht në shtrat. Kur ishte rritur

dhe kishte ardhur në Zvicër, përsëri ishte frikuar prej një qeni, kur shkonte me prindërit në një hotel. Frikohej pa masë prej nënës dhe babait kur e merrte ndonjë notë të keqe. Frikohej dhe prej eksperimenteve kur i bënë në shkollë në ndonjë lëndë. Ky fëmijë, pas terapisë së dytë, filloi të mos urinonte më në shtrat, iu përmirësua të folurit, u bë i qetë dhe nuk frikohej më prej qenve dhe prej jetës përgjithësisht.

M A J A

(ILUZIONI, MOSDIJA, HIJA E ZOTIT)

“T’i njohësh të tjerët është mençuri, të njohësh vetveten është mençuri kulminante”

(Lao Ce)

“Rrobat dhe mjekra nuk të bëjnë të shenjtë, por dija e lartë që ta dhuron Zoti”

(Salih Basha, mistik)

Maya (maja) rrjedh prej gjuhës vedante të Indisë që don të thotë: iluzion, mosdije, hije e Zotit dhe në gjuhën e sufizmit quhet Mejaz.

Këto shënime tejet të rëndësishme për ju, lexues të dashur, dhe ju ndjekës të rrugës së të Vërtetës, i kam marrë prej librit “Biseda” (Discourses-angl.) të Resulullah (Avatar, Meher Babës - Mësues i Mësuesve – Resulullah mbi Resulullah (Avatar) mbi Resulet). Këtë temë e kam zgjedhur që ju ta dini kah rrjedh rruga e vërtetë, ku është qëllimi i çdo njeriu në këtë botë, për çka është krijuar kjo botë dhe përse ne jetojmë në këtë Iluzion.

*

*

*

Çdokush dëshiron të dijë dhe ta realizojë të Vërtetën. E Vërteta nuk mund të njihet e të realizohet si e Vërtetë, derisa mosdija të mos njihet e të mos kuptohet si mosdije. Për këtë arsye duhet të njihet *Maja-Iluzioni*, përkatësisht Principi

i Mosdijes. Njerëzit mjaft dëgjojnë dhe flasin për Majën, por pakush prej tyre me të vërtetë e kupton atë. Nuk është e mjaftueshme të arrihet gjer tek të kuptuarit sipërfaqësor të Majës (Iluzionit); shumë me rëndësi është që Maja me të vërtetë të kuptohet ashtu si është. Ta kuptosh Majën apo Principin e Mosdijes, don të thotë ta kuptosh gjysmën e të Vërtetës së tërë Universit. Që shpirti të përforcohet në gjendjen e Vetënjohjes, të gjitha format e Mosdijes duhet së pari të eliminohen.

Për këtë arsye njerëzimi, në çdo mënyrë, duhet ta zbulojë çka është gënjeshtër dhe, si gënjeshtër, prej saj të lirohet. Cila është natyra thelbësore e gënjeshtres? Në qoftë se e vërteta njihet si e vërtetë dhe gënjeshtra njihet si gënjeshtër, do të mbetet vetëm një dukje e njohjes ku më gënjeshtra nuk ka. Gënjeshtra shfaqet atëherë kur për të vërteten supozohet se është gënjeshtër dhe për gënjeshtren supozohet se është e vërtetë; kjo ndodh kur për diçka konsideroni se është, e në realitet ajo nuk është.

Kur vdes i dashuri, shfaqet pikëllimi dhe vetmia. Ndërkaq, ndjenja e humbjes i ka rrënjët tek lidhja juaj me formën, të pavarur nga shpirti. Ajo çka është zhdukur, është formë, e jo shpirt. Shpirti nuk është i vdekur; në natyrën e tij të vërtetë ai askund nuk shkon; ai gjindet gjithkrah. Simbas kësaj, duke anuar për trupin, forma bëhet me rëndësi. Lakmitë e njerëzve, dëshirat, ndjenjat dhe mendimet, janë të orientuara në formë; dhe, kur pas vdekjes, forma zhduket, mbetet vakumi, i cili orientohet në lakminë e humbjes së formës.

Sikurse formës mos t'i kishim dhënë aq rëndësi, nuk do të ishte as pikëllimi, as dëshira për të vdekurin.

Në anën tjetër, ndikimi i Majës bën që gjërat me rëndësi të duken pa rëndësi. Në thelb, e vetmja gjë më e rëndësishme është Zoti; por pak janë ata që për Zotin, dhe veç për Zotin e për të Vërtetën, janë të interesuar. Në qoftë

se njeriu i botës fizike i kthehet Zotit, kjo është kryesisht për shkak të qëllimeve vetiake që njerëzit i kanë në këtë botë. Ai shpreson se nëpërmes Zotit ka për t'i plotësuar dëshirat dhe shpresat dhe deri atje, nëpërmes intervenimeve hyjnore, kanë për t'iu paguar të gjitha padrejtsitë që iu kanë bërë. Ai nuk e kërkon Zotin për të Vërtetën. Ai lakmon për më të madhen, veçse jo për të Vërtetën, të cilën e konsideron të parëndsishme. Këtu prapë ka të bëjë me verbimin, të cilin e sjellë Maja. Njerëzit e kërkojnë fatin në çdo send, veçse jo në Zotin, kurse Ai është burim i pashterrshëm i lumturisë së përjetshme.

Ndikimi i Majës shihet edhe në shprehinë e mendjes, që çdo gjëje i jep domethënie tjetër në raport me atë që me të vërtetë është. Kjo ndodh atëherë kur ritualet, ceremonitë dhe praktikat tjera të religjionit fillojnë t'i trajtojnë si qëllim dhe jo si mjete. Ritualet dhe ceromonitë i kanë vlerat e veta, si mjete që të çojnë kah qëllimi, si bartëse të jetës dhe mediume të shfaqjes së tyre. Duke i shpallur për të vërteta, njeriu u jep atyre domethënie të tepruar, e cila atyre gjithsesi nuk u përket. Në momentin kur ceremonitë dhe ritualet bëhen të rëndësishme për vetveten, ato fillojnë ta pështjellin jetën, në vend që ta paraqesin shfaqjen e jetësisë.

Deri tek e vërteta shpirtërore nuk arrihet duke ndejtur ulur në kanape e duke spekuluar, por arrihet vetëm me veprim të drejtë. Aksioni i drejtë dhe real të drejton t'i largosh të pavërtetat shpirtërore. Për vështtrimin dhe hulumtimin e së vërtetës spirituale nuk është i nevojshëm mendimi i thellë, i mundimshëm, por nevojiten vetëm mendimet e pastra dhe të qarta. E mendimet e pastra e të qarta janë fryt i mendjes së pastër e të drejtpeshuar.

Vetëm atëherë kur largohet gjurma e fundit e të pavërtetës, e formuar nga Maja apo Iluzioni, Zoti mund të njihet si e Vërtetë. Vetëm kur Maja mbisundohet plotësisht, lind njohja kulminante që *Zoti është e vetmja e Vërtetë*.

Vetëm Zoti është i vërtetë. Çdo gjë që nuk është Zot - tërësisht është e paekzistencë dhe mbaron në iluzion të dualitetit - kjo është e tëra gënjeshtër. Vetëm Zoti është e Vërtetë e pakufishme. Të gjitha ndarësitë që duken brenda së Vërtetës janë gënjeshtër; ato në të vërtetë nuk ekzistojnë.

Të kuptuarit se Zoti është i ndarë - është pasojë e Majës apo Iluzionit. Llojllojshmëria e botës nuk do të thotë se Zoti është i ndarë në lloj-lloj pjesësh. Ekzistojnë lloje të ndryshme të ego-mendjeve, lloje të ndryshme trupash, lloje të ndryshme formash, po vetëm një Shpirt. Shpirtërat e ndarë krijohen kur Shpirti i vetëm (Zoti) merr lloj-lloj formash të ego-mendjeve dhe trupave. Ndërkaq, kjo në asnjë rast nuk sjell deri te ndonjë ndarje brenda vetë Shpirtit. Shpirti është dhe gjithmonë mbetet i pandarë. Shpirti i vetëm dhe i pandarë është bazë e lloj-lloj ego-mendjeve dhe trupave, të cilët mendojnë dhe veprojnë në lloj-lloj mënyrash dhe kalojnë nëpër lloj-lloj përvojash të dualitetit. Shpirti është dhe gjithmonë do të mbetet mbi të gjitha mendimet, mbi të gjitha veprat si dhe mbi të gjitha përvojat e dualitetit.

Shpirti vetvetiu si shpirt nuk mendon; ego-mendja është e vetmja e cila mendon. Të menduarit dhe njohjet, tek të cilat arrihet nëpërmjet të mendimit, rrjedhin prej ego-mendjes së papërsosur dhe jo të plotë.

Shpirti vetëm si Shpirt është mendim i pakufishëm dhe inteligjencë e pakufishme. Nuk ka dallim në mes atij që mendon, të menduarit dhe sjelljes së përfundimit; as ndarje të subjektit dhe objektit. Vetëm ego-mendja, e cila është në sipërfaqe të shpirtit, mund të bëhet ajo që mendon. Shpirti individual si Shpirt, ai mendim i pakufishëm dhe inteligjencë e pakufishme, nuk mendon dhe as që kryen çfarëdo aktiviteteve intelektuale. Intelekti me të menduarit e kufizuar rrjedh prej ego-mendjes. Në përsosshmëri dhe vetëmjaftushmëri inteligjenca e pakufishme, përkatësisht

Shpirti i vetëm, nuk ka nevojë për intelekt apo për aktivitetet intelektual.

Me largimin e gjurmëve të fundit të gënjeshtreve, të cilat i ka krijuar Maja apo Iluzioni, shpirti i vetëm jo që e njeh të vërtetën e vet, dhe atë që nuk është njëjtë si trup i vrazhdë fizik, apo trup subtil dhe mental, por e njeh veten si Zot, i cili është e *vetmja* e Vërtetë. Në këtë gjendje shpirti kupton se mendja, trupi subtil dhe trupi fizik, kanë qenë kreacion i inteligjencës së vetvetes dhe në realitet kurrë nuk kanë ekzistuar. Ai tash e kupton se prej Mosdijes ka konsideruar për vete se është mendje, trup subtil apo trup fizik. Po ashtu e di se në një mënyrë, është bërë mendje, trup subtil dhe trup fizik dhe prej mosdijes është identifikuar me iluzion të vetëformuar.

Zoti është i pakufishëm, sepse Ai është mbi pengesat e dualitetit. Ai është mbi aspektet e kufizuara të së mirës dhe të së keqës, të së voglës dhe të së madhes, të së drejtës dhe të së padrejtës; mbi aspektet e vetive pozitive dhe negative; mbi aspektet e gjendjes së mirë e të pasur fizike dhe të varfërisë; për këtë arsye Ai është i pakufishëm. Sikur Zoti të ishte më shumë i mirë sesa i keq, apo më shumë i keq sesa i mirë; sikurse të ishte i vogël në vend se i madh; apo i madh në vend se i vogël; sikur të ishte më pak i drejtë se i drejti apo më shumë i drejtë se i padrejti; sikur të kishte më shumë veti të mira e më pak të këqija apo më shumë veti të këqija sesa të mira; sikur të ishte më shpesh i lumtur se jo i lumtur apo më shumë i palumtur sesa i lumtur - Ai atëherë kishte me qenë i kufizuar dhe jo i pakufishëm. Zoti është i pakufishëm vetëm për atë se ekzistimi i Tij është mbi tërësinë e dualitetit.

Vetëm Zoti është i vërtetë; Ai është i pakufishëm, një dhe nuk ka asgjë tjetër përveç Zotit. Ekzistimi i të kufishmes është vetëm dukje, gënjeshtër, iluzion.

Si atëherë është krijuar bota e rrejtshme me gjërat e kufizuara? Përse kjo bota jonë në përgjithësi ekziston? Këtë

botë e ka krijuar Maja, apo Principi i Mosdijes. Maja vetvetiu nuk është iluzion. Ajo është krijuese e iluzionit. Maja nuk është gënjeshtër. Ajo është ajo që e prodhon përshtypjen e rrejshme. Maja nuk është e pavërtetë. Ajo është ajo që prodhon përshtypje se e vërteta është e pavërtetë dhe se e pavërteta është e vërtetë. Maja nuk është dualitet: ajo është shkaktar i dualitetit.

Ndër të tjera, që gjërat të jenë të kapshme në mënyrë intelektuale, e marrim që Maja është e pakufishme. Ajo e krijon iluzionin e fundësisë dhe prapë vetvetiu nuk është e fundme. Të gjitha iluzionet e formuara prej Majës janë të kufishme dhe tërë universi dual i cili veç në dukje ekziston, duke iu falënderuar Majës, gjithashtu është i kufishëm. Njeriut mund t'i duket se universi përmban gjëra të panumërta, por kjo nuk e bën të pafundshëm. Në të ekzistojnë sasi të panumërta yjesh. Në realitet me miliarda yje e përfshijnë gjithësinë, por tërësia e tërë yjeve është e kufishme. Gjithashtu edhe koha e hapësira mund të duken pjesë të pakufishme, por prapë ato janë të kufishme. Çdo gjë që është e kufishme dhe kufizuar i takon botës së Iluzionit, edhe pse principi i cili e shkakton këtë Iluzion duhet në një mënyrë të konsiderohet *jo*-iluzion.

Maja nuk mund të konsiderohet e kufishme. Ndonjë gjë bëhet e kufishme kur kufizohet në kohë dhe hapësirë. Maja nuk ekziston në hapësirë dhe nuk mund të kufizohet me hapësirë. Ajo nuk mund të jetë e ndarë me mexhë në hapësirë. Sepse vetë hapësira është prodhim i Majës. Hapësira, me të gjitha gjërat që i përmban, është iluzion, i cili varet prej Majës. Maja në anën tjetër, në asnjë pikëpamje nuk varet prej hapësirës. Ajo nuk mundet, si gjërat tjera, që të jetë e kufizuar në hapësirë. Po ashtu nuk mund as të jetë në kohë e kufizuar. Prandaj, në gjendjen e Mbidijes, Maja, më në fund, zhduket; ajo nuk mund të konsiderohet e kufishme. Maja nuk ka as fillim as mbarim në kohë, sepse koha është

vetëm një prodhim i Majës. Koha është në Majë. Maja nuk është në kohë. Koha me të gjitha ngjarjet të cilat ndahen në kohë, është prodhim i Majës, dhe Maja vetvetiu nuk është e kufizuar me kohën. Koha lind prej diktatit të Majës, dhe zhduket në momentin kur edhe ajo zhduket. Zoti është e Vërtetë e pakohshme. Për këtë, realizimi i Zotit dhe zhdukja e Majës është një akt pakohor.

Maja nuk mund të konsiderohet e kufishme për asnjë arsye. Sikur të ishte e kufishme, ajo do të ishte iluzion; sikur të ishte iluzion, ajo nuk do të kishte fuqi që të formonte iluzione të tjera. Për këtë është më së miri që të pranohet Maja si e vërtetë dhe si e pakufishme; në të njëjtën mënyrë si edhe Zoti që zakonisht konsiderohet i vërtetë dhe i pakufishëm. Prej të gjitha shpjegimeve të mundshme intelektuale për Majën, shpjegimi se Maja është njëjtë si Zoti, e vërtetë dhe e pakufishme, është më i pranueshëm për mendjen e njeriut. Prapë Maja nuk mundet *përfundimisht* të jetë e vërtetë. Kudo që ekziston dualiteti, ekziston edhe gënjeshtria në të dy anët. Njëra anë gjithmonë e kufizon tjetrën. Nuk mund të ekzistojnë dy anë të Pafundësisë. Mund të ekzistojnë dy entitete tepër të mëdha, por jo edhe dy entitete të *pakufishme*. Sikur Zoti dhe Maja t'i kishin ekzistencat e përbashkëta, të pavarura e të përputhura në mes veti, atëherë e vërteta e pakufishme e Zotit do të paraqiste vetëm një segment të realitetit të ndarë. Sqarimi intelektual se Maja nuk është e vërtetë, ndërkaq është vetëm sqarim më i mirë.

Edhe kur Maja kuptohet si iluzion i plotë, edhe kur ajo kuptohet si tërësisht e vërtetë, lajmërohen vështirësitë. Sipas kësaj, të gjitha përpjekjet e intelektit të kufizuar që të kuptojnë Majën çojnë në qorrsoak. Në njërën anë, sikur Maja të konsiderohej e kufishme, kjo do të thoshte se ajo është iluzore; dhe do të pushonte së qeni shkaktare e botës iluzore të gjërave të kufishme. Për këtë Maja duhet të

konsiderohet e vërtetë dhe e pafundme. Në anën tjetër, sikur Majës t'i përshkruhej epiteti i të vërtetës së pakufishme, atëherë ajo do të paraqiste "anën tjetër të medales" - të edhe një Të Vërtetë të Pa kufishme, e kjo është Zoti. Sipas të gjitha këtyre pikëpamjeve, vjen tjetri përfundim: Maja është e kufishme dhe iluzore. Pra, Maja nuk mund të paraqesë të vërtetën e pafundme, edhe pse ashtu duhet të trajtohet që më mirë të sqarohet bota iluzore e gjërave të fundme.

Intelekti i kufizuar, sado që mundohet, nuk mundet plotësisht ta kuptojë Majën. Nuk është e mundur të kuptosh Majën me intelekt, se ajo është, sikur edhe Zoti - e pakapshme, e pakuptueshme. Për këtë thuhet se Maja është hija e Zotit. Çdo personalitet e ka hijen e vet. Zoti po ashtu e ka hijen e vet: Majën sekrete. Megjithëse Zoti dhe Maja plotësisht janë fshehtësi për intelektin, i cili ndikon në nivelin e dualitetit; natyra e saj e vërtetë, njeriut, i zbulohet tërësisht vetëm në momentin e Njohjes përfundimtare. Deri te Realizimi përfundimtar, enigma e Majës qëndron e pazgjidhur. E pas Realizimit njeriu e kupton se Maja nuk ekziston në Realitet.

Ekzistojnë dy gjendje ku nuk ekziston Maja: Në gjendjen e parë të pavetëdijes së të Vërtetës, dhe në Mbivetëdije, në gjendjen e Mbidijes së Zotit. Ajo lajmërohet vetëm në vetëdijen e Zotit, në botën e shfaqur të dualitetit; e kjo është, kur të lajmërohet vetëdija për botën e vrazhdë fizike, suptile dhe mentale. Maja lajmërohet atje ku nuk ka Mbidije dhe ku sundon vetëdija për "të dytën", të imagjinuarën; pra, kur vetëdija është e mbizotëruar dhe e pandihmë në kategoritë e rrejshme të dualitetit. Maja ekziston vetëm në pikat e ekzistimit të kufishëm. Dhe vetëm në dukje të iluzionit Maja mund të ndikojë si krijues i pakufishëm i gjërave të pavërteta dhe të kufishme.

Në të Vërtetën e fundit dhe të vetmen të Realizimit nuk ka asgjë përveç të pakufishmes dhe Zotit të përjetshëm.

Aty nuk ka iluzion për të kufishmen, ose gjëra të ndara nga Zoti, dhe më nuk ka as Majë, as krijues të atij iluzioni. Shpirti në luftën e brendshme me tejkalimin e Majës vjen deri te Vetënjohja. Nëpërmes të Vetënjohjes ai jo vetëm që vjen deri te vetëdija se lloj-lloj ego-mendje dhe lloj-lloj trupa kurrë as që kanë ekzistuar, mirëpo edhe deri tek e vërteta se tërë universi, edhe vetë Maja kurrë nuk kanë ekzistuar si principe të *veçanta*. Çfarëdo sendi të prekshëm që të ketë bërë, Maja zhduket në qenien e pandashme të të vetmit Shpirt. Shpirti i bashkuar e di tash se ajo që gjithmonë ka qenë - përjetshëm e Vetërealizuar në dije të pakufishme dhe në vetë ekzistimin, e liruar është përjetësisht prej dualitetit. Ky nivel më i lartë i Vetënjohjes, është përndryshe plotësisht i pakapshëm për intelektin dhe i kuptuar vetëm për ata të cilët e kanë arritur Realizimin më të lartë.



Resulullah (Avatar)-Mësues i mësuesave-**Meher Baba**

Resulullah (Avatar)-Meher Baba

FJALOR I FJALËVE TË PANJOHURA

Adept = rrjedh prej fjalës latine: adeptus = "ai që e ka ruajtur". Në okultizëm don të thotë: "një që e mban një të fshehtë", mjeshtër në shkencë apo në ezotheri; ai që ka shkëlur në perandorinë shpirtërore; ai që e njeh evolucionin njerëzor, i dituri, mësuesi i jetës etj.

Avatar = në gjuhën vedante don të thotë manifestim i plotë i Zotit në formën njerëzore, në tokë, si mësues i përjetshëm dhe mësues i përsosur i gjallë; sjellja direkte e të vërtetës në botën iluzore, shpëtuesi, më i larti ndër më të lartit, i lashti, po ashtu: Zoti njeri, Mesija, Buda, Krishti, Rasool.

AUM (OM) = don të thotë Zot. Gjithashtu është edhe Fjala e Parë. Om-i është zëri i parë pranues në fillim të Fillimit të kreacinit në Univers.

Ashram = është një vendbanim, një shkollë ku një apo më shumë mësues i ushtrojnë nxënësit për një zhvillim të lartë shpirtëror.

Antenat "L" = Janë tela metalikë; më të mirat janë prej telit të bakrit, të cilat duhet ta kenë formën e germës "L". Me këto antena njeriu mund të hulumtojë ujërat nëntokësorë ose rrezatimet, të cilat janë të padukshme për syrin e njeriut. Te ne, në trojet shqiptare, vendet ku ka ujë nëntokësor hulumtohen për të çelur bunar për ujë etj.

Autohipnozë = Vetëhipnozë, kur personi vetushtron për ta arritur këtë gjendje ose ia mundëson hipnotizuesi, ku më vonë e merr vetëkomandën, me vetëdije, të ndërdisjes së vet. Autohipnozën unë e quaj gjendje e vetëdijshme gjumi ku në të njejten kohë ke vetëdije për të aneshmen dhe të këndeishmen. (S. Basha, hipnotizues).

Bota eterike = Është botë e ngjashme me fiziken edhe kjo botë quhet botë materiale po po vibracionet e energjisë janë më të imëta. Kur njeriu del me trup eterik në botën eterike, e

ka të vështirë për ta dalluar botën fizike prej asaj eterike, sepse kjo botë plotësisht i përngjan botës fizike, edhe pse i ka ligjet pak më tjetërfare nga fizikja. Në këtë botë ka fortësi, ftohtësi ngrohtësi etj. Kur del në këtë botë, nëse ke vetëdije mund të fluturosh (nese ke aftësi), të hysh nëpër mure dhe të marrësh forma të ndryshme; kjo varet se në çfarë shkalle të zhvillimit je. Në këtë botë, përveç se janë të gjitha krijesat e tokës, ekzistojnë edhe krijesa që gati kurrë në materie nuk dalin, si p.sh. zanat e malit, djajtë, patulakët apo xhuxhmaxhuxhët dhe të gjitha krijesat e elementeve të ndryshme kosmike, si të elementit të zjarrit, të ajrit, të ujit dhe të tokës.

Bota astrale = Është botë pak më e lartë se eterikja, po është e përzier pak me këtë dimenzion dhe me dimenzionin mental. Okultistët e quajnë "mbeturinat e mendjes", sepse në këtë botë janë edhe mendimet e mira, edhe të këqijat të njerëzve, të cilat kanë krijuar si një lloj elemenarësh (shih: Elementarët) të gjallë, të mirë ose të këqij. Kjo botë është botë me shumë ngjyra, por edhe kjo i ka banorët dhe ligjet e veta.

Budist = personi që merret me budizëm: mediton, lutet, pastrohet shpirtërisht.

Dervish = rrjedh prej fjalës persishte **darvish** që don të thotë **i varfër**. Ky kuptim ekziston edhe në turqishte. Dervishi është një asket, i cili udhëton gjithkrah, ka fuqi shumë të madhe magjike-shpirtërore dhe i cili, pas shkallës së gjashtë, arrin deri te shehu.

Dervish Destani = Sufi dhe qartëpamës, i cili i takonte tarikatit Halveti dhe shehu i tij ka qenë i nderuari Sheh Nexhati, i cili ishte udhëheqës i tarikatit Halveti të Prizrenit.

Djalli = Është qenie e ferrit, e dëmshme, me fuqi magjike të errëta; është mashtrues i madh; ka aftësi të mëdha hipnotike dhe është mjeshtër i formimit të vizioneve të qarta tek të tjerët; ka aftësi të merrë edhe formë njeriu dhe të krijesave të tjera. Ka lloje të ndryshme, simbolikisht duken të kuq dhe të

zinj; kanë fytyrë njerëzore, po të shëmtuar; janë me brirë dhe këmbë të dhisë. Ka djaj të zinj, të gjelbër etj.

Diadë = komunikim i dypalshëm; dy vetë kur komunikojnë dhe e dëgjojnë njëri-tjetrin me vëmendje.

Elementarët = Janë krijesa, që njeriu i krijon vetë me forcën e vet magjike të mendjes, dhe pastai elementari bëhet i dëgjueshëm për njeriun dhe ia kryen shumë punë magjistarit, si në botën astrale, ashtu edhe në atë fizike. Elementari përbëhet prej energjisë së magjistarit dhe duhet të ruhet shumë që të mos bjerë në dorë të huaj, se magjistarit mund t'i shkaktohen dëme të mëdha. Elementarit duhet t'i caktohet vdekja në Akashë, se përndryshe, me vdekjen e papritur të magjistarit, elementari mund të merrë kontrollin vetë dhe të bëhet si një dhampir e t'iu shkaktojë dëme të tjerëve.

Engjëjt = Janë qenie të dritës, të cilat nuk kanë gjini. Engjëjt ekzistojnë në botën shpirtërore dhe janë apsolutisht pa ego. Ata ekzistojnë edhe në ne. Engjëj ka të kategorive të ndryshme dhe kryejnë urdhërat dhe ligjet e Zotit në mënyrë absolute.

Ego = nevci (arabisht) ose mendja, "un-i", shpirti si formë.

Hipnozë = fjalë greke: hypnos=gjumë. Edhe pse kjo gjendje shpirtërore duket si gjumë, nuk është gjendje gjumi, sepse hipnotizuesi flet me mediumin dhe ai i jep përgjigje. Mediumi në hipnozë është nën udhëheqjen e hipnotizuesit.

Hipermnezia = Të mbajturit mend të tepërt.

Hartat për hulumtim me lavjerrës = Janë harta normale, me të cilatm, me anë të lavjerrësit hulumtohen gjërat e ndryshme në largësi.

Guri i murmurimës = Pas zbrazjes së vetëtimes lirohet një energji jashtëzakonisht e madhe, e cila gjuan në një vend, në të cilin lihet një gjurmë, si vrimë, në tokë; në atë vend, pas 40 ditësh, del nga toka një si lloj guri, me fuqi magjike jashtëzakonisht të madhe. Ky është "Guri i murmurimës", i cili njihet në popullin tonë.

Iluminim = Përndritje. Njohje e vetvetes - Zotit në ne; njohje e të Vërtetës; arritje e vetëdijes Kosmike; realizim i të Vërtetës. Ky është qëllimi i ekzistimit njerëzor, bashkim me Zotin me vetëdije të plotë.

Impresionet apo Sanskara = Impresionet janë përjetimet tona të përditshme, qofshin fizike, mendore apo astrale; pra, çdo gjë që shohim, përjetojmë, veprojmë, mendojmë -në materie dhe astral. Impresionet janë edhe të jetërave të kaluara, dhe atë me mija vite dhe me neone, si në evolucionin njerëzor dhe inkarnimin si njeri, ashtu edhe në involucion, kur njeriu punon për të realizuar Zotin dhe për t'u bërë Zot. Në gjendjen e Zotit sanskarat zhduken dhe njeriu e realizon Zotin, e njef të vërtetën Apsolute.

Joga apo Yoga = rrjedh prej gjuhës sanskrite, që do të thotë: "union", "shoqatë". Joga është metodë e meditimit dhe e ushtrimeve fizike, me anë të të cilave njeriu fillon rrugën e vet spirituale të zhvillimit të lartë. Ka shumë degë të Jogës, dhe drejtime, të cilat më së shumti përdoren në Indi. Joga trajtohet si një shkencë psikike, e cila ka të bëjë drejtpërdrejt me njohjen e vetvetes. Me praktikimin e jogës shkon duke u zgjeruar vetëdija deri në vetëdijen kosmike; pra, deri te iluminimi apo përndritja - njohja e Zotit në ne, njohja e së vërtetës, realizimi i qëllimit kryesor të njeriut në tokë.

Jogin = Personi i cili e praktikon jogën.

Jin-Jang (yin-yang) = Rrjedh prej gjuhës kineze; janë simbole të dy fuqive kosmike dhe në mesë fuaqija e tretë neutraliteti se germa S. Yang: princip mashkullor, aktiv, nxehtësi, zjarr, princip i thatësisë; dhe Yin: princip femëror, pasiv, errët, ftohët, lagështirë. Janë dy principe të kundërta nëpërmes të cilave tërë univerzi iluzor ekziston. Ne i njohim si: mirë-keq, hëna-dielli, toka-qielli etj.

Koan = Në zenbudizëm njihet një fjalë apo fjali, e zgjedhur prej mësuesit shpirtëror, që nxënësi gjithnjë, pandërprerë, e përsësit derisa ta ndalë plotësisht mendjen dhe të iluminohet

(përndritet). Kjo është ngjashëm si dhikri te sufisë e tarikatit Mevlani “Hu-Allah” e të tjera.

Kanalizimi spiritual = Është kur një medium, në transin autohipnotik ose hipnotik, bëhet kanal për ndonjë inteligjencë jashtëtokësore apo nga botërat shpirtërore, ku mediumi e lëshon trupin fizik, del me trupin e vet astralo-eterik dhe, në gëzhhojnë trupore të tij, hyn krijesa e dimenzionit tjetër dhe ia shfrytëzon trupin fizik për të sjellë porosi nga bota tjetër në botën fizike, kuptohet: në marrëveshje me mediumin.

Kundalini = Ose energjia kosmike e cila flen në çakrën e parë (Muladhara çakra), e cila gjendet në fund të boshtit kurrizor dhe te organet seksuale. Me zgjimin e kundalidinit, të gjitha çakrat mund të çilen dhe personi të arrijë vetëdijen më të lartë kosmike. Rreziku qëndron në faktin se me hapjen e këtyre botërave tek një person i papërgatitur sa duhet për këto gjëra ose pa mësues mund t’i shkaktojë vetes dhe të tjerëve dëme të mëdha me aftësitë e veta të pakontrolluara psikike dhe shpirtërore.

Lethoteknika = Fjalë greke që do të thotë: Teknikë e Letës - teknikë e lumit të harresës.

Lavjerrësi = Lavjerrësi ka forma të ndryshme; bëhet nga metali, druri, kristali dhe përdoret në radiestezi për hulumtimin e shumë gjërave. Lavjerrësi është vetëm mjet, i cili e transmeton përgjigjen prej ndërdisjes në vetëdije, ku vetëdija ka qenë parashtrues i pyetjes. Lavjerrësi përdoret për shumë qëllime, si në hulumtimin dhe zbulimin e ujërave nëntokësore, të rrezeve të dëmshme në dhomë; bën zbulimin e sëmundjeve te njeriu; shërben për marrjen e përgjigjeve të sakta nga ndërdisja etj.

Meher Baba-Resulullah (Avatar) = Mervan Sheriar Irani, është i lindur në Puna të Indisë, me 25 shkurt të vitit 1894. Prindërit e tij, Sheriar dhe Shirin, kanë qenë të besimit zoroastrian të prejardhjes persiane. Babai i tij, Sheriar, ka

qenë hulumtues i vërtetë i Zotit - ka qenë dervish. Një ditë të muajit maj, 1913, gjatë kohës së studimeve në kolegjin Dekan në Punë ka kaluar me biçikletë afër të nderuarës myslimane, Hazrat Babaxhan, një nga pesë mësueset e përosura të asaj kohe, ashtuquajtur “kutube”. Ajo e ka thirrë Mervanin afër vetes dhe e ka puthur në ballë, duke ia shpalosur statusin e vërtetë të Resulullahit-Avatarit, manifestimin absolut të Zotit në formën njerëzore.

Në fillim Mervani kishte mbetur i trullosur. Gradualish, pas disa muajsh, i është kthyer vetëdija për rrethin ku gjendej dhe i ishte mbjellë vetëdija që, sa të mundej, të merrte kontakt me mësuesin apo kutubin, Sai Baba, prej Shirdijës, i cili e ka udhëzuar dhe dërguar te një mësues tjetër i përsosur (kutub), i quajtur: Upasni Maharaxha, hindus nga Sakorija. Kutubi, Sai Baba, nuk e ka bartur dijen hyjnore tek të tjerët. Kurse, Upasni Muharaxh, për shtatë vjet me radhë, ia ka integruar Mervanit (Babës) vetëdijen hyjnore me vetëdijen e botës fizike, duke e përgatitur për rolin e Resulit-Avatarit të kësaj kohe. Misioni i tij i Resulit-Avatarit ka filluar të manifestohet në botën e jashtme më 1921, kur kanë filluar që rreth tij të mbledheshin nxënësit e parë, të cilët ia kanë dhënë emrin **Meher Baba** që do të thotë: ”At i Mëshirshëm”.

Magjia e bardhë = Merret me shërimin e njerëzve - me anë të hipnozës, sugjestionit pozitiv etj.; merret me zbulimin e magjive të zeza, bën largimin e qenieve të ferrit nga trupi astral-eterik; jep këshilla pozitive për jetën. Magjistari ose magjistarja e bardhë iu ka dorëzuar Zotit dhe punon me ndihmën e krijesave të dritës, si me shpirëta të mirë dhe me engjëj.

Magjia e zezë = Shkakton sëmundje tek njerëzit, bën shkatërrimin e jetës së njerëzve nëpërmes ritualeve të ndryshme, ku shtrigat ose shtriganët dinë t’i sëmujnë njerëzit, t’u shkaktojnë dëme në jetë. Këto rituale i dinë edhe njerëzit

e thjeshtë. Në trojet tona këto rituale të magjive të zeza më së shumti i bëjnë femrat dhe atë, për fat, në mënyrë primitive. Tepër rrallë dikush di të punojë në mënyrë profesionale në këtë drejtim. Për t'i sëmure njerëzit këta persona përdorin lloj-lloj ritualesh, duke i marrë ndonjë send personit që i mësyhet e keqja, dhe kështu ndodh: prerje e teshave, e flokëve; marrja e gjakut, marrja e spermës etj.

Mnemoteknika = teknikë e lartë e të mbajturit mend.

Mbidija = Dija kosmike. Mbidija arrihet kur njeriu pastrohet tërësisht prej sanskarave dhe arrihet përndritja (iluminimi), njohja e Zotit të vërtetë si në ty ashtu edhe jashtë teje.

Mugjizet = Janë mrekulli të sufive. Me lejen e shehut, dervishët bëjnë para të tjerëve shumë mrekulli ose vetë shehu i përdor për nevoja spirituale e jetësore.

Neologizëm=Teknikë e harresës.

Mbrojtja “Atlanta” = Është një unazë apo pllakë që për simbol ka dy trekëndësha anash unazës dhe në mes 9 vija të drejta e të ndërprera, e cila ka fuqi shumë të madhe mbrojtëse kundër rrezatimeve të ndryshme të dëmshme. Unaza është gjetur në një varr në Egjipt dhe tash përdoret për mbojtje si talisman.

Ndërdija = Vetëdija e trupit astral. Vetë fjala tregon se diçka ekziston nën vetëdijen tonë. Ndërdija funksionon me pjesët jo të vetëdijshme të njeriut. Ndërdija i rregullon të gjitha funksionet e organizmit, duke filluar prej frymëmarrjes, ritmit të zemrës etj. Ndërdija është pothuaj neutrale për vetëdijen tonë, kah e çojnë bindjet dhe besimet e vetëdijes ajo funksionon si për mirë ashtu edhe për keq. Një shembull krahasimi: Ndërdija është si një anije gjigante, e cila bart me vehte të gjitha gjërat, si të mirat, ashtu të këqijat, mirëpo timoni i kësaj anijeje është vetëdija. Me njohjen e ligjeve të ndërdijes njeriu mund të arrijë gjëra të mëdha në jetën e vet. Kur njeriu me vetëdije e lidh kontaktin me ndërdijen, atëherë njeriu fillon ta arrijë një shkallë të lartë të zhvillimit shpirtëror.

Pafundësia = Pafundësia është gjendje e thellë shpirtërore, për të cilën mendja e njeriut fare nuk mund të fletë, vetëm mundet simbolikisht ta përshkruajë. Pafundësia vetëm mund të përjetohet. Me njohjen e Pafundësisë njihet Zoti në ne, ne e realizojmë të vërtetën, përndritemi. Pafundësinë që ne e mendojmë me mendjen tonë nuk është Pafundësi.

Psihometria = D.m.th. "lexim i shpirtit". është mënyrë e leximit të objekteve me anë të ndërdijes, pa marrë parasysh se çfarë madhësie kanë. Personat që kanë aftësi qartëpamëse janë në gjendje që vetëm një send-shenjë apo ndonjë objekt, sado të vogël, t'ia marrin personit sa për ta prekur me dorë dhe të fillojnë të flasin për atë person, si për të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen e tij.

Qiti = Në gjuhën sanskrite indiane don të thotë vetëdija më e lartë që mund të arrihet.

Radiestezia = Fjalë lat./gr.: thupër-shufër-lavjerrës. Zbulim i rrezatimeve të padukshme -qoftë te njeriu, shtazët, bimët; si dhe zbulimi i energjisë statike (mbeturina elektrike etj), si ajo e ujërave nëntokësorë, ajo kosmike etj. me anë të lavjerrësit apo mjeteve tjera të radiestezisë.

Regresimi = Kjo metodë njihet në hipnozë si metodë ku mediumi rikthehet në vitet e fëmijërisë ose dërgohet në përjetimin e jetërave të kaluara, të cilat, si kujtime të mëparshme, janë të deponuara në ndërdije. Me regresim personi, qoftë vetë, qoftë nën udhëheqjen e shëruesit, mund të shërohet prej shumë sëmundjeve, të cilat e kanë burimin qoftë në të kaluarën e kësaj jete, qoftë në jetërat e kaluara; po ashtu prej reinkarnimeve të kaluara mund të nxirren njohuri, të cilat i ka harruar njeriu në këtë jetë.

Rrezet elektrike statike = Këto rreze janë shumë të dëmshme për trupin e njeriut, të shtazëve dhe të bimëve. Rrezet më të dëmshme teknike që ekzistojnë janë rrezet e frigoriferit dhe të mikrovalëve; pastaj të televizorit, të kanaleve nëntokësore, të centraleve elektrike, atomike etj.

Shtëpitë e nemura-kanceroze = Nëse ndonjë shtëpi është e ndërtuar mbi ndonjë nyje nëntokësore, ku nën tokë kryqëzohen dy lumenj, ajo energji përfshin tërë shtëpinë. Në këtë shtëpi të gjithë pothuaj mund të vdesin prej kancerit dalngadalë. Në këtë shtëpi njerëzit janë tepër nervozë dhe të sëmurë. Ka shtëpi që janë të nemura prej ndonjë personi të gjallë ose të vdekur, i cili me fuqinë e mendjes e ka nemur atë shtëpi, në të kurrë kurrë nuk shkon mbarë dhe kjo shtëpi dalngadalë shkon duke dalur fare.

Sheh Halili = Sheh Halili ishte mësues shpirtëror, i cili ka jetuar deri pas Luftës së Dytë Botërore në fshatin Vraniq të komunës së Suharekës. Ka qenë në tarikatin Sinani, degë e tarikatit Halveti, të teqes së sheh Hasanit, më vonë teqe e sheh Nexhatit të Prizrenit. Sheh Halili ka bërë shumë muxhize (mrekulli), të cilat i njohin sufitetë botëror; një nga ato muxhize ka qenë edhe bilokacioni, kur një shpirt, në të njëjtën kohë, shihet dhe kryen punë në botën fizike në shumë vende.

Sheh = Është mësues shpirtëror, i cili ka njohuri të botërave të ndryshme dhe dimensioneve të ndryshme. Shehu duhet ta ketë realizuar të Vërtetë dhe të gjendet në Hakikat. Është udhëheqës kryesor i një teqeje dhe i një tarikati, ku pas tij vijnë dervishët, punëtorët e ngushtë, hyzmeçarët apo shërbëtorët dhe myhybët, ata që janë pranuar në tarikat për një zhvillim të lartë shpirtëror në drejtimin islam.

Sfera e kristalit = Mjet, që njeriut i shërben në gjendje autotransi të shikojë në të kaluarën, në të tashtmen dhe në të ardhmen; sfera nuk ka fuqi, po njeriu ia jep atë fuqi.

Shenjtërit = Në të gjitha kohërat dhe epokat, në tokë, në të njëjtën kohë, gjithmonë ekzistojnë 56 Shiv-Atmi (në gjuhën sankrite, që d.m.th. Shpirtëra të përsosur-Realizues të Zotit). Prej këtyre 56 Shiv-Atmi, disa rrinë në gjendjen e Majzoobiat-it - kjo fjalë gjendet në sufizëm dhe d.m.th.: gjendje e tetë e Zotit), kurse disa rrinë në gjendjen e

ashtuquajtur: Turija-avastha dhe d.m.th.: gjendje e bashkimit me Zotin). Kurse në terminologjinë sufiste këta shenjtër njihen si: „Fana-ma-al-baqa“ (d.m.th.: gjendje e nëntë e Zotit, kontakt me Zotin). Disa të tjerë të këtij grupi, pas kalimit në Bashkim Hyjnor, rrinë në gjendjen e ashtuquajtur: „Sulukiyat“ (në sufizëm d.m.th. gjendje e vërtetë e hulumtuesit). Po ashtu qëndrojnë në gjendje të ashtuquajtur: „baqa-billah“ (në sufizëm d.m.th. qëndrim në Zotin) dhe këtë në fund të udhëtimit të dytë hyjnor. Vetëm pesë prej të 56-tëve rrinë gjithmonë në gjendjen e Kutubiatit (Qutubiyat); të gjithë këta janë në formën njerëzore.

Pra, në të gjitha kohërat dhe në të gjitha epokat, në tokë, gjithmonë ekzistojnë pesë Kutubë (Qutub) ose Satguru (gjuhë sankrite) ose të ashtuquajtur shqip Mësues të Përsosur, të cilët jetojnë në mesin e njerëzve, duke i shfrytëzuar aspektet e pakufijshme të „ahadiyat-it“ (në sufizëm d.m.th.: vetëdije më e lartë hynore dhe kosmike) në Arsh-e-ala (në sufizëm që d.m.th.: fronti më i lartë - gjendje më e lartë shpirtrore ose gjendja e Avatarit (Resulullahit), respektivisht e Kutubëve.

Kutubëve u shërbejnë katër ndihmës e këta quhen **Advallë**. Detyra e këtyre është që gjithmonë të jenë të vetëdijshëm, të mbajnë pushtet në të katër anët e botës dhe, pa ndërprerë, t’u lajmërojnë Kutubëve për çdo ndodhi në botë. Përveç këtyre katër **Advallë-ve**, nën ta ekzistojnë dhe 40 **Avdallë** të tjerë: „Ata që janë ndërruar shpirtërisht“. Nën 40 Avdallët gjenden edhe 70 **Fisnikë** e pas tyre vijnë 300 **Të Lartë**. Sufistët e shenjtë në këtë hierarki, që nuk kanë obligime, quhen: Vali.

Trupi i Parë dhe **Trupi i dytë** = I nderuari, Mehmet Selaj, i cili për mua është mistik i rangut të lartë, por i cili, momentalisht, është ende i panjohur, në librin e tij të parë, ende të pabotuar, të ashtuquajtur “Fillimi i jetës” si dhe në librin e tij të dytë: ”Parajsa dhe humnera”, në të cilët, unë

vetë, gjatë kam punuar, e shpjegon fillimin e krijimit të universit, ku si Parajsë e quan Trupin e Parë (trupi i Parë ka të bëj më shumë se me parajsë, parjas jo si e shpjegon religjioni), kurse Ferr e quan Trupin e Dytë dhe detajisht e përshkruan se çka përmban Trupi i Parë, ai i Dytë, në sa shkallë ndahen ata, kush dhe si u shërben atyre e kështu me radhë.

Telekineze = Fjalë greke që don të thotë: tele-larg dhe kinese-lëvizur. Lëvizja e një gjëje në largësi, me forcën shpirtërore, pa e prekur fizikisht; pra, lëvizje e një objekti vetëm me fuqinë e mendjes dhe të shpirtit.

Qiti = Është vetëdije më e lartë transcendentale që mund të arrihet.

Udhëheqësi shpirtor = Është qenie e brendshme hyjnore; shumica e quajnë engjell pa flatra, i cili mund të jetë qenie që ka kryer të gjitha reinkarnimet dhe ka kaluar në botën hyjnore, ku tash iu shërben njerëzve; mund të jetë shpirt njerëzor, i cili ka vdekur dhe ka vendosur që personit të afërm t'i ndihmojë gjatë jetës nga bota astrale, varësisht si e caktojnë dhe e lejojnë qeniet e larta, të dritës.

Ujërat nëntokësorë = Toka është damar-damar, nëpër të cilët rrjedhin ujërat e ëmbël dhe ato minerale. Këta ujëra mund të jenë ose si përrocka nën tokë, ose si lumenj. Aty ku kalon ai ujë nëntokësor, lëshohet një energji e fuqishme statike, në drejtim të sipërfaqes së tokës dhe humbet diku lart në hapësirë. Nëse ndodh që njeriu ta bëjë shtëpinë mbi ato rreze, njerëzit e asaj shtëpie mund të sëmuren dhe shkaku i sëmundjes vështirë të përcaktohet.

Vendet negative = Vendet negative në tokë janë ato vende, ku dominon energjia negative statike, që mund të jetë nga ujërat nëntokësorë, nga rrezatimet e mineraleve të dëmshme, nga vetë rrjeti i rrezatimeve kosmike ose nga ndonjë rrjet i fuqishëm elektrik.

Vendet pozitive = Janë vendet në tokë, ku toka rrezaton pozitivisht, bjeshkë ,rrafshina etj; si vende pozitive mund të jenë vendet ku ndonjëherë ka qenë e ndërtuar ndonjë xhami, kishë apo ku njerëzit janë lutur a kanë medituar kohë të gjatë. Me qëlluar njeriu me banuar në këso vendesh pzitive, kishte me pasur një rahatit të madhe në jetë.

Vendet neutrale = Këto vende janë shumë të mira për banim; në to gjumi të merrë i mirë dhe çohesh i pushueshëm. Në këto vende edhe njeriu i sëmurë fillon të shërohet. Të rrallët janë ata që kanë fat të qëllojnë në këso vendesh neutrale, ku të kënaqet shpirti dhe pushon shumë mirë dhe përtërihesh.

Vendet e papërshtatshme për banim = Janë ato vende, të cilat intensivisht bombardohen prej energjive të ndryshme negative - qofshin ato prej ujërave nëntokësorë, rrezatime teknike, kosmike; rrezatime nga mineralet ose shtëpitë e ndërtuara mbi varreza e të vjetra; rrezatime vendi ku janë bërë kurban njerëzit apo shtazët për Satanën ose Iblisin se masakrat gjat luftrave etj.

Vullneti = Vullnetin që ne e njohim, sipas mistikëve, nuk është vullnet. Vullnet i vërtetë është vullneti hyjnor, ku një qenie njerëzore bën gjëra të larta, të cilat me vullnetin normal njerëzor, kurrë nuk do të mund t'i bënte. Vullnet i vërtetë është kur një Jogi rri i shtangur dhe pa lëvizur me trupin fizik me muaj; vullneti normal i njeriut këtë nuk mund ta bëjë.

Zenbudizëm = Religjion i cili ka rrjedhë prej avatarit - Buda dhe merret me zhvillimin e lartë shpirtëror, deri te realizimi i Zotit, njohja e së Vërtetës në vete - përndritja.

Zëri ynë i brendshëm = Është zë të cilin njeriu e ndien pastër nga thellësitë e vetvetes, i cili gjithmonë e thotë të vërtetën.

Zanat e malit = Janë qenie të botës eteriko-astrale, të cilat e kanë vetëm një element kosmik; janë femra dhe meshkuj me bukuri të rralla dhe me fuqi shumë të madhe magjike, të cilat

vetëm natën kallin zjarre, vallëzojnë dhe këndojnë në grupe;
kanë aftësi telepatike e qartëpamëse të mëdha si dhe aftësi të
teleportimit prej një vendi në vendin tjetër.

B I B L I O G R A F I A

1. "Bog govori" (Zoti flet) Avatar-Meher Baba
2. "Besede" Avatar-Meher Baba
3. "Iskre Meher Babe" (Xixat e Meher Babës)
4. "Rad Gurdijeva " (Puna e Gurxhievit" Kerlin Riordan Spit
5. "Medicina stanovanja" (Medicina e banimit) Zhak La Maja
6. "Rruga drejt Adeptit të vërtetë" Franc Bardoni
7. "Gibt es eine Kunst des Vergessens" (Ka një art të harresës), skriptë, autor: Harald Weinrich.

PARATHËNIE	5
LEXUES TË DASHUR!	5
FJALA RECENSENTIT	7
NË VEND TË PARATHËNIES	8
DY FJALË PËR LIBRIN	10
ZBULIMI I UJËRAVE NËNTOKËSORË, I VENDEVE POZITIVE DHE NEGATIVE ME ANTENAT “L”, ME LAVJERRËS DHE AUTOHIPNOZË	11
ARTI I HARRESËS	23
KUKULLA E HUMBUR U GJET	33
ZBULIMI I MAGJISË SË ZEZË DHE SHËRIMI NG AJO	44
KEQPËRDORIMI I AUTOTRANSIT:.....	59
ARSIMTARJA NË VEND TË NJËSHIT, NË DITAR, PA VETËDIJE, IA SHËNON DYSH.....	59
KEQPËRDORIMI I AUTOTRANSIT	63
ARSIMTARI I GJUHËS TËRË ORËN BËRI SHAKA PA VETËDIJE	63
HARRIMI I TRUPIT ETERIKO- ASTRAL NË TRUP TË FEMRËS.....	66
BISEDË ME BIMËT	70
SHP... FLET ME TRËNDAFILIN	70
ZBULIMI I MAGJISË SË ZEZË	80
SI SAMIU DHE MUHARREMI GJETËN TE NJË MIK MAGJI TË ZEZË?	80
E AJURA E FYTIT SI EKSPERIMENT	85

PO MË VJEN FTOHTË NATËN, KUR PO BI NË ODË TË FLEJ	88
HUMBJA E PËRJETIMIT TË KOHËS: 4 MINUTA SI 24 ORË	90
HARRIMI I TRUPIT ETREIK NË TRUP TË HUAJ ...	94
SI MOTRA LULE MBETI ME TRUP ETERIK NË TRUPIN TIM FIZIK	94
SHPENDI NË RREZIK DHE FUQIA E INTUITËS	98
MOS U KOLL!	98
B.V.M - BASHKIMI VULLNETAR I MANGUPVE....	104
NDODHITË GJATË USHTRIMEVE TË PROJEKSIONIT ASTRAL.....	112
SI U BËRA I VETËDIJSHËM, NË ASTRAL, KUR E VURA NJË LIBËR SHUMË TË VJETËR MBI BARKUN TIM	112
KALIMI NËPËR TERRITORIN E DJAJVE.....	117
HYRJA NË VETVETE, ZVOGËLIMI MË SHUMË SESA NJË ATOM NË PLANETIN E DIJES	120
PËRJETIMI NË KOPËR	126
Ç’ ËSHTË PËRNDRITJA (ILUMINIMI): NJOHJE E SË VËRTETËS, NJOHJE E ZOTIT NË NE APO REALIZIM I NJOHJES MË TË LARTË?.....	139
PËRJETIMI NË TREN	141
PËRJETIMI I RITUALIT TË ECJES ZBATHUR NËPËR ZJARR DHE NËPËR XHAMA	147
PËRJETIMI NË MIKROKOZMOS NË PLEKSUS SOLARIS – TE SEJANTOLOGU, RIKARDO REGACIO	159
RRITJA DHE ZVOGËLIMI I ASTRALIT.....	166

ZVOGËLIM DHE ZMADHIM DERI NË PAKUFI.....	166
SI DERVISH DESTANI NA SHPËTOI TË GJITHËVE PREJ FATKEQËSISË	172
POSTHIPNOZAT E NDRYSHME	174
SHKAKTIMI I NJË SENZACIONI NË NJË KURS TË ZHVILLIMIT PSIKIK	178
SI E SHËROVA LULJETËN PREJ ZORRËS QORRE	182
SI MË DËRGOI UNI I VËTRETË QË TA PËRJETOJ TRUPIN E PARË, TRUPIN E DYTË DHE PAFUNDËSINË.....	186
UDHËTIMI NËPËR BIMË DHE DRUNJ	189
PËRJETIMI I NJË REINKARNIMI SI FEMËR.....	195
FRIKA GJATË USHTRIMEVE SPIRITUALE	203
KUSH MA NGJITI PËR FYTI NË TË ANDEJSHMEN	203
HARRIMI I EMRIT PERSONAL E TË TJERA	210
I DEHUR ME UJË TË ZAKONSHËM.....	216
SI E REGRESOVA LULEN DERI PARA LINDJES...	226
I VDEKURI NUK DINTE QË KA VDEKUR.....	229
ITALIANI DONTË T'I GRABISTE ME DHUNË NOTAT MUZIKORE, TË CILAT PAS 100 VJETVE DO TA MAHNISNIN BOTËN	233
IDENTIFIKIMI ME ELEMENTET KOSMIKE DHE ME DIELLIN.....	236
UDHËHEQËSI SHPIRTËROR MË KËSHILLON	238
MBROJTJE.....	241

KUR SHKUAM TË KËRKONIM GURË TË MURMURIMËS: ÇKA I NDODHI SAMIUT, KUR DESHI TË MA SHQYENTE ME BRISK ASTRAL TRUPIN ETERIK?.....	241
Ç' MË NDODHI NË BJESHKË TË KRISTALEVE ...	247
DHE NË MAJËN E LYBETENIT	247
SI LUFTOVA KUNDËR TË KEQES DHE SI ERDHËN SHENJTËRIT NË NDIHMË.....	252
SI HYRI LETAFETJA NË NJË DIMENZION KOSMIK KU KIShte MUNDËSI TË NDËRRONTE ÇKA TË DONTË NË MATERIE N FIZIKE	255
Ç' PËRJETOVA ME DIELLIN.....	260
SI, ME VETËDIJE, E NDRYSHOVA ËNDRRËN, E CILA, MË VONË, MË NDODHI NË REALITETIN FIZIK	264
SI HYRA NË NJË TUNEL DRITE TË KALTËR DHE DOLA NË NJË DIMENZION KU IShte ÇDO GJË E MUNDSHME	267
SI I SHËRUAM HELMET UNË E SAMIU DHE SI E ZBULUAM SE ATO ISHIN PASTËR MAGJI E ZEZË	270
SI KRIJOHET REALITETI OBJEKTIV NË JETËN TONË NËPËRMJET SUGJESTIONIT	273
SI I BËRA DISA SHËRIME INTERESANTE ME HIPNOZË.....	276
M A J A	287
(ILUZIONI, MOSDIJA, HIJA E ZOTIT)	287
FJALOR I FJALËVE TË PANJOHURA.....	296

BIBLIOGRAFIA.....	309
--------------------------	------------

GJENDEN NË SHITJE LIBRAT E PARË NË GJUHËN SHQIPE MBI FENOMENET BUZË SHKENCËS TË AUTORIT SABIR KRASNIQI


HIPNOZA **Shkencë apo fiksion**

Në këtë libër, ndër të tjera, mund të lexoni:

- a është hipnoza degë shkencore apo vetëm një fiksion?
- A mund të hipnotizohet dhe të hipnotizoj secili individ?
- A është hipnoza metoda më efikase për shërimin e shumë sëmundjeve trupore e shpirtërore?
- A e përdori UDB-ja hipnozën tek të burgosurit politikë shqiptarë?
- A mund të bëhet me ndihmën e hipnozës modifikimi i sjelljeve, kontrolli i trurit ?

Si dhe shumë tema të tjera interesante, përgjigjet e të cilave mund t'i gjeni në brendin e këtij libri.

Libri ka 224 faqe, kopertina me ngjyra, është i ilustruar me fotografi dhe kushton 15 €



PARAPSIKOLOGJIA

Shkencë që troket në dyert e të sotmes


Në këtë libër mund të lexoni:

- për trurin, inteligjencën;
- për parapsikologjinë, respektivisht zhvillimin e saj të hovshëm në kohën tonë;
- për gjumin dhe ëndrrat;
- për magjin e zezë dhe të bardhë;
- për hajmalitë dhe talismanët;
- për hermetizmin dhe raportet e tij me njeriun bashkëkohorë;
- për bioenergjinë, telekinezën, telepatinë, forcën e mendimit;

si dhe shumë gjëra të tjera interesante.

Libri ka 136 faqe, mbi 60 fotografi, kopertina me ngjyra dhe kushton 10 €

Porosia e librave mund të bëhet përmes E-mail-it:
sakra@sunrise.ch



Salih Basha

**HIPNOZË
PËRVOJA TË NDRYSHME &
SHEMBUJ PRAKTIKË**

Përgatitja kompjuterike
Sabir KRASNIQI

Tirazhi 1000 copë

Shtypi: